



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 20 DHE 23. 01. 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 20. i 23. 01. 2012. GODINE**

**JANAR – JANUAR
2012**

E premte – e hënë , më 20 dhe 23. 1. 2012

Drejton seancën kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e sesionit pranveror të mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në mbledhje janë të pranishëm 95 deputetë, andaj fillojmë me punimet e mbledhjes plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Amendamenti i rendit të ditës

Përcaktimi i rendit të ditës, neni 42. Kryesia, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare e përcakton rendin e ditës për mbledhjen e radhës së Kuvendit. Rendi i ditës u dërgohet deputetëve.

Rendi i ditës konsiderohet i miratuar, përveç se kur në fillim të mbledhjes një ose më shumë grupe parlamentare, përfaqësuesin të një ose më shumë komisioneve, së paku 6 deputetë, ia propozojnë me shkrim kryetarit një amendament për rendin e ditës, përkatësisht nëse një deputet e ngrit një çështje të ngutshme dhe kjo e merr miratimin e shumicës.

Shqyrtimi i çështjeve urgjente

Neni 49 i Rregullores.

Një, në secilën mbledhje plenare, deputeti duke njoftuar paraprakisht kryetarin e Kuvendit, mund t'i propozojë që Kuvendit ta shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente e cila duhet të jetë në përputhje me përkufizimin e shtojcës së parë të shprehjeve të Rregullores.

Kryetari i Kuvendi ia mundëson deputetit të propozojë në Kuvend propozimin e tij, vihet në votim. Nëse Kuvendi me votim vendos ta marrë çështjen parasysh çështja radhitet në rendin e ditës së mbledhjes.

Propozimet e grupeve parlamentare për shqyrtim të çështjeve urgjente vendosen me votim në Kuvend.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, pas së cilës mund të vijnë mocionet e grupeve parlamentare.

1. Koha për diskutim jashtë rendit të ditës

Koha për diskutim jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupeve parlamentare zgjatën deri në 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarojnë se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka fjalën nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Kolegë deputetë të nderuar,

LDK-ja është e shqetësuar për zhvillimet politike të javës së fundit, që kanë marrë trajtën e retorikës dhe të veprimit konfliktual. Retorika dhe veprimi konfliktual politik sot, institucional apo jo institucional, sjell dëme të mëdha për zhvillimet e brendshme e të jashtme të Kosovës.

Çështje njeje u bë mocioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës për reciprocitet politik dhe ekonomik me Serbinë dhe interpretimi i tij nga ana e Qeverisë duke shtruar raportin ndërmjet institucioneve të Kosovës, Kuvendit dhe Qeverisë, duke marrë interpretime të veçanta kushtetuese.

Kuvendi tha që vendimet e tij janë të obligueshme për Qeverinë, madje dhe kryetari i Kuvendit, kurse Qeveria bëri interpretim në tri shkallë. Herën e parë dokumentet e Kuvendit e quajti këshillues, herën e dytë e quajti një theksim i detyrimit të Qeverisë që është duke u bërë, kurse pas shpërthimeve të dhunës, çështja u la e hapur për t'u biseduar në institucione.

Lidhja Demokratike e Kosovës, kërkon fuqishëm funksionimin demokratik të institucioneve të Kosovës, kryerjen e detyrave të tyre në bazë të Kushtetutës, zgjidhjen e çështjeve politike në interes të Kosovës duke përjashtuar çfarëdo dhune.

Në këtë kuptim, LDK kërkon që Qeveria t'i zbatojë vendimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Si votuese e mocionit, LDK përjashton çfarëdo metode të dhunshme të zbatimit të tij, qoftë nga ana e subjekteve politike, qoftë nga ana e Qeverisë.

Marrëveshja është gjithmonë zgjidhja më e mirë politike e brendshme për interesat e Kosovës dhe të popullit të saj.

Jemi në një situatë shumë delikate të raporteve në Kosovë me botën ndërkombëtare, kështu që marrëveshjet e brendshme politike demokratike dhe funksioni demokratik i institucioneve, mund ta ruajë fuqinë dhe kredibilitetin e vendit përball nevojave dhe detyrimeve ndërkombëtare të tij.

Ky është stabilitet që i duhet Kosovës, çfarëdo ideje që mund të ketë stabilitet duke ushtruar dhunën dhe detyrimin, është ide e papranueshme dhe e rrezikshme për Kosovën, sot.

Asfare reciprociteti nuk mund të mbajë Kosova nëse nuk ndërton raporte të sakta, pa ekuivoke ndërmjet institucioneve përfaqësuese dhe ekzekutive. Këtu duhet një mirëkuptim. Deri më tani mosmarrëveshja mbështetet në mënyra të interpretimit. Tjetër çka kupton Kuvendi me reciprocitet, tjetër çka kupton Qeveria.

Duket që problemi rri diku tjetër, në obligimet që po merr Qeveria në dialogun me Serbinë, të cilat obligime nuk janë bërë transparente, të plota as për Kuvendit as për qytetarët e vendit.

Prandaj, ritheksojmë se as dialogu, as përfundimet e tij që prekin interesa fundamentale të shtetit të Kosovës, nuk mund të realizohen pa u ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, madje jo vetëm me votën e shumicës aktuale. Për vendime të mëdha që obligojnë vendin dhe popullin duhet të sigurohet konsensusi politik që shkon përtej një shumice qeverisëse.

Mendojmë për ndodhitë e pritshme të Kosovës në javët dhe muajt që vijnë në raport me bashkësinë ndërkombëtare dhe në raport me dialogun e propozuar dhe të detyruar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ky dialog duhet të ridimensionohet dhe të studiohet në një këshillim të gjerë të partive parlamentare në mënyrë që t'i sigurojë interesat e Kosovës dhe assesit të mos rrëshqas në dobi të tjerëve, madje duke mos pasur garanca që marrëveshjet do të zbatohen dhe që Kosova t'i ketë dobitë e veta në udhën e integriteteve evropiane.

Problemi madhor i Kosovës sot është shtrirja e sovranitetit të institucioneve në gjithë territorin e saj dhe në këtë pikë duhet të studiohen e të merren veprime në koordinim me mbështetësit e Kosovës.

Mospajtimi ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe përbërësve të këtyre institucioneve që merr trajtën e retorikës së ashpër apo të veprimit të dhunshëm, qoftë si ideologji politike, kjo qoftë si program social, vetëm mund të largojë Kosovën nga interesat e veta e të popullit të saj.

Në anën tjetër, aktorët, institucionet apo entitetet politike që me ndeshjet e tyre kujtojnë se do të marrin pëlqim publik apo ndonjë votë të shtuar, e kanë gabim. Poenët e tyre eventual do të jenë në fakt humbje për Kosovën.

LDK si parti institucionale që në krye të herës dhe tash edhe nga pozita e partisë më të madhe opozitare, kërkon që çështjet e mëdha të vendit të zgjidhen në bashkëpunim kushtetues institucional dhe në këtë udhë e ka detyrim programor dhe parimor që të japë gjithë ndihmesën e vet politike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Ne kemi të lajmëruar për fjalë, po paraprakisht ua kisha dhënë fjalën atyre deputetëve që janë paraqitur në emër të grupeve parlamentare.

Nga Partia Demokratike, nuk është paraqitur asnjë në emër të grupit parlamentar.
Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Deputetë të nderuar,

Edhe ne jemi shumë të shqetësuar për gjendjen e krijuar së fundi në Kosovë dhe për dhunën qeveritare të ushtruar ndaj qytetarëve të Kosovës, madje, sidomos ne jemi të shqetësuar për dhunën qeveritare ndaj qytetarëve të Kosovës, të ushtruar më 14 janar të këtij viti.

Më 14 janar kur qytetarët e Kosovës po demonstرونin paqësisht në mbrojtje të Republikës dhe në mbrojtje të vendimit të Kuvendit të Kosovës, Qeveria reagoi egërsisht kundër interesave të Republikës së Kosovës dhe kundër demonstruesve paqësor, duke u rreshtuar kështu hapur në mbrojtje të interesave ekonomike, tregtare, politike dhe strategjike të Serbisë në Kosovë.

Konfirmojmë edhe një herë se protesta e organizuar nga Lëvizja “Vetëvendosje” ishte tërësisht paqësore dhe e padhunshme, ashtu siç edhe ishte qëllimi i saj dhe ashtu siç edhe ishte e paralajmëruar më parë. Prandaj, urdhri për ndërhyrjen ndaj demonstruesve ishte tërësisht i panevojshëm, jo profesional dhe njëkohësisht tepër i dhunshëm. Në asnjë hallkë të rrjedhës së protestës nuk ishte e nevojshme ndërhyrja e policisë ndaj protestuesve e me gjithat policisë iu dha urdhër për ndërhyrje pikërisht kur protestuesit marshonin shumë të qetë drejtë destinacionit të tyre.

Pikërisht niveli i mirë i organizimit paqësor ua prishte skenarët qeveritarëve, të cilët e përcjellën protestën nga zyrat e tyre të cilat i kishin kthyer tashmë në laboratorë skenarësh dhune

Me urdhër politik, me skenarë tërësisht konspirativ, duke përdorur mekanizma jo formal, Qeveria keqpërdori Policinë e Kosovës kundër qytetarëve të saj, të cilët po kërkonin mbrojtjen e vendimit të Kuvendit dhe interesave të Republikës së Kosovës.

Përveç dhunës fizike edhe mjetet e përdora nga ana e policisë ishin të rrezikshme, me një rrezikshmëri të lartë si mjete toksike më afate të skaduar, gaz dhe sprej e po ashtu edhe ujë i ftohtë në temperatura nën zero, gjë që e bën ndërhyrjen e policisë të mos ishte thjesht përdorim i forcës, por një torturë e tmerrshme për demonstruesit.

Policia e Kosovës si institucion me një kredibilitet të lartë në shoqëri u keqpërdor nga kryeministri dhe ministri i Brendshëm, duke dëmtuar rëndë autoritetin e këtij institucioni kredibil para qytetarëve. Prandaj, le ta mbrojnë këtë institucion duke mos lejuar që Policia e Kosovës të kthehet në shërbim të pushtetit, por në mbrojtje të qytetarit dhe të shtetit, polica është e shtetit, jo e pushtetit.

Pra, Qeveria e Kosovës duke shkelur mbi qytetarët e saj, shkeli mbi vendimin e Kuvendit të Kosovës, shtypi me dhunë zërin e qytetarit, mbylli me dhunë kufirin me Shqipërinë, hapi me dhunë kufirin me Serbinë, ndaloi me kordonë policia autobusët nga

Shqipëria dhe futi me forca policie kamionët nga Serbia, duke zbatuar kështu produktet e marrëveshjet e fshehta me Serbinë.

Këmbëngulja e Qeverisë për prezencën e Serbisë në Kosovë, në rrafshin ekonomik, politik, strategjik, do ta ketë kurdoherë kundërshtimin e fuqishëm të qytetarëve të Kosovës.

Keqpërdorja e Policisë dhe e Parlamentit, pavarësisht numrave aktual nga ana e Qeverisë, do të jetë gjithmonë e papranueshme.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, kryetari i Grupit Parlamentar, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës mendon se kjo që po shohim ditët e fundit, është pasojë e dy elementeve në shoqërinë kosovare. Elementi i parë është degradimi i jetës në Kosovë, i cili po ndodh që një kohë të gjatë, humbja e shpresës së qytetarëve të Kosovës se jeta e atyre mund të bëhet më mirë, korrupsioni i cili i ka tejkaluar edhe normat ballkanike: varfëria, papunësia, arsimi i nivelit më të ulët që ka parë ndonjëherë ky vend, të gjitha këto kanë akumuluar një pezëm, e kanë akumuluar një ndjenjë të pasigurisë, një ndjenjë të pakënaqësisë të qytetarëve të Kosovës, në mes të cilëve edhe ata më pesimistët nuk kanë pritur që 4 vjet pas pavarësisë së Kosovës, Qeveria vetë mund t' i sjellë në këtë ditë.

Kjo gjendje në Kosovë, kjo gjendje e varfërisë, e territ, e pasigurisë ose e pamundësisë për të parë përpara e ka ndërtuar njërin ekstrem, e ka ndërtuar Qeverinë e cila tanimë ka kaluar në çfarëdo aspekti të përgjegjësisë ndaj popullit të vet dhe ndaj të ardhmes së vendit dhe gjithmonë një ekstrem prodhon ekstreme tjera dhe këto ekstreme prodhojnë situata antidemokratike në Kosovë.

Në ditët e fundit, qytetarët e Kosovës dëgjojnë lajme për bllokada, dëgjojnë lajme për terr prapë, dëgjojnë lajme për rritje të tatimit në pronë, qytetarët e Prishtinës, qytetarët e Kosovës, të cilët e kanë trashëguar pronën e vet e të cilët jetojnë në atë pronë, me 200 ose 300 euro në muaj e shohin se do t' u dyfishohet tatimi. Ata dëgjojnë se do t' u rritet edhe çmimi i rrymës të cilin mezi e paguajnë prapëseprapë dhe të njëjtën kohë ne përballemi me dy ekstreme.

Njëri ekstrem është vendi ku policia fillon t' i rrahë deputetët e po ju them aty ku policia i rrah deputetët, demokracia vdes nëse nuk ka njerëz të cilët e mbrojnë.

Dhe ekstremi tjetër është një parti politike e cila beson se duke e marrë vetë ligjin në dorë e duke provuar vetë t' i implementojë të gjitha ato që mendon se duhet implementuar provon ta rregullojë vendin, këtë të dytën njerëzimi e ka parë diku për një 90 vjet. Njerëzimi për një 90 vjet e ka parë se çka sjell nëse vetëm një forcë politike e vetme provon me vu ligj, provon të bëjë rend.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e thërret Kuvendin e Kosovës, popullin e Kosovës, të gjitha forcat politike në Kosovë, që të fillojnë ta sjellin Kosovën në normalitet, që të ikin prej ekstremeve, qoftë të majta, qoftë të djathta, qoftë ekstremeve të cilat po mendojnë se në Kosovë i ka ardhur fundi patriotizmit dhe s'ka nevojë për patriotizëm, qoftë në ato ekstreme që mendojnë se edhe rryma, edhe buka edhe uji, duhen të lidhen drejtpërdrejt vetëm me patriotizëm arkaik.

Ne ju thërrasim që të kemi kujdes për shkak se populli i Kosovës është varfëruar skajshëm, populli i Kosovës nuk po sheh shpresë dhe shpresën nuk mund t'ia sjellim as me këtë Qeveri, po as me ide revolucionare të cilat synojnë që ta rregullojnë vendin me lëvizje të cilat po them edhe një herë bota i ka provuar që një kohë të gjatë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU- KODRA: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që fillimisht të përshëndes edhe fillimin e dialogut për liberalizim të vizave, duke vlerësuar kështu se 19 janari paraqet një hap tejet të rëndësishëm për shtetin dhe qytetarin e Kosovës.

Ky moment historik pa dyshim se paraqet një dimension tejet të rëndësishëm në skenën tonë politike dhe shoqërore.

Dialogu është një veprim për të cilin janë angazhuar i gjithë spektri politik dhe shoqëror, duke filluar nga Qeveria, Kuvendi, shoqëria civile, andaj jam e bindur që të përmbushen të gjitha këto kriterë për liberalizim të vizave, nevojitet një angazhim edhe më i shtuar nga të gjithë ne.

Synimi, por edhe vizioni ynë, nuk duhet të ndalet apo të përfundojë me liberalizimin e vizave, por me krijimin dhe zhvillimin e Republikës së Kosovës në një vend evropian, vlera dhe parime mbi të cilat është ndërtuar edhe Bashkimi Evropian. Pra, respektimi i pa kompromis i parimeve evropiane është duke e ndërtuar dhe zhvilluar Kosovën, në një shtet modern, demokratik dhe evropian. Këto qëllime e synime dhe vlera kanë filluar që të shndërrohen në pjesë përbërëse të shtet ndërtimit të Republikës së Kosovës.

Përfundimisht i ftoj të gjithë që t'i lënë anash ngjyrimet politike, etnike, racore, fetare dhe gjinore dhe të kontribuojmë së bashku në krijimin e një Kosove evropiane.

Po ashtu do të përshëndes edhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të hequr tatimin mbi vlerën e shtuar për mediat në Kosovë.

Me këtë rast konsideroj se do të krijohen kushte për media të lira, por edhe një ambient i përshtatshëm për punë më efikase.

Heqja e kësaj takse nënkupton lirim nga tatimi mbi vlerën e shtuar në të gjitha shitjet dhe blerjet që bëjnë mediat, duke ndikuar kështu që për këto shërbime të paguhet 16% më pak.

Në kohën kur mediat po përballen me vështirësi financiare, lrimi nga tatimi mbi vlerën e shtuar, do të jetë një lehtësim jashtëzakonisht i madh për tregun medial në Kosovë, i cili edhe ashtu është relativisht i vogël. Kjo reformë fiskale do të krijojë edhe kushte më të mira për zhvillimin e biznesit në Kosovë dhe uljen e kostos së shërbimeve.

Ky vendim po ashtu do të ndikojë drejtpërdrejt në ngritjen e lirisë së medias, pasi që 16% e buxhetit të paraparë për blerje të elementeve të nevojshme për punë, do të mund të shfrytëzohet për nevojat zhvillimore. Kjo po ashtu do të ndikojë edhe në përshejtimin e procesit të digjitalizimit, i cili konsiderohet si proces i ndërlikuar, por edhe me kosto mjaftë të lartë.

Përveç kësaj heqja e tatimit mbi vlerën e shtuar, do të bëhet edhe për të gjitha universitetet private dhe shërbimet spitale të kujdesit mjekësor.

Të nderuar kolegë deputetë,

Vendimi i kryeministrit Thaçi për lirim nga kjo barrë tatimore, tregon edhe një herë për përkushtimin e Qeverisë së Kosovës, për të ecur përpara drejt proceseve integruese, por edhe për ta quar vendin përpara.

Në fund inkurajoj mediat në Kosovë, që të vazhdojnë të bëjnë punën e tyre në informimin e drejtë dhe të saktë të opinionit të gjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: I nderuar kryetar,

Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë i kam dy çështje për t'i ngritur, së pari edhe LDK-ja përshëndet lirim nga mediave dhe universiteteve private nga TVSH-ja, por mediat nuk kanë vetëm probleme financiare, mediat kanë edhe një problem tjetër, kanë kufizimin e lirisë së shprehjes, kështu që Qeveria duhet të mendojë edhe në eliminimin e ndërhyrjes që bën në media.

Duke mos dashur aspak të vë hije në ngjarjet e fundit të fillimit të këtij viti unë sot ngris edhe një çështje tjetër, atë të energjisë elektrike.

Gjatë gjithë vitit të kaluar në këtë Kuvend shpesh kemi ngritur çështjen e KEK-ut, energjisë elektrike për shkelje të drejtave njerëzore nga ana e KEK-ut duke ndarë konsumatorët në kategori për furnizim me energji. Kemi diskutuar për energjinë edhe në kontekstin e mos përmbushjes së premtimit nga ana e kryeministrit, për rrymë 24

orë, që nga 2007, kjo mbeti vetëm premtim edhe pse kryeqyteti qëndron mirë me furnizim, nëpër komuna tjera, sidomos në zonat rurale reduktimet e rrymës janë përditshmëri.

Por, në këto ditë të ftohta janari ku temperaturat po arrijnë deri në minus 10, një çështje tjetër po diskutohet, po diskutohet me të madhe për shtrenjtimin e çmimit të energjisë elektrike.

Korporata Energjetike e Kosovës i ka bërë kërkesë Rregullatorit të Energjisë për lejimin e shtrenjtimit të energjisë elektrike. Zyra e Rregullatorit të Energjisë edhe pse organ i pavarur, po përballet me presion nga ana e Qeverisë, për lejimin e këtij shtrenjtimi. Kjo është cekur edhe në letrën e kryeministrit dërguar Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Ngritja e çmimit të energjisë elektrike është gjë e keqe që mund t'u ndodhë qytetarëve të Kosovës, duke marrë parasysh që kemi rreth 45% të popullsisë të papunë, një 15% në varfëri ekstreme dhe rreth 35% të bashkëqytetarëve tanë që kanë më pak se një euro për shpenzime ditore.

Një vit të tërë që kaluam, sa herë që opozita i bëri pyetje Qeverisë, ne kishim vetëm një përgjigje, atë të ngritjes së pagave, kthimit të dinjitetit të kategorive që përfituan nga kjo ngritje.

Kish me qenë shumë e drejtë që Qeveria të dalë sot në foltore dhe t'u shpjegojë qytetarëve se po kërkon ngritjen e çmimit të energjisë elektrike, sepse Qeveria duhet të përmbushë numrat fiktiv që ka vënë në buxhetin e vitit 2012. Kështu, për të plotësuar nja 30 milionë në buxhet, Qeveria ka kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve, që ta rrisë taksën e KEK-ut për shfrytëzimin e thëngjillit, nga 26 centë në 3 euro. Mirëpo, KEK-u nuk ka se ku t'i marrë këto të holla, kështu që i ka bërë kërkesë Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike, që të ngritët çmimi i energjisë për t'i nxjerrë këto 30 milionë euro për të paguar shfrytëzimin e thëngjillit. Për çdo gjë në fund po paguajnë qytetarët e Kosovës dhe kjo nuk është e drejtë.

LDK-ja është kundër ngritjes së çmimit....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot do të ngris për diskutim një çështje, që po ashtu ka të bëjë me protestën e 14 janarit dhe që është njëra nga çështjet më të dhimbshme që patëm rastin ta përjetojmë. Këtu e kam fjalën, që atë ditë Qeveria e Kosovës, përpos dhunës represive që ndërmori mbi protestuesit, ajo përdhosi edhe vlerat historike dhe kombëtare.

Pra e kam fjalën për arrestimin dhe dhunimin e deputetit të Kuvendit të Kosovës, kolegut tonë Afrim Hoti. Edhe po të mos ishte përfaqësues i institucionit më të rëndësishëm politik në vend, deputeti Hoti është përfaqësues i vetëm i një institucioni më të rëndësishëm moral dhe historik të kësaj shoqërie, ai është vëllai dhe familjari i njërit prej dijetarëve më të spikatur të filozofisë politike kombëtare, i simbolit të sakrificës nacionale dhe historike, intelektualit të dalluar, Ukshin Hoti.

Është po ashtu vëllai i dëshmorit të kombit, Ragip Hoti, është djali i plakut të rënë në luftë, Nazifit dhe i shumë e shumë anëtarëve tjerë të kësaj familje, që dhanë jetën për lirinë e Kosovës., paramendojeni pra, arrestohet një anëtar i kësaj familje.

Kurse ajo që është më skandaloze është fakti se asistenti i Grupit tonë parlamentar, po ashtu i arrestuar atë ditë, pasi u tregon dhunuesve se ky person që ju po e arrestoni është deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe po ashtu që është më kryesore, është vëllai i Ukshin Hotit, policia përsëri e goditi me grushte në bark, duke i thënë: “A, ti qenke vëlla i Ukshinit?”. Pra, në rrethana normale, policët pasi të ishin informuar se kanë arrestuar njërin nga pjesëtarët e familjes, që është ikonë e sakrificës kombëtare, ata do të duhej ta kishin shoqëruar deri në shtëpi, se mos po rrezikohet jeta e të vetmit anëtar të mbetur gjallë të vëllezërve të mëdhenj të familjes Hoti. E paturpësia e arriti kulmin, kur askush nga strukturat qeveritare nuk i kërkoi falje dhe nuk u pendua për këtë akt ndaj anëtarit të kësaj familje, që dha gjithçka, madje, duke mos kursyer as jetën për lirinë e Kosovës.

Megjithatë, ky qëndrim shpërfillës tregon se tashmë kjo strukturë atë ditë nuk e kishte mendjen te vlerat kombëtare, por te negociatat e drejta e të padrejta me Serbinë. Është ky shtet, që padrejtësisht tash e sa kohë zvarrit çështjen e trupave të vrarë e të pagjetur, duke e shndërruar atë thjesht vetëm në një çështje teknike, trupa këta, në mesin e të cilëve gjendet edhe vëllai i personit në fjalë. E kjo Qeveri edhe përkundër këtij fakti, ka bërë fjalë për realizimin e këtij dialogu dhe arritjen, gjoja të një pajtimi historik ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Por, a duhet ta dijë se këtë pajtim dhe këtë falje, mund ta bëjë vetëm në emrin e saj personal, por jo këtë pajtim ta kërkojë dhe të falë edhe në emrin e vuajtjes së viktimave, që nuk janë më. Dhe aq për më tepër, ajo nuk ka të drejtë të dhunojë padrejtësisht edhe njëherë këtë familje, siç është rasti i Afrim Hotit.

Kjo nuk është Kosova për të cilën u sakrifiku me vetëdije të plotë, për liri intelektual, Ukshin Hoti.

KRYETARI: Afrim, pa emocione. Edhe arsyetimet nuk i ke të qëlluara.

Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër,
Qeveritarë të nderuar,
Kolegë deputetë,

Meqenëse në këtë pjesë, na jepet rasti t'i shtrojmë disa çështje që nuk mund të shtrohen, disa çështje, tema që u ngritën këtu, ose çështje, ne do të kemi mundësi pak më vonë, në një mocion që do të ngritët këtu, t'i flasim dhe t'i sqarojmë edhe disa opinione tona.

Megjithatë, unë po shfrytëzoj rastin të kthehem edhe një herë te procesi i liberalizimit të vizave, është një prej ngjarjeve që nuk mund të anashkalohet, një ngjarje shumë e rëndësishme por proceset ne vendin tonë. Meqenëse, unë kam qenë njëri prej atyre që kam punuar në një dokument, i pari në Kosovë, në një udhërrëfyes, i cili ka qenë i miratuar njëanshëm prej Qeverisë, dëshiroj të shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë ata që kanë punuar në këtë dokument dhe në realizimin e obligimeve, që kanë dalë nga ky dokument dhe po ashtu t'i inkurajoj të gjithë ata, që tanimë, kur zyrtarisht po fillon ky proces, të angazhohen edhe më shumë në zbatimin e kriterëve, që dalin nga dokumenti, që veç do të vijë zyrtarisht së shpejti.

Dhe po ashtu, dëshiroj të ngris edhe një çështje, që mendoj që është me rëndësi, ka të bëjë me mbetjet e luftës, mbetjet eksplozive. Para disa ditësh kemi pas rastin e plagosjes së rëndë të dy fëmijëve, mendoj që është një rast kyç nga institucionet tona, ndoshta, Ministria e Mbrojtjes edhe e Forcës së Sigurisë edhe me aktivitetet tjera, që kanë të bëjnë edhe me organizatat ndërkombëtare, të ndikojnë te pushteti i Beogradit, që të gjithë ata oficerë, policorë e ushtarakë, të cilët kanë qenë në luftën ose kanë marrë pjesë në luftën e fundit në Kosovë, të identifikojnë fushat e minave dhe objektet tjera, të cilat ata i kanë lënë, në mënyrë që më tutje të mos kemi viktime në Kosovë, nga këto mjete eksplozive të luftës së fundit në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Kanë kaluar më shumë se dy javë, që kur Istogu, Peja dhe Klina, pjesërisht, por me theks të veçantë Istogu, i cili mbi 95% të shtëpive familjare sot, kanë mbetur pa kullm, për shkak të erërave të forta dhe do të thotë, stuhive të cilat janë shkaktuar atje diku ndërmjet datës 7 dhe 8 janar, ka pësuar një katastrofë natyrale.

Prej asaj dite, do të thotë, janë më shumë se dy javë dhe kjo Qeveri, përveç një takimi shumë të vonshëm, edhe pse ka qenë një situatë emergjente dhe unë nuk e di çfarë Qeverie në botë pret pesë ditë, në një situatë emergjente, kur qytetarët e saj ballafaqohen me temperatura të ulëta, me borë, me shi, me erë, janë jashtë dhe këta presin 4 – 5 ditë veç me u taku. Pas takimit, vendimi që është marrë, ka qenë i papranueshëm, ka qenë një fyerje, vendimi ka qenë, po i ndajmë 400 mijë euro për tri komunat.

Kjo ka qenë komplet në disproporcion me humbjet tepër të mëdha, të cilat me theks të veçantë i kanë banorët e Istogut. Këtë nuk po e them pse jam banore e Istogut, po pse të gjithë ata njerëz që kanë shkuar atë ditë e kanë parë që është përsëritur në fakt pamja e 99-ës dhe fillimi i 2000-ës, kur krejt shtëpitë kanë qenë të shkatërruara, po, po,

kryeministër, krejt kulmet atë ditë kanë qenë në tokë. Dhe ju, ose ndonjë anëtar i Qeverisë, të paktën, s'e ka marrë mundin të shkojë për të parë çka po ndodhë, ekziston, mbas dy javësh keni shkuar.

Ekziston Komisioni i Emergjencave, i cili as nuk është prononcuar në këtë drejtim. Edhe sot, është java e tretë, po vazhdojnë të jenë temperaturat shumë të ulëta dhe ju po vazhdoni këtu të rrini, të bëni politikë e për të keqpërdorur për marketing politik gjithçka, që po ndodh në Kosovë, ndërkaq nuk e keni marrë një vendim, që lidhet me komunat e Dukagjinit.

Unë ju ftoj këtu sot, përkundër shqetësimeve që i kanë ata njerëz, sepse mosinteresi për qytetarin nga ana juaj si kryeministër i këtij vendi dhe si Qeveri, ka mbërri kulmin dhe pasojat po shihen, janë parë edhe më 14 janar në rrugë.

Po ju ftoj, që të dilni nga ky mentalitet i krahinizmave, të mos interesoheni vetëm për ata ku i keni bastionet, sepse edhe qytetarët e Istogut edhe të Pejës edhe të komunave tjera, janë tatimpagues të këtij vendi dhe kanë të drejtë dhe qasje në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Dhe, urgjent ju ftoj këtu, që të ndërmerri një vendim, i cili do t'iu ndihmojë këtyre njerëzve që t'iu sanojnë problemet e ndërtimit të shtëpive, bëhet fjalë për mbijetesë. Këta njerëz sot edhe më tutje, vazhdojnë që me forca të veta të provojnë t'iu rindërtojnë shtëpitë dhe kulmet e shtëpive të tyre e kjo është me prioritet. Edhe një herë po e them, sepse sikur të bëhej ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Me këtë diskutim, harxhohet koha e deklarimeve jashtë rendit të ditës, për deputetët.

Tani e ka fjalën kryeministri Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht, dëshiroj t'ju përgëzoj të gjithëve për kontributin tuaj për të arriturën historike të Republikës së Kosovës, për hapjen e dialogut për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Pra, dje ishte një ditë e mirë, e gëzimit dhe e bekuar për qytetarët e Republikës së Kosovës, që filluam së realizuari ëndrrën shekullore për perspektivë të sigurt evropiane. Për të ardhur te ky proces, natyrisht se është kërkuar kohë, është kërkuar mund, prandaj falënderoj të gjithë kontribuuesit e këtij procesi, spektrin, të gjithë do të thotë spektrin politik kosovar, të gjitha autoritetet që kanë punuar, shoqërinë civile, kryetarët e komunave, autoritetet komunale. Tani do të punojmë bashkërisht në komisione të përbashkëta, institucionet e Kosovës, Qeveria e Kosovës, së bashku me autoritetet evropiane për implementimin e kritereve të nevojshme dhe të domosdoshme. Disa kritere veç i kemi implementuar në mënyrë të njëanshme suksesshëm, prandaj edhe

kemi hapjen e dialogut. Ajo që është shumë me rëndësi, është se Kosova do të trajtohet, siç u deklarua edhe dje nga komisionerja Mollstrom, se do të trajtohet në mënyrë të barabartë, si të gjitha vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Prandaj, edhe sa i përket zhvillimeve të fondit, unë dua t'ju bëj ftesë që të zhvillojmë debatin në Kuvend, që të punojmë bashkërisht, që secili t'i shikojmë interesat e shtetit mbi ato partiake, mbi ato grupe dhe të sillemi në mënyrë evropiane, në mënyrë që të lëvizim drejt perspektivës së sigurt evropiane dhe në asnjë rrethanë me ndonjë sjellje të pahijshme ta vonojmë, ta shtyjmë apo ta fusim në qorrsokak perspektivën evropiane të Kosovës.

Sa më tepër stabilitet, sa më tepër bashkëpunim, sa më tepër punë të përbashkët, sa më tepër vlera evropiane, sa më tepër t'i implementojmë kriteret e domosdoshme për këtë proces, ne do të jemi shumë afër edhe liberalizimit të plotë të vizave.

Pra, sa më tepër, ne si në mënyrë evropiane, po aq më afër do të jemi edhe zyrtarisht në Evropë. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se vetëm bashkëpunimi, komunikimi, dialogu është ajo çka duan qytetarët, duke respektuar, gjithmonë Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Në anën tjetër, dëshiroj të theksoj se, vetëm komunikimi dhe integrimi është e ardhmja jonë dhe jo bllokadat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Fjalën e ka zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI, HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Me siguri që sot Kuvendi, po edhe ne do të kemi shanse që të japim mendimin tonë për atë që u thanë, për shumë gjëra edhe ne e kemi qëndrimin tonë. Besoj që do të përkojë me realitetin, por do të provoj që t'i përgjigjem zonjës Kadaj.

Zonja Kadaj, besoj që e dini edhe ju, por është mirë që ta dijë edhe opinionin publik, në natën e premte, në orën 12:56 minuta, unë kam folur me kryetarin e komunës, zotin Haki Rugova dhe kam ftuar FSK-n, po atë natë, gjeneral Zymer Halimin, që të shkojë, t'i dërgojë forcat e FSK-së atje. Pastaj, tërë natën kemi biseduar dhe kemi qenë në kontakt me kryetarin e komunës. Po ia përmend emrin, do të thotë, ai mund të reagojë ndryshe dhe kemi marrë të gjitha masat e mundura, për ta tejkaluar atë fatkeqësi.

Në anën tjetër, unë personalisht pa media, jo sikur ju, e kam vizituar, ndërsa, me media, zëvendëskryeministri Petroviq. Dhe, unë besoj që nuk ka pasur nevojë të bëjmë shumë reklamë. Qeveria e Kosovës ka marrë tri vendime për këtë.

E para, ka ndarë një ndihmë emergjente prej 400 mijë eurosh, për të sanuar dëmet e qytetarëve.

Vendimi i dytë është, që ministritë përkatëse do t'i rregullojnë objektet që u takojnë atyre, shkollat, spitalet, stacionet e policisë dhe kështu me radhë.

Dhe, vendimi i tretë, që është shumë me rëndësi, një komision i përbashkët, i Qeverisë së Kosovës dhe i komunave, do t'i vlerësojë dëmet dhe ne pastaj do ta bëjmë pagesën. Dhe, e kalojmë me miliona, që ne duhet ta bëmë në Kuvendin e Kosovës. Dhe, kështu shkon në botën demokratike. Dhe, krejt në fund po e them, na kurse prej dy gjërave, prej kualifikimeve personale dhe prej ngritjes së zërit. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputetja Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Nuk po di prej kur u bëtë kaq të kulturuar, para dy tri ditëve e kemi parë që keni urdhëruar të rrahën deputetët, e sot po ju vjen mërzi nëse ngritët zëri në foltore. Po e ngris zërin për qytetarët e vendit tim, të cilët nuk kanë nevojë për telefonata tuajat, por kanë nevojë për përkrahje institucionale. Ju keni thirrur takimin emergjent katër ditë pas ngjarjes. Kjo nuk ndodhë në botën demokratike.

KRYETARI: Replikë, zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, zoti Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI, HAJREDIN KUÇI: Unë besoj që Donika, janë disa takime që bëhen publike, e disa nuk bëhen. Unë nuk fola shumë duke menduar që në fazën hajt pak, nuk ka reagime, s'ka replika, përndryshe, ne bëjmë edhe replika. Faleminderit!

KRYETARI: Replika nuk ka në pjesën e deputetëve, por deklaratimet e Qeverisë, kanë edhe replika. Lexojeni Rregulloren.

Fjalën e ka ministri i Arsimit, Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Ato që desha t'i them, shumicën e tyre i tha zëvendëskryeministri, por po ju them një gjë, që të nesërmen herët në mëngjes kur ka ndodhur ajo që ka ndodhur, që thoni ju zonja deputete Kadaj, ministri i Arsimit ka qenë në terren në Istog dhe jo vetëm që ka vizituar, por menjëherë, po atë ditë, ka marrë vendim që të ndihmojë për atë që do të duhej të ndihmonte për ato shkolla, për të sanuar atë gjendje që ishte atje. Andaj kjo është krejtësisht e paqëndrueshme, që s'kemi qenë në terren, sepse në fakt kemi qenë me mëngjes herët të nesërmen e asaj dite dhe kemi ndërmarrë hapa konkret për t'u rinovuar ato shkolla me mjetet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Fjalën e ka ministri i Financave, zoti Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Dola për një çështje, e cila u ngrit këtu, çmimi i energjisë elektrike. Është çështje që është e rregulluar shumë mirë dhe shumë qartë, mirëpo nganjëherë disa për të bërë politikë, po krijojnë konfuzion, po krijojnë konfuzion vetëm te vetvetja.

Çmimi i energjisë elektrike, kërkesa bëhet nga KEK-u. I drejtohet Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike. Zyra e Rregullatorit të Energjisë është trup i cili i përgjigjet Kuvendit dhe është pjesë e Kuvendit. Dhe, sa i përket ndërhyrjeve, unë jam shumë i sigurt që njerëzit që janë në Rregullatorin e Energjisë, e bëjnë punën e vetë dhe nuk bien nën presion të asnjë ndërhyrjeje.

Kompetenca Qeveria, sa i përket çmimit të energjisë elektrike, nuk ka. Është rrugë tjetër, prandaj nuk është mirë për ta involvuar Qeverinë në çështje të caktuar, që nuk ka të bëjë.

Dhe, çështje tjetër, çmimi i energjisë elektrike nuk lidhet me buxhetin. Pjesë e tabelave të buxhetit, nuk është energjia elektrike. Të gjitha të hyrat, të cilat krijohen, i takojnë KEK-ut, ndërsa nuk vijnë në buxhetin e Kosovës, ndërsa KEK-u paguan, normalisht vetëm tatimet, që i ka si obligim.

Dhe, çështja tjetër, e cila u ngrit, që gjithashtu nuk është ashtu, është çështja e tatimit në pronë. Tatimi në pronë është e hyrë, e cila mbledhet nga komunat dhe u kthehet komunave. Prandaj, nuk ka ngritje të normës së tatimit në pronë për 100%, por është një propozim- ligj, i cili e krijon një normë, limitin e poshtëm të tatimit në pronë, ku ka një laramani te komunat, që nisen prej 0,07% dhe disa kanë 0,20%. Dhe, nëse themi që norma e ulët e tatimit në pronë është 0,15%, ndërsa, komunat me mesatare, shumica e kanë domethënë, këtë normë, disa ndoshta kanë mundësi me e ulë, disa ndoshta duhet me e ngritë pak. Prandaj, këto janë çështje që kanë pas nevojë për një sqarim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Replikë, deputetja Hikmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Ministër, po më duket s'më ke dëgjuar me vëmendje. Nuk thash që energjia është pjesë e tabelave të buxhetit, por janë taksat. Ju e keni rritur taksën për shfrytëzimin e thëngjillit prej 26 centë në 3 euro. Keni kërkuar, keni bërë presion te Komisioni për Miniera dhe Minerale. Ato shkojnë në buxhet. Unë e kuptoj shumë mirë kompetencat e Zyrës së Rregullatorit, kompetencat e Kuvendit e të gjitha ato. Ju po mundoheni të krijoni konfuzion e ndoshta ia arrini të krijoni te një pjesë e qytetarëve të Kosovës, por, jo tek unë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër e ke fjalën!

MINSITRI, BEDRI HAMZA: E nderuar deputete, ti prapë vazhdove të krijosh konfuzion, po s'krijohet konfuzioni kështu. Nuk ka ngritje të taniemave. Konfuzion njeriu mund të krijojë për vetveten, jo për tjerët, se tjerët i dinë gjërat, nuk ka ngritje të

tantiemave. Kosova ka nevojë t'i valorizojë pasuritë e veta, mirëpo, kjo që ju po e deklaroni, nuk qëndron. Do të thotë, nuk ka ngritje të tantiemave, por në të ardhmen, definitivisht, Kosova ka nevojë t'i valorizojë pasuritë e veta. Mos thoni gjëra të pavërteta, të lutem!

KRYETARI: Për replikë, më duket e ka kërkuar fjalën Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Iu referua fjalës sime te tatimi në pronë edhe duhet thënë që kjo qasje e Qeverisë, kjo mënyrë e komunikimit, kjo hedhje hi syve popullatës po i shkakton ato ekstreme, të cilat thashë dhe jo vetëm ekstremet politike, por edhe ekstremet tjera.

Ministri vetë tha se është një draftligj e unë po e pyes ministrin, mbasi po do të mos shkaktojë konfuzion, a ka dëgjuar ndonjëherë që komunat bëjnë draftligj. Kush e ka bërë draftligjin, zoti ministër? Ju e keni bërë. Ju e keni sjellë atë draftligj. Ju po doni ta rrisni tatimin në pronë dhe tash thua jo komunat e mbledhin. Ju po i mbyllni vrimat, të cilat i keni hapur vetë në buxhet, duke qitur qindra miliona jashtë Kosovës, duke ua rritur tatimin qytetarëve, duke rritur çmimin e rrymës. Ju e rritni, se këtu ka zënie të shtetit. Mos më flisni për KEK. Ju e dirigjoni krejt. Qeveria, ju e dirigjoni. Për t'i dënuar ata që paguajnë, për t'i mbuluar vrimat të cilat i keni shkaktuar vetë, po i rritni çmimet edhe të rrymës, po i rritni tatimet, po i rritni taksat, po e varfëroni popullin edhe më tepër edhe dilni këtu na thoni jo komunat i mbledhin, kur ligjin e keni bërë vetë.

KRYETARI: Urdhëro, ministër e ke fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar deputet, ligjin e sponzoroi Ministra e Financave. Para se me kalua ligji në Kabinetin qeveritar, ne kemi organizuar takim me të gjithë kryetarët e komunave. Të lutem referoju edhe raporteve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku rekomandimi i tyre është, që norma e tatimit në pronë, si një prej tatimeve më të qëndrueshme, më të drejta, që duhet ta menaxhojë komuna, është që të ngritet në 0,5%. Tue pas për bazë gjendjen e qytetarëve të Kosovës, ne jemi dakorduar që norma, apo limiti i poshtëm i tatimit në pronë të jetë 0,15%. Disa komuna, qysh sot e kanë 0,20%, prandaj, ne e sponzorojmë ligjin, por Kuvendi është ai që e miraton ligjin, nuk e miraton Qeveria. Ju e dini shumë mirë këtë dhe nuk ka ngritje të taksave dhe nuk ka ngritje të tatimeve. Prandaj, këtë drejtim ligji vjen në Kuvend, deputetët kanë mundësi me dhënë kontributin e tyre, por është një harmonizim dhe një pajtueshmëri e plotë, me të gjithë kryetarët e komunave, se para se me u procedu ligji në Qeveri, është diskutuar me kryetarët e komunave. Faleminderit

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Fjalën e ka kryeministri!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Vetëm sa për të sqaruar një çështje, që u ngrit këtu më herët. Në kuadër të vendimeve të fundit, që ka marrë Qeveria e Republikës së Kosovës, për krijimin e kushteve më të mira për funksionimin e mediave të lira në Kosovë, por dhe për rritjen e cilësisë në arsimin edhe privat, ka qenë një nga vendimet edhe për heqjen e TVSH-së për të gjitha mediumet e pavarura. Ka qenë edhe premtim elektoral në të njëjtën kohë edhe për universitetet private.

Dëshiroj të theksoj, se u ngrit edhe çështja tjetër, se nuk kanë mediumet vetëm këtë problem të TVSH-së apo jo TVSH-së, por ka qenë edhe bashkëbisedim me të gjitha mediumet, pa asnjë dallim. Prandaj, kemi pasur edhe përgjegjësi edhe elektorale edhe shtetërore dhe iu uroj dhe përgëzoj për suksesin që do ta kenë në të ardhmen në ruajtjen dhe kultivimin e mediumit të pavarur në Republikën e Kosovës, gjithashtu edhe për rritjen e cilësisë dhe krijimin e kushteve shumë më të mira për arsimin edhe në universitetet private. Por, në të njëjtën kohë, dëshiroj të potencoj se jemi dëshmitarë në dhjetëditëshin e fundit të presionit nga zyrtarë, opozitarë, ndaj mediumeve të pavarura. Kemi pasur në një të përditshme, që janë botuar edhe SMS-at, por në televizione, por edhe në një presion tjetër, i drejtpërdrejtë, gjithashtu nga një parti tjetër opozitare në drejtim të televizioneve të pavarura. Prandaj, ky presion politik e dëmton edhe perspektivën e liberalizimit, e procesit të liberalizimit të vizave dhe ju ftoj, që t'i shmangeni këtij presioni politik dhe kërcënimi politik ndaj mediumeve të pavarura.

(Ndërprerje e shkurtëri)

KRYETARI: ... Ndoshta është mirë, në ndërkohë ta bëjmë edhe ligjin dhe me ligj ta bëjmë këtë.

Urdhëro Sabri, e ke fjalën!

SABRI HAMITI: Nuk dua të komentoj asgjë, veçse të precizoj edhe se këtu e kemi edhe ministrin e Arsimit, e ai e di që universitete private në Kosovë nuk ka, ka kolegje universitare. Shpresojmë, që do të bëjmë edhe universitete. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Mendoj, që këto deklaratimet jashtë rendit të ditës u kryen. Vazhdojmë me rendin e ditës. Fjalën e ka kërkuar, deputeti, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Duke u mbështetur në Rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 49 pika 1 dhe 2 mbi shqyrtimin e çështjeve urgjente, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, kërkon që në këtë seancë plenare, të futet si pikë e veçantë e rendit të ditës, debati për zhvillimet e fundit në Kosovë.

Arsyetim. Zhvillimet e fundit në Kosovë, janë karakterizuar me situata të cilat i kanë dhënë imazh jo të mirë proceseve politike në vend, si në opinionin e brendshëm ashtu

edhe në atë ndërkombëtar. Ne si grup parlamentar jemi të përkushtuar, që çështjet me rëndësi për Kosovën dhe qytetarët e saj t'i trajtojmë brenda institucioneve të vendit, brenda përgjegjësive kushtetuese, për të cilat edhe jemi zotuar t'i mbrojmë. Kërkojmë nga i gjithë spektri politik, që të diskutojmë brenda institucioneve tona, për të gjitha çështjet që konsiderohen të rëndësishme, në mënyrë që të tregojmë maturinë dhe pjekurinë politike institucionale.

Debati ka për qëllim t'u shërbejmë proceseve politike dhe të ndihmojmë rrugëtimin e vendit tonë drejt shtet ndërtimit dhe integriteteve evropiane. Në mbështetje të nenit 65 pika 1, pika 9 dhe 14 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 52 pika 2 dhe 40 e Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, i propozon kësaj seance për miratim këto rekomandime.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me kompetencat e saj, të parapara me Kushtetutë, ka kompetenca të plota në zbatimin e masave të reciprocitetit me Serbinë.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës, i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës çdo tre muaj në lidhje me mbarëvajtjen e masave të reciprocitetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e votimit, pra sot, në Kuvend dhe shfuqizon vendimet tjera, që kanë të bëjnë me këtë çështje.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

A po shkojmë në votim, a po shkojmë në deklaram të kryetarëve të grupeve parlamentare?

Shkojmë në deklaram të grupeve parlamentare.

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në propozimin, që e bëri zoti Grabovci, duhet dalluar dy çështje.

Çështja e parë është hapja e debatit, ne këtë e përkrahim, por kjo duhet ndarë. Rekomandimet vijnë në fund. Si çështje, mund të bisedohet dhe ne e përkrahim, por kjo duhet të sqarohet që në fillim, që përkrahja e hapjes së kësaj çështjeje në seancë dhe diskutimi dallon prej rekomandimeve. Rekomandimet duhet të vijnë në fund, prandaj këtë ta kemi të qartë dhe si Grup parlamentar, ne për t'u debatuar, për të diskutuar në Kuvend, e përkrahim, por tek rekomandimet, ajo vjen në fund dhe atë e themi qëndrimin tonë si Lidhje Demokratike e Kosovës.

KRYETARI: Të merremi vesh. Si çështje urgjente, hyn debati. Çështja e rekomandimeve është çështje pas harmonizimit me grupet parlamentare të Kuvendit. A jeni dakord kështu, dy pjesë? Po. Pra, kjo është kështu, nuk mund të shkojë ndryshe, do të thotë, është diskutimi, harmonizim i kërkesave të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike bëhet me kryetarët e grupeve parlamentare, pastaj mund të hyjë si pjesë votim i mocionit, në fund të debatit. A jeni kështu do të thotë, kjo është procedura që shkon?

Në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ne mendojmë që çështje shumë e ngutshme që duhet diskutuar në këtë seancë, është politizimi i Policisë në përgjithësi të cilin e kemi parë veçanërisht ditëve të fundit, pra këtij uzurpimit të këtij institucioni nga Qeveria e Kosovës dhe përdorimi i këtij institucioni për interesat e pushtetit dhe dhuna policore e cila ka ndodhur më 14 janar.

Kjo është çështje urgjente e ngutshme për shkak se ka ndodhur tash rishtazi dhe është një gjë që ka ndodhur pasi që është miratuar rendi i ditës për këtë seancë. Për sa i përket kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së, rekomandimin, kryetari i Grupit Parlamentar nuk është dashur ta lexojë tash në fillim. Nëse rekomandimi do të vijë në fund, atëherë ai duhet të vijë pasa debatit, pra pasi që t'i dëgjojmë të tjerët se çka po thonë e jo kështu paraprakisht të supozohet nga një grup parlamentar, pavarësisht numrave që i kanë se si do të vijojë dhe për çfarë do të flitet në debat.

Ne jemi si grup Parlamentar absolutisht kundër shfuqizimit të vendimit të mëhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës që e mbulon këtë çështje. Ai është vendim i Kuvendit të Republikës së Kosovës edhe pamundësia edhe mos vullneti i Qeverisë së Kosovës për ta zbatuar atë, i shkakton shumë dëme Kosovës si Republikë dhe Kosovës si shtet dhe kjo tendencë e Grupit Parlamentar tash për çfarë është për ta shfuqizuar atë vendim të Kuvendit konsiderojmë se është vetëm një tendencë për t'ia mundësuar Qeverisë të vazhdojë ta bëjë atë që e ka bërë deri tash, pra shpërfilljen e Kuvendit dhe shpërfilljen e interesave të vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

E drejta është për të propozuar, por pastaj harmonizimi është e drejtë e të gjithëve. Në emër të AAK-së e ka fjalën deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, kryetar!

Edhe një herë po shihet se krejt atë çka e thashë në fillim të kësaj seance, qëndron e vërtetë. Këto sjellje po e bëjnë Kosovën një Republikë qesharake, kjo është mënyra më e mirë për ta degraduar sistemin politik, për t' i bërë njerëzit për mos i besuar sistemit, por të tallën me institucionet e Kosovës, pra ne mendojmë se këto nuk janë mënyra për të dalë prej situatave. Ne mendojmë se të paktën nuk duhet për t'u befasuar Kuvendi me propozime. Me siguri se ky propozim i cili erdh sot, është menduar më herët. Nuk i ka ra ndërmend dikujt sot në mëngjes për ta sjellë këtë mocion në Kuvend, e nëse nuk u ka ra ndërmend me e sjellë sot në mëngjes, atëherë na kanë pasur këtu të gjitha grupet parlamentare që shumë ditë, askujt nuk i ka ra ndërmend për t' u konsultuar me grupet tjera, ndërsa sot partitë në pushtet, Partia Demokratike e Kosovës me aleatët e vet e sjell një mocion i cili neve na befason, na zënë në seancë edhe ato pas fillimit të seancës, definitivisht se nuk kemi se si ta mbështesim, qoftë në aspektin procedural, qoftë në aspektin e ndërtimit të procedurave demokratike në Kuvendin e

Kosovës. Ne ju urojmë sukses në këtë sjellje dhe në këtë degradim, seriozisht po them në këtë degradim të demokracisë në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryetar!
Përshëndetje për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar,
Për të gjithë deputetët në seancë,
Grupi Parlamentar për Kosovë të Re, e përkrah debatin që nëpërmes debatit të dalin rekomandimet në fund të seancës.

Për arsye të çështjes çfarë ndodhet Kosova, debati është më se i mirëseardhur në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Në emër të SLS-së, deputeti Sasha Millosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!
I Poslanička Grupa Samostalne Liberalne Stranke, podržava predlog Parlamentarne Grupe PDK.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Në emër të Grupit 6+, deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Parlamentarna Grupa „6+“ podržava debatu i preporuke Parlamentarne Grupe PDK.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Në fakt i kemi dy kërkesa në emër të debatit urgjent, që mund të bëhet në një kërkesë nëse debatojmë për ngjarjet e 14 janarit. Unë mendoj që mund të diskutohet edhe ajo për të cilën mendon Grupi i “ Vetëvendosjes”.

Pasi e kemi këtë mocion, pasi i dëgjuam shefat e grupeve parlamentare, e qesim në votim debatin për kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Debat.

(Pyetje nga salla)

Jo, unë mendoj që lidhen edhe me çështjen e juaj. Unë mendoj se çështja më urgjente është debati që është kërkuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, është çështje më urgjente.

(Reagim nga salla)

Mirë, atëherë i ndajmë të dyja dhe i votojmë. Atëherë votojmë për kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, mocionin...

(Ndërhyrje, Sabri Hamiti)

Urdhëro Sabri Hamiti, e ki fjalën

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit, koleg Krasniqi.

Ne e morëm vesh ta sh këtu në seancë që janë këto dy kërkesa urgjente, një e PDK-së dhe një e “Vetëvendosje”-së, përpara s’ i kemi pasur. Në frymën e asaj që deklarova në fillim dhe këtu ndodhet fundamentalisht LDK-ja, ne kërkojmë që edhe tash mos ta bëjmë atë që s’ di.

Ky debat do të ketë të bëjë me ndodhitë e javës së fundit. Ngjitjani emrin debat i PDK-së ose i “Vetëvendosjes”, prandaj nuk ka nevojë të votohen dy. Ky Kuvend voton: A do të bisedojmë për aktualitetet, mund të formulohet si të doni, ndodhitë politike në Kosovë lidhur me këtë e këtë. Prandaj, po mendoj nuk është mirë të votohet njëri se ju e keni shumicën dhe sigurisht e votoni edhe ju e të anulohet tjetri, sepse u edhe tash konsideroj që është e njëjta temë. Formulimi mund të quhet si të doni. Faleminderit!

KRYETARI: Thashë, për mua janë shumë të ngjashme dhe të dy temat janë për këtë aktualitet dhe janë shumë të ngjashme, të bisedojnë dhe deputetët të debatojnë për këto, për çështjet të cilat edhe janë çështje urgjente nëse i bëjmë bashkë. Edhe unë mendoj se do të duhej të votojmë si çështje urgjente - debatin për ngjarjet politike të javës së fundit.

Shkojmë me votim të hapur apo me elektronikë.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

(Reagime nga salla)

Debat, sipas kërkesës së Partisë Demokratike, unë mendoj që e njëjta gjë është edhe e juaja. Mirë. Atëherë votojmë mocionin e parë të propozuar nga Partia Demokratike dhe, votojmë tash.

Marrin pjesë 99 deputetë.

Me 53 vota “për”, 24 “kundër”, 10 abstenime, Kuvendi miratoi kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, të mbështetur nga koalicioni dhe Lidhja Demokratike, për debat.

(Reagime nga salla)

Unë e kam pasur një mocion dhe unë e kam kryer detyrën time dhe kjo çështje hyn në rend dite. Po. Në rregull, dakord, nuk e ka përkrahur Lidhja Demokratike, por ka votuar shumica e deputetëve.

Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Vetëm ta theksoj edhe një herë, kërkesa jonë ishte për pikë të rendit të ditës e cila do të titullohej kështu: Politizimi i Policisë në përgjithësi dhe dhuna policore më 14 janar. Pra kjo është pikë e rendit të ditës të cilën kërkoj me vullnet në votim.

KRYETARI: Shikoni, realisht kërkesat e tilla si çështje urgjente bëhen me shkrim dhe nuk e keni bërë me shkrim, megjithatë unë e qes në votim dhe le të vendos Kuvendi, por të mësohemi, kërkesat për çështje urgjente mund të hyjnë në rend dite kur bëhen me shkrim dhe i votojmë. Megjithatë, unë edhe një herë po them se do ta qes edhe kërkesën e Grupit “Vetëvendosje”.

Kush është për t futur në rend dite kërkesën e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”?
Votojmë, tash.

Me 21 vota “për”, 53 “kundër”, 9 abstenime, nuk hyn në rend dite. Në sallë janë 96 deputetë.

Të nderuar deputetë,

Do të thotë kërkesa e Grupit Parlamentar, hyri në rend dite si debat, si debat urgjent.

A jeni që kjo pikë të hyjë menjëherë në vazhdim pasi ta miratojmë, pasi ta kryejmë rendin e ditës, pyetjet parlamentare dhe miratimin e procesverbalit, të hyjë si pikë e katërt e rendit të ditës.

A jeni dakord?

(Reagime nga salla)

Ratifikimin përpara, pas ratifikimit kjo. A jeni dakord? Në rregull. Vazhdojmë seancën.

Unë për pyetjet parlamentare për të shkurtuar kohën, po i lexoj vetëm pyetjet parlamentare.

Zoti kryeministër, pyetjet parlamentare ka për juve. Po, mund ta tejkalojmë, nuk prish punë se ka çështje të ngutshme.

Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin, Bajram Rexhepi.

Deputete e ke fjalën.

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Dua ta përsëris vërejtjen time në lidhje me rubrikën “Hajt Pak” siç e quajti Ministri i Drejtësisë, që është një konstatim shumë i papërgjegjshëm që vjen nga ana e një ministri për punën që bën Kuvendi. Mendoj që ajo është rubrikë shumë e rëndësishme ku ne ngrehim shqetësimet tona. Po, jo, jo, ju nuk ma dhatë fjalën. Nga tre – katër herë ua dhatë fjalën të tjerëve dhe unë i kisha komentet e mia.

Mirë, tani pyetja për ministrin e Brendshëm. Në dialogun në mes Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë, i cili po ndërmjetësohet nga BE-ja, të gjitha palët kanë konfirmuar se kufiri në mes Kosovës dhe Serbisë ose kufiri administrativ siç e quan Serbia dhe një pjesë e BE-së, do të mund të kalohet me karta identiteti, ndërsa nuk është kërkuar asnjëherë nga Serbia që të njohë edhe pasaportat me shenjen e Republikës së Kosovës.

Si kompromis atje është arritur që qytetarët e Kosovës do të mund ta kalojnë kufirin, duke treguar së pari letërnjoftimin e tyre, ndërsa policia serbe, do t'ua japë një letër të veçantë që do të thotë se nuk njihet dokumenti i lëshuar nga autoritetet e Kosovës, si dokument i pranuar zyrtar në territorin e Serbisë. Po si kompromis për përdorimin e targave, është arritur marrëveshja sipas së cilës në Kosovë, do të ketë dy lloj targa: një lloj sikur ato që deri me tani i ka lëshuar UNMIK-u, me shenja KS dhe targat e tjera të reja, me shenjën RKS. Në Serbi, pa pasur nevojë të ndërrojnë tabelat e veturave, do të mund të kalojnë të gjitha veturat me shenjën KS, ndërsa në kufi do të duhet të paguajnë vetëm sigurimin e veturave. Ata që në vetura i kanë targat me shenjën e Republikën e Kosovës, nuk mund të kalojnë në Serbi me to, por në kufi do të marrin targa të përkohshme që do të vlejné brenda territorit të Serbisë. Mirëpo, në këtë marrëveshje nuk thuhet që këto targa të përkohshme do të jenë targa RKS. Prandaj, pyetja...

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

(Reagim i Alma Lamës)

KRYETARI: Jo, jo se ke folur shumë. E ke marrë fjalën për rend dite, fol për rend dite, mos e ngatërroni rendin e ditës.

MINISTRI BAJRAM REHXEPI: I nderuar, kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Lama,

Me datën 26.12. 2011, ka filluar zbatimi i marrëveshjes së lirisë së lëvizjes të arritur në Bruksel me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Në po të njëjtën ditë, një delegacion në nivel ekspertësh, nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe EULEX-i, ka vizituar Nishin për të parë nga afër procesin e implementimit të marrëveshjes së regjistrave civil.

Delegacioni i Ministrisë së Punëve të brendshme, ka udhëtuar me 2 vetura private, njëra me targa RKS dhe tjetra me targa KS. Kjo është bërë me qëllim për të parë nga afër zbatimin e marrëveshjes së lirisë së lëvizjes. Gjatë kalimit në pikën kufitare në Merdar, automjeti me targa KS nuk është pajisur me targa provuese, ndërsa automjeti me targa RKS është pajisur me targa provuese. Në fakt kjo ka qenë në përputhje me konkluzionet e arritura në Bruksel.

Ndërsa, sa i përket dokumenteve të Republikës së Kosovës, në pikën kufitare në Merdar, delegacioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka prezantuar letërnjoftimet, patentë-shoferët dhe librezat e automjetit, të gjitha të lëshuara me simbole të Republikës së Kosovës.

Sa i përket vendosjes së targave provuese, në targat RKS, më lejoni të konfirmoj se në bazë të konkluzioneve operacionale për zbatimin e marrëveshjes së lirisë së lëvizjes, pika 16, Qeveria e Republikës së Kosovës ruan të drejtën për të vendosur masa reciproke, pra targa provuese duke përfshirë edhe çmimin për targa provuese.

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shitesë?

ALMA LAMA: Po. Faleminderit!

Meqenëse nuk pata kohë ta lexoj pyetjen, pyetja ime e mëparshme ishte kjo, do t'i bashkoj bashkë me pyetjen e dytë- A konsideroni këtë mosrespektim të marrëveshjes, pra duke vendosur targa të RKS-së në makinën e delegacionit të Kosovës, fyerje të shtetit të Kosovës?

Dhe, e dyta- pse nuk e bëni ju të njëjtën gjë me automjetet që vijnë nga Kosova, pra t'i vendosni, me automjetet që vijnë nga Serbia, automjeteve që vijnë nga Serbia, t'i vendosni targa RKS në territorin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: A ke përgjigje, vazhdoje ministër?

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ajo vendosje e targave të përkohshme, nuk është shkelje në bazë të konkluzioneve, ato kanë qenë konkluzione. Edhe një herë them se pika 16 e konkluzioneve e thotë se Kosova e ruan të drejtën për reciprocitet dhe nëse e bën atë, do ta bëjë në konsultim me Unionin Evropian. Deri tash nuk kemi marrë vendim të tillë. Nëse merret vendimi i tillë, do ta zbatojmë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

GANIMETE MUSLIU: Ju faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë dhe ju kolege deputete,

Para disa javësh, Qeveria e Kosovës ka pranuar një informatë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, nga e cila njoftohet se Ministria e Shkencës dhe e Artit të Landit të Hesentit, ka vendosur në kujdesin e saj disa figura nga balta të kulturës Vuça, të cilat nga zyrat e trashëgimisë kulturore në Darmshtat, dyshohet të jenë pronësi e Kosovës dhe në Gjermani kanë hyrë ilegalisht, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të shprehë interesimin e saj dhe këto figura t'i verifikojë dhe nëse kjo qëndron, t'i marrë në pronësinë e saj.

Duke pasur informata se Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit ka shprehur gatishmërinë dhe interesimin që të bëjë verifikimin e këtyre figurave, unë pyetjen konkrete për ministrin Hoxhaj e kam- çfarë ka bërë Ministria e Punëve të Jashtme për iniciimin e procedurës për verifikimin e pronësisë së objekteve të trashëgimisë kulturore të Kosovës, të ndaluara në Ministrinë e Shkencës dhe Artit të Landit të Esentit në Gjermani, kur dihet që afati i dhënë nga Qeveria e Republikës së Gjermanisë, skadon me 26 janar. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit shumë, zonja deputete,
Shumë i respektuar zoti kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra,
Kabinet qeveritar,

Dje Ministria e Kulturës e ka dorëzuar kërkesën me shkrim në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në të njëjtën kohë dua t'ju informojë zonja deputete që në vitin e kaluar, kemi ndërruar notat verbale me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë dhe me cilën notë verbale janë në fuqi 34 marrëveshje të reja në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Gjermanisë dhe të njëjtën kohë gjatë këtij viti, jemi duke punuar në mënyrë intensive, që jo vetëm sa i përket kulturës së Vinçës, thirrret kultura e Vinçës e jo Vuçës, dhe jo vetëm sa i përket sa i përket kulturës së Vinçës dhe këtyre objekteve që janë atje, mirëpo sa i përket bashkëpunimit tonë kulturor, ta kemi një marrëveshje të re në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Gjermanisë. Edhe unë shpresoj që kjo marrëveshje do të jetë në fuqi.

Ne presim që këto objekte t'i kthehen Kosovës, por në të njëjtën kohë jemi duke bërë përpjekje që të marrim informata atë saktë në çfarë forme këto objekte kulturore të kulturës së Vinçës, një kulturë parahistorike në Republikën e Kosovës, vërtet kanë mbërri në Gjermani dhe në çfarë forme duhet të kthehen sa më shpejtë në Republikën e Kosovës.

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?

GANIMETE MUSLIU: Ju faleminderit në përgjigje zoti ministër, gjithashtu të falënderoj edhe për përmirësimin, gabimin teknik që e bëra në emërtimin e figurave nga Vinça në Vuça.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti Arsim Bajrami, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Pyetja ime ka këtë kontest. Para 4 viteve, Ministria e Drejtësisë ka përgatitur doracakun për dhënien e provimit të jurispodencës. Provimi i jurispodencës është një provim shtetëror shumë i rëndësishëm në procesin e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve, e në momentin kur është përgatitur ky doracak, ende nuk ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe shumë ligje që i kemi miratuar pastaj dhe ky doracak është bazuar kryesisht në të drejtën pozitive ekzistuese.

Meqenëse në ndërkohë e drejta pozitive ka ndryshuar, atëherë unë mendoj se është e domosdoshme që të rishkruhet ky doracak, të bazohet plotësisht në legjislacionin e Kosovës dhe pyetja ime ka të bëjë me planet e Ministrisë së Drejtësisë për të hartuar apo për të rishkruar doracakun e ri për dhënien e provimit të jurispodencës.

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër e ke fjalën.

ZËVENDSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit kryetar i Kuvendit, të nderuar deputet,

I nderuari profesor Bajrami,

Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, luan një rol kyç në gjithë procesin e testimit dhe vlerësimit të këtij procesi. Prandaj, si hap fillestar, gjithnjë është ndier nevoja për përmirësimin, plotësimin dhe përditësimin e këtij doracaku. Për më tepër, përveç rëndësisë që e ka në përgatitjen e kandidatëve për provimin e jurisprudencës, ai kontribuon dukshëm në ngritjen e kualitetit të përgjithshëm të profesionistëve ligjor, qoftë të profesioneve të lira apo të gjyqtarëve, prokurorëve, por edhe të gjithë juristëve të tjerë të interesuar për këto çështje.

Para së gjithash, më lejoni të theksoj që Ministria e Drejtësisë, vitin që shkoi ka themeluar Zyrën për profesione të lira, mision i cili do të jetë specifikisht menaxhimi i këtij provimi, përfshirë edhe atë të noterisë dhe të ndërmjetësimit.

Në lidhje me pyetjen tuaj, më lejoni të kujtoj se në kuadër të prioritetëve të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2012, i kam publikuar brenda këtij muaji. është paraparë edhe përditësimi dhe hartimi i doracakut të provimit të jurisprudencës. Një planifikimi dhe nismën, Ministria e Drejtësisë ka marrë parasysh legjislacionin e vendit dhe publikimin e fondit të vitit 2009, konkretisht në kornizën ligjore dhe ligjet e reja, reformat e ndryshme të zhvilluara në ndërkohë, të cilat duhet të jenë në pajtim dhe rekomandimet që dalin gjatë këtyre viteve.

Me këtë synohet që ky doracak të përditësohet dhe të plotësohet me informatat relevante për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar, me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të kandidatëve dhe inkuadrimin e tyre në sistemin e drejtësisë. Gjatë punës, planifikohen të angazhohen ekipet profesionale të fushave përkatëse, duke marrë parasysh analizën e dokumentit ekzistues, por edhe nevojat për ndryshime dhe plotësime.

Më lejoni po ashtu të theksoj se brenda këtij viti, pritet që të bëhen ndryshime në disa ligje thelbësore, sikur që është Ligji për marrëdhënie detyimore, Kodin Penal të Republikës së Kosovës, e shumë shpejtë do të procedohet Kodi i Procedurës Penale, pastaj Ligji për procedurën përmbarimore, të cilat presin që brenda këtij 6 muaji të parë, Kuvendi i Kosovës do t'i procedojë dhe do t'i miratojë dhe e pritshme është që në korrik të këtij viti, të filloj hartimi i ri i draftit të doracakut.

Krejt në fund, më lejoni të them që për mua dhe Ministrinë e Drejtësisë, ky doracak gëzon një vëmendje të veçantë dhe po ashtu presim bashkëpunimin e Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe të tuajin personalisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ke pyetje shtesë. Jo. Ju faleminderit!

Vazhdojmë.

Deputetja Afërdita Berisha- Shaqiri, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

AFËRDITA BERISHA- SHAQIRI: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuari kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Komuna e Dragashit gjendet në pjesën më jugore të Kosovës, në trekëndëshin e kufirit Kosovë-Shqipëri-Maqedoni, me lartësi mbidetare 1500 metra, që paraqet përparësi të pakontestueshme për zhvillimin e turizmit dimëror malor. Zona tek Guri i Zi në malet e larta të Dragashit, ishte nisur të bëhet qendër e madhe për skijim në Kosovë, me potencial ndërkombëtar, si pjesë e një plani të sajuar nga komuna e Dragashit, me mbështetje të kryetarëve të komunave fqinje, Qeverisë dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Në vitin 2007, 3.5 milionë euro janë derdhur në përgatitjen e shtegut malor për shtrim, ku Dragashi investoi në shtrirjen e energjisë elektrike, për herë të parë në atë zonë, ndërsa, afaristë lokalë i hapën kursimet e tyre për të ndërtuar hotele, në përgatitje për arritjen e turistëve. Sot, rruga e pashtuar u kthye në gjendje fillestare të saj, hotelet vazhdojnë të jenë të zbrazur dhe të papërfunduar, ndërsa qendra për skijim mbetet ëndërr e largët.

I nderuar zotëri ministër, pse nuk u përfundua ky projekt? Kjo rrugë do të duhej të lidhte fshatrat boshnjake, komunën e Prizrenit dhe Zaplluzhën me atë të Dragashit. Zaplluzha do të duhej të lidhej me Gurin e Zi, ku qendra për skijim ishte pjesë e një plani strategjik për turizëm, rruga, pastaj do të vazhdojë për në Veshallë, afër kufirit me Maqedoninë.

I nderuar zoti ministër, sa janë mundësitë, që ky projekt të riinicohet, të jetësohet apo të implementohet një ditë?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA : I nderuar kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Afërdita Berisha- Shaqiri,

Sipas dokumenteve zyrtare të Ministrisë së Transportit në vitin 2007, kjo ministri ka lidhë një kontratë për ndërtimin e rrugës lokale, Prizren – kufiri me Maqedoninë, përkatësisht Prizren – Qafa e Elezit, në gjatësi prej 9.1 km. Këtë segment, është haur trasa, janë kryer objektet e parapara për fazën e parë, ndërsa, për mungesë të mjeteve buxhetore, nuk kanë vazhduar fazat tjera të punimeve. Po flas për periudhën 2009 – 2011.

Kjo rrugë pra, nuk ka qenë në programin e investimeve për dy vitet në vijim. Këtë vit, është planifikuar që të përfundojmë punimet në segmentin e parë të kësaj rruge përkatësisht, segmentin Prizren-Pouskë-Jabllanicë, që Qeveria ka ndarë një vlerë prej 450.000 euro dhe më pak se një muaj ka që ky Kuvend, ka miratuar këtë shumë të mjeteve, ndërsa, për finalizimin e këtij projekti, që është një nga prioritetet tona, do të

punojmë vazhdimisht, në bashkëpunim edhe me Kuvendin edhe me komisionet parlamentare, që t'i japim prioritet kësaj pune, ashtu siç do t'i japë prioritet Ministria e Infrastrukturës, por gjithmonë duke folur në kuadër të mundësive buxhetore të vendit dhe interesave në ndërtimin e rrugëve të tilla.

Pra, një numër i madh i rrugëve, që ndërtohen në Kosovë, natyrisht që marrin një buxhet jo të vogël dhe në këtë Kuvend, prioritetet e përcaktuara janë votuar dhe tashmë ne kemi bërë planin për vitin 2012, të cilin sigurisht se do e realizojmë në tërësi, por për vitin 2013 do të shohim prioritetet dhe natyrisht, që në këtë projekt do të investohet edhe më tutje.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete e ke fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, ministër!
Është një lajm i mirë për qytetarët dhe mendoj, është edhe një arsye më tepër për të investuar në këto rrugë, sepse do të lidheshin domethënë, Opoja, komuna e Dragashit, Prizrenit me Tetovën dhe viset tjera të banuara me shqiptarë në Maqedoni. Edhe aspekti tjetër është, kjo rrugë është një perspektivë shumë e mirë në komunën e Dragashit, sepse ekzistojnë parakushtet për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij regjioni, duke shfrytëzuar bukuritë natyrore dhe terrenet te Guri i Zi, që janë të shkëlqyera dhe më të përshtatshme edhe se terrenet e Brezovicës.

KRYETARI: Faleminderit!
Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, e nderuara deputete.
Atëherë, ne po pajtohemi plotësisht edhe në qasje edhe në drejtimin, që kemi marrë për ndërtimin e këtyre rrugëve. Unë vetëm dua t'ju rikujtoj, që ka edhe shumë projekte tjera të rëndësisë nacionale në Kosovë, për të cilat ne do të sjellim programin, sigurisht me rishikimin e buxhetit dhe vendimet që merr Kuvendi, ne do t'i zbatojmë.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Burim Ramadani, pyetja për ministrin Bajram Rexhepi.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!
Zoti ministër, edhe gati katër vjet prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe rreth tri vjet prej kur kanë filluar të shpërndahen targat e veturave RKS, gjithandej në rrugët e Kosovës, po vazhdojnë të shihen targa, vetura me targa të para vitit '99, pra, sikurse janë GL, PR, PZ e të ngjashme.

Pyetja ime është shumë e thjeshtë- Mbi çfarë baze ligjore, ju, ministria juaj, agjencitë brenda ministrisë suaj, nuk i konfiskoni këto targa? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Ramadani,

Fillimisht, më lejoni, një korrigjim të lehtë të bëj, se targat e veturave RKS kanë filluar të lëshohen më 6 dhjetor të vitit 2010, pra më tepër se 13 muaj, por, jo rreth tre vjet, siç e keni cekur në pyetjen tuaj. Tani, më lejoni t'ju njoftoj se e drejta për bartjen e targave në fjalë, deri në muajin korrik të vitit 2008, ka qenë e lejuar me vendim ekzekutiv të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të përgjithshëm. Pastaj, kjo e drejtë është vazhduar edhe me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 03/25 të datës 3.7.2008, ndërsa, aktualisht, bazuar në konkluzionet e arritura në Bruksel, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, në korrik të vitit të kaluar, pika 6 dhe 7, Qeveria e Republikës së Kosovës, më datë 13 tetor 2011 ka nxjerrë vendimin, me të cilin u është lejuar pronarëve të automjeteve, të cilët bartin targat në fjalë, t'i regjistrojnë veturat e tyre me targat RKS apo KS.

Një gjë e tillë tani ka filluar së aplikuari, nga data 1 nëntor 2011. Dhe, pronarët e automjeteve po i regjistrojnë automjetet e tyre dhe po pajisen me targa të reja të lëshuara nga autoriteti kompetent, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme, por, këta po pajisen edhe me dokumentacion personal në të njëjtën kohë.

Më lejoni t'ju informoj se nga data 1 nëntor 2011 deri më datën 19 janar 2012, gjithsej 3 mijë e 820 qytetarë të komunitetit serb janë pajisur me targa të reja, prej tyre 2.727 janë pajisur me targa RKS, ndërsa 1 mijë e 99 janë pajisur me targa KS.

Vlen të ceket, po ashtu, se 347 qytetarë serbë nga pjesa veriore e vendit, kanë aplikuar për targa të lëshuara nga institucionet e Republikës së Kosovës. Nisur nga ky trend pozitiv i regjistrimit të automjeteve me targa të Republikës së Kosovës, ne kemi vazhduar afatin e regjistrimit të automjeteve edhe për një kohë të caktuar. Çka është me rëndësi të thuhet është se shumë shpejtë në territorin e Republikës së Kosovës, do të qarkullojnë vetëm automjete me targa të lëshuara nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Dhe, krejt në fund në bazë të kësaj dinamike, është interes i madh që të gjithë të pajisen me targa...

(Ndërprerje e zërit në mikrofon)

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

BURIM RAMADANI: Shumë shkurtimisht, zoti ministër.

Ju po thoni, shumë shpejtë. A bën ta di, kur është ajo, shumë shpejtë? Cili është afati? Dhe, si mund të vendosen afate të pacaktuara për të respektuar një vendim të Qeverisë? Do të thotë, është një vendim i Qeverisë dhe nuk dihet saktë se kur ai vendim duhet të hyjë në fuqi dhe të përmbillet, realisht, jo të hyjë në fuqi.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

BAJRAM REXHEPI: Realisht, keni të drejtë që të përcaktohet një datë e caktuar, mirëpo edhe në momentin kur e kemi dhënë afatin e parë 31 dhjetor, ne kemi qenë të vetëdijshëm se s'mund të kryhen edhe për arsye teknike edhe për një kohë shumë të shkurtër.

Edhe njëherë, po them se për neve është shumë më mirë të pajisen edhe me dokumente personale dhe me targa të regjistrimit, që janë legale dhe koha nuk është ajo kryesorja. Ne do ta përcjellim dinamikën dhe do të lidhet me kalimin e regjistrimit të vjetër. Do të jenë të obliguar të marrin regjistrime me targat e RKS ose KS, por do të caktohet edhe një datë përfundimtare, kur mendojmë se nëse jo krejt, shumica e tyre do të pajisen me targa.

Këtë duhet ta marrim bashkërisht në një konsultim të Qeverisë, por ndoshta edhe me faktorin ndërkombëtar, që t'ju japim mundësi, që ata më të mos shkojnë me targa ilegale, ndërsa, për ato tabelat e reja, që kanë qenë ilegale, me prefikse të qyteteve të Kosovës, edhe më tutje është vendimi në fuqi për konfiskim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjen e fundit, deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.

Deputete, e ke fjalën.

ALMA LAMA: Po, faleminderit!

Pyetja ime ka të bëjë me kthimin e Fondit pensional.

Tashmë janë mbushur 10 vjet, prej kur me rregulloren e UNMIK-ut është vendosur një sistem pensional në Kosovë, një sistem tjetër financimi nga ai i gjeneratave, pra sistemi i vetëfinancimit. Në atë kohë u themelua Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, institucion i cili administron skemën pensionale, të vetëfinancuar nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pra, Trusti administron, por bordi i tij është i zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, merr vendimet se si të investohen mjetet e mbledhura nga qytetarët. Sidoqoftë, është interesante se ky model i sistemit pensional është zgjedhur, pikërisht, nga Banka Botërore. Duke analizuar modelet e sistemeve pensionale në rajon, të njëjtën e gjejmë në Kroaci, Maqedoni e plotë shtete të tjera. Por, në asnjërin nga këto shtete nuk injorohen kontribuuesit e së kaluarës, nuk imponohet një institucion i vetëm që menaxhon me mjetet e kontribuuesve. Dhe në fakt, kjo nuk i lihet në dorë vetëm një bordi, pra, një shumë, menaxhimi i kësaj shume prej 558 milionë sa u deklarua dje.

Gjithsesi, mbajtja e këtij fondi jashtë shtetit të Kosovës, së bashku me Fondin e privatizimit, sjell pasoja të rënda për ekonominë e vendit. Prandaj, pyetja ime është: Çfarë veprimesh ka ndërmarrë deri më tani Qeveria e Kosovës për kthimin e kursimeve të Trustit Pensional në Kosovë?

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Kryeministri, përgjigjen e ka adresuar te ministri i Financave, zoti Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet Qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Deputete, zonja Alma, faleminderit për pyetjen për investime në Fondin e

Trustit Pensional të Kosovës, siç e dini me ligjin aktual, është e lejuar që deri në 5% të këtij fondi, të ketë mundësi të investohet në Kosovë. Përgjegjëse për investimin e këtyre parave është Bordi i Trustit.

Duke pasur për bazë fillimin e operimit të suksesshëm të tregut të letrave me vlerë dhe duke pasur për bazë nevojën që këto para të kthehen dhe të vendosen në favor të zhvillimit ekonomik të Kosovës, ne e kemi draftuar projektligjin për fondin e Trustit Pensional të Kosovës, i cili është aprovuar në Kabinetin qeveritar dhe është proceduar në Kuvend. Me projektligjin e ri, i cili është i dakorduar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar, gjithashtu, kontribut ka dhënë edhe Banka Botërore, është rritur mundësia, që deri në 30% e lartësisë të këtij fondi të ketë mundësi të investohet në Kosovë dhe për çdo vit nga fonde të reja të mbledhura, 50% e kësaj mundësie, të ketë mundësi të investohet në Kosovë dhe të vendoset në favor të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Po, faleminderit zoti kryetar!

Duke pasur parasysh, që bëhet fjalë për një shumë mjaft të madhe, që është e vlefshme për ekonominë e Kosovës, në rast se ajo do të sillej këtu dhe do të investohej, por nga ana tjetër është shumë e rëndësishme të theksohet që mbajtja e këtij fondi jashtë Kosovës, çon një mesazh shumë negativ tek investuesit, që do të mund të vinin në Kosovë, sepse menjëherë krijohet imazhi që Kosova nuk është një vend i sigurt për investime, përderisa edhe paratë e saj i çon dhe i mbanë jashtë vendit.

Prandaj, pyetja ime është se, a ju shqetëson juve ky fakt dhe e konsideroni ju të mjaftueshme, që tani me këtë ligj, vetëm 30% e këtij fondi të vijë në Kosovë dhe të investohet?

Dhe, në fakt e mira do të ishte që të vijë i tërë fondi në Kosovë. Bile, ka pasur më përpara edhe humbje shumë të mëdha, për shkak të krizës financiare, sepse ky fond ka qenë jashtë Kosovës.

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë thashë që aktualisht është vetëm 5%. Fillimi i operimit të suksesshëm i tregut të letrave me vlerë është një parakusht, që këto para të vijnë dhe të investohen në Kosovë.

Deri në 30%, është arritur marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe deri në 50% të shumës së akumuluar, brenda çdo viti. Ne duhet të kemi për bazë praktikën ndërkombëtare, me rastin e investimit të parave edhe diversifikimin e riskut. Prandaj, të gjitha këto janë marrë në konsideratë dhe unë besoj, që këto dy momente që kanë ndodhur, fillimi i operimit të suksesshëm të letrave me vlerë, projektligji i cili është në Kuvend, krijon një bazë të mirë, që masë e madhe e këtyre parave të vijnë dhe të vendosen në mbështetje të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Kjo pikë e rendit të ditës përfundoi. Tani na duhet votimi, duhet t'i presim deputetët, të kthehen në sallë.

(Ndërprerje e zërit nga mikrofon)

Ndoshta është mirë këtë pikën... kaq shumë ka të pa interesuar për pyetjet parlamentare... Ose me e lënë në fund të rendit të ditës, ose ta heqim krejt. Megjithatë, duhet deputetët të jenë të përgjegjshëm. Nuk i kemi as dy orë që jemi këtu dhe salla është e zbrazur. *(Një ndërhyrje)* ... gjysmë e zbrazur, e përmirësua deputet.

(Sërish ndërprerje e zërit nga mikrofon)

Vazhdojmë.

Në sallë kemi 61 deputetë.

Pika e tretë e rendit të ditës,

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur me 20 dhe 21 dhjetor 2011.

Kush ka vërejtje në procesverbal?

Konstatohet që Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 20 dhe 21 dhjetor 2011.

Po fillojmë me pikën e rendit të ditës, të kërkuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, për faktin se nuk kemi numrin e duhur për të shkuar në ratifikimin e ...

(Ndërhyrje nga salla)

... ne thamë që debati hyn përpara. Dhe, vazhdojmë me debatin!

Vazhdojmë me shqyrtimin. Për shkak të papërgjegjësisë së deputetëve dhe me gjasë edhe të ministrit të Rendit. Vazhdojmë,

4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për mandat të ri

Para se të kërkojmë, unë dua ta lexoj nenin 144 të Kushtetutës.

Paragrafi 1: “Qeveria, presidenti ose $\frac{1}{4}$ e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit mund të propozojnë ndryshimin dhe amandamentimin e kësaj Kushtetute”.

Paragrafi i 2: “Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e $\frac{2}{3}$, të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dhe $\frac{2}{3}$ e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.

Paragrafi 3: “Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi”, dëgjoni me vëmendje këtë : “vetëm pasi të ketë adresuar kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar ose amendamentet e propozuara në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në kapitullin e 2 të Kushtetutës”.

Dhe, paragrafi 4 : “Ndryshimet e Kushtetutës hynë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës”. Ky është neni 144 i Kushtetutës së Kosovës, që tregon mënyrën e amandamentimit të Kushtetutës sonë.

Ne e kemi futur këtë pikë të rendit të ditës në shqyrtim, jo me vendimin e kryesisë që përbëhet nga nënkryetarët, po ka qenë kërkesa këmbëngulëse e shfave dhe grupeve parlamentare dhe e kemi futur në rend të ditës, edhe pse po të lexohet me vëmendje Kushtetuta nuk ka merituar të jetë në rend të ditës.

Komisioni për Amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i formuar me vendim të Kuvendit, më 22 prill 2011 në bazë të Rezolutës së Kuvendit, më datën 7 prill 2011, ka kërkuar nga Kuvendi mandat të ri me qëllim të amandamentimit të nenin 84 të Kushtetutës që përcakton kompetencat e Presidentit të Republikës së Kosovës. Ndërkohë, 31 deputetë të Kuvendit kanë parashtruar kërkesën me shkrim për iniciimin e procedurës për amandamentimin e nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kërkesa është në përputhje me nenin 144 paragrafi 1 që parasheh amandamentimin e Kushtetutës. Qeveria, presidenti ose $\frac{1}{4}$ e deputetëve të Kuvendit sipas Rregullores së punës së Kuvendit mund të propozojnë ndryshimet dhe amandamentimet e Kushtetutës.

Gjithashtu, komisioni ka shprehur gatishmërinë për rishkrimin dhe të dispozitave kalimtare të Kushtetutës që ndërlidhen me pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës. Edhe pse komisioni ka mund ta amandamentojë edhe këtë nenin 84 të Kushtetutës. Pasi Kuvendit i vijnë jo në emër të komisionit, por në emër të 31 deputetëve ose të kryeministrit ose të presidentit. Megjithatë ne shkojmë sipas radhës së diskutimeve.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, deputeti Arsim Bajrami, si propozues i kësaj çështjeje.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush të arsyetoj kërkesën e Komisionit për dhënien e një mandati të ri për rishikimin e nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Siç dihet, themelimi i Komisionit për Amendamentim të Kushtetutës është bërë në një kontekst politik - mbi bazën e një Rezolute të Kuvendit të Kosovës, me të cilën janë autorizuar dy komisione ad-hoc që të përgatisin amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht amendamentimin e Ligjit për zgjedhje të drejtpërdrejta.

Në mandatin ligjor që ia ka dhënë Kuvendi këtij komisioni, ka qenë shprehimisht e përcaktuar që ky komision autorizohet për të përgatitur amendamentet që do të mundësojnë zgjedhjen e drejtpërdrejt të presidentit, si dhe legjislacionin që ndërlidhet në këtë reformë kushtetuese.

Në ndërkohë Komisioni brenda mandatit dhe kohës së caktuar, bile edhe një muaj para kohe, i ka miratuar amendamentet që do të mundësojnë implementimin e këtij detyrimi ligjor të përcaktuar nga Kuvendi, pra pakon e 12 amendamenteve që mundësojnë zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit.

Gjithashtu Komisioni e ka finalizuar Ligjin për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit dhe është duke e përfunduar amendamentimin e Ligjit ekzistues për presidentin, për shkak se në mandatin e këtij komisioni janë edhe këto dy ligje, një ligj i ri që duhet të rishkruhet dhe një ligj që duhet të amendamentohet.

Në mandatin tonë legal, për shkak se veprojmë krejtësisht mbi bazën e mandatit legal, nuk ka qenë marrja me fuqi kushtetuese të presidentit, përkatësisht marrja me kompetenca të Kushtetutës me nenin 84, që padyshim është dispozita kryesore e Kushtetutës së Kosovës, e cila përcakton edhe formën e regjimit politik të Kosovës, përkatësisht përcakton tipin e Republikës që e kemi, për shkak se në asnjë dispozitë të Kushtetutës Republika jonë nuk atribuohet si Republikë parlamentare, por përcaktohet si një Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushtetit.

Për këtë arsye, gjatë punës tonë, por edhe në raportimet që unë i kam bërë vazhdimisht, dhe pothuaj se çdo muaj kam raportuar për progresin e Komisionit, kemi cekur problemet që i kemi me amendamentimin e nenit 84 dhe kemi parë të nevojshme si eksperiencë e jona profesionale që kjo reformë nuk do të jetë e plotë, nuk do të jetë plotësisht e implementuar në qoftë se krahas një presidenti të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli nuk rregullohen mirë edhe kompetencat e presidentit, për shkak se neni 84 në shumë kompetenca ka edhe dispozita dualiste ku në raport me Qeverinë janë shumë kompetenca që duhet të harmonizohen me këto dy hallka të pushtetit.

Për këtë arsye ne nuk kemi kërkuar mandat shtesë, por mandat të ri, pasi që e kemi përfunduar mandatin e parë dhe pakon e amendamenteve e kemi miratuar dhe aktualisht

kjo pako e amendamenteve është duke u vlerësuar në Komisionin e Venecias. Ideja e Komisionit ka qenë që para se të votohen formalisht në Parlament, të kemi edhe ekspertizën e këtij institucioni të autoritetshëm në nivel të Evropës dhe të sigurohemi që ndryshimet kushtetuese janë plotësisht në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, Komisioni në pikën 4 të kërkesës, ka shprehur gatishmëri, nuk ka kërkuar mandat për këtë, por ka shprehur gatishmëri se në qoftë se nga Komisioni, në kohën deri sa është në proces të amendamentimit të nenit 84, kërkohen edhe rishikime tjera, madje edhe ato që lidhen me pavarësinë e mbikëqyrur, Komisioni është i gatshëm që të merret me ato çështje.

Pra, dëshiroj që në emër të Komisionit të mënjanoj çfarëdo keqkuptimi lidhur me pikën 4. Kjo nuk është një kërkesë për një mandat të ri që ne të merremi me pavarësinë e mbikëqyrur dhe nëse nga deputetët kuptohet si diçka e tillë, në emër të Komisionit, ne mund edhe të heqim dorë nga kjo kërkesë, për shkak se pavarësia e mbikëqyrur është një proces politik ku duhet të përfshihen shumë akterë dhe ne kërkojmë mandat prekluziv dhe ekskluziv që të rregullojmë nenin 84, një nen shumë i rëndësishëm që do të përcaktojë fuqitë kushtetuese të presidentit. Faleminderit!

KRYETARI: Për hir të saktësisht të kësaj çështjeje, Komisioni ka mund t'i kryejë amendamentimet, por zyrtarisht amendamentet nuk janë ardhur në Kuvend dhe ne si Kuvend nuk mund të saktësojmë se a është kryer detyra.

Megjithatë, e respektojmë radhën e diskutuesve. Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Në emër të Partisë Demokratike, kush e kërkon fjalën? Deputeti Behar Selimi!

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përkrah kërkesën për mandat shtesë dhe konsideron se janë ndryshime të domosdoshme për të krijuar një ekuilibër të mirë në mes pushteteve shtetërore në Republikën e Kosovës. I inkurajojmë edhe deputetë tjerë që të na përkrahin në këtë kërkesë.

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Lidhja Demokratike e Kosovës, përkrah kërkesën e Komisionit Kushtetues për ndryshimin e nenit 84, respektivisht ndryshimin e kompetencave të presidentit.

Kërkesa e Komisionit Kushtetues për mandat të ri, me qëllim të rregullimit të kompetencave të presidentit në raport me Qeverinë, është bërë me qëllim që reforma kushtetuese që ka të bëjë me institucionin e presidentit, të jetë e plotë. Me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila ishte bazuar në marrëveshjen e liderëve të tri partive, Kuvendi i dha mandat Komisionit për ndryshimet kushtetuese dhe të bëjë

ndryshimet e nevojshme për metodën e zgjedhjes së presidentit, pra për të mundësuar zgjedhjen e drejtpërdrejt të presidentit dhe kjo shumë qartë e ka përjashtuar çdo mundësi që Komisioni kushtetues të bëjë ndryshimin e kompetencave.

Lidhja Demokratike e Kosovës mendon se çdo ndryshim i kompetencave të presidentit duhet të bëhet shumë shpejt, në mënyrë që kjo të mos ndikojë në kohën e paraparë për mbajtjen e zgjedhjeve presidenciale, prandaj mendojmë se Komisioni duhet të mandatohet me një afat maksimal prej 2 muajsh për të bërë të gjitha ndryshimet e nevojshme. Duke pasur parasysh se dispozitat e tanishme kushtetuese parashohin një sërë kompetencash të përziera në mes institucionit të presidentit dhe Qeverisë dhe kjo ka krijuar vështirësi edhe në praktikë, mendojmë se këto dispozita duhet të sqarohen, por assesi të ketë fuqizim të kompetencave të presidentit, prandaj jemi të mendimit se ndryshimet e tilla që kanë për qëllim sqarimin e kompetencave, mund të kryhen shumë shpejt.

Edhe një herë e theksoj se Lidhja Demokratike e Kosovës, do ta përkrahë kërkesën e Komisionit Kushtetues për ndryshim të kompetencave të presidentit, pra që ka të bëjë me nenin 84. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, këtu më nuk është kërkesë e Komisionit. Është kërkesë e 31 deputetëve. Si Komision, s'keni pasur të drejtë për të bërë kërkesë. Prandaj, këtu po flasim për kërkesën e 31 deputetëve, të cilët kanë të drejtë me e sjell në Kuvend, ju, si Komision, s'keni pasur të drejtë ta sillni në Kuvend.

Në emër të “Vetëvendosjes”, kush e do fjalën për këtë çështje?
Fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Shihet se këtu tash u krijua një konfuzion i madh lidhur me këto reforma kushtetuese.

Në radhë të parë ne konsiderojmë se ndoshta është dashur dhe kishte qenë më mirë që fillimisht të vijnë në Kuvend – në seancë plenare amendamentet e përgatitura deri më tani për reformën kushtetuese dhe ta kishim parë a do të votohen ato apo nuk do të votohen dhe më pastaj të kishim kërkuar mandat shtesë, sepse në esencë neve nuk e dimë se a do të votohen ato amendamente.

Çështja tjetër, është fakti pse reformat e bëra deri më tani dhe amendamentet kanë shkuar në Komision të Venecias, dhe kanë të bëjnë sepse edhe në këtë reformë kushtetuese ka dominuar një lloj logjike politike më tepër se sa një nevojë kështu më fundamentale për të prodhuar reforma kushtetuese që do të prodhonin stabilitet konstitucional.

Në këtë kuptim, ne nuk do ta përkrahim asnjë kërkesë e cila ka, sidomos, për qëllim të anulojë pikën 4 të Komisionit, me të cilën ndërlihet puna e Komisionit për të rishikuar dispozitat kalimtare dhe ndërlihen me pavarësinë e mbikëqyrur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe prej teje.
Në emër të AAK-ës deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!
Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet kërkesën e Komisionit dhe të 30 e më shumë deputetëve, të cilët e kanë sjell në Kuvend, sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar për Koalicionin për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryetar!
Duke marrë parasysh se edhe në fillim ju shqyrtuat çështjen e ardhjes së kërkesës nga Komisioni ad-hoc për plotësim-ndryshimin e Kushtetutës, e cila rrjedh si rezultat i një marrëveshjeje në mes tre liderëve politikë dhe një Rezolutë të votuar në Kuvendin e Kosovës, mirëpo e kemi edhe një kërkesë për inicimin e procedurave për amendamentimin e Kushtetutës nga 30 deputetë, prandaj ne duhet të kemi kujdes se ne nuk mund të shkojmë çdo 6 muaj në plotësim-ndryshim të Kushtetutës me nga 30 nënshkrime, se është akti më i lartë i shtetit.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të re, e mbështet kërkesën e Komisionit parlamentar për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për zgjerim të mandatit me qëllim të ndryshimit të nenit 84 të Kushtetutës, respektivisht të nenit që ka të bëjë me kompetencat e kreut të shtetit, por njëkohësisht vlerëson se mandati shtesë nuk duhet nënkuptuar edhe mundësinë e mosrespektimit të marrëveshjes së 3 liderëve politikë, marrëveshje e cila pastaj rezultoi me Rezolutë të Kuvendit në mbështetje të së cilës është formuar Komisioni dhe ka filluar amendamentimi i Kushtetutës dhe i Ligjit për zgjedhje.

Grupi i Koalicionit për Kosovë të Re i vlerëson shumë të rëndësishme këto amendamente, por njëkohësisht tërheq vërejtjen se ky mandat shtesë nuk duhet të nënkuptojë edhe shtesë për Komisionin. Ndryshimet apo amendamentet e nenit 84 të Kushtetutës mund të bëhen në një afat shumë të shpejt kohor, me çka do të mundësojë respektimin e afatit kohor të dhënë në Kuvend për amendamentimin e Kushtetutës.

Ne, si Grup Parlamentar, konsiderojmë se amendamentimi i këtij neni, nuk do të kërkonte kohë të gjatë, andaj edhe e mbështesim kërkesën e Komisionit për mandat shtesë, por edhe të deputetëve.

Po ashtu, ne si Grup Parlamentar jemi në favor të respektimit të marrëveshjeve të arritura, andaj çdo tendencë, në emër të mandatit dhe kohës shtesë, për mos respektim të marrëveshjes, për ne do të jetë e papranueshme.

KRYETARI: Në emër të SLS, deputeti – kryetar i Grupit, Sasha Millosavljeviq, e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

I Parlamentarna grupa Samostalne Liberalne Stranke podržava predlog 31 poslanika za izmenu člana 84. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit 6+, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar 6+ e përkrah kërkesën e 31 deputetëve në emër të Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës lidhur me amendamentimin e nenit 84, që ka të bëjë dhe përcakton kompetencat e presidentit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në fakt, në emër të vetit, nënkryetari Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë të falënderoj haptas para Kuvendit për korrektësinë e interpretimit të asaj që është biseduar në Kryesi dhe për korrektësinë që kërkon në procedura të amendamentimit të Kushtetutës.

Ndiej nevojë ta them këtë, sepse një debat është bërë në Kryesi dhe po del që krejt ajo që kemi thënë atje ka qenë shumë e dobishme dhe e vërtetë, sepse nganjëherë çështja e vullnetit politik edhe procedura janë dy gjëra.

Në këtë rast, është arritur njëfarë pajtimi kur janë ndërtuar këto dy komisione ad-hoc, që një vullnet politik të kalojë në procedura parlamentare dhe ka kaluar. Po tash jemi në fundin e mandatit të dhënë me atë Rezolutë të Kuvendit të njërit prej komisioneve shumë shpejt i vjen fundi i mandatit edhe Komisionit për zgjedhje.

Dua të precizoj para qytetarëve dhe para jush, deputetë e kolegë të nderuar, që afati nëntëmujor kaloi. Dhe sot, Kuvendi i Kosovës, nuk i jep mandat shtesë Komisionit, por i jep kohë dhe mandat për një çështje tjetër. Kemi të bëjmë me një moment krejt të ri, nuk është vazhdim i zakonshëm. Ai Komision e kreu mandatin për çka është mandatuar deri tash, është krejt

çështje tjetër a është përfunduar puna. Unë po ju them që, në kuptimin e Komisionit, sigurisht është përfunduar profesionalisht, por politikisht s'është përfunduar, proceduralisht s'është përfunduar se ajo çka këta kanë hartuar nuk ka ardhur në mënyrë institucionale në Kuvend dhe nuk e kemi në Kuvend.

Ju mund të thoni ndonjëri prej jush, por ne kemi informuar çka ka ndodhur Mundet. Mund të jem edhe unë i informuar për atë rrugë të punës.

Po ne, sot e dëgjuam nga kryetari i Komisionit në këtë foltore që ato amendamente janë krijuar nga Komisioni, po janë në Venecia. Shkurt i bie, ende nuk janë të plotfuqishme nga ana e Komisionit në Kuvend.

Prandaj, sot ne nuk po vendosim me i dhënë mandat shtesë, por po e rimarrim Komisionin ad-hoc për Kushtetutën duke ia dhënë një detyrë për ta kryer. Dhe, këtu besoj që sqarimi është i qartë.

E dyta, meqë nuk po merremi me kërkesën e Komisionit, sepse kryetari tha që tash jemi në procedura tjera dhe kemi një kërkesë të 30 deputetëve, që të shqyrtohet kjo çështje, unë meqë kam biseduar gjatë në Kryesinë e Kuvendit për këto punë dhe po del se kam pasur të drejtë, dhe atëherë po ju them mos të mund të kalojë edhe një herë pa e marrë në shqyrtim kërkesën e Komisionit, sepse implikon shumë punë që u dukën pak në fjalime këtu, edhe s'u dukën. Ajo që quhet pika 4, që shpreh Komisioni një vullnet që do të punonte edhe punë të tjera që priten në ndryshimet e Kushtetutës, implikon sqarime të forta. Ndryshimi i Kushtetutës, ky që po e bëjmë ne tash, është bërë me një kontratë politike të një momenti. Dhe po bëhet me komisione ad-hoc. Asnjë ndryshim më. Ato të pritshmet, për shkak të statusit të Kosovës, ose ato esenciale që i do kjo Kushtetutë, nuk duhet të bëhen përpara se Kuvendi i Kosovës, si çdo kuvend tjetër parlamentar i sistemeve, ta emërojë Komisionin Kushtetues, i cili s'është më ad-hoc, por është Komision që merr detyra për ta kryer punën.

Pra, përtej kësaj që po bisedojmë sot, asnjë komision ad-hoc nuk duhet ta formojë Kuvendi i Republikës së Kosovës, po Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta formojë Komisionin kushtetues, i cili do të merret me të gjitha punët që ky komision i ka.

Nuk do ta ketë, normalisht, këtë tip formacioni. Do të ketë formacion shumë më të madh dhe do të drejtohet, siç është zanati e zakoni, prej kryetarit të Parlamentit të Kosovës. Faleminderit!

(Drejton mbledhjen nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bajrami, keni replikë, për 2 minuta!

ARSIM BAJRAMI: Më tepër sqarime se sa replikë!

Fillimisht e përkrah idenë e profesor Hamiti që të ketë një komision të përhershëm kushtetues e tani jemi në debate për Rregulloren e re dhe meqenëse jemi shtet dhe kemi Kushtetutë, mendoj se duhet ta kemi një komision të përhershëm kushtetues që do të punojë sa herë që Kuvendi ka nevojë për segmente kushtetuese dhe jo vetëm për shkrim të Kushtetutës, por se kemi edhe raporte kushtetuese në institucione kushtetuese.

Por, po dua edhe një herë me u sqaruar. Reforma që ka të bëjë me presidentin e Republikës është një reformë unike. Është dashur debati për mandatin e saktë të Komisionit të diskutohet më tepër kur është formuar Komisioni, për shkak se ne kemi qenë të kufizuar me e rregulluar, por ne e kemi studiuar nenin 84, por legalisht nuk kemi pasur asgjë të drejtë të prekim sa i përket nenit 84 dhe kjo reformë është unike, është një

proces unik për shkak se drejtpërdrejt implikon zgjedhjen e drejtë të presidentit dhe prekjen e kompetencave.

Ne, aty ku kemi bërë ndryshime në 12 amendamente, ne i kemi rregulluar raportet me Kuvendit dhe i kemi shfuqizuar të gjitha dispozitat që shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtyre amendamenteve.

Sa i përket Komisionit të Venecias, profesor Hamiti, praktikisht asnjë proces kushtetues nuk miratohet në Kuvend në shtetet e Evropës Juglindore para se të merret mendimi i Komisionit të Venecias.

Edhe kur është shkruar Kushtetuta e Kosovës, nuk ka ardhur teksti në Kuvend derisa nuk e kemi marrë mendimin e Komisionit të Venecias. Dhe është jashtëzakonisht mirë se kur të vjen Komisioni i Venecias ne nuk kemi debate politike, sepse e kemi një ekspertizë shumë profesionale dhe për këtë arsye në momentin kur ato janë votuar përmes një marrëveshjeje ndërkombëtare, dhe meqë Kosova nuk është anëtare e Komisionit të Venecias, ne kemi arritur që t'i sigurojmë Kosovës qasje në këtë komision dhe aktualisht teksti është duke u shqyrtuar në atë Komision dhe shumë shpejt do të vjen edhe ekspertiza dhe ne do ta dorëzojmë komplet pakon e amendamenteve dhe të dy ligjet që po përfundojnë në Kuvend për miratim.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Hamiti, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: S'kam unë replikë në kuptim të kundërshtimit, por të sqarimit, sepse janë probleme të mëdha dhe është mirë që të sqarohen edhe para deputetëve edhe para qytetarëve të Kosovës çka po ndodhë.

Është evidente që ai Komision, me Rezolutën e Kuvendit e ka harxhuar kohën, se janë 9 muaj. Kjo është evidencë.

Është evidente se ai Komision për 9 muaj e ka kryer punën profesionalisht, po puna në kuptimin e administrimit të krejt asaj s'është kryer për Kuvendin.

Është evidente që kërkesa e re do afat shtesë, të ri për atë Komision ad-hoc dhe e ka detyrën e shikimit të një neni.

Është evidente që një anëtar i Komisionit dhe anëtare e Komisionit nga LDK-ja i përmendi 2 muaj.

Është evidente që, nëse Komisioni i lyp 2 muaj, do t'i duhen minimum edhe 2 të tjerët, goftë në marrjen e mendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, që është detyrim ligjor, jo vetëm të Venecias, dhe kur të kalojnë të gjitha këto nëpër këto, problemi është kur mbaron mandati i këtij komisioni.

Është problem nëse fiksohen 2 muaj. Unë ju them që s'e kryen për 2 muaj, duke i marrë parasysh rregullat, komunikimet me institucione të cilat ky mendim do t'i kalojë dhe duhet t'i kalojë.

Prandaj, për mua është me rëndësi kjo që ky Komision është ad-hoc, por sot po merr detyrë plotësuese dhe po merr mandat të ri, i cili, po ju them dhe ju e dini që s'ndodh shumë shpejt, e kam dëgjuar në diskutime- kjo është punë që kryhet për dy javë! Harrojeni! Nuk kryhet për dy javë, dhe ne jemi këtu dhe do ta shohim që as proceduralisht nuk kryhet kaq shpejt.

Kjo është çështja që desha ta theksoj publikisht dhe le të mbetet, sepse nuk ndërrohet Kushtetuta veç prej vullneteve politike. Ka procedura, ka mënyra votimi dhe në finale i do 80 vota, 2/3-at të cilat nuk i bën ky Parlament dhe asnjë parlament, pa marrëveshje të fortë parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Duke e mbështetur atë që tha kryetari i Komisionit, të cilit shfrytëzoj rastin t'i shpreh komplimente e mirënjohje për mënyrën si e ka udhëhequr Komisionin dhe gjithë Komisionin për punën që e ka bërë vërtet në frymë konstruktive edhe kur ka pasur qëndrime të ndryshme, megjithatë e konsideroj të nevojshme që disa çështje të sqarohen edhe më tej.

Kuvendi i Kosovës e ka formuar me vendim të datës 22 prill 2011, tekstualisht "Komisionin për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës". Në diapozitiv, është theksuar edhe "për ta amendamentuar Kushtetutën, në mënyrë që presidenti i Republikës së Kosovës të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli", e tjera. Dhe ky është presedani që iu ka imponuar edhe Komisionit.

Nuk është e zakonshme që ndryshimi i Kushtetutës të fillojë në këtë mënyrë, me limitime, këtë dhe asgjë tjetër. Dhe kjo është theksuar që në fillim. Është praktikisht e pamundshme. Një. Sepse ka dispozita të tjera të cilat lidhen drejtpërdrejt pikërisht me mënyrën e zgjedhjes së presidentit. Mënyra e re e zgjedhjes së presidentit imponon ndryshime edhe në dispozitat tjera. Dhe kjo është theksuar që në fillim. Megjithatë, Komisioni ka punuar. Ka konstatuar Komisioni madje edhe anomali të tjera, që s'lidhen vetëm me zgjedhjen e presidentit. Për shembull, fjalja e parë e Kushtetutës sonë, në një gjuhë flet për popullin, në një gjuhë tjetër flet për "people" që është njerëz, e diçka tjetër, kurse në një gjuhë tjetër flet "gradjani". Thotë në një dispozitë, është shtet i qytetarëve, kurse në të vërtetë është ndërtuar sipas konceptit të komuniteteve. Në të njëjtin nen, diku flet për revizorin, diku flet për auditorin. Dhe ne kemi qenë të tanguar, të penguar që mos t'i prekim këto, sepse s'kemi mandat, që është një absurd i llojit të vet.

Megjithatë, këto si dhe dispozitat që kanë të bëjnë me tranzicionin mund të futen në një grup të çështjeve tjera, por ama janë disa çështje, unë po e përmendi vetëm ndonjë prej tyre, që lidhen drejtpërdrejt me mënyrën e zgjedhjes së presidentit të cilat nuk mund të mos preken.

Për shembull, neni 18 ka prodhuar shumë anomali ajo formula e ratifikimit dhe ne kemi një rrëmuje në trajtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Pse të mos korrigjohet kjo?

Ose, mënyra e re e zgjedhjes së presidentit, ka paraparë se presidenti është një propozim edhe të betohet edhe të shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese. Nëse kjo miratohet, a mund atëherë të qëndrojë edhe dispozita që presidenti t'i emërojë kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese? Është konflikt edhe interesi, është *contradictio in adjecto*, siç thuhet.

E njëjta gjë është edhe me Komisionin zgjedhor. Komisioni zgjedhor do t'i administrojë zgjedhjet edhe të presidentit, sipas propozimeve dhe sipas disa praktikave, kurse presidenti e emëron edhe kryetarin e Komisionit zgjedhor e tjera. Është përsëri një anomali që duhet korrigjuar, dhe është e lidhur drejtpërdrejt me mënyrën e zgjedhjes së presidentit.

Ne na është thënë “s’keni mandat për t’i prekur” dhe ne s’i kemi prekur, por megjithatë mendoj se ka mundësi dhe propozimi im është ky, për të hequr edhe anomali të çështjet që lidhen me ndryshimet e imponuara nga ndryshimi i mënyrës së zgjedhjes së presidentit, të përfshihen në këtë çështje. Mund ta quajmë mandat i ri, mund ta quajmë zgjatje mandati, nuk ka asnjë rëndësi, por kjo duhet të bëhet dhe mendoj mund të bëhet shpejt, siç u tha, madje edhe më shpejt se sa dy muaj.

Kurse, çështjet tjera që lidhen me dispozitat kalimtare, të cilat duhet të bëhen në bashkëpunim me praninë ndërkombëtare, pajtohemi të gjithë, dhe anomali të tjera, mund të bëhen pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur. Pajtohem, dhe atëherë, ndoshta edhe me një komision të ri kushtetues e tjera, këtu nuk jemi të motivuar fare nga kjo.

Por, megjithatë, mendoj se, nëse nuk duam ta bllokojmë procesin, por nëse duam ta përshpejtojmë se këtu e kuptoj edhe drojën, mos mandati i ri po bëhet në funksion të zvarritjes. Ne nuk e kemi këtë motiv, por nëse është kjo drojë, le të ndahen çështjet, le të amendamentohen dispozitat që kanë të bëjnë dhe që ndërlidhen me zgjedhjen e presidentit, çështjet tjera le të lihen që në një pako ndryshimesh të bëhen pas ndonjë kohe. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Tani kërkohet deklarimi me votim për miratim të kërkesës së Komisionit dhe grupit të deputetëve si nënshkrues për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për mandat të ri lidhur me amendamentin e nenit 84 të Kushtetutës, që i përcakton kompetencat e presidentit të Republikës së Kosovës dhe rishikimin e dispozitave kalimtare kushtetuese që ndërlidhen me pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës.

Në sallë janë të pranishëm 71 deputetë dhe po hyjmë në votim.
Votojmë tash.

Konstatoj se me 62 vota për, 1 abstenim dhe 2 kundër, Kuvendi e miratoi kërkesën e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për mandatin e ri lidhur me amendamentimin e nenit 84 të Kushtetutës, që i përcakton kompetencat e presidentit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

Ne e kemi një çështje që mendoj do të duhej ta miratojmë në këtë pjesën e para ditës, në qoftë se ka kuorum, e që është:

- **Ratifikimi i Marrëveshjes financiare në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim, për përmirësimin e sistemit të ngrohjes së qytetit.**

Lus, të thirrren deputetët të vijnë në sallë, para se të hyjmë në debat, sepse pastaj me siguri do të ketë mungesë të deputetëve.

(Ndërhyrje)

Do të ishte ta votojmë menjëherë, por të dimë se sa deputetë janë në sallë, ju lutem. Lus, të thirrni ata që s'janë këtu.

(Ndërprerje e incizimit)

(Drejton mbledhjen kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Në sallë janë 89 deputetë.
Pra, kjo është pika e pestë e rendit të ditës-

5. Ratifikimi i Marrëveshjes financiare në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim, për përmirësimin e sistemit të ngrohjes qendrore.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 87 vota për, asnjë kundër, 1 abstenim, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për zhvillim, për përmirësimin e sistemit të ngrohjes qendrore.
Faleminderit.

(Ndërhyrje)

Po, veç dua të them se votimin që e keni bërë për Komisionin nuk e keni saktësuar, dhe keni lënë shumë hapësirë, është dashur që Kuvendi të debatojë më shumë rreth asaj

çështjeje dhe të saktësojë më mirë se sa që është bërë kërkesa. Keni votuar, dhe unë e respektoj atë që e keni votuar. Pauzë, deri në orën 14,00.

(Vijon pauza)

(Pas pauze, mbledhja vazhdoi punën)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, i zini vendet tuaja!

E fillojmë pikën e gjashtë të rendit të ditës,

6. Debat për ngjarjet e fundjavës së shkuar, i kërkuar nga koalicioni në fuqi

Për të arsyetuar këtë pikë të rendit të ditës, fjalën e ka deputeti, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra, të nderuar kolegë deputetë,

Kosova është shtet i pavarur dhe sovran që nga 17 shkurti i vitit 2008, i njohur nga 86 vende të botës dhe shumë të tjera janë në procesin e njohjes. Si vend i pavarur dhe sovran, Republika e Kosovës ka pranuar validitetin e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare, siç është Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut, CEFT-a e shumë marrëveshje të tjera.

Kosova është përcaktuar për ekonomi të lirë të tregut, garanton lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave. Për një kohë të gjatë Kosova është thirrur në logjikën e arsyes së ligjshmërisë, respektimit të marrëveshjeve për ekonomi të lirë, në respektimin e ndërsjellë me të gjitha vendet dhe shtetet, duke përfshirë edhe Serbinë. Si rezultat i mosrespektimit të marrëveshjeve të tilla, Kosova ka aplikuar masën e reciprocitetit me Serbinë. Vazhdimësia e krimit të organizuar dhe mosrespektimi i institucioneve të Republikës së Kosovës, ka rezultuar me veprimin e shtetit të Kosovës, më 25 korrik, për të vënë rendin dhe ligjshmërinë edhe në veri të vendit, për të luftuar krimin dhe kontrabandën dhe krijimin e kushteve për lëvizje të lirë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e vendit.

Në Bruksel janë arritur marrëveshjet për njohjen e vulave doganore, njohjen e doganave, njohjen e diplomave, kthimin e dokumenteve kadastrale si dhe menaxhimin e integruar të kufijve, që nënkupton njohjen e kufijve të Republikës së Kosovës. Kosova është përcaktuar që të respektojë parimet e ekonomisë së lirë të tregut, qarkullimit të lirë të njerëzve dhe mallrave, pavarësisht origjinës kah vijnë, por që përmbushin kriteret e nevojshme. Në ndërkohë ka ndodhur votimi i një mocioni në Parlamentin e Kosovës, për respektimin e masës së reciprocitetit politik, ekonomik, tregtar, për të cilin kanë votuar

deputetët e opozitës dhe një pjesë e pozitës, çka do të thotë se të gjithë janë për masën e respektimit të reciprocitetit në mes të shteteve, qoftë edhe me Serbinë.

Por, ajo që ka ndodhur më 14 janar, dëshmon qartë se disa kolegë tanë keqpërdorën qëllimin e singertë dhe korrekt në emër të vendimit për respektimin e reciprocitetit në vend, me politikën e shmangies nga institucionet e shtetit, të cilat janë ngritur me shumë mund e sakrificë për të shtruar, diskutuar dhe zgjidhur të gjitha problemet dhe shqetësimet e qytetarëve tanë.

Rruga nuk është vendi përmes së cilës zgjidhen problemet. Thirrjet për dhunë janë të papranueshme. Populli ynë ka nevojë të shërojë plagët e vjetra e jo të hap plagë të reja.

Ky është vendi ku duhet të flitet, debatohet dhe të merren vendime. Ju bëjmë thirrje, për hir të ruajtjes së shtetit, për të mirën e popullit dhe përcaktimit tonë euro-atlantik të mos shkëputemi nga rruga institucionale, si rrugë e vetme e drejtë për zgjidhjen e të gjitha çështjeve dhe shqetësimeve.

Duke respektuar institucionet, respektojmë veten tonë, respektojmë votuesit tonë, respektojmë miqtë tanë, për të cilët kishim nevojë dhe kemi nevojë sot, do të kemi nevojë edhe në të ardhmen. Të mos bëhemi kopje e ligë e rrugëve barrikaduese, që e çojnë vendin drejtë izolimit, pengojnë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave, siç po ndodhë në veri të vendit. Ky është vendi ynë, është shteti ynë, janë institucionet tona, ku duhet të zgjidhen të gjitha problemet dhe shqetësimet e shumta, që kanë qytetarët e vendit.

Sot të jemi në pozitë, nesër mund të jetë dikush tjetër, por ta instalojmë praktikën e zgjidhjes së problemeve me rrugë institucionale dhe kurrësi me atë të rrugës dhe të dhunës.

Prandaj, ju ftoj të diskutojmë, të debatojmë dhe të përcaktohem si bashku, drejtë dhe qartë, a jemi për të promovuar politikën, që çojnë drejt izolimit, apo për politikën që çojnë drejt hapjes, drejt integritetit të vendit dhe hapjen e perspektivës për të mirën dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve të vendit? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Qeverisë, ministri i Punëve të Brendshme, zoti Bajram Rexhepi e ka fjalën.

BAJRAM REXHEPI: I nderuari kryetar i Parlamentit,

Kryeministër,

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pas paralajmërimeve të subjektit politik “Vetëvendosje” për bllokimin e pikave kufitare në Mërdar dhe Dheu i Bardhë, me qëllim të, siç është thënë “zbatimit të mocionit të Kuvendit të Kosovës, për vendosjen e masave të reciprocitetit, në raport me mallrat e Serbisë.”, Ministria e Punëve të Brendshme duke konsideruar një formë të tillë, të shfaqjes së pakënaqësisë si joligjore, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për menaxhimin e situatës.

Fillimisht vlen të theksohet se “Vetëvendosja” si organizatore e kësaj proteste, në kundërshtim me Ligjin për tubime publike, neni 6, paragrafi 2, nuk ka lajmëruar organet kompetente, në këtë rast Policinë e Kosovës, për organizimin e kësaj proteste. Pra, protesta si një e drejtë legjitime për shfaqjen e pakënaqësisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi, të nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet lajmëruar 72 orë para mbajtjes së saj, në organet kompetente.

Pra, duke mos paraqitur protestën tek Policia e Kosovës, “Vetëvendosja” ka shkelur Ligjin për tubime publike. Nisur nga parimi se e drejta e disa qytetarëve, për të protestuar dhe shprehur pakënaqësinë, nuk duhet të abuzohet në dëm të lëvizjes së lirë të qytetarëve tjerë dhe mallrave në territorin e Republikës së Kosovës, Policia e Kosovës, si garantuese e zbatimit të ligjit, në përputhje me mandatin dhe përgjegjësinë që i takon, ka përgatitur planin operativ për parandalimin e bllokimit të pikave kufitare Merdar dhe Dheu i Bardhë, si dhe rrugëve magjistrale, të cilat shpijnë në këto pika kufitare.

Zhvillimi i situatës te pika kufitare në Merdar, ashtu siç ishte paralajmëruar, udhëheqës dhe aktivistë të “Vetëvendosjes”, të përkrahur edhe nga qytetarë tjerë, të cilët ishin bashkëngjitur për pjesëmarrje në këtë protestë, ishin nisur në drejtim të pikës kufitare në Merdar.

Në zbatim të planit operacional, Policia e Kosovës, ka angazhuar 350 zyrtarë policorë të rendit publik dhe 140 operatorë të njësive të specializuara. Protestues në këtë aktivitet kanë qenë rreth 800. Në orën 12:30, protestuesit fillimisht kanë filluar të tubohen në grupe dhe kanë bërë bllokimin e rrugës, ku nga komandantët taktikë në terren, kanë urdhëruar që ata të largohen nga rruga.

Mirëpo, pasi që ata nuk janë larguar nga rruga dhe kanë filluar t’i provokojnë zyrtarët policorë, duke hedhur mjete të forta, kubëza betoni, gurë, etj, atëherë fillimisht, është intervenuar me njësitë e rendit dhe më pas edhe me njësitë e specializuara. Për rreth dy orë rruga magjistrale ishte e bllokuar për qarkullim. Në përpjekje për të bindur protestuesit dhe duke i shfrytëzuar disa lloje të metodave të komunikimit, Policia e Kosovës i ka bërë thirrje protestuesve, të lirojnë rrugën, duke përdorur edhe megafonin, ku përfundimisht është dhënë një kohë e caktuar për lirin e rrugës.

Përkundër këtyre përpjekjeve, protestuesit nuk iu kanë bindur urdhrave të Policisë dhe në orën 14:12, pas tri paralajmërimeve të bëra nga Policia e Kosovës dhe refuzimit të protestuesve për të liruar rrugën, ka filluar deblokimi i rrugës. Fillimisht me zyrtarë policorë të rendit publik, të angazhuar në kordonin e parë, me ç’rast protestuesit kanë filluar të hedhin gjëra të forta në drejtim të tyre, ku edhe ka pasur lëndime të zyrtarëve policor dhe pastaj kanë intervenuar njësitë e specializuara.

Njësitë policore në terren nga ky moment kanë vazhduar me largimin e protestuesve nga rruga, duke përdorur pajisjet dhe mjetet e autorizuar zyrtare, policore, përfshirë edhe topin e ujit, gazin lotsjellës dhe sprejin, me qëllim të lirim të rrugës dhe rikthimit të qarkullimit normal në këtë aks rrugor. Diku rreth orës 17:25 situata është normalizuar dhe

ka vazhduar pa ndonjë vështirësi, qarkullimi i qytetarëve dhe mallrave. Protestuesit kanë vazhduar në drejtim të Terminalit doganor, në Podujevë, duke sulmuar dhe dëmtuar pronat që gjendeshin aty. Gjatë këtij sulmi është thyer një parafango e një maune në terminal, pas intervenimit të njësive të specializuara, situata është normalizuar edhe aty.

Bilanci i kësaj proteste ka qenë:

- Janë lënduar 29 zyrtarë policorë dhe disa aktivistë të “Vetëvendosjes”.
- Janë arrestuar 117 persona, me vendim të organeve kompetente të drejtësisë.
- 9 persona janë nën masën e arrestit shtëpiak, akuzohen për sulm ndaj personave zyrtarë.

Ndërsa, të tjerët janë liruar në procedurë të rregullt. Zhvillimi i situatës tek pika kufitare Dheu i Bardhë. Edhe në drejtim të pikës kufitare të Dheu i Bardhë, përfaqësuesit e “Vetëvendosjes” dhe disa qytetarë, të cilët ishin bashkëngjitur për pjesëmarrje në këtë protestë, ishin nisur në drejtim të kësaj pike kufitare.

Në zbatim të planit operativ, Policia e Kosovës kishte angazhuar 250 zyrtarë policorë të rendit publik dhe 68 operatorë të njësive të specializuara.

Protestuesit në këtë aktivitet kanë qenë diku rreth 700. Prej orës 13:00 deri në orën 17:30, nga Policia e Kosovës, përmes udhëheqësit taktik ka urdhëruar disa herë protestuesit të shpërndahen dhe të lirojnë rrugën, nisur nga fakti se gjatë tërë kohës, njëra korsi ka qenë e bllokuar nga protestuesit. Mirëpo, këto urdhra nuk janë përfillur nga protestuesit. Në orën 17:30, nga komandanti taktik në terren, është kërkuar edhe një herë nga protestuesit të lirojnë rrugën dhe të njëjtit të shpërndahen. Protestuesit nuk kanë përfillur kërkesën dhe urdhrin e Policisë, rreth orës 17:45 Policia e Kosovës, në përbërje të zyrtarëve policorë të rendit publik dhe njësive të specializuara, ka filluar largimin e protestuesve nga rruga.

Bilanci i kësaj proteste ka qenë:

- Janë lënduar 3 zyrtarë policorë dhe
- 2 aktivistë të “Vetëvendosjes”.
- Janë arrestuar 45 persona.
- Pas konsultimit me prokurorin, të gjithë janë lëshuar me procedurë të rregullt.

Në kryerjen e detyrave, sipas planit operativ, Policia e Kosovës është mbështetur edhe nga agjensione tjera, si Shërbimi i Zjarrfikësve, shërbimet shëndetësore komunale, kompanitë për mirëmbajtje dhe pastrim të rrugëve.

Si konkluzion, Ministria e Punëve të Brendshme konfirmon se urdhri operativ i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës dhe planet operative të drejtorive rajonale të Policisë së Kosovës, janë hartuar duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi si dhe në pajtim me parimet dhe procedurat standarde të operimit të Policisë së Kosovës, duke pasur gjithnjë si qëllim, ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike si dhe qarkullimin e lirë të njerëzve dhe të mallrave.

Njësitë policore, të angazhuara në terren, pas paralajmërimit disa herë ndaj protestuesve, për lirim të rrugës dhe pas refuzimit të urdhrave policorë dhe sjelljes së dhunshme, duke hedhur gjësende të forta në drejtim të zyrtarëve policorë, janë detyruar të intervenojnë, duke përdorur pajisjet dhe mjetet e autorizuar zyrtare policore, me qëllim të lirit të rrugës dhe mundësit të lëvizjes së lirë të njerëzve dhe qarkullimit të mallrave.

Ministri i Punëve të Brendshme, disa ditë para se të zhvillohet protesta, ka urdhëruar Inspektoratit Policor të Kosovës, si mekanizëm i pavarur nga Policia e Kosovës, me mandat mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe performancës së Policisë së Kosovës, që të ketë prezencë në zonat ku është mbajtur protesta dhe të monitorojë situatën dhe sjelljen e zyrtarëve të Policisë së Kosovës, të angazhuar në këtë operacion. Po ashtu, është angazhuar më datën 14 janar, ka qenë edhe ekspert të Agjencisë...

(Ndërprerje e mikrofonit nga regjia)

KRYETARI: Regjia, zgjatja fjalën!

BAJRAM REXHEPI: ... Inspektorati Policor i Kosovës, duke u bazuar në informatat preliminare, ka konstatuar se Policia e Kosovës ka përdorur forcën dhe mjetet tjera të parapara me ligj. Në të njëjtën kohë Inspektorati Policor i Kosovës, ka identifikuar tri raste specifike, të cilat lidhen me veprimet e zyrtarëve policorë, për të cilët janë duke u zhvilluar hetime konkrete. Po ashtu, raporti i përgatitur nga monitoruesit e EULEX-it vlerëson se Policia e Kosovës ka vepruar në përputhje me nivelin e kërcënimit ndaj zyrtarëve policorë. Siç kam deklaruar gjatë këtyre ditëve, si ministër i Punëve të Brendshme, mbaj përgjegjësi të plotë profesionale dhe politike, për zbatimin e planit operativ të Policisë së Kosovës, i cili ka pasur për qëllim ruajtjen e rendit publik dhe kushtetues në vend. Ndërsa, për çdo rast eventuale të ndonjë zyrtari policor, të tejkalimit të autorizimeve policore, kam kërkuar hetim dhe masa konkrete nga Inspektorati Policor i Kosovës. Në këtë drejtim, ftoj të gjithë qytetarët, institucionet përgjegjëse dhe mediat të bashkëpunojnë me Inspektoratin Policor dhe të ofrojnë informacione dhe dëshmi në rast se ndonjë zyrtar policor ka vepruar në kundërshtim me parimet dhe procedurat standarde të operimit të Policisë së Kosovës.

Dhe, meqenëse u ngrit një shqetësim për validitetin ose kohëzgjatjen e gazit lotsjellës, mund të konfirmoj se kanë validitet deri në vitin 2014. Pra, nuk iu ka kaluar afati atyre gazrave.

(Dëgjohen zëra nga salla, ndërkohë zëri nga mikrofonin ndërprehet)

KRYETARI: Faleminderit!

Ne dëgjuam mocionin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, informacionin që na dha nga Qeveria, ministri i Rendit.

Tani është fjala për shefat e grupeve parlamentare.

Në emër të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo me afat, ishte interesant, të gazit lotsjellës.

Pa dëshiruar ta zgjas, realisht mendimet dhe qëndrimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës, si tha, mjaft të kornizuara, zoti Hamiti, profesori, megjithatë, më lejoni t'i them edhe disa fjali, meqenëse u hap debati. Padyshim që bisedimet, fillimi i bisedimeve, mënyra e fillimit dhe realizimit të tyre, pashmangshëm lidhen edhe me ngjarjet që pasuan më vonë, pse jo edhe më 14 janarin. Jo, si nevojë e arsytimit të asaj ndodhi në rrugë, por e një qasjeje joserioze, jo kompetente dhe të papërgjegjshme të Qeverisë, sepse e kemi thënë dhe sot e përsërisim, që Lidhja Demokratike e Kosovës është për bisedime, por të përgatitura, por është për ratifikim të marrëveshjeve në këtë Kuvend.

Ratifikimi i atyre marrëveshjeve, konkluzave, sido që t'i quajmë, do t'ia hiqte atunë Qeverisë, që në bazë vullnetare të thotë, mundem apo nuk mundem, obligon apo nuk obligon një vendim i Kuvendit, siç ishte vendimi, gjegjësisht mocioni i miratuar, që asnjë dilemë nuk është, ai mocion e obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës. Por, sinjerisht ta them, me dy-tri qasje që i kanë pasur, asnjëherë të njëjtë, prej momentit kur është nxjerrë ky mocion është votuar, dy-tri herë, siç u tha edhe më herët, ka evoluar mendimi rreth vetë mocionit, prej asaj se s'është, realisht asgjë, deri te ajo që jemi duke e realizuar.

Megjithatë, ne jemi shumë të vetëdijshëm, që mocioni i votuar dhe i përkrahur nga Lidhja Demokratike e Kosovës, ka qenë dhe mbetet mocion i cili obligon institucionet, para së gjithash Qeverinë. Dhe, asnjërin prej neve subjekteve, si parti politike nuk mund, apo nuk e kemi të drejtën, që këtë punë ta marrim ne në dorë. Dhe, për këtë, konsiderojmë që megjithatë, Qeveria nuk e ka kryer dhe nuk po e kryen punën ashtu siç duhet, por, prapë kjo nuk është arsyetim i mjaftueshëm, që gjërat të merren në dorë dhe realisht, të rrezikohen qytetarët.

Prandaj, është shumë e qartë, që konsiderojmë, nuk janë shterr të gjitha mundësitë institucionale dhe të gjitha rrugëzgjidhjet duhet kërkuar brenda institucioneve, në mënyrë që të mos rrezikohet jeta e asnjë qytetari, po as e atyre të cilët janë të thirrur ta mbrojnë rendin.

Sigurisht, që Lidhja Demokratike e Kosovës shpreh shqetësimin dhe nuk përkrahë, sado që të tjerët do të jenë kompetentë, inspektorati, siç u tha nga zoti ministër, të vlerësojë as përdorimin e dhunës, as arrestimin e nënkryetarit dhe deputetëve. Pavarësisht se si është interpretuar, megjithatë, këta zotërinj, ne këtu jemi deputetë të Parlamentit dhe me gjithë respektin ndaj qytetarëve, nuk mund të jetë qasja e askujt njësoj si ndaj qytetarit, si ndaj në deputeti.

Dhe, edhe një herë e përsëris, Lidhja Demokratike e Kosovës, konsideron që në këtë rast, njëra palë, me tregimin e dhëmbëve se si e mbron shtetin, e bën, lëre që e përdor edhe dhunën, por e bën edhe njëloj marketingu politik, por edhe ana tjetër se si dalim ta mbrojmë me çdo kusht atë që ka vendosur Kuvendi edhe ky, na vjen keq, por vërtet është diçka që nuk mund të realizohet, për mendimin tonë, në formën se si është paraqitur. Prandaj, shkurt, Lidhja Demokratike e Kosovës e mbështet, e ka mbështetur

mocionin për reciprocitet, konsiderojmë se nuk po realizohet ashtu siç duhet, por, po ashtu këmbëngulim që kjo të bëhet brenda institucioneve dhe këtë e kanë obligim edhe Qeveria edhe të gjitha institucionet kompetente.

Edhe një herë, ne shprehim keqardhjen për atë që ka ndodhur dhe shprehim gatishmërinë tonë, që si gjithmonë, si parti serioze shtetformuese dhe ndërtuese, të japim kontributin tonë në realizimin e asaj që obligon ky Kuvend. Dhe, ky Kuvend ka obliguar dhe obligon Qeverinë, të sillet së paku në mënyrë të përgjegjshme dhe jo injoruese, siç ka qenë gjer më tani, ndaj vendimeve të Kuvendit. Por, është shumë i qartë qëndrimi ynë, ne nuk përkrahim diçka, që është dhe del jashtë institucioneve. E kam thënë dhe po e përsëris, janë institucione shumë të lodhura, shumë të papërgjegjshme, por janë të tilla dhe vota është ajo që këta i çon në shtëpi dhe këtë duhet t'ua mundësojmë qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka kryetari, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të gjithë jeni në dijeni, që kur u votua mocioni për reciprocitet të plotë politik, ekonomik e tregtar me Serbinë në këtë Kuvend, më 7 dhjetor të vitit 2011, pati trysni të ndryshme, nga anë të ndryshme për ta kthyer atë në rivotim. Këtë e kërkonte Grupi Parlamentar i PDK-së përmes kryetarit Adem Grabovci, por edhe Qeveria, me shpresë se në votimin e dytë do ta anulojnë mocionin me numrat e tyre në Kuvend.

Nuk bëhej fjalë nga ata fare për interesin politik e ekonomik të vendit. Ata kërkonin me ngulm, që Kuvendi mos ta obligojë Qeverinë, që kjo institucionalisht ta vendosë Kosovën në marrëdhënie reciprociteti, pra, barazie karshi Serbisë. E kur e kundërshton barazinë ndaj Serbisë, atëherë, me automatizëm natyrisht, kërkon nënshtrim ndaj saj.

Siç e dimë të gjithë, mocioni nuk u kthye dhe u shndërrua në vendim të Kuvendit. Kur u kuptua se vendimi nuk kthehet, Qeveria e riformatizoi sjelljen e saj karshi Kuvendit, filloi ta shpërfillë atë, duke thënë se ky vendim është opinion i Kuvendit. Po, kjo është thënë siç e dini të gjithë, nga kryeministri i Qeverisë dhe se si i tillë është jo obligativ. Pra, tregoi se nuk e ka ndërmend ta zbatojë atë.

Ndërkohë, që në publik fliste se si tashmë, qenkemi në marrëdhënie reciprociteti të plotë me Serbinë. Në njërën anë e shpërfillte përfaqësimin, Kuvendin e në anën tjetër e gënjente të përfaqësuarin, qytetarët. U rebelua ndaj institucionit më të lartë legjislativ e vendimmarrës, duke e sulmuar kështu Republikën për së brendshmi.

Kur paralajmëruam protestën tonë në mbrojtje të Republikës dhe prodhimit vendor, Qeveria filloi sulmin mediatik e verbal. Kryeministri Hashim Thaçi na quajti “të vetëfundosur” e “faqezinjë”, si dhe na krahasonte me strukturat ilegale të Serbisë. Edhe në këtë rast ai nuk merrej fare me interesin e vendit ose me obligimet, që i kishte si kryeministër, por merrej me ne, duke na fyer dhe duke thënë secilën fjalë kundër nesh,

lëvizjen “Vetëvendosje” pra, të cilët kishim vendosur t’i dëlnim në mbrojtje kësaj republike dhe të interesit të vendit.

Kryeministri nuk merrej as me Serbinë, që po na lufton për çdo ditë në secilin rrafsh, por merrej me ne që thërrisim për angazhim institucional të bllokimit të Serbisë nga ndërhyrja e saj në territorin e Kosovës.

Kur dolëm në protestë, Qeveria na sulmoi. Detyroi Policinë e Kosovës, që t’i zbatojë urdhrat e saj në kundërshtim me Kuvendin dhe me të drejtën e interesit të qytetarit. Ia hapi dhunshëm rrugën Serbisë, duke i rrahur, plagosur e arrestuar qytetarët e Kosovës. Më 14 janar, Qeveria i bllokoi rrugët. U ndaluan dhe u rrahën e keqtrajtuat shqiptarët nga Tirana e Tetova, që ishin nisur të vinin në Merdar dhe Dhe të Bardhë. U ndaluan shqiptarët nga komunat e Kosovës, që ishin nisur në këto pika. U ndaluan të gjithë protestuesit në rrugë, larg pikave dhe nuk u lejuan të lëvizin dhe pastaj u sulmuan e u arrestuan nga policia të gjithë, ndonëse ishin paqësorë dhe qëndronin ulur, sa kohë që rriheshin e arrestoheshin.

U arrestuan deputetët e këtij Kuvendi, u rrah nënkryetari i këtij Kuvendi, vetëm e vetëm për t’iu hapur rruga Serbisë, që politika e saj të ketë mundësinë të vazhdojë luftimin e shtetësisë së Kosovës edhe përbrenda territorit të Kosovës, që mallrat e saj të vazhdojnë ta uzurpojnë tregun e Kosovës, pra që të kenë mundësi ta luftojnë edhe përbrenda prodhimin dhe ekonominë e vendit.

Serbia nuk është shtet normal, karshi Kosovës. Ajo nuk njeh dhe na lufton për çdo ditë. Me të nuk kemi marrëdhënie reciproke. Meqenëse, mungon reciprociteti, mungon barazia. Bllokimi i Serbisë, meqenëse po na bllokoi ajo, si dhe ndërprerja e negociatave me të, duke qenë se këto janë vetëm në favor të saj, do ta vendoste Kosovën në avantazh karshi Serbisë. Ne do t’ia kthenim kurrizin asaj, derisa ajo të vendosë që të ndryshojë karshi Kosovës. Tendencë e Qeverisë së Kosovës për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë, në këto kushte pabarazie, sjell asgjë tjetër, përveç nënshtrimit politik e ekonomik të Kosovës ndaj Serbisë.

Marrëveshjet e Brukselit dhe zbatimi i tyre po e ndryshojnë Kosovën e jo Serbinë. Ato po e heqin Republikën dhe po e betonojnë mosnjohjen e Serbisë karshi Kosovës, duke ia pranuar natyrisht, edhe luftën speciale, që ky shtet e bën kundër Kosovës.

Duhet ta kemi parasysh një gjë. Logjika e kësaj Qeverie është shumë e rrezikshme. Kjo logjikë është shprehur disa herë nga persona të ndryshëm, qoftë kryeministri apo ministra të Qeverisë dhe u shpreh edhe sot nga zoti Adem Grabovci, pra kryetari i Grupit Parlamentar.

Kjo logjikë thotë kështu: “Serbia është bota. Po që se e bllokojmë Serbinë, izolohemi nga bota.”. I nderuar kryeministër dhe ju ministra, po edhe ju deputetë të tjerë, Serbia është një shtet në botë, nuk është bota. Ka shumë shtete në botë. Serbia është një shtet në botë, i cili qartazi tregon se është armike ndaj Kosovës dhe vepron me armiqësi ndaj Kosovës. E

ka bërë të njëjtën gjë në të kaluarën, vazhdon ta bëjë sot e edhe planin për të ardhmen e ka armiqësor dhe kriminel karshi Kosovës.

Dua të flas pak edhe për mocionin, të cilin e lexoi kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, në rastin kur e parashtrori kërkesën për këtë debat, në të cilin jemi tash. Ky mocion i propozuar, në njërën anë tregon qartë se nuk ka masa reciprociteti me Serbinë, për shkak se aty thuhet, që Qeveria e Kosovës i ka kompetencat për ta zbatuar një masë të tillë, pra, që nuk është duke e zbatuar një masë të tillë. Dhe, e përgënjeshtrohet tërë atë që e ka thënë Qeveria e Kosovës prej momentit kur është votuar mocioni këtu në Kuvend, për masa reciprociteti, kur na thoshin që tashmë jemi në masa reciprociteti, se jemi duke e zbatuar atë. Pra, keni harruar t' i njoftoni edhe deputetët tuaj, që jeni duke e bërë një gjë të tillë.

E dyta, mocioni e dobëson Kuvendin. Duke kërkuar që të shfuqizohet një vendim i Kuvendit, që kërkohet në pikën e tretë të këtij mocioni, që e fuqizonte, në fakt, Kuvendin karshi Qeverisë si institucion më i lartë legjislativ e vendimmarrës, ky mocion synon t'ia nënshtrojë Kuvendin Qeverisë. Pra, t'ia nënshtrojë Kuvendin një Qeverie, e cila tashmë, i është nënshtroar Serbisë. Mocioni është edhe qesharak, por është edhe antikushtetues. Ai kërkon t' i caktohen kompetenca Qeverisë, kur një gjë e tillë është tashmë e përcaktuar me Kushtetutë. Nuk mund t' i caktojmë ne kompetencat Qeverisë me një mocion. Kjo gjë nuk bëhet kështu. Janë dokumentet, ligjet dhe Kushtetuta, që ia caktojnë secilit institucion kompetencat, që ai i ka.

Mocioni kërkon nga Kuvendi, që ta lejojë Qeverinë, ta bëjë atë që e ka bërë deri tash, pra, të vazhdojë t' i nënshtrohet Serbisë, të vazhdojë t' ia hap rrugën Serbisë dhe në rastet e fundit të vazhdojë t' i rrahë qytetarët e Kosovës, për t' ia hapur këtë rrugë Serbisë. Unë kujtoj që detyrë e këtij Kuvendi është, që t' i vihet në kundërshtim Qeverisë, kur kjo Qeveri është në kundërshtim me interesat e vendit. Pra, është detyrë e secilit prej nesh si deputetë, që një gjë të tillë ta kemi parasysh, sa herë që votojmë në këtë Kuvend, madje, madje sa herë edhe që flasim dhe veprojmë politikisht, qoftë këtu brenda, apo jashtë tij.

Po, tash po shihet, në fakt, se pse kjo Qeveri ka bërë ose ky subjekt, që e ka marrë qeverisjen, ka bërë aq shumë për t' i vjedhur votat dhe ka insistuar, që ta krijojë një institucion si Kuvendi, ku një pjesë e konsiderueshme e tij, deputetëve të tij, në fakt kanë ardhur këtu, duke i manipuluar dhe vjedhur votat e jo duke i zgjedhur qytetarët. Se, tash kjo vjedhje e votave, në fakt, po ju hyn këtyre në shërbim, pra një Kuvend, i cili del nga një proces, absolutisht i manipuluar zgjedhor, pastaj është Kuvend, i cili natyrisht, që do të bëjë çmos që këtë institucion politik t' ia nënvendosë Qeverisë dhe t' ia jep Qeverisë në duar, në mënyrë që kjo ta përcaktojë agjendën dhe të bëjë çfarëdo që do me të.

Një gjë duhet me e pas parasysh, deputeti mban përgjegjësi për punën e vet, karshi qytetarëve, e jo karshi kryeministrit. Këtë duhet ta keni parasysh edhe ju deputetë të koalicionit. Dhe, nëse jeni për të përgjegjshëm karshi qytetarëve, duhet t' i mbronit interesat e qytetarëve, e jo interesat e kryeministrit, çfarëdo qofshin ato.

Edhe një gjë, kisha dashur ta them këtu për fund, meqenëse, po e përfundoj tash, ne e kemi bërë të qartë disa herë, Lëvizja "Vetëvendosje" ka organizuar dhe do të organizojë

protesta, sa herë që mendojmë se interesi i vendit po dhunohet, pra nëse pajtohemi, së interesi i vendit po dhunohet dhe që po dhunohet Republika, me këto malverzime që po i bën Qeveria e Kosovës, atëherë do të protestojmë, jo vetëm brenda hapësirave institucionale, që po quhen institucione, por edhe duke e përdorur institucionin tjetër demokratik, që është rruga.

Protestat në rrugë janë legjitime dhe janë të domosdoshme në një vend siç është Kosova. Rrjedhimisht, lëvizja “Vetëvendosje”, do t’i bëjë ato. Është detyrë e secilit deputet, për ta mbrojtur Kuvendin nga shkelja, që ia bën Qeveria. Pra, jo vetëm e Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe për këtë në vend se ta kritikoni Lëvizjen “Vetëvendosje”, që po del në rrugë, ishit dashur të dilni në rrugë edhe ju. Ju faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë dola këtu vetëm për hir të sqarimit të qytetarëve dhe tendencës për ta keqpërdorur edhe këtu para nesh, para të gjithëve këtë foltore, për mua, të shenjtë, për të cilën kemi kontribuar shumë që të kemi këtu, t’i ngrisim shqetësimet, t’i mbrojmë ato. Shpif parafolësi, kur thotë se Grupi Parlamentar i PDK-së ka kërkuar rivotim. Ju lutem, a ka dalë në rivotim? Nuk është e vërtetë. Përkundrazi, janë bërë keqpërdorime të votave. Te tjetra, që dua të them se kush çka ka bërë për këtë vend dhe kush sa ka qenë i angazhuar, është historia ajo që e dëshmon shumë qartë, e shkruan shumë drejt dhe ne nuk jemi të përcaktuar për ta izoluar vendin. Ne, përkundrazi, kemi qenë të angazhuar dhe do të angazhohemi të kemi miqë, të kemi përkrahës, t’i hapim rrugë perspektivës së vendit tonë, që të jetë dhe të aderojë në familjen e madhe evropiane.

Ju lutem, a ka ndodhur për këto vite, mbi 20 vite që një parti serioze, që i thotë vetvetes, të deklarohet hapur kundër Washingtonit, kundër Berlinit, kundër Brukselit, kundër Tiranës, kundër të gjithëve, përveç “Vetëvendosjes”?

Ju lutem, mjeti i rrugës, tendenca për ta bartur problemin në rrugë, nuk i sjell të mira këtij vendi, i sjell vetëm të këqija. Prandaj, unë i bëj thirrje “Vetëvendosjes”, që t’i thirr mendjes së vet dhe të mendojë për interesat e qytetarëve të vendit, të mendojë për të sotmen dhe të ardhmen e vendit. Nuk mundet Kosova të ecën përpara pa miq.

(ndërprerje e zërit nga mikrofon)

KRYETARI: Kundër replikë, deputeti Visar Ymeri.
Veç, ju lutem, në histori mos hyni shumë!

(Dëgjohet një e qeshur në sallë)

VISAR YMERI: Kryetar, mendoj që unë e gëzoj këtë të drejtën e fjalës së lirë. Konsideroj edhe mund të flas edhe për histori nëse dua, po s’po hy në histori tash, veç

kur të dua të flas për histori, do të flas për histori. E di që ju pengon juve historia, po s'kam çka t'iu bëj.

I nderuar deputet Grabovci, ta kesh parasysh një gjë, që interesi i vendit është për zhvillim edhe pavarësi politike. Besoj, që këtu pajtohem të gjithë. Nuk është në interes të vendit t'i nënshtrohemi Serbisë. Nuk është në interes të vendit, ta mbysim prodhimin vendor, për shkak se do t'ia hapim rrugën produkteve që vijnë nga Serbia. Prandaj, kur flet për interesin e vendit, ti veje gishtin në kokë edhe mendo pak, se çka është interesi i vendit. Interesi i vendit, në këtë moment, nuk është në përputhje me interesin tënd, për shkak se populli i Kosovës është jashtëzakonisht i varfër, e ti je shumë i pasur për me e ditë se çfarë është interesi i të varfrit. Ti vetë e ke deklaruar pasurinë tënde të jetë milionëshe, prandaj, ti nuk e din...

(Ndërprerje e zërit në mikrofon)

KRYETARI: Faleminderit, edhe ju lutem, bëhuni më të dëgjueshëm. Kur t'ju vjen rendi merreni fjalën edhe mendoni çka po flisni mirë.

Po, urdhëro, kundër replikë, një minutë e ke.

ADEM GRABOVCI: Unë kam qenë i përcaktuar prej kohësh, shumë qartë dhe shokët e mi, po edhe partia që i takoj, se kah duhet të shkojë Kosova. Kemi dhënë kontributin tonë në të gjitha periudhat kohore, kur dikush as s'ka guxuar të flasë shqip, e jo t'ia kthejë gjoksin, t'ia qetë Serbisë, ne e kemi bërë atë dhe e kemi sjellë deri këtu. Pasurinë time, i nderuar, kur të do çdo qytetar i Kosovës, është i lirë të vijë, të verifikojë. Çdo gjë që kam pasur e kam vu gjithnjë në shërbim të interesave të qytetarëve të vendit. Prandaj, unë kështu edhe do të vazhdoj, por rruga që e keni zgjedhur ju, është rruga e shkatërrimit, e izolimit. Dhe, ju do ta izoloni vetveten, jo Kosovën.

KRYETARI: Visar, pasi ja dhashë Ademit Fjalën edhe ti një minutë e ke.

VISAR YMERI: Adem Grabovci, prapë po e mohon thelbin e çështjes. Natyrisht, ky po get edhe nuk ka mundësi me kuptua çka po them unë, por, një gjë duhet me e pas të qartë. Unë fola edhe më herët edhe tregova, që nuk është në interes të Kosovës, me iu kthye Serbisë, Adem. Qikjo është pika. Mendoj që këtu nuk ke çka me thënë më. Nuk është në interes të Kosovës me iu kthye Serbisë edhe këtë nuk mendoj, që ka të drejtë me e bë askush, qoftë ai deputet, kryeministër a ministër.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kush e do fjalën?

Deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kabinet Qeveritar,

Për neve nuk është qudi, as 14 janari, as ky fjalor që po përdoret këtu, sepse me start është gabuar, është nisur pa përgjegjësi dhe po përfundon me dhunë, po përfundon në mënyrën më të keqe të mundshme, për qytetarët e Kosovës.

Mosmarrëveshjet, qëllimisht po i quaj mosmarrëveshje, sepse, kurgjë s'janë marrë vesh, as Qeveria e Kosovës me Qeverinë e Serbisë, për shkak se kurgjë s'po zbatohet në obligimet, që ka marrë Qeveria ndaj qytetarëve të Kosovës dhe krejt ato edhe ato që po zbatohen, po zbatohen aq keq, sa që po paguan çmim qytetari i Kosovës.

Një Qeveri e përgjegjshme, e cila niset pa platformë, pa agjendë, pa afate të caktuara, pa e ditë cakun përfundimtar, nuk mund të përfundojë me rezultate ndryshe, përveçse me këtë skenë që e kemi parë më 14 janar. Këtë ua kemi thënë kur janë nisë, s'po ua themi tash. Ky është veç një përfundim logjik i veprimeve, që po i bënë kjo Qeveri. Është nis me zbatimin e reciprocitetit, që Qeveria neve po do me na tregu, si deputetë të Parlamentit të Kosovës, se si duhet kuptuar ne reciprocitetin. Jo ashtu si duhet të jetë, po si duhet kuptuar, ashtu siç e kupton Qeveria. Dhe, kjo Qeveri, që nuk e kupton se ka marrë një mocion në këtë Parlament për ta zbatuar, e obligon Grupin Parlamentar, që përbëhet nga kjo Qeveri, për ta sjellë një mocion tjetër, në këtë Kuvend, për ta rrëzuar atë tjetrin dhe atë, pa e përgatitur fare ashtu si duhet, sepse ju e dini që marrëveshjet politike bëjnë konsensuset brenda partive, pajtimet bëhen të partive, për të arritur deri te një qëllim. Por, përkundrazi deputetët e Parlamentit të Kosovës, marrin vesh në seancë, që paska një mocion tjetër, që po u dashka të votohet dhe ta kërkojnë votën. Çfarë injorimi është ndaj deputetëve më së pari edhe partnerëve politikë, cilët do qofshin ata, qoftë të pozitës, qoftë të opozitës, kur është një qëndrim i përbashkët për t'u arritur. Edhe me e pas njet me e votu, kur të qesin para aktit të tillë të kryer, thua nuk ia vlenë.

Një Qeveri, e cila urdhëron arrestimin dhe burgosjen e deputetëve, është Qeveri e cila tregon falimentimin e vetë logjik, sepse nuk bazohet në parimet e demokracisë, që së pari dialogu të jetë ajo mënyra e konsultimit. Por, para se të ndodhin 14 janari, këtu kemi pas fryrje të zjarrit, qëllimisht që të vije deri te dhuna. Kjo është nisë nga Qeveria, e cila, ju shumë mirë e dini, fjalorin e kryeministrit dhe të tjerëve, që në vend se të kërkojnë një pajtim, për t'u arritur një qëllim, këtu ka më shumë nxitje. Edhe tani po vërehen nxitje të tilla, që të mos ndalen pasionet e rrezikshme për vendin, por përkundrazi, ato të shtohen. Dhe, kjo Qeveri, me këtë veprim, e kalon krejt veriun. E ka harruar tash, sepse ka agjendë, domethënë, tjetër, më të drejtpërdrejtë me njerëzit, të cilët kërkojnë realizimin e një të drejte, të një reciprociteti të shtetit dhe janë harruar edhe problemet e mëdha të qytetarëve, që sot i ngarkojnë në jetën e tyre të përditshme.

Këtë që po dua ta them tash, vlen për të gjitha partitë politike. Kurdo që niset një iniciativë, duhet të kërkohet bashkëpunimi. Kjo vlen për të gjitha. Nëse e bëhen veprime të cilat dalin jashtë këtyre kornizave dhe jashtë marrëveshjeve, atëherë nuk ka pse të kërkohet edhe një nënshkrim ose një votë e një deputeti të partisë tjetër. Kjo vlen për të gjitha partitë politike qoftë të pozitës, qoftë të opozitës.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konsideron se janë krijuar institucione të cilat janë valide, janë të dalura nga vullneti politik i qytetarëve të Kosovës dhe janë obligim në nivelet e përcaktuara që i kanë, dhe kjo Qeveri ka obligim ta kryejë mocionin që është nxjerr nga ky Parlament që bazohet në vullnetin e popullit të Kosovës dhe jo të na

tregojnë se a është mendim i Parlamentit, a është këshill e Parlamentit, duke mos e kuptuar se Parlamenti është institucioni më i lartë i vendit.

Edhe një herë kërkoj që Qeveria ta zbatojë çdo vendim që del nga ky Parlament, çdo marrëveshje që arrihet me Serbinë në bazë të rezolutës të aprovuar në këtë Parlament sillet në Parlament përndryshe do t'i keni defektet dhe problemet të cilat do t'ju përcjellin në vazhdimësi deri në fundosjen tuaj.

Dhe, përfundimisht mendoj se rruga e demokracisë që ka Kosova është ajo e logjikës së shëndosh, e bashkëpunimit dhe kur kemi të bëjmë me çështje nacionale të nivelit më të lartë të shtetit të ruhemi dhe të mundohemi që të pajtohemi në këto çështje.

Mënyra se si po sillet edhe kjo Qeveri edhe deputetët të cilët në momentin e fundit tregojnë në seancë se paska një mocion, e kanë të humbur betejën dhe nuk është mirë ta sjellin qytetarin e Kosovës para kësaj gjendje.

Në fund më lejoni që të thërras edhe një herë në konstruktivitet, në zbatim të vendimeve të Parlamentit të Kosovës si organi më të lartë të shtetit përndryshe Qeveri e nderuar, pa kokë jeni nisë, pa kokë po më duket keni me përfunduar.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Mos i paragjykoni gjërat!! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar, i cili është sot prezent këtu!

Përshëndetje për të gjithë deputetët!

Duke marrë parasysh situatën çfarë ndodhemi pas 14 janarit, atëherë një debat i tillë çfarë është dashur ndoshta të organizohet dhe menjëherë mbas ngjarjeve të 14 janarit është fatbardhësi që sot po debatohet, dhe jo me çështjet e mocionit çfarë u paraqitën në fillim, por me çështjet të një debati të mirëfilltë për ngjarjet, pas 14 janarit.

Dhe, duke marrë parasysh se Republika e Kosovës është shtet parlamentar dhe në bazë të aktit më të lartë Kushtetutës së Kosovës, atëherë Kuvendi është organi në të cilën të gjitha partitë politike duhet të debatojnë dhe fatbardhësisht të gjithë këtu duhet të debatojmë për ngjarjet e 14 janarit dhe pas 14 janarit për procesin që prapë subjekti politik Vetëvendosje donë që për arsye të mos zbatimit të vendimit të Kuvendit të dalë edhe njëherë në protestë.

Kërkoj nga subjekti politik të cilët janë kolegë tanë njëkohësisht dhe nga vetë Qeveria që të kalojnë petkun e tyre partiak dhe të vendosin në favor të Kosovës, duke marrë parasysh se ky Kuvend, e dini mjaftë mirë në zhvillimet pas vendimit të masave të reciprocitetit - vendosi një rezolutë diku me 25 korrik ku të gjitha subjektet politike i dhanë përkrahje Qeverisë që të vazhdojë masat e reciprocitetit dhe njëkohësisht të vazhdojë shtrirjen e autoritetit edhe në pjesën veriore të Mitrovicës.

Kërkoj mirëkuptim nga të gjithë deputetët që mos t'i drejtohem me fyerje një subjekt ndaj një subjekti tjetër për arsye se Kosova është e të gjithëve dhe të gjithë jemi duke punuar për një qëllim që Kosova të jetë një shtet i fortë juridik dhe kushtetues.

Shteti i Kosovës është njohur edhe pas vendimit të GJND-së, jo edhe aq shumë prej vendeve tjera si është pritë, mirëpo për shkak të raporteve ndërkombëtare është dashur të hyjë në bisedime. Çështja e hyrjes në bisedime teknike në mes të Serbisë dhe Kosovës ka sjell disa marrëveshje dhe këto marrëveshje shihet se diku po zbatohen e diku s'po zbatohen, mirëpo prapëseprapë Kuvendi i Kosovës është organi më i lartë i cili duhet që të kërkojë nga Qeveria që të dihet se çka po zbatohet dhe çka s'po zbatohet.

Edhe një herë, insistoj prapë te problemi i protestës të kemi kujdes, të kemi maturi politike si deputetë dhe si subjekte politike se çka i sjellim në të ardhmen shtetit tonë.

Është e vërtetë që është nxjerrë një vendim nga Kuvendi i Kosovës për masat e reciprocitetit me Serbinë, mirëpo të shohim në efekt deri ku po shkojnë ato masa të reciprocitetit të zbatohen. Ne jemi Kuvendi dhe Kuvendi e thirr Qeverinë në raport në Kuvend sa herë të dëshiron një subjekt politik ose një numër i deputetëve dhe kërkojmë që partitë politike energjitë e tyre shumë të mira për shtetin e Kosovës t'i shfrytëzojnë në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Ndërsa, çështja e dhunës e cila u potencua këtu, dhunës nga policia ose nga protestuesit, atëherë AKR-ja kërkon nga të gjitha strukturat vendimmarrëse në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës të jap përgjegjësi secili për dhunën e ushtruar ndaj secilit person. Do të thotë se të gjithë qytetarët e Kosovës janë të barabartë para ligjit.

Njëkohësisht, kërkojmë nga Qeveria që mund të na jap mundësinë të shohim zbatimin e masave të reciprocitetit apo vendimit të cilit është marrë në këtë Kuvend deri kur mund të zbatohen këto masa të reciprocitetit.

Edhe njëherë si Koalicion për Kosovë të Re dhe pjesë e Qeverisë ju drejtohem me besimin më të madh, se të gjithë jemi kolegë, të tejkalojmë këto mosmarrëveshje dhe të arrihet në një pajtim të domosdoshëm për procesin në vazhdim dhe për mbylljen e shtet ndërtimin e Kosovës e kemi akoma sfida.

Duke marrë parasysh se edhe shumë pak ditë na ndajnë nga përvjetori i shpalljes së pavarësisë, atëherë si Kuvend i cili e ka shpallur pavarësinë e Kosovës me përjashtim Lëvizja Vetëvendosja që s'ka qenë pjesë e Kuvendit mirëpo ka qenë pjesë e proceseve në të cilat ka ndodh Kosova, duhet të kemi kujdes çfarë porosie po ju japim qytetarëve tanë pas 4 vjetëve dhe çfarë mundësie po ju japim miqve tanë, çfarë shteti është kah ndërton Qeveria, Kuvendi, qytetarët e Kosovës, çfarë shteti po ndërtojnë në rajon.

Të keni kujdes, unë po ju them, dhe ndoshta ju duket pak e tepërt mirëpo ndonjëherë për çështje shumë madhore të Kosovës duhet të tejkalohej edhe do çështje tjera. Të lypet llogari nga Qeveria është shumë normale se kjo është demokracia. Ju faleminderit!

KRYETARI: SLS a keni të lajmëruar për diskutim? Nuk keni. “6+”? Rasim Demiri e ka kërkuar fjalën. Deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, presedniçe!

Poštovani predsedniçe,

Poštovani članovi Kabineta vlade,

Poštovani kolege,

Parlamentarna Grupa „6+“ podržava svako demokratsko rešenje svakog problema.

Smatramo da u svakoj demokratskoj državi, svako ima pravo da iskaže svoje nezadovoljstvo, pa bilo ono i putem protesta. Ali, smo sigurni da postoje i drugi načini rešavanja problema, kao i onih koje vidimo u naporima Vlade, i zato podržavamo svaku aktivnost Vlade Republike Kosova kao i Ministarstva unutrašnjih poslova, da se svaki problem reši u korist građana Republike Kosova. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, tash është radha e deputetëve, fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetari i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Natyrisht që nuk është rasti të flasim për histori sepse jemi deputetë dhe duhet debati ynë të jetë brenda një kornize ligjore dhe institucionale dhe kontributi im i këtij debati do të jetë kryesisht nga ky këndvështrim.

Fillimisht, dëshiroj të theksoj që esenca e një demokracie parlamentare është e drejta e qytetarëve – e zgjedhësve me zgjedh një organ përfaqësues që jemi ne dhe brenda këtij organi përfaqësuese del një Qeveri e cila e merr funksionet kushtetues me e udhëheq vendin dhe del një opozitë që e ka funksionin kushtetues me e kontrolluar vendin.

Pra, në dy demokracitë moderne janë dy funksione të shenjta: është funksioni i qeverisjes dhe funksioni i kontrollit të qeverisjes dhe të gjitha kushtetutat moderne duke përfshirë edhe kushtetutën tonë i ka instaluar mekanizmat që mundësojnë me u qeverisë vendi në mënyrë demokratike, por edhe mu kontrolluar qeverisja. Në ato vende ku s’ka mekanizma kushtetues të kontrollit të Qeverisë mund të lind diktatura.

Kushtetuta jonë i ka ato vende dhe në këtë drejtim jemi me një Kushtetutë që i ka marrë modelet e mira të qeverisjes.

Në anën tjetër derisa pluralizmi të zhvillohet brenda institucioneve në disa parti politike pranojnë të hyjnë në një garë zgjedhore, pranojnë hyrjen në jetën publike, në ndërtimin e politikave publike, atëherë ato kanë një bazë në të cilën e ndërtojnë veprimin demokratik. Ajo bazë është Kushtetuta dhe ligji, i cili është mbi demokracinë. Definitivisht, demokracia nuk është një kopsht me lule ku mund të marrësh lulet më të mira, por është një lojë e sjelljes së përgjegjshme politike e bazuar në ligj, brenda ligjit dhe kornizës ligjore.

Kështu që unë dëshiroj me i pa këto fenomene në këtë kontekst, nuk dua me u marr me episode, nuk dua me u marr me dhunë, sepse qytetarët këtë javë kanë pasur një lloj torture mediale me këto akte të dhunës, me një debat të pamerituar sepse qytetarët po ballafaqohen me probleme ekzistenciale dhe nuk ka qenë e udhës që politika me iu riprodhuar, dhe nëse s'mundet me jua lehtësuar jetën në krizë sociale atëherë mos po iu dhënë epizoda të dhunës.

Si menaxhohen pakënaqësitë apo konfliktet në një kuadër demokratik? Menaxhohen me mjetet ligjore dhe në këtë segment është legjitime që opozita nuk do të jetë asnjëherë e kënaqur me Qeverinë, dhe nuk do të ishte opozitë në qoftë se do t'i duartrokiste Qeverisë. Opozita ka për detyrë me e kontrolluar Qeverinë.

Raportet Qeveri dhe Parlament janë raporte kushtetuese të definuar mjaftë mirë. Qeveria e Kosovës është një Qeveri parlamentare që zgjidhet nga Parlamenti dhe që mund t'i merret besimi në Parlament.

Nëse jemi të pakënaqur me punën e Qeverisë, atëherë janë instrumentet demokratike, instrumentet institucionale, që do të flas edhe për protestën si instrument demokratik, por edhe si instrument legal dhe ato instrumente demokratike, si njerëz që na ka zgjedh populli me udhëheq dhe me kontrolluar udhëheqjen, nuk janë konsumuar dhe janë 3 instrumente që për të pakënaqurit me vendimet e Qeverisë apo me moszbatimin e vendimeve, sepse Qeveria duhet t'i zbatojë vendimet e Parlamentit - 3 instrumente të fuqishme që nuk po përdoren për të ndërtuar një veprim të mirëfilltë opozitar.

Është interpelanca parlamentare, që nuk po ngritet, nuk po përdoret ndoshta për të kontrolluar Qeverinë;

Është mocioni i investimit parlamentar, një mocion të cilën ne vetëm njëherë e kemi përdorur. Unë jam në legjislaturën e katërt dhe vetëm njëherë e kemi përdorur, por investigimi parlamentar është një mocion shumë i fuqishëm të cilën zakonisht e udhëheqë opozita dhe merr për detyrë me investigate se sa është ekzekutive dhe agjencitë brenda ekzekutivit e kanë abuzuar ligjin, nëse e kanë abuzuar ligjin dhe me investigim parlamentar ushtrohet një kontroll shumë, shumë i fuqishëm dhe esencial që shpeshherë ka edhe efekte shumë të rëndësishme.

Dhe, në qoftë se investigimi parlamentar do të tregonte që Qeveria s'ka punuar mirë, ose se ka zbatuar vendimin është mocioni i mosbesimit.

Mocioni i mosbesimit është një fitore e opozitës dhe është një rënie e Qeverisë dhe është mundësia në vend me prurje një qeveri të re.

Fatkeqësisht këto nuk janë shfrytëzuar, këto mekanizma që i kemi ndërtuar vetë, e kemi votuar këtë Kushtetutë vetë dhe në një mënyrë jemi betuar kur jemi zgjedh deputetë që do të punojmë me këtë kuadër të Kushtetutës, e kemi parë tekstin e betimit, dhe po kërkohen rrugë tjera që nuk janë tipike për veprimet parlamentare.

Natyrish, edhe si profesor i demokracisë parlamentare, por edhe si hartues i 4 Kushtetutave në 20 vjetshin e fundit të Kosovës, unë e di që protesta është një mjet shumë i fuqishëm demokratik. Është një liri elementare për të cilën kanë luftuar ideologët më të njohur duke filluar me Martin Luter Kingu e deri te ideologët tjerë. Dhe, është e drejtë kushtetuese e çdokujt që mendimet e veta politike, pakënaqësitë, e drejta e protestës, e drejta e kërkesës për ndihmën e Qeverisë t'i artikulojë në protesta dhe manifestime publike. Por protesta përpos që është instrument demokratik është edhe instrument ligjor.

Protesta nuk është një diçka që mundesh me e bë çfarëdo dhe mundesh me e bë edhe të pamundshmen. Çdo ligj, çdo kushtetutë cakton se çka mundesh me e bë në protestë. Në protestë nuk mund të rrëzohet një Qeveri. Në vendet ku qeveritë japin dorëheqje në protesta, demokracia është e sëmurë ose është e papjekur.

Na po i shohim këto epizodat e fundit të revolucioneve në disa shtete, por po lutemi që ato të përfundojnë. Kështu që, po protesta është e drejtë, është legjitimi por veprimi parlamentar do të kërkonte që zgjidhja të gjendet brenda kuadrit ligjor dhe kushtetues, brenda kuadrit parlamentar dhe do të kishte efektin shumë më të madh për opozitën, shumë më të madh do ta kishte efektin për opozitën në qoftë se këto instrumente përdoren, shpenzohen dhe konsumohen dhe do të reflektonin tek zgjedhësit në zgjedhjet e ardhshme. Sepse e dini se opozita në Amerikë dhe Angli nuk sheh kurrë ëndërr me ardhur në pushtet para 4 vjetëve, por ajo punon çdo ditë që para 4 vjetëve t'iu tregojë dhe t'i bind qytetarët se këta janë më të mirët se këta që janë në Qeveri dhe qytetarët reflektojnë dhe përcjellin veprimin opozitar.

Kështu që apeloj që t'i kthehemi nacionalitetit. Jemi persona të zgjedhur, përfaqësojmë këtu qytetarë. T'i kthehemi zgjidhjes racionale, të lirohemi nga emocionet dhe të dërgojmë mesazhe qetësuese tek qytetarët. Unë sot kërkesën e kuptova të kryetarit të grupit parlamentar si kërkesë për debat, si debat të lirë, një debat i cili do të nxirrte konkluzione racionale, kërkesa racionale të cilat do të përkraheshin nga shumica e partive politike, në mënyrë që ne ta menaxhojmë këtë situatë e cila nuk ka qenë situatë e mirë dhe ne duhet ta kalojmë këtë fazën e emancipimit politik. Tani jemi shtet dhe po sprovohemi në qoftë se ne mendojmë që shteti mund të vihet në situatë të tilla çdo vit atëherë vërtetë ne vetë nuk po e duam këtë shtet, apo nuk po e ruajmë këtë shtet dhe ne nëse nuk e duam dhe nuk e ruajmë këtë shtet mos të presim që të tjerët të na vendosin gjithmonë tutori mbi shtet apo kujdestari me këtë shtet.

Kështu unë angazhohem që nga ky debat të dalin konkluzione të qarta që ne të kërkojmë prej Qeverisë të ndërtojë dhe implementojë politikat e reciprocitetit. Politikat e reciprocitetit janë politika ekonomike për të cilat në bazë të Kushtetutës është përgjegjëse Qeveria. Meqenëse ekziston vendimi i Parlamentit, Qeveria duhet t'i ndërtojë dhe duhet t'i implementojë politikat e reciprocitetit, të njoftojë Parlamentin rregullisht, të praktikoj njoftimin e rregullt të Parlamentit për problemet që mund t'i ketë në implementimin e politikave të reciprocitetit dhe të njoftojë më rregullisht për procesin e Brukselit, për procesin e bisedave që të kemi më shumë transparencë edhe si deputetë, të jemi të

njoftuar rregullisht në mënyrë që të kemi informacione të mjaftueshme për të bërë edhe veprime adekuate politike.

Kështu që mendoj se këtë situatë, që nuk ka qenë fare mirë, nuk ka qenë e mirë për qytetarët nuk po flas e mirë për pozitë-opozitë sepse televizionin e këqyrin edhe qytetarët e pozitës dhe opozitës dhe askush nuk është ndie mirë me këto skena të cilat disa prej neve i kemi përjetuar para 20 vjetëve apo 30 vjetëve, por t'i kthehemi zgjidhjes institucionale. Nuk kemi nevojë ne për politika para institucionale. Jemi shtet, kemi pas përvojë shumë me politikat para institucionale, t'i kthehemi politikave institucionale, të ndërtojmë mekanizmat e kontrollit, t'i japim mundësi zgjidhjeve kushtetuese në mënyrë që të kthejmë besimin tek qytetarët, të kthejmë besimin tek institucionet, të kthejmë besimin tek institucionet e pavarura. Policia e Kosovës është polici e këtij populli, nuk është polici e regjimeve çfarë ne e kemi pa. Nuk është perfekte, është institucion i ri. Por megjithatë sipas të gjitha sondazheve është institucioni më i respektueshëm dhe më i besueshëm në Kosovë.

Ne nuk mund të funksionojmë pa një polici të mirë. Mund të ketë gabime, por ato gabime të trajtohen dhe të menaxhohen në mënyrë institucionale, jo me inate, jo as me arrogancë, por në mënyrë institucionale. Ekzistojnë mekanizmat që të adresohen në qoftë se ka pas tejkalim të përdorimit të forcës. Urdhëroni përdorni ato instrumente dhe jemi këtu që të gjithë të adresojmë edhe përgjegjësit konkrete, por edhe përgjegjësit e institucioneve në qoftë se ato edhe kanë ekzistuar. Faleminderit!

KRYETARI: Arben Gashi e ka fjalën, le të përgatitet Alma Lama.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si Lidhje Demokratike morëm vendimin që të përkrahim mocionin, mocion i cili kishte disa qëllime.

Drafti i parë i mocionit, i propozuar nga lëvizja Vetëvendosje ishte një draft i ndryshëm nga ai që doli në fund, i cili u përkrah edhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Lidhja Demokratike e Kosovës përkrahu mocionin për disa arsye: duke parë se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk po sillej si një shtet i pavarur dhe sovran. Lidhja Demokratike e Kosovës, mendoj, veproi dhe vendosi që të përkrah një mocion dhe mocion i cili kishte për qëllim që të bëjë, të ngritë vetëdijen te Qeveria e Kosovës se duhet të sillet si shtet, duhet të ruajë dinjitetin e shtetit, duhet të ruajtur interesin e qytetarit të Kosovës dhe të ekonomisë kosovare.

Qeveria e Kosovës duhet të sillet në mënyrë reciproke me të gjitha shtetet dhe në mënyrë të veçantë në mënyrë reciproke me ato shtete që kanë qasje negative ndaj Republikës së Kosovës.

Ky ishte qëllimi i këtij mocioni. Kjo ishte ajo çka Lidhja Demokratike e Kosovës përkrahu dhe kjo është ajo çka Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon: që Kosova të trajtohet si një shtet i barabartë nga të gjithë fqinjët dhe partnerët.

Lidhja Demokratike e Kosovës kërkoj që kur Kosova diskriminohet nga të tjerët, me të njëjtën mënyrë t'ju përgjigjet. Kërkoj që kur Kosova trajtohet në mënyrë preferenciale edhe nga aspekti ekonomik, tregtar dhe politik, në mënyrë preferenciale të silltet edhe me të tjerët.

Në këtë kuptim qasja për reciprocitet politik, ekonomik dhe tregtar kishte këtë qëllim: Nëse nuk njihen dokumentet e Republikës së Kosovës nga një shtet, duhet të merret në konsideratë që dokumentet e këtij shteti të trajtohen në mënyrë të njëjtë, nëse zyrtarët e lartë të shtetit të Kosovës nuk pranohen nga një shtet, zyrtarët e shtetit tjetër duhet të trajtohen ashtu, nëse nuk pranohet certifikata e cilësisë së mallrave të Republikës së Kosovës nga një shtet, në këtë rast të veçantë nga Serbia, nuk duhet të pranohen certifikatat e cilësisë së kualitetit nga shteti i Serbisë dhe mallrat nuk mund të hyjnë pa këtë certifikatë, nëse shkëmbimet ekonomike dhe tregtare nuk lejohen që të ndodhin mes Serbisë dhe Kosovës, Kosova nuk mund t'i kryej këto shërbime me Serbinë, atëherë as Serbia s'mund t'i kryej me Kosovën.

Kjo ishte ajo çka kërkuam na. Kjo ishte ajo për të cilën ne u angazhuam. Ky ishte shteti për të cilën ne kërkuam që të zbatohet. Ia kujtuam Qeverisë në mënyrë shumë demokratike nëpërmjet një mocioni në Parlamentin e Kosovës.

Çka ndodhi pastaj? Pastaj, ndodhi që njëri nga partnerët e këtij mocioni mori një instrument tjetër për të kërkuar që të zbatohet ky mocion, e drejtë e tyre që të marrin, edhe pse ne nuk u pajtuam me këtë. E drejtë legjitime, sepse njihet me ligj. Se a duhet të ndodh apo s'duhet të ndodh, përdori dhunë Vetëvendosje apo nuk përdori dhunë Vetëvendosja kjo mbetet që të studiohet dhe të gjykohet nga organet kompetente.

Neve çka na shqetëson këtu, është përdorimi i dhunës nga institucionet. Institucioni nuk guxon të përdorë dhunë. Me ligj, me Kushtetutë, me ligje pozitive, me akte juridike ndërkombëtare institucionet nuk përdorin dhunë.

Ministri dhe kryeministri na thonë që shteti përdori dhunën për të mbrojtur interesat e shtetit. Shteti nuk përdor dhunën, shteti me ligj dhe me karta ndërkombëtare përdorë forcën sepse është i pajisur me forcën ligjore, është i pajisur me mjete teknike dhe përdorë forcë adekuate ligjore për të kontrolluar situatat, ndërsa përdorimi i dhunës është i papranueshëm, i papranueshëm si koncept, i papranueshëm si politikë, i papranueshëm si masë, sepse e rrezikon demokracinë, rrezikon stabilitetin.

Këtu parafolësi para meje tha se ne jemi demokraci, Parlamenti është tempulli i demokracisë dhe Parlamenti balancon institucionet.

Jam shumë dakord se kështu do të duhej të ishte, por çka ndodhi, çka ndodhi javën e kaluar?

Ndodhi që dhuna e Qeverisë, çizmja e Qeverisë shkeli mbi fytyrën e nënkryetarit të Parlamentit. Këtu u shkel Parlamenti, u shkel dinjiteti i këtij Parlamenti. U shkel pavarësia e institucioneve, u shkel ndarja e pushteteve, u shkel Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Nuk flitet këtu për një individ. Flitet për Parlamentin e Republikës së Kosovës i cili ka për detyrë dhe obligim kushtetues që të balancojë dhe të kontrollojë pushtetet dhe këtu ndodhi fatkeqësia e madhe. Pushteti ekzekutiv shkeli mbi pushtetin legjislativ. Këtu ndodhi disbalancimi dhe ky disbalancim në vendet demokratike nuk guxon të ndodh.

Ne po pretendojmë se duhet të anëtarësohemi në Bashkimin Evropian, ne po pretendojmë se duhet të marrim praktikën më të mira euro-atlantike. Praktikën më të mira euro-atlantike nuk thonë se duhet të shkelet mbi Kuvendin. Deputeti i Parlamentit të Kosovës nuk guxon të keqtrajtohet nga përfaqësuesi i Qeverisë.

Ministri i Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës nuk guxon të thotë se u përdor dhuna mbi deputetët dhe do të përdoret prapë nëse dalin në rrugë. Nuk guxon të ndodh kjo! Sepse deputeti i Parlamentit të Republikës së Kosovës është përfaqësuesi i popullit të Kosovës. Këtu u shkel Republika, nëpërmjet Republikës u shkel Parlamenti nga çizmja e Qeverisë dhe kjo çizme e Qeverisë është e rrezikshme. Kjo ndodh në disa vende, e bile edhe atje kam dyshim a ndodh a s'ndodh.

Kjo mund të Korenë e Veriut, por jo në ndonjë vend demokratik ku ka të ndarë pushtetet, ku pushteti legjislativ është strumbullari i gjithëçkaje, ku Kuvendi vendos, ku Kuvendi voton, ku Kuvendi nxjerr ligje që Qeveria duhet t'i zbatojë. Dhe ligjet kur merren në dorë nga përfaqësuesit e Qeverisë për interesa të veçanta, kjo është e rrezikshme.

Prandaj, këtu është problemi. Problemi është çfarë lloj demokracie po ndërtojmë ne? A po rrezikojmë që të shkojmë drejtë një diktature. Ky është hapi i dytë fatkeqësisht, drejt diktaturës. Hapi i parë drejt diktaturës ka qenë vjedhja e votave, manipulimi me vullnetin e lirë të qytetarëve të Kosovës. Manipulimi me vullnetin e qytetarëve të Kosovës është shumë i rrezikshëm, prandaj ne jemi në këtë situatë ku në njërin anë përdoret çizmja e Qeverisë kundër deputetëve të Parlamentit të Kosovës dhe në tjetrën anë të përdoret mocioni i Parlamentit të Kosovës si formë për të garantuar apo për të arrit që të merret një simpati më e madhe popullore.

Le ta përdorin, është çështje e tyre, e drejtë e tyre që të përdoret. Është normale në demokraci, se mund të ndodh të nxjerrin kapitalin më të madh politik nga një veprim politik i caktuar. Mirëpo e papranueshme, e paligjshme, antikushtetuese, antidemokratike të përdoret çizmja, dhuna e Qeverisë ndaj deputetëve të Parlamentit të Kosovës, dhe për pasojë ndaj demokracisë së Kosovës, dhe për pasojë ndaj stabilitetit të Kosovës, dhe për pasojë rrezikohet e ardhmja e këtij vendi, rrezikohet qëndrueshmëria institucionale. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në demokracinë përfaqësuese, ku mëtojmë të jemi edhe ne, në këtë sistem politik që është edhe Kosova i është dhënë kuptim i ri sovranitetit popullor, pra edhe ligjimitetit në qeverisje. Ai përcaktohet si qeverisja e shumicës me respektimin e pakicës.

Zgjedhjet parlamentare rezultojnë gjithmonë me shumicë dhe pakicë elektorale, që në parlament shprehet nëpërmjet pozitës dhe opozitës. Të dyja këto janë të barasvlershme, sepse përbëhen nga përfaqësuesit e të qeverisurve.

Kështu vullneti i popullit, pra elektorati, dhe si rrjedhojë edhe sovraniteti është tërësia e shumicës dhe e pakicës. Prej këtej opozita konsiderohet pjesë e sovranitetit të popullit.

Por, çfarë ka ndodhur këtë kohë në Kuvendin e Kosovës e më gjerë, në sistemin politik të Kosovës, nuk ka të bëjë aspak me demokracinë.

Në të vërtetë është një deformim, që pos në vendet e dala nga sundimet koloniale dhe ato autoritare, vështirë se gjendet diku tjetër.

Me 7 dhjetor partitë opozitare, por edhe deputetët nga partitë e tjera votuan mocionin për respektimin e marrëdhënieve reciproke me Serbinë. Kuvendi, pra mori një vendim. Atë e mori pjesa më e madhe, e në këtë rast sovraniteti popullor.

Pas këtij vendimi, pati edhe tentativë për t'i detyruar deputetët ta ndryshojnë votën e tyre. Deputetët në bazë të Kushtetutës së Kosovës, duhet të veprojnë sipas bindjes dhe ndërgjegjes së tyre. Precedenti i ndryshimit të votës pas votimit tashmë është krijuar në Kuvendin e Kosovës, me disa ligje.

Meqë kjo nuk ndodhi, atëherë Qeveria deklaroi se vendimi i Kuvendit nuk është obligativ. Por meqë kjo fjali sërish nuk gjend vend në Kushtetutën e Kosovës, atëherë vendosi injorimin e plotë të Kuvendit, pra vullnetit të sovranit. Por, natyrisht të mbyllësh sytë në një situatë të tillë, do të thotë të pajtohesh me të keqen, me injorimin, me diktatin e Qeverisë dhe supermacinë e veprimeve të saj.

E ky, nuk është koncepti demokracisë në shekullin e XXI. Heshtje e nënshtrimi, nuk është as profili i njeriut të shekullit të XXI. Ky njeri sot është një qytetar aktiv, është një qytetar politik i cili kërkon të marr pjesë në qeverisje, i cili nuk mund të mos pyetet më për fatin e tij dhe për fatin e shtetit në të cilin është organizuar.

Dhe pikërisht këtu ishim ne, anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe qytetarë të tjerë të Kosovës, qytetarë dhe politikanë aktivë të cilët nuk mund t'i nënshtrohen arbitraritetit e injorimit institucional.

Heshtja përball gjendjes aktuale, do të ishte barazim me kotësinë e të ekzistuarit politik dhe kotësinë e konceptit të përfaqësimit.

Besoj se këtu nuk ka njeri guxim të kundërshtojë faktin se e drejta e opozitës është që të përdorë të gjitha mjetet e lejueshme për të kundërshtuar politikat e palejueshme dhe të këqija të Qeverisë. Është e drejtë e saj që ta detyrojë Qeverinë të modifikojë politikën e vet. Kjo e drejtë është sanksionuar edhe në Kushtetutën e Kosovës.

Nga ana tjetër, kuptimi i ri i sovranitetit është mbizotërim i tolerancës, e cila është mjet që karakterizon konkurrencën për pushtetin politik brenda shoqërisë demokratike.

14 janari, pra protesta paqësore, ishte mjet i lejueshëm në demokraci, i cili kishte vetëm një qëllim: Ta detyronte Qeverinë të korrigjonte veprimet e saj. Me një fjalë, të zbatonte reciprocitetin me Serbinë.

Mirëpo, atë ditë nuk pati nga ana e Qeverisë as respekt për protestën e as tolerancë. Atë ditë pati dhunë, një dhunë e cila nuk ndryshonte shumë nga ajo që shumëkush prej jush në këtë sallë e ka provuar në kurrizin e tij para disa vitesh.

Me 14 janar, në emër të lirisë së lëvizjes u pengua liria e lëvizjes. Në rrugën për Merdare dhe Dheun e Bardhë u rrahën, e u përndoqën brutalisht deputetët e Kuvendit të Kosovës. U rrahën sepse protestuan aktivistët dhe qytetarët e thjeshtë. U arrestuan njerëzit në oborret e shtëpive të tyre, apo që rastësisht kalonin nëpër këto rrugë. U rrahën gazetarët, të cilët po kryenin punën e tyre duke dëshmuar sjelljen e policisë për t'ia paraqitur, pra publikut.

Me 14 janar, u pengua liria e lëvizjes në kufirin me Shqipërinë për tu hapur liria e lëvizjes në kufi me Serbinë.

Me 14 janar, u rrahën disa qytetarë nga Shqipëria në Morinë.

Me 14 janar, Qeveria varrosi të drejtën e protestës.

Me 14 janar, Qeveria varrosi demokracinë, tolerancën politike si karakteristik themelore të saj, varrosi të drejtën e opozitës dhe qytetarëve për të mos u pajtuar me qeverisjen.

Por, me 14 janar pati edhe një rilindje. Në Kosovë rilindi autoritarizmi dhe dhuna shtetërore. Policia u përdor dhe u instrumentalizua për hakmarrje personale ndaj deputetëve të lëvizjes Vetëvendosja. Sot u përdor policia, nesër mund të përdoret ushtria.

Rrahja e deputetëve është precedenti më i rrezikshëm që është vendosur deri tani në Kosovë. Por, unë ia kujtoj Qeverisë, se në këtë rast ajo nuk është e vetmuar. Shtetet si Rusia apo Ukraina janë modele udhëheqëse në këtë pikëpamje. Shtypja e protestave paqësore dhe arrestimi e burgosja e liderëve të opozitës është mënyra e tyre për të ruajtur pushtetin, e sot edhe mënyra e Qeverisë Kosovës.

Por, nuk mund të mos përmendet këtu atmosfera e krijuar para protestës së 14 janarit. Qeveria e Kosovës përpara protestës, me fjalorin e saj radikal, fyes e frikëndjellës krijoi “qauzes is bellin” e saj për të ndërhyrë brutalisht mbi protestuesit. Në vend të marrjes së

përgjegjësi për respektimin e vendimeve të Kuvendit, ajo përgatiti justifikimin për dhunën që do të përdorte më pas.

Është e vërtetë që demokracia është sundim i shumicës. Por ka kohë, ama shumë kohë që në vendet perëndimore, në Bashkimin Evropian, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka demokraci ligjore, që do të thotë sundim i shumicës duhet të kushtëzohet nga sundimi i ligjit.

Autoritetet shtetërore nuk mund të përdorin dhunën për vrasjen e lirisë së individit. E drejta e protestës është në radhë të parë liri e individit për të shprehur mendimin, opinionin, refuzimin, për gjithçka që ai e gjykon apo e dëshiron. Individit po ashtu e ka të drejtën e mbledhjes, asociimit dhe organizimit.

Së fundi më kanë habitur shumë edhe qëndrimet e disa partive politike, të cilat mendojnë se protestat janë të panevojshme. Në të vërtetë këto parti e kanë shfrytëzuar të drejtën e protestës në disa rrethana të cilat parimisht nuk mund të prodhojnë kurrfarë efekti. Pra, kanë protestuar kundër vendimeve të drejtësisë vendore e ndërkombëtare.

E, pra këtu kemi të bëjmë me raportet në mes individit me drejtësinë, sepse në demokraci siç e dini fajësia nuk mund të jetë kolektive. Këtu kemi pasur të bëjmë madje edhe me raportet e individit me drejtësinë ndërkombëtare, institucionet e të cilave ne i kemi pranuar.

Unë shtroj pyetjen këtu: A është dashur që policia t'i rrah ata protestues dhe liderët politik që ishin në krye të tyre?

Gjithashtu, më kanë bërë përshtypje edhe disa deklaratat të disa personaliteteve vendore e ndërkombëtare kur thoshin se “nuk ka arsye për të protestuar.”. Unë e di vetëm një gjë, dhe kjo është aksiomatike që e drejta e protestës nuk vdes kurrë. Ajo është e drejtë universale, dhe arsye për të protestuar ka gjithmonë, sa kohë që njeriu mendon dhe protesta ka kuptim edhe në liri edhe në mungesë të saj.

Ndërkohë, zoti Bajrami tha një fjali këtu, e cila nuk më duket e qëndrueshme. “Qeveria nuk rrëzohet me protesta” tha zoti Bajrami. Besoj që kemi shembuj të pafund ku qeveria pikërisht rrëzohet me protesta dhe qytetarët kanë të drejtë ta bëjnë atë, sepse qeveria e humbë legjitimitetin kur dështon të përmbushë kërkesat e qeverisë.

Në fakt rrëzimi i Qeverisë nuk ka qenë synim i lëvizjes Vetëvendosje, por unë personalisht mendoj që kjo do të ishte shumë e ligjshme sa kohë që protestat janë paqësore.

Bile, si i thonë: një rrugë e dy punë, siç thotë populli, sepse edhe dorëzohej Qeveria edhe në këtë mënyrë do krijohet një Qeveri më demokratike e cila do të zbatonte edhe reciprocitetin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë, deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Atëherë, në mësimet akademike që bëhen për konceptet e demokracisë ne i mësojmë edhe nxënësit edhe studentët se qeveritë zgjidhen dhe shkarkohen përmes sistemit të zgjedhjeve. Sepse komplet demokracia është një sistem që funksionon përmes zgjedhjeve dhe kur qeveritë nuk janë të mira, s'kanë punuar mirë, ato rrëzohen me mekanizmat tjerë, jo me protesta.

Unë e thash se ato kur qeveria rrëzohet me protesta me kryengritje, demokrati nuk ka. Ajo demokraci është e paqëndrueshme, apo është demokraci delikuede, sepse e kam lexuar një libër para dy jave ku një autorë thotë se “kanë lind edhe demokracitë delikuede, janë pikërisht ato që rrëzohen me protesta, me revolucione, me kundër revolucione.”.

Mendoj se e kemi kaluar at stad ne. Ne kemi hy në një rrugë, në një rrugë të një shteti demokratik dhe duhet të mësohemi e të edukohemi, se pakënaqësitë tona politike me Qeverinë t'i artikulojmë në mënyrë institucionale.

Ka mjaft hapësirë në Parlament. Kushtetuta ka dhënë mjaft hapësirë për me shpreh pakënaqësi për punën e Qeverisë. Vetëm duhet t'i shfrytëzojmë ato, dhe nëse ato shfrytëzohen me sukses mund të jenë kapital më i madh për opozitën se sa protesta, sepse në atë mënyrë opozita mund të bëjë alternimin apo rotacionin parlamentar dhe mund t'i bindë qytetarët se ata janë më të mirë dhe ata ia vlen me qeverisë vendin më mirë.

Për këtë arsye unë edhe e mbroj qëndrimin se vendet që i rrëzojnë qeverinë me kryengritje, me revolucione, me protesta ende nuk janë vende demokratike.

Ne kemi hy në një cikël të një demokracie, kemi ndërtuar 4 cikle zgjedhore dhe të gjitha qeveritë që kanë ardhur në periudhën e pasluftës kur ka filluar tranzicioni demokratik në Kosovë, që s'kanë përfunduar, kanë ardhur vetëm mbi bazën e rezultateve të zgjedhjeve dhe ato kanë funksionuar mbi atë legjitimitet zgjedhor dhe natyrisht që në momente të caktuara ka pas kërkesa për përgjegjësit e Qeverisë dhe ato janë adresuar gjithmonë në rrugë parlamentare dhe në rrugë institucionale.

KRYETARI: Kundër-replikë, deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Padyshim që qëndroj në ato që thotë zoti Bajrami dhe mendoj që edhe unë atë thash. Me protesta demokratike mund të rrëzohen jo vetëm qeveritë, sa kohë që ato dështojnë të përmbushin kërkesat e të qeverisurve, por mund të rrëzojnë edhe sistemet politike. Dhe ajo për të cilën ne po flasim sot është pikërisht kjo, që ne nuk jemi në demokraci, sa kohë që shteti përdor dhunën kundër protestuesve të cilët kanë të drejtë të protestojnë.

Në vendet e lira dhe demokratike e kanë këtë të drejtë. Këtu është dhunuar kjo e drejtë. Dhe pikërisht ne po themi këtë, që ne nuk jemi në këtë fazë pra, prandaj po flasim këtu dhe po diskutojmë dhe të vendosim se çfarë mund të bëjmë më tej për të ecur përpara, sepse në këtë fazë ne nuk jemi një vend demokratik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se situata e re, e krijuar pas 14 janarit, është si pasojë e mos zbatimit të vendimit të Kuvendit nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Me këtë rast mendoj se është vë në pikëpyetje institucioni më i lartë i shtetit dhe është vë në pikëpyetje edhe funksionimi i demokracisë dhe i shtetit ligjor.

Për mua është tepër shqetësuese edhe deklarata e disa ndërkombëtarëve se Qeveria mund të mos e zbatojë vendimin e Kuvendit, që domethënë është cenim i demokracisë dhe shkelje e rëndë e parimeve demokratike.

Sa i përket çështjes së intervenimit të policisë në protesta, ka mundur të jetë më ndryshe. Për arsye, sepse vetë ata që i kanë dhënë urdhra policisë, ka qenë dashur të kujtojnë se mbi Urën e Ibrit ende ka bllokada, se në pjesën veriore të Kosovës ende ka bllokada ku cenohet liria e qarkullimit edhe të njerëzve edhe të mallrave, dhe është dashur të mendohet pak më tepër rreth kësaj.

Mendoj se sjellja e tillë ndaj deputetëve të Parlamentit të Kosovës, gjithashtu është shkelje e identitetit, shkelje dhe përdhosje e institucionit shtetëror dhe nuk ka qenë dashur të ndodhë, sepse ka pasur hapësira që të ketë edhe sjellje tjera, pa marrë parasysh se a është vë në pikëpyetje tash liria e qarkullimit apo jo në pikat kufitare ku është protestuar.

Unë mendoj se Qeveria para se të merret me këto çështje duhet ende të punojë rreth zbatimit të vendimit të Kuvendit për reciprocitet ndaj Serbisë. Nuk është aspak e arsyeshme që këtu përsëri të silllet një mocion tjetër dhe të anashkalohet vendimi që është marrë në dhjetor.

Nga Qeveria e Kosovës nuk është bërë as përpjekja më e vogël që të respektohet ky vendim, prandaj unë jam përsëri për këtë vendim, kam votuar për këtë dhe parimisht do të kërkoja nga Qeveria e Kosovës që të respektojë vendimin e Parlamentit të Kosovës, sepse Parlamenti i Kosovës është institucioni më i lartë shtetëror i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Debati i sotëm për mocionin e iniciuar nga Partia Demokratike e Kosovës po zhvillohet në një situatë të re të krijuar pas zhvillimeve të fundjavës së kaluar në Kosovë.

Momentet aktuale politike nëpër të cilat po kalon Kosova kërkojnë një përgjegjësi më të madhe nga secili prej nesh që me votën tonë të kujdesemi për vullnetin e sovranit, votuesit, qytetarit të Kosovës.

Mocioni i Parlamentit për zbatimin e reciprocitetit me Serbinë nuk zgjidhet me protesta, por me rrugë institucionale përmes impenjimit më të madh të Qeverisë në funksion të zbatimit të vendimeve të Parlamentit dhe harmonizimit të vendimeve në mes të gjitha forcave politike në vend.

Është përgjegjësi e secilit prej nesh të krijojmë rrethana dhe klimë më të mirë politike në mënyrë që Kuvendi i Kosovës, Qeveria dhe të gjitha institucionet ta bëjnë punën e tyre. Vendimet që dalin nga kjo sallë nuk duhet të mbeten në letër, në tavolinat e Qeverisë. Implementimi më azhur vendimeve të Parlamentit nga ana e Qeverisë është vendimtarë për zhvillimin e përgjegjësisë institucionale si dhe kjo do të jetë në funksion të plotësimit të rekomandimeve të Raportit të Progresit për Kosovën, për rritjen e rolit të Parlamentit në vendimmarrje. Por, në të njëjtën kohë askush prej nesh nuk e ka mandatin që në çfarëdo rrethane problemet t'i nxjerr nga institucionet në rrugë apo të tentojë që ligjin e rendin ta mbajë në duart e veta.

Pikërisht, ky vendim këta deputetë pas debateve të shumta dhe votimeve krejtësisht demokratike e të lira i kanë dhënë vizë Qeverisë së Kosovës, e kanë mandatuar atë për bisedime për çështjet teknike me Beogradin, gjithnjë të ndërmjetësuar dhe të lehtësuara nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Beogradi nuk po tregon sa duhet vullnet e gatishmëri që t'i kryejë përgjegjësit e tij në konkretizimin e rezultateve të bisedimeve dhe këtu mendoj unë është problemi kryesor. Këtë duhet ta dinë dhe ta kenë parasysh konsideroj edhe ndërmjetësit dhe miqtë tanë nga Bashkimi Evropian. Ky është problemi esencial i moszbatimit të plotë edhe i asaj që quhet reciprocitet me Serbinë.

Megjithatë, e tërë kjo që do të duhej të jetë motivim i strukturave të caktuara politike në Kosovë që të bëjnë edhe këndej të njëjtën gjë, ajo pasqyrë e keqe e serbëve të veriut nuk guxon të bëhet kopje edhe nga shqiptarët që përmes bllokimit të rrugëve dhe qarkullimit të lirë të bëjnë përpjekje të marrin ligjin në dorë, të shkelin Kushtetutën, mandatin dhe vullnetin demokratik të votuesve të tyre dhe të qytetarëve të Kosovës.

Në situatat e tilla me të drejtë komunikimi ndërkombëtar do të mund të tërhiqte paralelen dhe të na krahasonte me serbët e veriut. Kjo për faktin se katër liritë: liria e lëvizjes së njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit është parim bazë i Unionit Evropian. Për më tepër ky Union Evropian ekziston për të vetmen arsye dhe kjo arsye është evitimi i të gjitha barrierave për zhvillimin e katër lirive të lartpërmendura në funksion të promovimit të ekonomisë së tregut.

Po i referohem katër lirive të lëvizjes për të argumentuar faktin se sot, në totalin e marrëdhënieve ndërkombëtare, çdokush që i cenon këto liri do të jetë i gjykuar dhe do të bartë fajësi, pavarësisht shkaqeve që i shkakton cenimet e këtyre lirive.

Veriu i keq nuk mund të jetë një kopje e mirë, sikur pati përpjekje të ndodhë me iniciativën e një pjese të politikës opozitare në Kosovë.

Unë mendoj se në vend të thellimit të dallimeve dhe thellimit të paarsyeshëm të frontit dhe përçarjeve politike, më e udhës do të ishte të bëhemi bashkë t'i harmonizojmë qëndrimet, idetë dhe konceptet për ta normalizuar jetën dhe siguruar lëvizjen në liri të qytetarëve tanë në veri të Kosovës.

Ne gjithashtu jemi në një situatë kur duhet të presim rezultate të bisedimeve dhe të kërkojmë përgjegjësi nga Qeveria për rezultatet e bisedimeve, përgjegjësinë e zbatimit të atyre rezultateve nga ajo në partneritet me faktorin ndërkombëtar. Ne vetë e kemi mandatuar Qeverinë për këto çështje.

Unë ju ftoj që në procesin e menaxhimit të rrugës drejt integritetit evropian, të marrim pjesë të gjithë bashkë, t'i ndajmë meritat, mundin dhe përgjegjësitë secili së bashku.

I ftoj kolegët e caktuar deputetë që të heqin dorë nga shprehja e pakënaqësisë përmes formave të ndryshme të protestave, ta kalojnë këtë stad. Përfaqësimi në Kuvend është përgjegjësi më e lartë e të zgjedhurit dhe në funksion të unifikimit të gjitha forcave politike për çështjet me rëndësi shtetërore, siç është ushtrimi i sovranitetit shtetëror dhe raportet me Serbinë, e kjo përgjegjësi do të jetësohet me mençuri politike, me vizion e largpamësi.

Për aq kohë sa jemi të përçarë në këtë rrugë, do t'i krijojmë mundësi dhe terren Serbisë që të rehabilitohet sa më shumë në rrafshin ndërkombëtar, që të jetë gjithnjë më komode në diplomacinë e saj destruktive kundër Kosovës, pavarësisë sonë dhe njohjeve të reja ndërkombëtare, që i presim.

Prandaj, konsideroj se mocioni i sotëm i Partisë Demokratike të Kosovës duhet të gjejë përkrahjen e gjithë neve në këtë Kuvend. Ky mocion e ka pikërisht këtë synim dhe jo ndonjë kundërvënje politike ndaj një mocioni tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën!

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Protesta e 14 janarit shkaktoi pamje trishtuese. Kthimin e kujtimeve të vështira, ende të freskëta në mendje të qytetarëve. Krijoi një ndjenjë të rëndë, të shohësh Policinë tonë kundër qytetarëve tanë. Shkaktoi një polarizim të ashpër të skenës politike në ne dhe ta. Krijimin e një pamje të ngjarjeve në versionin bardh e zi dhe instalimin e dhunës si mjet politik.

E gjithë kjo, bën të mendosh: Si erdhi deri këtu? Kush e shkaktoi, çfarë dobie i solli Kosovës dhe si të vazhdohet?

Këtu nuk mund të anashkalohet që pjesa kapitale e fajit i takon Qeverisë, për shkak të nënçmimit në vazhdimësi të Kuvendit të Kosovës.

Nënçmimi i Kuvendit me Rezolutë për fillimin e bisedimeve, të votuar një ditë pas nisjes së bisedimeve, e cila komplet e eliminoi rolin e Kuvendit në këto bisedime, biseda pa platformë bisedimesh, pa ratifikim vendimesh në Kuvendin e Kosovës.

Ky nënçmim i vazhdueshëm i Kuvendit, solli nevojën për një mocion si masë korrigjuese e gjithë kësaj. E Qeveria, vazhdoi me moszbatimin e reciprocitetit. Dhe sot, kërkon edhe shfuqizimin e saj.

Mungesa e iniciativës për bisedë me Vetëvendosjen për evitimin e protestave, është përsëri vazhdimësi e shkyçjes së gjithë akterëve prej bisedave. Logjika përjashtuese e Qeverisë, apo sundimi i Qeverisë mbi Parlamentin, urdhri i Qeverisë për Policinë për përdorim të dhunës së tepruar. Cila qeveri urdhëron policinë kundër qytetarëve të vet? Cila qeveri urdhëron qeverinë që ajo ta humbë kredibilitetin para qytetarëve të vet?

Vendosja e kordonit të policisë në vendbanim, që me vetëdije të rrezikohen banorët e atij vendbanimi. Dhënia e afatit për 5 minuta për deri sa në protesta në veri ka durim të pakufishëm. Rrahja e qytetarëve, e atyre nëpër oborre të veta, të personit në karrocë, të gazetarit, rrahja e deputetëve dhe nënkryetarit të Kuvendit.

Më 14 janar u rrah Parlamenti! Çka duhet të presim pas rrahjes së nënkryetarit? Rrahjen e kryetarit të Parlamentit!? Rrahjen e presidentes?! Çka pritet pas kësaj?

Po, mungesa e strategjisë zhvillimore, një papunësi, korrupsioni, mungesa e zbatimit të ligjit, vjedhja e votave dhe fitimi i pushtetit me abuzim – ka krijuar shkallën e lartë të pakënaqësisë. Dhe kjo pakënaqësi normal se është burim potencial për protesta.

Por, në anën tjetër, mendoj se edhe Vetëvendosja e ka pjesën e vet të përgjegjësisë. Përdorimi i mocionit, të votuar prej tri partive opozitare, si shkas për protesta pa i shterur mundësitë institucionale, pa kërkuar bashkëveprim me këto parti tjera të cilat ndihmuan që ajo pjesë e letrës e dhënë prej Vetëvendosjes të shndërrohet në vendim të Kuvendi të Kosovës. Dhe në qoftë se flitet në emër të popullit, në qoftë se kërkohet një masë në emër të popullit, atëherë në emër të popullit duhet të mblidhen votat e popullit në këtë Parlament.

Mendoj se ajo ndjenja e mungesës së shpresës së popullit pa shpresë, mungesa e shpresës apo pa shpresa e popullit – papunësia, u përdorën dhe u ndihmuan që të mblidhet një numër i madh i qytetarëve në këto protesta.

Po ku është sot Kosova pas 14 janarit? Çka u arrit, cili është përfitimi? Nga zyrat e NATO-s dëgjuam krahasimin e situatës së sigurisë në Kosovë me situatën e marsit 2004 dhe shndërrimin e Kosovës në një terren potencial të dhunshëm. E kjo do të ndikojë në kërkesën e aplikimit të masave mbrojtëse politike ndaj grupeve potencialisht të rrezikshme. A e kemi dashur këtë? S'ma merr mendja!

Qytetari sot, pas 14 janarit është edhe më i shqetësuar nga dhuna, dhe rritja e pakënaqësisë vetëm se vazhdon.

Sot kur po flitet për biseda politike Kosovë – Serbi, kur opsionet e Tadiqit po merren në konsiderim nga shtetet e fuqishme evropiane, sot i japim një mundësi më të madhe të përkrahjes së ideve për masat mbrojtëse ndaj komuniteteve dhe territorit i cili sot nuk po menaxhohet nga Kosova.

Në këtë moment, mendoj se nuk kemi luks të merremi me faje, por të kërkojmë zgjidhje. Të kërkojmë zgjidhje për tejkalimin e situatës.

Kosova sot ndodhet në një udhëkryq të rrezikshëm ku kërkohet maturi maksimale, kërkohen koka të ftohta dhe zgjidhje të shpejta.

Por sot, në fillim të seancës, u kërkua shfuqizimi i atij mocioni. U kërkua një mocion i ri dhe kjo fatkeqësisht nuk jep shenjë që Qeveria me të vërtetë kërkon zgjidhje. Qeveria nuk kërkon qetësim të situatës, por vazhdimin e lojës kush është më i forti, e në këtë kohë tregon se e gjithë kjo shkon në dëm të Kosovës.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu!

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryetar i Parlamentit!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryemistra,

Ministra,

Të nderuar kolegë dhe ju kolege deputete,

Kohëve të fundit e kemi dëgjuar shumë herë se në çdo vend të botës ekziston e drejta e protestës. Kjo është më se e vërtetë dhe është shumë mirë që kjo e drejtë radhitet ndër të drejtat themelore të njeriut edhe në Kosovë.

Por, të nderuar, të shfrytëzosh këtë të drejtë thelbësore për të bllokuar kufijtë e shtetit, është keqpërdorim i kësaj të drejte. Tentimi për bllokimin e kufijve është një akt antishtetëror dhe secili që mendon se mund ta bëjë një gjë të tillë, duke besuar se organet shtetërore do të rrinë duarkryq dhe do të sodisin ka rënë vetëm prej manipulimeve.

Nga organizatorët e protestës së fundit, shpesh po tërhiqen disa paralele të mbështjellura në një zhargon politik propagandues, duke krijuar konfuzion tek pjesa dërmuese e qytetarëve të Kosovës.

Paralelja e parë, është krahasimi me veriun e Kosovës, duke e bërë parim të veprimeve të veta. Çka po ndodhë në veri, mund të ndodhë edhe në pjesë tjera të vendit. Si mundet që dikush të tërheq një paralele të tillë tani kur më në fund arritëm që gjithë bota ta kuptojë, ta pranojë dhe ta dënojë se në këtë pjesë të vendit ekzistojnë struktura kriminale të cilat minojnë çdo të drejtë njerëzore dhe çdo aspekt të shtetësisë së Kosovës.

Kush nga ne ka leverdi që të identifikohet me këto struktura kriminale? Populli i Kosovës, dhe unë personalisht jo.

Paralelja e dytë është ajo në mes Policisë së Kosovës dhe regjimit millosheviqian. Nëse protestuesit, kudo qofshin ata, sulmojnë policinë atëherë policia do të ndërhyjë. Kjo nuk ndodh vetëm në Kosovë. Kjo ndodh në çdo vend të botës. Dallimi i vetëm është që në sistemet demokratike gjërat analizohen dhe vlerësohen. Dhe nëse vërtetohet se është përdorur forca pa arsye, atëherë duhet të ketë mekanizma për të cilët do të kërkohet përgjegjësia, por përgjegjësia, të nderuar, duhet të kërkohet çdo herë objektivisht nga të gjitha palët e përfshira në ngjarje.

Personalisht jam kundër tërheqjes së paraleleve me një regjim shfarues, duke apeluar kështu në ndjenjat ende të lënduara të këtij populli. Vetë pamjet e tilla si ato të 14 janarit ngjallin frikën dhe traumat ende të freskëta të asaj kohe famëkeqe. Nëse dikush me metoda të tilla koncepton patriotizmin, atëherë nga kjo foltore i them se nuk ka as idenë se çka nënkupton patriotizmi.

Kosovës nuk i duhen më viktima. Kosovës nuk i duhet më gjak, sepse ka dhënë mjaft nga të dyja në të kaluarën. Tani duhet të punojmë në forcimin e shtetit, në forcimin e institucioneve, në forcimin e lirisë.

Ky forcim nuk arrihet duke nxjerrë grupe njerëzish në rrugë dhe duke i pozicionuar ata kundër policisë, kundër institucioneve dhe kundër shtetit të Kosovës.

Slogani i protestës së fundit ishte “ta ndalojmë Serbinë në Kosovë”. Por, të nderuar prapa tij fshihej – “duam pushtet”.

Organizatorët e kësaj proteste e dinë shumë mirë se tregtia nuk ndalet me një formë të tillë veprimi. Protesta është e drejtë dhe demokratike, por ajo mund të manifestohet në dy forma, në atë konstruktive dhe në subversive.

Lëvizja Vetëvendosje në të kaluarën ka realizuar disa aksione të cilat, me plotë kuptimin e fjalës mund të cilësohen si formë konstruktive e protestës, për çka edhe kishte përkrahjen dhe simpatinë e shumicës. Por, protesta e 14 janarit kishte një bazë shkatërruese dhe nuk mund të cilësohet ndryshe vetëm si subversive. As forma, as koha, as motivi i kësaj proteste nuk mund të quhen ndryshe vetëm se shumë të dëmshme për Kosovën.

Organizatorët e kësaj proteste e dinë shumë mirë se tentimi për bllokimin e kufijve nuk do të ketë efektin e sloganit të kësaj proteste. Prandaj, dua që të dërgoj një apel tek të gjithë qytetarët se efekti më i mirë arrihet duke u vetëdijësuar të gjithë ne për t'i dhënë prioritet prodhimeve vendore. Kjo do të shërbejë në ngritjen e vazhdueshme të kuantitetit të prodhimeve, por në të njëjtën kohë do të shërbejë edhe në ngritjen e vazhdueshme të kualitetit që për prodhimet tona është shumë me rëndësi.

Qytetarët e Kosovës, e dinë se Kosova është nënshkruese e disa marrëveshjeve ndërkombëtare dhe se ato marrëveshje duhet respektuar. Dhe, ne qoftë si popull në përgjithësi, por qoftë edhe ne këtu si deputetë i gjykojmë dhe kundërshtojmë barrikatadat dhe pengimin e lëvizjes së lirë në veri dhe të njëjtën kohë të njëjtat i tolerojmë në pjesë të tjera të Kosovës, atëherë ne humbim çdo seriozitet dhe çdo besim në atë çka synojmë.

Apeloj tek të gjithë qytetarët e Kosovës se mënyra më e mirë dhe më e shëndoshë e protestës është dhënia e prioritetit prodhimeve vendore. Nëse mallrat nga Serbia, të cilat si duken ishin një nga shkaqet kryesore të kësaj proteste, janë aq të urryera, atëherë lini në raftet e shitoreve dhe ato do të dalin vetë nga Kosova.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 14 janar Qeveria është marrë me demonstratën tonë nëpërmjet policisë, dhe këtë e dimë të gjithë.

Policia e Kosovës atë ditë ka qenë instrument në duart e Qeverisë për ta dhunuar të drejtën elementare dhe universale të qytetarit për demonstratë paqësore. Dhe, sa herë që me demonstratat paqësore është marrë Qeveria përmes Policisë dhe sa herë është zbatuar ndërhyrja e tyre, dhuna ka qenë e provokuar, e shkaktuar dhe e zbatuar me urdhër të Qeverisë. Kurse sa herë është zbatuar skenari i Vetëvendosjes kurrë, asnjëherë, askush nuk është lënduar sepse lëndimi kurrë nuk është qëllim.

E dyta. Qeveria qëllimisht e ka shmangur dhe devijuar thelbin e çështjes. Krejt diskutimi është reduktuar në atë se kush ia nisi i pari – a Lëvizja Vetëvendosje, a Policia? Unë po them, asnjëra.

Këtë problem e ka filluar Qeveria. Pse po them kështu? Po them kështu sepse Kuvendi e ka bërë punën e vet. E ka miratuar reciprocitetin e plotë politik, ekonomik dhe tregtar me Serbinë, kurse Qeveria nuk e ka bërë punën e vet.

Në këtë mënyrë ne po hyjmë në një fazë autoritarizmi politik, sepse çdo ditë e më shumë po konturohet një Qeveri e cila nuk ka kurrfarë kufizimi. Ajo tashmë nuk kufizohet dhe nuk kontrollohet nga Kuvendi, nuk monitorohet nga drejtësia dhe nuk kontrollohet nga populli. Kjo Qeveri kontrollohet nga katër faktorë tjerë: nga interesi personal; siç e pamë më 14 janar nga interesi ekonomik i Serbisë; nga stabiliteti në Ballkan në kurriz të shqiptarëve, dhe nga zyrat e huaja ndërkombëtare. Ky nuk është lajm i mirë për demokracinë.

Së treti. Është thënë se Lëvizja Vetëvendosje po e merr në duar shtetin dhe ligjin. Kjo, nuk është e vërtetë! Ne vetëm po e shfrytëzojmë një të drejtë universale, e bile edhe të garantuar me Kushtetutë, pra të drejtën e protestës, për të bërë trusni mbi Qeverinë që ajo t'i kryejë detyrat e saj. Ky është 14 janari.

Aty ku Kuvendi i kryen detyrat dhe nxjerr vendime, por Qeveria rebelohet dhe i shpërfillë ato, nuk mund të ketë demokraci dhe rend institucional republikan. Në këtë

mënyrë, ajo që po i ndodhë Kosovës mund të definohet si ngritje e pushtetit përmbi shtetin.

Aty ku pushteti ngrihet mbi shtetin, ky është fundi i shtetit demokratik. Qeveria vazhdimisht thirret te shteti por e vetmja gjë në të cilën seriozisht po investon, është pushteti. E shtete, ka lloj – lloj. Shtet është edhe Siria, por ne duam shtet të së drejtës.

Kjo është arsyeja pse kemi protestuar atë ditë. Dhe ne nuk e kemi marrë ligjin në dorë, por do të bëjmë gjithçka që është e nevojshme që Qeveria ta merr ligjin në dorë.

Pyetja kryesore që një popull duhet t’ia shtrojë vetes, është kjo: Çka nëse Qeveria ndonjëherë nuk i zbaton ligjet, shpeshherë i shkelë ato, si dhe nuk e përfillë demokracinë? E popuj të ndryshëm, e kanë zgjidhur këtë problem moti.

Për shembull, amerikanët thonë se populli duhet ta mbrojë shtetin nga një qeveri arbitrare. Kurse duke e lexuar Kushtetutën e Italisë, e gjeta një nen shumë interesant, që e rregullon edhe këtë gjë. Po citoj: “Kur pushtetet publike shkelin të drejtat dhe liritë fundamentale të garantuara me Kushtetutë, rezistenca ndaj shtypjes është e drejtë dhe detyrë e qytetarit”. Kushtetuta jonë, nuk e rregullon këtë çështje. E megjithatë, kjo nuk mund të jetë arsye që të rrimë duarkryq tek sa Qeveria t’i shkelë të drejtat para hundës.

Ndërkohë, Qeveria thotë se ajo duhet ta ketë ligjin në dorë, qasja e saj e deritashme ndaj ligjit ka qenë selektive. Dhe dihet mirë se drejtësia selektive nuk është drejtësi.

Kur është puna te ligje e vendime të cilat e mbrojnë dhe forcojnë sovranitetin, shtetësinë dhe zhvillimin, Qeveria nuk paraqet interes. Pra, kur është çështja që të mbrohen prodhuesit vendës, që me masa të ndryshme të mbrohet tregu i Kosovës nga Serbia, ashtu sikur që e bëjnë plotë shtete të Bashkimit Evropian, dhe që me Serbinë të ketë reciprocitet – Qeveria i mbyllë sytë. Por kur vjen puna te ligjet e planit të Ahtisarit, sikur ai i Hoqës së Madhe apo enklavizimi i Prizrenit, Qeveria i mobilizon të gjitha resurset duke i përfshirë edhe thirrjet telefonike shtrënguese dhe shantazhin ndaj deputetëve.

Çka na tregon kjo? Kjo na tregon se Qeveria jonë më shumë është e Ahtisarit dhe aranzhmaneve ndërkombëtare se sa e popullit. Dhe në këtë rast, Ahtisari me interesat e popullit, nuk është i përputhshëm.

S’përputhja në mes këtyre dyjave si dhe prioritetizimi i Ahtisarit mbi interesat tona shtetërore dhe qytetare, e mundëson shkeljen e demokracisë në Kosovë.

Ne do të bëhemi shtet tamam demokratik, vetëm atëherë kur askush nuk është mbi ligjin, as Qeveria e as strukturat paralele të Serbisë, të cilat duhet të shpërbëhen në Kosovë dhe vetëm atëherë kur do ta vendosim interesin tonë shoqëror, qytetar dhe shtetëror mbi planin e Ahtisarit.

Për fund, po them se Qeveria po pretendon se paskemi reciprocitet me Serbinë. Kështu, po thotë! Logjika e Qeverisë, pra është kjo: Ne kemi reciprocitet me Serbinë, sepse kemi

marrëveshje me të. Marrëdhënia si e tillë nuk është vetvetiu reciprocitet. Reciprociteti është përmbajtja dhe cilësia e marrëdhënies. Marrëdhënia e njëanshme nuk është reciprocitet. Marrëveshja e cila, njërës palë i kërkon të heqë dorë nga kopjet origjinale të regjistrave civilë, të heqë dorë nga targat e saj republikane të automjeteve, të heqë nga emri i saj Republikë gjithkund, kurse palës tjetër ia lejon të gjitha, zonja dhe zotërinj ky nuk është reciprocitet.

Prandaj, gjërat duhet t'i thërrasim me emrin e tyre. Këto marrëveshje me Serbinë janë vulosje e mos-reciprocitetit.

Ka pas një prirje propagandistike të Qeverisë për ta devijuar diskutimin e vërtet të 14 janarit: A ka pas dhunë a nuk ka pas, kush ka filluar dhe kush ka përfunduar, a kemi pasur të drejtë a jo. Të gjitha këto nuk janë pa rëndësi, por rëndësia prioritare duhet gjithnjë të jetë: pse Qeveria nuk po e zbaton reciprocitetin me Serbinë.

Dhe ndonëse Qeveria ka lozur edhe mbi kartën e përçarjes së opozitës, ne si opozitë jemi të bashkuar në këtë pikë. Pra, reciprocitet i plotë me Serbinë. Kurse, mënyrat të cilat i zgjedhim t'i bëjmë trysni Qeverisë a me konferenca shtypi e debate parlamentare, apo përveç kësaj edhe me protesta e demonstrata, këto zotërinj janë metoda të subjekteve politike, me të cilat nuk do të merremi aq thellë sa të përhumbëm në to. Mbi të gjitha është mbrojtja e interesit të Kosovës pavarësisht rrugëve të cilat i kemi zgjedhur.

Tash këtu po sillet një mocion i cili do ta shfuqizojë mocionin e mëparshëm. Kur votoni në Kuvend, ju deputetë votoni për Kosovën. Hashim Thaçi sot është kryeministër, nesër mund të mos jetë. Por ju votoni sikur do të jetoni përgjithmonë këtu në Kosovë, sikur familjet e nipat tuaj dhe të gjitha brezat që do të vijnë do të jetojnë në një vend që ashtu qysh ia vlojmë ne atyre, që të jetojnë.

Pra, dita e sotme do të hyjë në histori kështu: Më 20 janar 2012 këta deputetë votuan që Kosova të jetë e barabartë me Serbinë, kurse këta të tjerët votuan që të shtrihet qafa ndaj Serbisë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kabinet qeveritar,

Mendoj se nuk ka nevojë të theksojmë se ne gjendemi në një situatë të ndërlikuar për zgjidhjen e së cilës duhet të tregojmë pjekurinë e duhur në interes të qytetarëve të Kosovës, në interes të dinjitetit të qytetarëve të cilët na kanë votuar në ato votime çfarëdo që ishin. Ne kemi hyrë këtu që të punojmë për të zbatuar ligjin, për të realizuar interesat e atyre qytetarëve dhe për tu shërbyer atyre, jo për t'i sunduar ata.

Pra, ne sot duhet të marrim vendime të cilat i kontribuojnë stabilitetit politik të Kosovës, i kontribuojnë ndërtimit dhe përmirësimit të imazhit të Kosovës, i kontribuojnë forcimit të rendit dhe ligjit dhe para se gjithash forcimit të institucioneve të Kosovës, duke i

respektuar institucionet në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësi të tyre ligjore.

Mendoj se gjithë këtë situatë mjaft të vështirë që e përjetuam në këto 10 ditët e fundit, diçka është pozitive. E ajo që është pozitive ka të bëjë me faktin se u kujtuam që Kuvendi është vendi ku kuvendohet për këto probleme kaq serioze, për të cilat ne kemi përgjegjësi. U kujtuam madje edhe ata pjesëtarë, disa nga kabineti qeveritar, të cilët pak ditë më parë e relativizojshin rolin e Kuvendit dhe vendimet e Kuvendit. Dhe, ky është një evoluim pozitiv. Unë e përshëndes atë evoluim. E përshëndes edhe kërkesën për debat të sotëm, sa do që unë i pash disa përpjeke qesharake lidhur me autorësinë e këtij debati. Janë qesharake sepse serioziteti i situatës është shumë më i ndërlikuar sesa dikush të marrë merita mbi iniciimin e këtij debati. Ky debat është kërkesë e qytetarëve të Kosovës, është kërkesë e deputetëve të këtij Kuvendi dhe ne duhet ta çojmë deri në fund me përgjegjësinë më të madhe.

Në këtë drejtim, ne sot jemi midis dy dokumenteve që i ka aprovuar ky Kuvend. Një, është Rezoluta jonë, me të cilën e kemi autorizuar Qeverinë që të zhvillojë bisedime teknike në Bruksel. Dhe ne, nuk mund ta injorojmë këtë fakt.

Dhe dy. Ky Kuvend ka vendosur lidhur me mocionin se reciprociteti i plotë politik, tregtar, ekonomik duhet të respektohet. Prandaj, edhe Qeveria edhe ne të dy këto gjëra duhet t'i shikojmë në një rrafsh të barabartë.

Nuk munden disa deputetë këtu të shohin vetëm Rezolutën për reciprocitet, ose kabineti qeveritar ta shoh vetëm Rezolutën për bisedime me Serbinë, kurse subjektet tjera vetëm mocionin. Këto dy janë pjesë përbërëse e një tërësie dhe këto dy rezoluta, qëndrimi ndaj tyre, e dokumenton përgjegjësinë tonë këtu. Ne duhet të sillemi me përgjegjësi ndaj të dy vendimeve.

Në këtë drejtim, mendoj se ka mjaft konfuzion dhe tendencë për zëvendësimin e tezave, dhe nuk mendoj se kjo na shpie në konkluzat të mira dhe na shpie për rezultate të mira.

Mu për këtë, mendoj se ne duhet të sillemi me përgjegjësi edhe për vendimet apo konkluzat që janë marrë në bisedimet teknike të Brukselit. Dhe, duhet të gjitha ato vendime që nuk e lëndojnë sovranitetin e Kosovës, që e përmirësojnë jetën e qytetarëve të Kosovës t'i aprovojmë dhe të kërkojmë të zbatohen.

Nuk e dimë sa po zbatohen. Qeveria po thotë po zbatohen plotësisht, tjerët thonë nuk po zbatohen, prandaj ky Kuvend nuk ka informacion të plotë sa po zbatohen këto.

Mu për këtë, ne duhet të konstatojmë sa po zbatohen këto marrëveshje, nën një. Dhe, nën dy, duhet të konstatojmë sa po zbatohet reciprociteti.

Ne kemi vlerësime diametralisht të kundërta. Qeveria thotë, gjithçka është mirë me reciprocitetin. Tjerët, ka edhe deputetë, e ka parti politike që thonë: asgjë s'është mirë me këtë; Dhe ky Kuvend duhet ta ketë informacionin e plotë.

Dhe, mu për këtë qëllim, unë propozoj sot që si konkluzë nga debati i sotëm, zoti kryesues, pra një konkluzë që të formohet komisioni i Kuvendit i cili, duke i mbështetur të gjitha marrëveshjet që janë mbërri në Bruksel, të cilat nuk e lëndojnë sovranitetin e Kosovës të konstatojë zbatimin e tyre dhe problemet në zbatimin e tyre, në një.

Nën dy. Komisioni i Kuvendit duhet që të shqyrtojë zbatimin e reciprocitetit.

Dhe, nën tre. Duhet të shqyrtojë gjithçka që ka ndodhur me 14 janar. Duhet t'i konstatoj të gjitha shkeljet e ligjit, edhe nga organizatori i protestave, edhe nga policia, edhe nga Qeveria, edhe nga secili. Sepse, ky Kuvend, nuk mund të amnistojë më shkeljen e ligjit.

Nëse ky Kuvend, vazhdon ta amnistojë shkeljen e ligjit, ne nuk do të ndërtojmë institucione demokratike. Dhe ju lutem, këtu nuk mund të thirremi më te ndërkombëtarët. Ndërkombëtarët janë këtu për të na ndihmuar që të zbatohet ligji. Edhe unë besoj se ata e dinë këtë fare mirë. Të gjitha qeveritë e tyre i kanë autorizuar dhe kanë kërkuar këtë prej tyre.

Prandaj, të gjitha angazhimet e ndërkombëtarëve janë të mirëseardhura nëse institucioneve të Kosovës iu ndihmojnë në zbatimin e ligjit dhe ne i mirëpresim në këtë drejtim.

Mu për këtë, duke formuar këtë komision, unë kërkoj prej kolegëve tanë deputetë që me formimin e këtij komisioni të kihet ndikim në mos mbajtjen e demonstratave, ose për evitimin e demonstratave, deri sa të konstatohet dhe të shohim çka mund të bëjë ky Kuvend. Kjo është kërkesë e imja dhe kërkoj që të zbatohet ligji.

Nuk mund askush ta marrë ligjin, as Vetëvendosja, as Qeveria. Dikush tha, ta marrë Qeveria. Jo, zotëri! Do ta merr Kuvendi ligjin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Behar Selimi!

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më vjen mirë që po më jepet mundësia të jap kontributin tim në këtë debat, duke qenë se kam përvojë edhe të institucionit i cili po përflitet kohën e fundit për dhunë policore, po edhe e kam një përvojë prej juristi dhe besoj se do t'i ndihmoj debatit që në fund të miratohet një akt politik, quani si të doni, në dashit rezolutë, në dashit deklaratë, në dashi vendim, e i cili akt politik kishte me e qartësuar akoma më shumë përgjegjësinë politike që Qeveria e ka karshi deputetëve. Pra, përgjegjësia politike është e vetmja përgjegjësi që Qeveria e ka karshi deputetëve dhe deputetët i kanë një varg masash ose mekanizmash përmes të cilëve e merr në përgjegjësi politike Qeverinë, duke e përfshirë në fund edhe mocionin e mosbesimit.

Shpresoj se në fund të debatit do të arrijmë ta kemi një akt politik i cili po ashtu qartëson edhe diçka tjetër që Kushtetuta jonë e ka organizuar pushtetin mbi bazën e parimit të ndarjes së pushteteve por edhe mbi bazën e ekuilibrit dhe të kontrollit reciprok. Me ekuilibrin, asnjë rast nuk nënkupton, se këtu ka edhe profesorë me tituj shkencorë dhe mund të më korrigjojnë, por ekuilibri në asnjë rast nuk nënkupton që njëri pushtet t'i hipë në qafë pushtetit tjetër. Domethënë, kjo është ajo që unë e kuptoj dhe e interpretoj si parim të ndarjes së pushteteve dhe të kontrollit reciprok dhe të ekuilibrit.

Besoj se në fund akti politik gjithashtu do të sqarojë akoma më shumë llogaridhënien politike të Qeverisë përmes afatizimit të raportimit të saj për zbatimin e masave të reciprocitetit. Gjithashtu mendoj se në fund të debatit, Parlamenti përkatësisht deputetët, përmes një akti politik do të tregojnë urtësi politike, pjekuri politike për të kuptuar se zbatimi i masave të reciprocitetit është proces.

Unë mund të mos e njoh reciprocitetin tregtar, mund të mos e njoh reciprocitetin ekonomik, por një gjë e kam të qartë se procesi i reciprocitetit politik do të zgjasë deri atëherë kur Republika e Serbisë ta pranojë Kosovën dhe ne ta pranojmë Republikën e Serbisë.

Pra, me një akt politik, me një terminologji të kujdesshme, me një vullnet politik të manifestuar ne mund ta mbështesim Qeverinë në procesin e zbatimit të masave të reciprocitetit.

Sigurisht se shumëkush prej juve pret nga unë që të flas diçka edhe për sundimin e ligjit, e sidomos për vetë aksionin.

Ky vend dhe ne si qytetarë të këtij vendi kemi kaluar shumë procese. Kemi kaluar një proces përmes të cilit është fituar liria. Me sa mund e me sa sakrifica e dimë ne, po e dinë edhe qytetarët më mirë se ne. E kemi krijuar po ashtu edhe paqen. E kemi ndërtuar edhe shtetin. Është pavarësuar ky shtet. Po një gjë akoma s'e kemi bërë dhe e kemi shumë vështirë me bërë, me krijuar shprehi të zbatimit të ligjit.

I kemi arsyet tona pse kemi problem me zbatimin e ligjit, lidhen edhe me të kaluarën tonë nën okupim, përkatësisht lidhet me të kaluarën tonë në kundërshtim të ligjeve të cilat nuk kanë qenë vullneti i këtij Kuvendi apo i popullit të Kosovës, prandaj edhe e kemi vështirë. Po ashtu, e kemi vështirë të veprojmë institucionalisht sepse kemi qenë të detyruar të veprojmë vite me radhë jashtë institucioneve për të ardhur deri te liria. Të gjitha këto, i kuptoj.

Unë thërras që sa më parë të fillojmë përditë secili prej nesh që ta promovojmë sundimin e ligjit, që të jetojmë me ligj, të bëjmë politikë me ligj, të bëjmë demonstrata me ligj. Pra, të jetojmë për ligjin, e kush donë vazhdimisht të jetë me ligjin.

Sa i përket aspektit legal dhe legjitimitetit, mund të më korrigjoj profesor Arsimi, sepse më herët e dha edhe ai një ligjëratë të mirë dhe unë kam qenë student i tij dhe e di që më

ka vlerësuar mirë atëherë prandaj nuk dua me e përsëritur profën, por Ligji për tubimet publike e ka një nen 7 paragrafi 4 dhe ai Ligj shprehimisht e ndalon tubimin të çerdhet, të ambulantet, të përmendoret e heronjve, në udhëkryqe dhe në magjistrale. Pra, edhe nëse dikush e paralajmëron tubimin në polici, policia nuk do të ketë të drejtë me lejuar, e madje edhe Qeveria nuk do të ketë të drejtë me lejuar dikë që të mbajë tubim në udhëkryq apo në magjistrale që ligji shprehimisht e ndalon. Neni 3 i këtij ligji, në bazë të përkufizimeve, na e jep interpretimin më të drejtë të mundshëm. Qoftë edhe me paralajmërim, tubimet e tilla në magjistrale, në udhëkryqe, e mos t'i përmend edhe një herë, në vende tjera – janë në kundërshtim me ligjin. Kështu unë e jep këtë interpretim. Mund të jetë pak i stilit dogmatik policor por edhe ka juristë që mund të më korrigjojnë.

Prandaj, kjo është shqetësuese. Dhe ajo që më ka shqetësuar shumë dhe besoj se e ndaj mendimin e shumicës së deputetëve, madje edhe të atyre që kanë marrë pjesë në sjelljen e fundit politike. Ka ditë që në diskursin politik Policia e Kosovës, dhe nuk po i përmend disa shprehje që janë përdorur, po edhe kërkoj mirëkuptim që të mos keqkuptohem, sepse kam shumë arsye me folur për Policinë e Kosovës. Pra, është bërë diskurs politik institucioni që përflitet, sulmohet kryesisht, akuzohet. Dhe, po harrojmë, me gjithë respektin që kam për kryetarin e Parlamentit dhe lutjen e tij që të mos futemi në histori, e unë megjithatë do të futem në historinë më të re të Kosovës. Ata policë, një numër i konsiderueshëm prej tyre, akoma i kanë gjurmët e plagëve të luftës së lavdishme, plagë që i kanë marrë nën betimin për flamurin kuq e zi, plagë që kanë marrë nën betimin për çlirim dhe bashkim.

Ata policë, që kanë qenë në protesta, një numër i konsiderueshëm janë të tillë. Sot i shërbejnë Republikës së Kosovës, flamurit të Republikës së Kosovës dhe zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës dhe janë të lumtur. Ata presin prej nesh që t'i mbështesim, t'i mbështesim me mirëqenie sociale, t'i mbështesim me sigurim social. Për të gjitha ato lëndime që i kanë marrë, mua më vjen shumë keq, me gjithë respektin që e kam, sidomos për qytetarët aty, por ata policë që janë lënduar kurrfarë sigurimi shëndetësor nuk kanë. Sigurisht ata s'kanë pasur qëllim politik me dalë aty, as nuk i ka çuar familja e tyre me dalë aty. Janë dalë me e zbatuar një ligj, dhe më së rëndi e kanë pasur ata.

Ata policë, në vitin 2004, kur Kosova mbeti pa UNMIK-un, sepse të gjithë policët e UNMIK-ut u strehuan disa në enklava, që edhe në ato enklava, tash po zhvillohet jetë normale, disa në Republikën e Serbisë. NATO-ja kishte problem me mandatin e saj. Nuk e dinte çka me bë. Vetëm këta policët e Kosovës e majtën ato ditë Kosovën. Kemi këtu edhe një aktor kryesor, në atë kohë, ish kryeministrin Rexhepi, përkatësisht ministrin aktual të Punëve të Brendshme.

Po ata policë, më 19 shkurt të vitit 2008 kur u shpall Pavarësia, ishin në Jarinjë dhe Bërnjakë, në mes të Serbisë e Kosovës, të plagosur. Shkuan, dy ditë pas shpalljes së pavarësisë që me trupat e tyre, pa përgatitje, sepse UNMIK-u s'e ka përgatitur Policinë e Kosovës si polici shteti. Pra, me trupat e tyre të plagosur shkuan që të ketë rend e qetësi në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjakë. Shumëkujt i kujtohen edhe pikat kufitare në Mutivodë dhe Muçibabë kur duarthatë policët tanë i mbrojnë edhe ato pika. Këta janë ata

policë. Bile që, edhe me emra e mbiemra mund t'ua them, sidomos këta që kanë qenë te pika kufitare në Merdar.

Më vjen keq, mund të keqkuptohem, mund të duke se po flas me emocione, por kjo është e vërteta për ata policë dhe kulmi arriti me korrikun e vitit të kaluar kur ata shkuan dhe përfundimisht u rivendos integriteti territorial. Pra, nuk po përzihem në sovranitet të integritetit territorial.

Prandaj, ju kisha lutur shumë që në diskurs të jemi të kujdesshëm. Nuk dua me i amnistua policët. Përveç kësaj, unë dua të ju them edhe dy karakteristika profesionale. Nuk ka, ama bash hiq nuk ka demonstratë në botë në të cilën mos të ketë tejkalime individuale të autorizimeve nga ata që e zbatojnë ligjin. Është natyra e demonstratës së tillë. Sikundër që, dhe një karakteristikë tjetër po ashtu e përgjithshme, nuk ka asnjë tubim apo administratë në botë të mos jetë dikush në mesin e protestuesve që për arsye të ndryshme të pakënaqësisë, mund të ketë pas ndoshta edhe ndonjë pakënaqësi individuale, e deri te ata të cilët e shfrytëzojnë tubimin e dikujt tjetër për ta goditur policin. Këto janë dy karakteristika të përgjithshme, në gjitha demonstratat në botë. Janë të dhëna empirike, nuk është mendim i shlrshëm.

Prandaj, kisha lutur shumë që në diskurs... Unë sot jam i kënaqur, pati kujdes, është fjala për një institucion i cili ka kredibilitet dhe po krijohen perceptcione sidomos nga dy-tri imazhe që po i shohim në televizion – perceptcione pra të dhembshme që po i fusin fëmijët tanë mos me i besuar kësaj policie në të ardhmen.

Unë kam pas problem me djalin tim. Më ka akuzuar shumë nga ato pamje. Më ka thënë: “Ti i ke trajnuar, ti i ke ble ato rroba!”. Ndërkohë, ato janë dy-tri pamje të mërzitshme, trishtuese, të rënda për vendin.

Prandaj, si ata që merren me politikë, si ata që bëjnë analiza, është lutje e imja, nuk është kërkesë, dhe nuk kam të drejtë të kërkoj prej askujt asnjë gjë, pra është lutje e imja, por sidomos edhe prej mediave – të na kursejnë pak. Të na kursejnë nga ato pamje sepse në aspektin strategjik kjo polici do ta humbë kredibilitetin.

Pajtohem me të gjithë se pas atyre ngjarjeve sigurisht, sidomos mosha e vjetër dhe fëmijët, e kanë krijuar një perceptcion të gabuar. Dhe, të krijosh perceptcion të gabuar për Policinë e Kosovës do me thënë ta humbësh besimin për një institucion i cili do të jetë kryesori në vazhdim për luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit, i cili do të jetë kryesori.

Prandaj, unë e bëra këtë lutje me qëllim që të jemi shumë të kujdesshëm dhe njëkohësisht gjatë debatit të arrijmë t'i nxjerrim disa përfundime, të cilat mund të na shërbejnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Në fakt, po filloj, jo zakonshëm fjalën drejtuar jush. Po filloj me një lajm që e ka krijuar Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Pra, sot në lajmet e Radio-Kosovës, thuhet kështu, citoj: “Kuvendi po debaton mocionin e paraqitur nga PDK-ëja, i cili pritet ta shfuqizojë mocionin e reciprocitetit me Serbinë”. Mund ta vërtetoni këtë.

Pra, PDK-ëja po përpiket t’ia mohojë, ose duke u përpjekur t’ia mohojë Lëvizjes Vetëvendosje një argument për protestë dhe po e jep një argument tjetër. Deri dje, shkeli vendimin e Kuvendit, tani PDK-ëja, dhe Qeveria e saj, po përpiket ta shkelë vetë Kuvendin.

Por do t’i kthehem prapë para dhe pas datës 14 janar. Para datës 14 janar, në momentin kur Lëvizja Vetëvendosje paralajmëroi protestën në mbrojtje të Republikës për prodhime vendore, me moton “Serbia nuk kalon”, Qeveria e Kosovës dhe eksponentë të veçantë të kësaj Qeverie duke filluar nga kreu i saj filluan me tendencë të krijojnë një atmosferë dhune paraprakisht.

Dhe deklaratimet e tyre që protesta e Vetëvendosjes do të thotë dhunë, do të thotë viktima, pastaj edhe krahasime tjera me “janarin e Tiranës” të vitit të kaluar dhe krahasimet tjera me veriun e Kosovës mu duken me plotë të drejtë sikur krahasimet e dikurshme të vitit 1996 – 1997 për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës kur kjo ushtri krahasohej me rebelizmin në Shqipëri dhe po ashtu krahasohej dhe etiketohej si “dorë e zgjatur e Serbisë”.

Pra, Qeveria në vend që të bënte thirrje për qetësi dhe demonstratë të qetë, protestë të qetë si e drejtë e qytetarëve, ajo kërkonte të krijonte një atmosferë dhune qoftë në opinionin publik qoftë edhe në opinionin ndërkombëtar.

Por, çfarë ndodhi pastaj? Me datën 14 Lëvizja Vetëvendosje edhe një herë e demonstroi se nuk kishte as qëllim, nuk kishte as objektiv politik, as ta rrëzonte Qeverinë në kufi, as nuk kishte qëllim që të bënte protestë të dhunshme dhe protestë me viktima.

Kur përmenden viktimat, atëherë rrjedhimisht vjen një pyetje: Meqë Qeveria përmend viktimat, athua është e gatshme të shkaktojë edhe viktima në mbrojtje të interesave strategjike, politike dhe ekonomike të Serbisë në Kosovë? Por po ashtu edhe deklaratat e qeveritarëve pas protestës. Kryeministri thekson në deklaratën e tij, në emër të Qeverisë, citoj: “Qeveria është në mbrojtjen e interesave shtetërore”. Theksoj: “Qeveria ishte në mbrojtje të interesave shtetërore”! Nuk do shumë koment.

Po ashtu, ministri i Brendshëm thekson: “U përdor forca minimale ndaj protestuesve”. Dhe, rrjedhshëm vjen pyetja: “Po forca maksimale, cila do të jetë”?

Dhe, në anën tjetër u instrumentalizua edhe Policia e Kosovës me anë të zëvendësit të saj duke dhënë statistika të rrejshme, statistika të cilat i përsëriti tani ministri i Brendshëm këtu.

Në anën tjetër, gjatë gjithë rrjedhës së protestës ashtu siç u tha edhe më herët këtu, në gjithë hallkën e zinxhirit të zhvillimit të protestës në asnjë rast, asnjë protestues nuk dha argument për policinë dhe arsye për ndërhyrje të policisë ndaj protestuesve.

Ishin në fuqi vetëm urdhrat politike për t'i dhunuar, për t'i rrahur, maltretuar dhe terrorizuar qoftë pjesëmarrësit në protestë, qoftë ata jashtë protestës. Në të njëjtën kohë edhe urdhrat për arrestime selektive ishin një pjesë e skenarit, një pjesë shumë e rëndësishme e skenarit të reagimit të policisë dhe të Qeverisë ndaj protestuesve.

Pajtohem me shumë parafolës këtu, qoftë nga opozita, qoftë edhe nga pozita të cilët e duan dhe e respektojnë dhe mbi të gjitha e çmojnë Policinë e Kosovës.

Vërtet Policia e Kosovës në sajë të profesionalizmit të saj, në sajë të gatishmërisë së saj, por edhe në sajë të shumë policëve të cilët siç u tha kanë plagë lufte meriton të respektohet më shumë. Meriton edhe të respektohet edhe të ruhet kjo polici kredibile, e jo të përdoret sa herë që i teket Qeverisë së shtetit policor të Kosovës.

Është e vërtetë që policët kanë plagë lufte, por është po ashtu edhe vërtetë që edhe protestuesit kanë plagë lufte. Pra, njerëzit që kanë plagë lufte nga njëra anë dhe njerëz që kanë plagë lufte në anën tjetër, nuk do të duhej të futeshin në konflikt të tillë siç tenton të bëjë Qeveria e Kosovës.

Ministri i Brendshëm i Qeverisë tonë tha që gazi lotsjellës ka afat deri në 2014. Unë e di që Ministria ka edhe gaz lotsjellës, ka edhe plumba, ka edhe mjete tjera dhune, por ato nuk do të duhej t'i kishte për qytetarët e saj. Vërtetë ka gaz me afat deri me 2014, por po harron se vërtetë kjo Qeveri tashmë është e dalur nga afati vetë.

Në të njëjtën kohë, Ministri jep pasaktësi kur ky i referohet të dhënave të pasakta që është edhe një abuzim i radhës me postin të cilin e mban. Njëkohësisht do të duhej vërtetë të ndihej, jo vetëm të deklarohen, por të ndihej përgjegjës një ndër përgjegjësit kryesor bashkë me shefin e tij dhe si të tillë, do të duhej së paku me vrap të iknin dhe të jepnin dorëheqje morale, nëse vërtetë e kanë një gjë të tillë.

Me këtë shkallë të dhunës ndaj qytetarëve, ministri i Brendshëm u kthye në një dhunues gjakëftoftë ndaj demokracisë në vend, Kurse shefi i tij, kryeministri i Kosovës, u bë tash një diktator që është i gatshëm të shkelë mbi këdo që ai e percepton se po ia rrezikon sundimin e tij në pushtet.

Edhe kur të protestohet kundër Serbisë, ai ndihet i rrezikuar në pushtetin e tij. Edhe kur protestohet në Vellanicë, po ashtu ai ndihet i rrezikuar në pushtetin e tij. Edhe kur shoqëria civile e proteston, po ashtu ndihet i rrezikuar në pushtetin e tij. Edhe çmimet e autostradës e bëjnë të ndihet i rrezikuar në pushtetin e tij. Kudoqoftë, sundimi i diktatorëve duhet të merr fund.

KRYETARI: Deputeti Lutfi Haziri, a është këtu?

Atëherë, vazhdojmë. Deputeti Nijazi Idrizi, e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: I nderuari kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë jam deputeti i vetëm nga radhët e Partisë Demokratike që e kam votuar mocionin për vetëvendosjen e reciprocitetit me Serbinë, me mendimin se kam bërë një veprim të qëlluar dhe të mirë për vendin tonë.

Në të vërtetë, para votimit të këtij mocioni nga Kuvendi i Kosovës, vendosjen e këtyre masave e ka bërë Qeveria e Kosovës. Ky Kuvend, siç doli nga votimi paska qenë i pakënaqur me heqjen e këtyre masave dhe ka vendosur vazhdimin dhe thellimin e tyre. Për vazhdimin e tyre ky Kuvend, siç jeni në dijeni, nga përmbajtja e tij e ka obliguar Qeverinë që t'i zbatojë ato.

Të nderuar deputetë,

Serbia nuk ka të drejtë që të vendos barriera administrative ndaj Kosovës për t'i shëruar kompleksitetet e superioritetit dhe për ta mbajtur opinionin e vet të acaruar ndaj shtetit të ri fqinjë për qëllime të përfitimeve politike. Vendosja e masave të reciprocitetit ndaj cilit do shtet që nuk i respekton parimet e barabarësisë, është obligim kushtetues demokratik, e madje edhe humanitar i çdo shteti, pra edhe i Kosovës.

Opinionin po e kërkon reagimin institucioneve tona ndaj qeveritarëve serbë që po e vizitojnë Kosovën dhe po përdorin fjalor fyes dhe mohues ndaj shtetit dhe demokracisë së Kosovës. Po ashtu asnjë shtet e aq më pak Serbia nuk ka të drejtë që me masa administrative të përfitojë ekonomikisht në kurriz të mirëqenies së popullsisë së Kosovës. Qytetarët e Kosovës e kanë mirëpritur aplikimin e policave reciproke të sigurimit ndaj Serbisë dhe Malit të Zi dhe pse kjo masë i ka goditur rëndë qytetarët e Luginës së Preshevës, të cilët pa vullnetin tonë, janë mbyllur në geto, e për të cilët duhet të gjendet një zgjidhje.

Në këtë kuvend ka kaluar një emocion i cili, siç e thash, e obligon Qeverinë që ta zbatojë atë. Në këtë mocion askund nuk është shkruar se as duhet ta zbatojnë politike e as grupet e interesit, por vetëm Qeveria e Kosovës.

Unë nuk e kam kuptuar reciprocitetin si një akt të vendosjes së një barriere e ndalon qarkullimin e produkteve që ne tash nuk i kemi, e të cilat nëse sigurohen gjetiu, janë më të shtrenjta sepse kështu shkaktojnë ngritje të çmimeve dhe rrezikojnë mirëqenien e qytetarëve tanë në këtë kohë krize dhe varfërie.

Unë konceptin e reciprocitetit nuk e kam kuptuar madje as si një aktivitet të prerë i cili mund të zbatohet në çast, por si një grumbull aktivitetesh të cilat duhet të bazohen me një plan të specifikuar dhe me një dinamikë kohore. Një plan të tillë është e obliguar Qeveria e Kosovës që ta hartojë edhe për t'i nxjerrë prioritetet në bazë të statistikave të importeve të produkteve që vijnë nga Serbia. Ajo, për ato që mungojnë, duhet t'i promovojë politikat e mbështetjes për prodhuesit tanë që ato të prodhohen në vend.

Këtë gjë duhet ta bëjmë edhe për vendet tjera për ta kursyer edhe investuar paranë e konsumatorëve në vend. Kjo qasje është në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian, të cilat e mbështesin shtetet të cilat i prodhojnë ushqimet e veta në vendin e tyre.

Të nderuar deputetë,

Me këtë rast unë dëshiroj që të distancohem nga dhuna që ka ndodhur atje, e cila ka mundur të iniciohet nga cila do palë. Po ashtu dëshiroj që t'i përkujtoj organizatorët e protestave se këtë mocion e kemi votuar disa deputetë edhe të partive të tjera. Ata është dashur të konsultohen paraprakisht për protestën me qëllim që veprimet t'i kenë të përbashkëta për shkak se bashkë kanë marrë pjesë në votimin e këtij mocioni.

I ftoj që për datën 22 t'i konsultojnë të tillët dhe të marrim një vendim bashkërisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Tash kanë mbetur vetëm deputetët e Partisë Demokratike dhe të Vetëvendosjes. Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Kryetar i Kuvendit të Kosovës!
Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Në vitin 2011 kishte 8 raunde të bisedimeve të Qeverisë së Kosovës me atë të Serbisë me ç'rast imazhi i Kosovës që Qeveria e sajoi për Kosovën ishte ai i një vendi që merret vesh për çështje të tij të brendshme me Serbinë.

Në vitin 2011, ndërkombëtarët nuk mund ta mendonin Kosovën pa e menduar e paramenduar edhe Serbinë.

Që prej se është shpallur pavarësia e Kosovës, Serbia kurrë s'ka qenë pjesë e përfytyrimit ndërkombëtar të Kosovës sikurse në mandatin e kësaj Qeverie që ende nuk i ka mbushur një vit.

Sot, për shkak të dialogut në Bruksel, Kosova në arenën ndërkombëtare shihet si Kosovë e dialogut Kosovë-Serbi. Kot shpenzohen para të buxhetit të Kosovës për imazhin e Kosovës. Imazhin Qeveria po e betonon në marrëdhënie me Serbinë ku i ashtuqajturimi proces i normalizimit po e ndryshon Kosovën dhe jo Serbinë.

Pushteti i Serbisë në Kosovë e ka sjell dialogun me Serbinë për Kosovën. Ky dialog tash po e rrit pushtetin e Serbisë në Kosovë. Jemi bërë shtet kopje që e heq fjalën Republikë nga emri i vet karshi Serbisë. Jemi bërë shtet pa integritet që i eliminon pikat kufitare ndaj Serbisë duke i shndërruar ato pika kaluese.

Është e vërtetë që ne jemi subjekti opozitar që kemi kërkuar dorëheqjen e Qeverisë dhe zgjedhjet e parakohshme. Mirëpo, me aksionin tonë të 14 janarit, Vetëvendosja synonte që t'ia marrte pushtetin Serbisë dhe t'ia japë këtë pushtet shtetit të Kosovës që duam ta forcojmë. Vetëm Serbia do ta pësonte me 14 janar. Askush tjetër.

Mirëpo, çfarë bëri Qeveria? Kur po e rrezikonim Qeverinë, Qeveria konstatoi rrezikim të pushtetit të saj! Të udhëhequr nga Kryeministri na keni sharë e na keni akuzuar, keni shpifur e keni gënjyer për neve. Përveç se na quajtët “faqezinj” e “vetëfundosje”, na krahasuat me kriminelin Veselinoviq, ku, siç thatë ju, edhe Serbia paska hequr dorë prej tij, thua se Serbia na qenka më e mirë se Veselinoviqi! Ky është ai shërbim i shkëlqyer Serbisë nga kryeministri i Kosovës.

Që të gjithë ju deputetët e tij, duhet ta kuptoni se nuk e prodhoi Zvonko Veselinoviqi Serbinë por anasjelltas. Së fundi, Serbia e hoqi vetë këtë kriminel, në mënyrë që kryetari i Serbisë, Boris Tadiq, të vie në Deçan dhe të thotë se asnjëherë s'do t'i heq strukturat e Serbisë, të cilat tash janë të rifreskuara. Aifarë Zvonko Veselinoviqi është një kriminel dhe kreu i një bande kriminale. Ai s'mund të krahasohet për nga krimi me Serbinë dhe Serbia nuk është më e mirë se ai ashtu siç mendon e flet ky Kryeministër.

Në të vërtetë, qysh para protestës sonë paqësore, ju e shfrytëzuar gjithë arsenalin e fyerjeve kundër Vetëvendosjes sepse i thatë qytetarëve që gjëja më e keqe është duke u synuar pikërisht nga Vetëvendosja dhe kjo është marrja e pushtetit. Po, pra, kjo është gjëja më e keqe që mund të ndodhë sipas kësaj Qeverie. Kjo tregonte preokupimin saj parësor, e që s'është Kosova e as populli i saj.

Së pari, modeli ekonomik në Kosovë është i gabuar. Nuk bën që arka e shtetit të mbushet nga taksat doganore por nga tatimi i brendshëm. Shteti nuk forcohet kështu. Vetëm kur shteti mbledh tatimet në paga dhe tatimet në fitim të ndërmarrjeve, shteti bëhet i sofistikuar dhe i fuqishëm. Mbushja e arkës së shtetit në kufi është thjeshtësi dhe dobësi e shtetit. Tri të katërtat e buxhetit të Kosovës vazhdojnë të mblidhen në kufi.

Në anën tjetër, ju konsideroni që është dashur të jeni patriotë vetëm në luftë, prandaj e konsideroni normale që jeni Qeveri jopatriotike e pasluftës. Por, nuk ka fatkeqësi më të madhe sesa një Qeveri jopatriotike për një popull. Fundja, qytetarët mund të mos jenë patriotë, por Qeveria e një vendi s'guxon të mos jetë patriotike. Patriotizmi nuk është fakultet që e kryen për tri vjet dhe mandej e merr diplomën duke u certifikuar si patriot për tërë jetën. Je patriot vetëm nëse je tërë jetën dhe për çdo ditë.

Pavarësia nuk është kapital që duhet të shpenzohet, por hap cilësor për zhvillim e përparim. Kjo Qeveri po sillet në mënyrë kanibaliste ndaj pavarësisë. Qeveritarët po e hanë pavarësinë. Sepse, pavarësinë po na e tresin bisedimet me Serbinë, kontratat super të shtrenjta me korporatat e huaja, manipulimet me tenderë dhe privatizimet e egra.

Kjo Qeveri ka tepër pushtet në një shtet gjithnjë e më të dobët. Dhe, këtë pushtet e ka përdorur për ta rrudhur e zvogëluar shtetin dhe për ta trashur pushtetin.

Nuk është çështja vetëm e reciprocitetit këto ditë, por e anashkalimeve të planifikuara të Kuvendit nga ana e Qeverisë në këtë vitin 2012 në të cilin porsa hymë. Qeveria mendon ta shesë Distribucionin e KEK-ut, PTK-në dhe Trepçën, ta pranojë njëfarë autonomie për veriun dhe për këtë qëllim dëshiron ta eliminojë Kuvendin e Kosovës si pengesë në këtë vit. Pra 14 janari është ë simptomë e vitit në të cilin kemi hyrë. Me mënyrat e kësaj Qeverie dështon shteti i Kosovës, sepse po dështon ai si Republikë dhe si ekonomi.

Serbia ka leverdi që të mos na njohë. Ajo përkundër mosnjohjes po eksporton mallra në Kosovë dhe duke mos na njohur e ka kontrollin më të fuqishëm në Kosovë dhe ndikimin më të madh në botë për Kosovën. Në maj të vitit 2006, Boris Tadiq pat reaguar kundër fushatës së Lëvizjes për Vetëvendosje për bojkotimin e prodhimeve të Serbisë. Ai pat kërkuar që PSSP-ja i atëhershëm Soren-Jessen Petersen të intervenojë ndaj nesh. Në demonstratën tonë të radhës mandej në qershor, policia e UNMIK-ut dhe ajo speciale e Kosovës u bënë shumë më brutale.

Pa përfshirë kontrabandën e mallrave, Kosova bën pjesë në mesin e 10 vendeve ku Serbia eksporton më së shumti. Nëse e përfshijmë kontrabandën, atëherë Kosova ngjitet në vendin e pestë a të katërt. Prodhuesit e Serbisë janë edhe më shumë se kaq të varur prej tregut të Kosovës. Sepse ata shesin në Kosovë, ndërsa eksportuesit më të mëdhenj të Serbisë edhe ashtu janë korporatat ndërkombëtare që kanë marrur pjesë në privatizim në Serbi. Pra ka një varësi të Serbisë që është ë ekonomike e tregtare prej Kosovës.

Duke shitur mallra në Kosovë, Serbia po na blen si treg. Gjatë luftës ajo i diegu, dëmtoi ose rrënoi 120.000 shtëpi të shqiptarëve në Kosovë, shkatërroi 60% të bagëtive dhe i plaçkiti ose diegu shumicën e traktorëve të bujqve shqiptarë. Pra, Serbia nuk po luftonte vetëm jetën dhe banimin shqiptarëve, por edhe kundër potencialit zhvillimor e prodhues. Serbia i ka marrur zyrtarisht 2,1 miliardë euro nga Kosova që prej pasluftës, kurse përmes rrugëve të tjera edhe dyfishin e kësaj.

Protesta paqësore është vlerë e Bashkimit Evropian dhe e garantuar me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Por duhet pasur parasysh një gjë: Edhe liritë edhe të

drejtat nuk janë në marrëdhënie diakronike por janë në marrëdhënie sinkronike, ato janë njëkohësisht. Nuk mund të thuash që njëherë po e shfrytëzoj këtë të drejtë sepse mandej mund ta shfrytëzoj këtë të drejtën tjetër, ashtu që të më krijohet mundësia për atë lirinë e fundit mandej. Pra, nuk ka një moment të lirisë dhe të drejtës. Ato janë në mënyrë sinkronike dhe të gjitha njëherazi.

Po ashtu edhe reciprociteti është vlerë e Bashkimit Evropian. Shtetet në Bashkimin Evropian e njohin njëra-tjetrën. Nuk ka asnjë shembull tjetër në botë ku dy shtete që nuk kanë marrëveshje të paqes dhe nuk e njohin njëra-tjetrën, megjithatë të kenë marrëveshje të tregtisë së lirë. Meqë Serbia nuk e njeh Republikën e Kosovës, as Kosova nuk duhet ta njeh Republikën e Serbisë. Asnjë automjet ose kamion me tabela të Serbisë s' duhet lejuar të hyjë në Kosovë. Serbia na ka shumë borxh për okupimin, gjenocidin dhe dëmet që na i ka shkaktuar. Sipas Qeverisë së Kosovës, jo vetëm që kjo as s'kërkohej e as s'përmendet, por po del që Kosova na e paska veten e saj si treg borxh ndaj Kosovës.

Sot janë bërë 45 ditë prej se Qeveria e Kosovës është rebeluar. Ajo është rebeluar kundër vendimit demokratik të Kuvendit për reciprocitet të plotë me Serbinë. Janë bërë 45 ditë prej se Qeveria nuk po e respekton rendin institucional. Qeveria e Kosovës po promovon anarki, sepse në mënyrë arbitrare po vendos se cilin vendim a ligj të institucioneve ta zbatojë e cilin jo. Tash, kjo Qeveri synon të shkojë edhe një hap më tutje. Ajo dëshiron që ta suspendojë vendimin e Kuvendit, ta shpërfillë Kuvendin jo vetëm në të tashmen por edhe të kaluarën e tij. Nuk është e rastësishme që kryeministri aktual Thaçi është takuar dy herë tinëz me Boris Tadiqin, madje një herë sa ka qenë në opozitë, siç ka njoftuar Wikileaks. Kjo rrugë e kësaj Qeverie e cila e bën Kosovën të hapur për Serbinë dhe të mbyllur për Shqipërinë, është rrugë e Ali Shukrisë dhe Sinan Hasanit.

Pra, Lëvizja Vetëvendosje është edhe në Kuvend edhe....

KRYETARI: Albin, merru me çështjen konkrete! Mos shko në histori shumë.

ALBIN KURTI:... në institucione por është edhe në rrugë, në rrugët shqiptare të Kosovës. Por kjo rrugë e kësaj Qeverie me këtë mocion që e ka propozuar është rrugë e Ali Shukrisë dhe Sinan Hasanit.

Udhëtim të këndshëm në atë rrugë nuk mund t'iu dëshiroj sepse s'mund të keni. Udhëtimi dhe destinacioni i kësaj rruge për juve do të jenë si gjithmonë për ata tjerët edhe të pakëndshme edhe të palavdishme. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, kryetar!

Dëshiroj të ju përshëndes të gjithëve të nderuar deputetë, dhe do të dëshiroja të përshëndes kësaj radhe edhe qeveritarët e koalicionit qeverisës edhe opozitën Vetëvendosjen dhe koalicionin, edhe protestuesit edhe qeveritarët.

Jemi jo vetëm në një sallë, por mendoj se jemi në fakt edhe në një kazan. Por t'ju them sinqerisht ajo që ndodhi javën që shkoi për mua ka qenë një përjetim i rëndë, dhe e them përsëri sinqerisht jo më pak i rëndë se sa e atyre që kanë ndodhur në atë valë, të dy anët. Dhe gjatë gjithë kohës më është kujtuar, më është sjell nëpër mend një qortim i Rexhep Berishës, babait të Nuhi Berishës.

Shumë vite më parë kur ne po përplaseshim për vota, ai e gjeti rastin kur ishim bashkë dhe na e tha: “Çka po boni bre djem? Jeni bërë pikë e pesë, nëpër partina e çka po di, dhe unë ju dua të gjithëve por nuk di çka të bëjë, e kam një votë. Çka të bëjë me të?”.

Atëherë, ishte fjala për një përplasje elektorale, por kjo ishte një përplasje krejt tjetër fare. Gati afër vëllavrasjes dhe ishte krejt e pazakonshme. Dy taborre për ballë në të dy atdhetarë e bijë atdhetarësh, në të dy çlirimtarë e bijë e bija çlirimtarësh. Shkoj gjatë për t'i përmendur emrat, por ju lutem shikoni emrat e tyre që ishin në ballë në të dy anët. Është diçka fatkeqe që mund të sjellë fatkeqësi të madhe për këtë vend.

Edhe këndej edhe andej ishte i njëjti brumë. Besoj shumë i njëjti ideal, i njëjti motiv atje në situatën e dhënë. Ishte një dallim në dinamikë, në dimension, në formë. Por jam i sigurt që 99% të dy taborëve, po të pyeteshin a janë për pavarësinë – për pavarësinë ishin, a janë për shtetin - për shtetin janë, për reciprocitetet – për reciprocitet janë, për dinjitet – për dinjitet janë dhe nëse ne nuk arrijmë edhe për kaç të gjejmë zgjidhje, faji është i politikës, faji është i yni.

Ishte një mocion i 40 e sa deputetëve pak përpara, por ishte edhe një Rezolutë e 28 korrikut e cila, nuk di pse po harrohet, e cila ka qenë miratuar me 89 vota, dhe e cila po ashtu kërkonte kontroll të plotë të kufijve dhe respektim ose zbatim të masave të reciprocitetit. Dhe me sa e di ka qenë bërë atëherë bashkë, me deputetë e qeveritar bashkë.

Atëherë kishe eufori, entuziazëm edhe prirje kah skajshmëritë, kah teprimet. Ka pasur edhe ndonjë tërheqje vërejtjeje, ndonjë kujtim të asaj urtisë së popullit “kush matet shpesh, vjen më lehtë”. Pasi pastaj edhe ndonjë deklaratë që e vinte në dyshim zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, pa dhënë sqarime të duhura. U injorua, nuk u shtruan siç duhet e sa duhet në Kuvend dhe erdhi përplasje vëlla me vëlla, shok me shok, bashkëluftëtar me bashkëluftëtar.

Dhe unë më sa kam konstatuar, shumica nuk e ka pëlyr krejt këtë situatë. Nuk e ka pëlqyer as njërën palë as palën tjetër. Dhe, më vjen keq që unë duhet të flas shpesh me këto “edhe, edhe”, “as, as”, por fort jam i bindur që e vërteta qëndron aty.

Nuk beson njeriu i ynë se zgjidhja është në bartje me lehtësi të problemeve nga institucionet e Republikës sonë, që janë formuar me gjak në rrugë, në sheshe e ku ta di ku. Nuk beson njeriu i ynë në efektin e kthimeve prapa, në modele e disperadosësh, edhe madje në modelet e tejkaluara të lëvizjeve popullore, sepse janë tejkaluar. Tash i kemi tjetër fare, institucionale.

Por nuk e pëlqen njeriu i ynë, prototip i tij, as demonstrimin brutal të forcës dhe dhunës policore sipas modeleve që i kemi njohur, i kemi përballuar dhe ua kemi parë edhe fundin. Nuk e pëlqen dhunën, kërbacin, çizmen, bombat me ujë dhe gazë lotsjellës kundër qytetarëve të paarmatosur - midis të cilëve shumë gara, fëmijë e pleq. Madje edhe kur ishin ulur, madje edhe në shtëpitë e tyre. Merreni me mend, pikërisht në lagje të banuar u gjet vendi për policinë tonë për të bllokuar protestuesit, nëse u dashka të bllokoheshin. Madje, siç keni vërejtur, edhe invalid pa asnjërin krah. Ata po e rrezikonin policinë dhe pushtetin tonë?! Madje edhe deputetë e nënkryetar të Kuvendit! Qoftë edhe nëse Policisë sonë ua kanë dhënë lejen e famshmja jonë Gjykata Kushtetuese, që aq mirë e qëndisi dhe teleisi punën e imunitetit të deputetëve!?

As deklaratat e sërta me kapadaillëk zyrtar, ndonjëherë të ardhur nga Qeveria jonë, nuk i pëlqen njeriu ynë. Dhe atyre edhe më pak u kanë hije ato. Aq më pak talljet e përqeshjet banale të ndonjë aparaqiku e poltroni servil, që e dëmtojnë më shumë se gjithkush Qeverinë dhe qeveritarët. Thotë një fjalë e popullit: “Kush fle me fëmijë, çohet i lagët”.

Nuk e pëlqen njeriu ynë bllokimin e Morinës dhe Jazhincës. Kush e ka menduar se policët tanë do të vijnë në atë detyrë? Për të bllokuar qoftë edhe njerëzit që vijnë andej, por midis të cilëve edhe studentë e njerëz që punojnë mëtanë. Me çfarë të drejte tash kjo bllokadë? Pse nuk duhet të shtrohet kjo?

Nuk e pëlqen njeriu ynë policizimin e pushtetit tonë demokratik dhe të Republikës sonë demokratike. Nuk i duhet policizimi. Jo pushka drejton politikën, por duhet të drejtojë politika pushkën e kërbacin dhe ata që e bartin pushkën dhe kërbacin. E kundërta është vërtetë rrezik shumë serioz për të ardhmen e vendit dhe për demokracinë e saj.

Duhet prandaj, zonja e zotërinj, edhe përgjegjësi në situatën e krijuar dhe në veprimet e bëra. Për mendimin tim, nga të dy palët.

Do të duhej përgjegjësi politike e partiake për ndonjë teprim, ose me veprim a vendim të tepruar edhe nga Lëvizja Vetëvendosje. Do të duhej përgjegjësi institucionale nga ata që janë përgjegjës për teprimet dhe veprimet e palejueshme që e kanë dëmtuar imazhin e Kosovës - jo më pak se protestat në përgjithësi. Protestat ndodhin gjithkund. Por shtetin e dëmtojnë veprimet e shtetit.

Nuk na duhen, motra e vëllezër, modele nga Afrika dhe referenca te Libia e Gadafi, nga asnjëra palë. Dallimi midis asaj që pamë në Merdare ose te Dheu i Bardhë, dhe asaj që po shohim në Afrikën e përflakur, është shumë i vogël. Prandaj, mendoj se edhe duhet të merren seriozisht.

Është fat që nuk pati viktima dhe mendoj se është rasti që ne të shkundemi, të këndellemi dhe të bëjmë që kurrë në Kosovën tonë të mos krijohen situata të tilla.

Pra, do duhej edhe të mendonim. E sikur të ndodhte ajo që nuk mund të ndodhë, të sulmonim ta zëmë që këndonin ata matanë Merdarës dhe të vinin me ato që kanë qenë përpara, çka do të ndodhte? Kush do ta kishte më të afërt, ta zëmë, se sa njëri tjetrin që ishin ballë për ballë për t'u kapur sup për sup dhe për të luftuar dhe për të rënë bashkë. Pse mos ta prij ky motiv?

Prandaj, zonja e zotërinj, unë e konsideroj shumë të rëndësishëm këtë debat dhe mendoj se duhet edhe të orientohet drejt.

E quaj të drejtë edhe idenë për të pasur një rezolutë, por do të ishte më mirë që rezoluta të ishte shtruar në mënyrë të rregullt. Rezoluta bëhet me shkrim disa ditë përpara, natyrisht kur nuk është urgjente. Këtu kishte një urgjencë, por urgjenca nuk ishte e tillë sa të mos mund të shtrohej në mbledhjen e Kryesisë, që ishte para 2-3 dite.

Megjithatë, ngapak edhe lëshime të tilla në procedurë na kanë sjell në situata të tilla.

Sido që të jetë rezolutë re, dakord! Por shumë do të dëshiroja ta nënvizoj dhe ta potencoj: kujdes me idenë e kërkuar për shfuqizimin e rezolutave të mëparshme. Nuk është praktikë parlamentare. Nuk di që të kenë ndodhur diku që një rezolutë të shfuqizojë rezolutat. Rezolutat zakonisht i referohen njëra tjetrës dhe ato tejkalojnë njëra tjetrën dhe e shfuqizojnë në ecje e sipër, por jo duke e shfuqizuar tërësisht.

Shtrohet dilema edhe parimore: Rezoluta flet për reciprocitetin, edhe kjo e mocionit edhe ajo e korrikut. Do ta shfuqizojmë reciprocitetin si parim?! Ka dy parime në marrëdhënien ndërkombëtare; reciprociteti dhe dominiumi. Kush e shfuqizon reciprocitetin, e përqafton me hir a pa hir dominionin, dominiumin që është një praktikë në vendet e varura ose formalisht të varura ende. Por edhe është një praktikë që në Kosovë nuk bën as të mendohet. Prandaj edhe mendoj që do të duhej rishikuar idenë e tillë.

(Ndërprerje nga regjia)

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Ju faleminderit, se e kreu, e kreu! Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Do të flas pak a shumë në lidhje me atë se çka u fol. Janë tri çështje.

E para do të lidhem tek deklarimi i ministrit Bajram Rexhepi, kur foli për intervenimin e Policisë tek Dheu i Bardhë. Dhe, do të doja të flas, meqë vetë isha atje dhe të them se

komplet deklarimi i tij për atje, ka qenë i pavërtetë nga se ngjarja ka ndodhur krejtësisht ndryshe.

Mos të harrojmë se 26 ditë përpara është paralajmëruar protesta përmes mediave dhe takim me policinë kemi pasur konkretisht edhe nga afër, dhe është sqaruar plotësisht, e po ashtu edhe në ditën e protestës tek Dheu i Bardhë ne kemi komunikuar vazhdimisht me Policinë.

Është bllokuar gjysma e rrugës, është lënë lëvizja e lirë, pra nuk ka pasur bllokim të lëvizjes së lirë. Fillimisht Policia e ka bllokuar tërë rrugën, dikur edhe ajo e ka liruar dhe ka filluar të ketë qarkullim të lirë. Për çdo problem, ne kemi komunikuar me Policinë dhe e kemi zgjidhë aty për aty. Nuk ka pasur gjatë tërë ditës asnjë problem, ka shkuar çdo gjë në rregull. Dhe gjatë tërë ditës, është zbatuar reciprociteti nga protestuesit dhe Policia, që të dy palët bashkërisht.

Dhuna ka ndodhur në mbrëmje nga njësitet speciale dhe me urdhër. Dhe kur flasim këtu për çështjet e intervenimit, do të mund të pajtohem me deputetin paraprak kur flet se në protestë ka çdoherë tejkalime, edhe nga policia edhe nga protestuesit mund të ketë. Aty nuk pati tejkalime nga protestuesit, por ta zëmë se janë ato dhe po i zëmë ato të arsyeshme.

Lëvizja Vetëvendosje nuk e fajëson policin, nuk vë gisht drejtpërdrejtë për të akuzuar si karakter policin dhe të qenit polic. Pra Lëvizja Vetëvendosje e akuzon Qeverinë dhe urdhërdhënien.

Të mos e harrojmë një gjë: që pamje të tilla shfaqen shpesh dhe ato po vazhdojnë të përsëriten të shfaqen, dhe nuk po merren masa.

Këtu në këtë Kuvend kemi bërë pyetje direkte. I kemi bërë ministrit Bajram Rexhepi për Kushtrim Halitin, zyrtarin nga Ministria e Punëve të Brendshme i cili shihet shumë qartë në incizim duke e goditur aktivistin e lidhur për toke, edhe pse është person civil. Kemi kërkuar! A janë marrë masa ndaj tij? Nuk është marrë asnjë herë asnjë masë. Kemi kërkuar edhe këtu në Kuvend, nuk na është përgjigjur asnjëherë.

Pra, kur të mos marrësh masa, do të thotë ti po e stimulon policin që të marr masa ndaj qytetarëve të vet, të jetë i dhunshëm ndaj qytetarëve shqiptarë, e po që se gabon rastësisht polici përballë dhe të jetë përballë ndonjë protestuesit që flet serbisht, atëherë duhet të jetë shumë i kujdesshëm, sikur qysh ka ndodhur në ndy protesta më herët, te pika kufitare në Mutivodë dhe afër Crepit, ku e kanë bllokuar rrugën vite më parë protestuesit serbë, me ç'rast Policia e Kosovës ka hëngër dajak prej protestuesve, dhe nuk ka pasur asnjëherë urdhër që të merr masa ndaj tyre.

Çështja tjetër, është çështja këtu që po përmendet shpesh se duhet të shteren mjetet institucionale, e duhet të përdoren mjete institucionale. Ato, na konsiderojmë se janë shterë. Këtu në Kuvend është fol, është marrë vendim dhe Qeveria e ka tash për me e

zbatuar. Pra mjetet institucionale janë shter plotësisht, dhe kemi shkuar deri në fund të tyre.

Protesta ka qenë pas një afati mjaft të gjatë kur kemi pritur që Qeveria do ta zbaton. Nuk e ka zbatuar, dhe tash këtu qëndron edhe pikërisht vlera e protestës. Protesta pra ishte ajo që e bëri të dukshme moszbatimin e atij vendimi të Qeverisë. Se, përndryshe, si shumë e shumë ligje tjera që nuk zbatohen, edhe kjo do t' mund të thuhej: U mor, e nuk u zbatua, e ashtu diçka, nuk do të përmendej fare. Por u deshtë të ndodhë protesta, që shihet shumë qartë se nuk ka vullnet jo vetëm të zbatohet, por ka vullnet të ndalohet çfarëdo përpjekje për zbatim.

Kjo i tregon shumë qartë vetitë të cilat e karakterizojnë shtetin sot. Dhe në këtë pikë protesta e 14 janarit e ka vlerën e vet, sepse e çjerri maskën e pushtetit sot.

Pika tjetër është çështja e të bëmave. Kur po flasim për të kaluarën po flasim për të bëmat, po flasim se qysh dikush ka bë, e sot nuk kemi bë, e kush ka bë, dikush më shumë e dikush më pak.

Është shumë e qartë se deri këtu kemi arritur nga të bëmat e qytetarëve dhe Kosova këtu ka arritur pikërisht falë mundit e gjakut të shumë dëshmorëve e veprimtarëve përgjatë historisë, përgjatë gjeneratës dhe brezave të tërë. Kosova pra është çliruar çdo ditë. Dhe një procesi i tillë i çlirimit po vazhdon edhe sot.

Tash jemi në pikën kur duhet t'i përmendim ato. Lëvizja Vetëvendosje absolutisht nuk i mohon, madje i çmon shumë lartë çka do që ka ndodhur në të kaluarën, cilido që ta ketë bërë. Nëse cili do gjatë jetës së tij, vetëm një ditë të vetme ia ka kushtuar këtij vendi, atë ditë duhet me ia konservuar edhe me ia ruajtur, por jo me ia përzier me ditët e tjera të cilat mund t'ia dëmtojnë edhe atë ditë. Pse? Sepse ajo ditë nuk është e tij. Ajo përpjekje nuk është e asnjërit prej atyre që kanë vepruar, por është e qytetarëve të Kosovës.

Të mos të harrojmë se edhe ata që kanë vepruar, deklarojnë. Besoj që atë nuk e kanë bërë për vete, e kanë bërë për qytetarët. Pra ajo është vlerë e qytetarëve dhe ne duhet ta ruajmë. Por tash kemi mbërri në pikën që ato vlera nuk po ruhen, ato po dëmtohen dhe ato po shkelen.

Pra sot po vijmë në pikën kur vlerat të cilat na kanë sjellë neve deri këtu po goditen dhe po goditen vazhdimisht dhe sistematikisht. Dhe ne duhet t'i hidhemi në mbrojtje atyre, dhe Lëvizja Vetëvendosje është çdo herë e gatshme t'i mbrojë këto vlera nga ky proces i cili po i dëmton.

Ne po e shohim gatishmërinë që këto vlera të goditen, ne po e shohim gatishmërinë që secili veç e veç, një nga një, ta dërgoj shoku shokun në burg duke i goditur vlerat e së kaluarës. Dhe ne do të jemi pikërisht ata që do ta mbrojmë cilëndo vlerë, të cilit do kujt nga qoftë në Qeveri, qoftë në pozitë, kudo qoftë, a cili do veprimtar. Pse? Sepse ajo është vlera e qytetarëve tanë, ajo është vlera e gjeneratave që vijnë. Fëmijët tanë sot

duhet të edukohen që ta ndërtojnë shtetin e vetë në frymën që e kanë sjell gjeneratat më herët dhe në frymën e UÇK-së, pra sot shteti ynë nuk po ndërtohet në këtë frymë.

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: I nderuari kryetar i Parlamentit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është mirë që debati është kthyer në Parlament, nga se si popull kemi vuajtur shumë në të kaluarën për të kërkuar të drejtën tonë në forma të ndryshe duke mos i pasur institucionet tona demokratike, ndërsa sot ato i kemi. Dhe para se të mendohej çfarëdo zgjidhje tjetër, për cilin do problem, do të duhej të shikohej se a janë shterur të gjitha mjetet për debat, a janë shfrytëzuar të gjitha mjetet institucionale dhe juridike, pra para se të ofrohej rruga si opsion pa alternativë, duke i injoruar dhe mohuar ligjet, Kushtetutën dhe vetë shtetin tonë që e ndërtuam me shumë mund dhe sakrificë.

Mendoj se koha për të demonstruar trimëri dhe sakrificë ka kaluar dhe sigurisht se një numër i konsideruar edhe i deputetëve këtu, e kanë vështirë të lirohen nga ai mentaliteti i robit.

Ishte kohë tjetër ai kur kërkohej trimëri dhe sakrificë, ndërsa tani është një kohë tjetër. Sot është koha që të veprojmë në mënyrë të mençur, me mpreshësi politike, me diplomaci duke rritur besimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, duke qenë partner serioz dhe me qëllim të arritjes së subjektiveve evropiane të popullit tonë. Prandaj jo rastësisht edhe populli thotë: ec me kohen.

Sigurisht se konceptet tona politike dallojnë dhe kjo do të duhej të jepte sharmë demokracisë por kurrsesi nuk duhet të lejojmë që për shkak të koncepteve politike të krijojmë armiqësi mes nesh dhe qytetarëve dhe t'i ftojme ata për urrejtje, protesta, konflikte e në veçanti me organet e rendit të cilat gjithashtu janë tonat dhe më shumë mund i ngritëm.

Nuk do të duhej as në ëndërr të mendoj dikush nga ne që të linçojë dhe demonizojë Policinë e Kosovës, me të cilën u mburrëm të gjithë përpara, gjatë dhe pas 25 korrikut dhe do të mburremi me ta edhe sot nga se ata janë në shërbim të këtij vendi dhe janë vëllezër dhe motra tona, ata janë mbrojtësit e Ligjit dhe nuk mund t'i njollosë askush për interesa politike personale.

Kosova ka ngritur mekanizmat e mbikëqyrjes së Forcës së Sigurisë edhe në kuadër të Policisë të Kosovës, por edhe të mekanizmave parlamentar të mbikëqyrjes së Forcës së Sigurisë dhe nuk lejohet ndërhyrja në to për qëllime politike. Pasojat për përpjekje të tilla politike, për domonizim dhe linçim të policisë, janë të dëmshme dhe vështirë të riparueshme për kredibilitetin e Policisë, i cili u ngritë me shumë mund dhe vetëflim të shumë policëve të rënë në detyrë, siç ishte rasti i policit Enver Zymberi e shumë kolegëve të tij më parë.

Duhet kuptuar a se në demokraci vlejné rregullat, ligjet, Kushtetuta dhe sigurisht për të gjithë ne që jemi pjesë e Parlamentit, përgjegjësia është më e madhe për të respektuar rregullat, ligjet Kushtetutën dhe rregulloret me përpikëri.

Ikja e disa deputetëve për të zgjidhë probleme nga Parlamenti në rrugë, është tendencë e dëmshme për reputacionin e këtij Parlamenti dhe të vetë deputetëve, duke zhvlerësuar kështu rolin e Parlamentit dhe sforcuar rrugën. Andaj protesta dhe rruga si koncept nuk u përkrah nga gjysma e deputetëve të Vetëvendosje dhe të cilët nuk iu bashkuan konceptit të rrugës në protestën e 14 janarit, e lere më as nga qytetarët e Kosovës. Dhe, shprehur në përqindje në protestën e 14 janarit, morën pjesë 0,02% të qytetarëve të Kosovës.

Në fakt kërkesa e Vetëvendosjes për reciprocitet, nuk ishte e tillë si u prezantua dhe u paraqitë nga ata. Në të gjitha debatet dhe diskutimet, Vetëvendosje thirrej në reciprocitet, ndërsa në fakt kërkesat i kishte për t'i kontestuar konkluzionet e arritura në dialogun teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë, për të cilin dialog dhe konkluzione Vetëvendosje dy herë humbi në Kuvend në tendencë për të ndalë dialogun teknik, i cili është obligim ndërkombëtar i Kosovës që buron nga Kombet e Bashkuara, ku pretendojmë të jemi anëtarë.

Vetëvendosje fshihet prapa një mocioni me koncept të gjerë politik, ekonomik dhe tregtar, që le shumë hapësirë për t'u interpretuar edhe nga ta dhe keqinterpretuar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Tani kur u hap dialogu për liberalizimin e vizave dhe po hyjmë në fazën e përmbylljes të pavarësisë së mbikëqyrur, do të duhej të gjithë së bashku të punojmë për t'i arritur objektivat për integritet evropian. Sikur të gjithë të jemi unikë në këtë, ka shumë punë dhe shumë sfida për të arritur.

Integritet evropian janë para nesh dhe mund t'i arrijmë në bashkëpunim me partnerët tanë të cilët Vetëvendosje i injoron dhe i shpërfillë brutalisht. Është e pajustificueshme kjo tendencë për ta prishur Kosovën me miqtë tanë të cilët na ndihmuan dhe përkrahën për t'u bërë të lirë dhe për t'u bërë të pavarur.

Dua vetëm t'ua rikujtoj disa nga deklaratimet e politikanëve ndërkombëtar për protestat e 14 janarit.

Jellko Kacin, thotë: “Albin Kurti po solidarizohet me serbet e veriut!”

Doris Pak: “Aksioni i Vetëvendosjes është çmenduri!”

Lulacek: “Aksioni i Vetëvendosjes dëmton imazhin e Kosovës”.

Gjentilini: “Aksioni i Vetëvendosjes do të minojë proceset evropiane”.

Andaj është e pajustificuar kryeneçësia e Albin Kurtit për të tentuar për të zgjidhë probleme në rrugë dhe injoruar të gjithë aktorët dhe faktorët relevantë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputetja Albulenë Haxhiu, e ka fjalën!

ALBULENA HAXHIU: Ju faleminderit, kryetar!
Përpara se disa kolegë deputetë të merren me legjitimitetin e protestës paqësore të 14 janarit, pse nuk po veprojnë kundër injorimit dhe përbuzjes së Qeverisë ndaj vendimeve të Kuvendit të Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës, po e shkel nenin 92.3 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, me anë të cilit nen është e obliguar të respektojë ligjet dhe çdo vendim tjetër të miratuar në Kuvend.

Përveç se kjo Qeveri e shkeli këtë nen, ajo vazhdo me urdhrat e saj që ta përdorë Policinë e Kosovës për shkeljen e së drejtës së protestës, por edhe ta përdorë po këtë polici për të ushtruar dhunë brutale ndaj qytetarëve paqësorë.

Pra, në vend që kjo Qeveri të respektonte apo të respektojë një obligim kushtetues, ajo vazhdoi ta shkelte po këtë Kushtetutë, pra nenin 43, ku theksohet që liria e tubimit paqësor është e drejtë e garantuar.

Protesta e Lëvizjes Vetëvendosje e 14 janarit ishte paqësore. Këtë e panë dhe e thanë të gjithë. Vetëm kjo Qeveri dhe njerëzit e kësaj Qeverie nuk e panë ose për më keq nuk donin ta shihnin për shkak se kësaj e kishin nisur fushatën kundër protestës paqësore të Lëvizjes Vetëvendosje duke përdorur gjuhë kërcënuese, duke e ndjell dhunë, frikë, madje edhe gjak.

E drejta për të protestuar, sanksionohet edhe me konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sanksionet edhe me këto konventa për shkak se po kjo e drejtë është arritur me sakrificë nga miliona njerëz anë e mbanë botës.

Unë do të marrë vetëm një shembull për t'ju informuar se si funksionojnë parimet e Bashkimit Evropian. Në vitin 2003, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, pra Gjykata më e lartë e cila merr vendime lidhur me çështje që kanë të bëjnë me Ligjin e Bashkimit Evropian, ka marrë një vendim të ngjashëm me atë se çfarë po ndodhë sot në Kosovë, që njihet si "Vendimi Schmidtberger".

Në këtë çështje, Kompania ndërkombëtare e transportit Eugen e Schmidtberger, ngriti padi kundër Republikës së Austrisë për faktin se ajo nuk kishte marrë masa për të ndaluar një protestë paqësore që kishte bllokuar njërin prej akseve rrugore kryesore të transportit në Austri, ku kalonin transit mallrat midis shteteve anëtare të BE-së.

Në këtë çështje, pra Vendimi i Gjykatës në fund e hodhi poshtë padinë e ngritur nga Kompania tregtare, me arsyetimin se kufizimi i tregtisë ndërmjet shteteve anëtare është i justifikuar nga interesi legjitim për mbrojtjen e të drejtave themeltare, në këtë rast të drejtën e protestuesve për lirinë e të shprehurit dhe lirinë për të protestuar.

Gjithashtu, Vendimi i kësaj Gjykate më tej thekson se: ndërkohë që një demonstratë në një autostradë publike, përgjithësisht nënkupton një pengesë për ata që nuk marrin pjesë në demonstratë, në veçanti duke penguar lëvizjen e lirë kjo pengesë në parim mund të tolerohet, nëse qëllimi i demonstratës është shprehja ligjore e një opinioni. Ky vendim shërben si precedent ligjor për të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Pra, kjo Qeveria ose nuk i njeh ligjet e BE-së ose me qëllim i shpërfillë ato.

Lëvizje e lirë të njerëzve e ka pengua kjo Qeveri. Dhe, përveç që i keni pengua hyrjen bashkëkombësve tanë nga Republika e Shqipërisë dhe qytetarët shqiptarë nga Maqedonia ju edhe i keni keqtrajtuar ata. Asnjë pushtet nuk ka të drejtë të pengojë qytetarët të marrin pjesë në një protestë.

Gjersa strukturat paralele të Serbisë përveç se në veri të vendit ku tani ushtrojnë pushtet të plotë, ata edhe në jug të vendit vazhdojnë të enden lirshëm dhe veprojnë hapur edhe në pjesë të tjera të vendit në komunat me shumicë serbe, duke sfiduar dhe luftuar çdo ditë shtetin e Kosovës.

Pushteti i Hashim Thaçit në mënyrën më të turpshme dhe më qyqare mundohet t'ia tregojë dhëmbët e shtetit bashkëkombësve tanë.

Nga krejt kjo, të vetmit që janë ndjerë të kërcënuar nga protesta paqësore e Lëvizjes Vetëvendosje dhe nga mbështetësit e kësaj proteste - është pushteti i Hashim Thaçit dhe Serbia bashkë me strukturat e saj kriminale në Kosovë.

Tendenca e Qeverisë për t'i viktimizuar disa policë, është tendencë për t'i shfajësuar urdhërdhënësit e dhunës.

Në fund, ne do t'i denoncojmë përgjegjësit kryesorë që shkaktuan dhunë e torturë ndaj protestuesve gjatë dhe pas arrestimit.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Të provohet që të zgjidhen problemet jashtë institucioneve të Kosovës është veprim i gabuar.

Dalja në rrugë për zgjedhjen e problemeve e sidomos pa i përfillur rregullat ligjore për tubime publike domosdoshmërisht çon deri te ballafaqimi me policinë, jo vetëm tek ne, por kjo ndodhë edhe në çdo vend demokratik të botës.

Dua të ju rikujtoj të nderuar deputetë dhe qytetarë të nderuar, se kjo qasje ndaj problemeve ka konsekuenca negative për shtetin e Kosovës. Dihet se për ngritjen e imazhit të Kosovës është punuar për vite të tëra dhe në këto momente të rëndësishme për Kosovën të dilet në rrugë dhe të tentohet të mirën nën kontroll pikat kufitare, është e papranueshme si për Qeverinë e Kosovës ashtu edhe për popullin e Kosovës.

Të gjithë e dimë që e drejta për të protestuar është e lejuar me Kushtetutë dhe me ligj, dhe në këtë rast organizatorët e protestës kanë shkelur ligjin një herë në mos marrjen e lejes nga policia, mosrespektimin e urdhrat të policisë për shpërndarje të protestuesve dhe mosshfrytëzimin adekuat të hapësirës.

Nuk është e drejtë që me anë të viktimizimit të tentojnë të jenë në qendër të vëmendjes sepse ky gjest nuk i bënë nderë asnjë qytetari të Republikës së Kosovës e aq më pakë atyre që janë përfaqësues të zgjedhur të popullit.

Derisa Kosova është shtet dhe i ka institucionet e veta shtetërore, të cilat janë ngritur me mund e me shumë sakrifica, detyrë e secilit qytetarë të saj e sidomos përfaqësuesve të zgjedhur të popullit është që të punojnë dhe ta forcojnë shtetin dhe në mënyrë institucionale problemet të zgjidhen, dhe jo me veprime të papërgjegjshme ta shkatërrojmë atë që mezi e kemi ngritur. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Dhe diskutuesi i fundit nga deputetët, është deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar e të respektuar shumë kolegë deputetë,

Me që jam i fundit do të mundohem për një performancë ëmbëlsire me e krijuar, megjithëse tema është shumë e hidhur dhe aspak entuziaste për ta trajtuar.

Tema për organizimin tonë dhe vështirimin tonë në raport me Serbinë nuk do të duhej të na ndajë, dhe edhe më pak të na përplas në mesë veti, por përkundrazi do të duhej të na motivojë për të plotësuar njëri tjetrin pozitivë e opozitivë. Jo nga dashuria për temën sa për ndjeshmëri apo procesin në të cilin janë protagonistë edhe qendrat e vendosjes në glob dhe madje me mjaft ndikim. Faleminderit zotit që është kështu!

Me 7 dhjetor kur ishte interpelanca me zëvendëskryeministren dhe ministren për reciprocitetin dhe kur parashtrohej dhe parashikoja rrjedhimet që pasuan, u angazhova të thërras ndërgjegjen e të gjithëve duke ju kërkuar veprime të përgjegjshme ashtu siç vepronte i madhi Fan Noli. Edhe pse nga viti 1945 - 1965 sa jetoj pas çlirimit të Shqipërisë, ai nuk kishte motiv për ta vizituar Shqipërinë atëherë, të cilën e donte shumë,

për të cilën punonte shumë dhe kur përballej me kundërshtarët e bashkëkohanikët e vet, me arsyetimin se kjo Shqipëri e kishte përzënë demokracinë dhe e ka larguar zotin duke u përballur me dy karakteristika e tipizonin personalitetin e tij si demokrat dhe si peshkop. Ai me urti ua thoshte gjatë viteve 1945 deri 1955, ta anëtarësojmë këtë shtet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe pastaj deri në vdekje u thoshte ta rrisim e ta forcojmë kështu si është, pa zot, pa demokraci. Dhe këtë e thoshte një peshkopë, udhëheqës i Kishës Autoqefale Shqiptare, dhe këtë e thoshte një udhëheqës i një lëvizje demokratike që kishte rezultuar me një Qeveri demokratike, por për masat e figurës së tij është vështirë të gjenden në ditët e sotme.

Të nderuar deputetë,

Shumë të përkushtuar në këtë ditë të sodit dhe në jetë të tuaja,

Perspektiva shqiptare dhe e Kosovës, ka vë në lëvizje forca regjionale dhe globale jo vetëm kundër shqiptarëve dhe Kosovës por edhe kundër dominimit të NATO-së, sepse ushtarët më të devotshëm të saj janë 7 milionë banorë më të coptuar dhe me një unisim gjuhe dhe perspektive, ku pas 100 vjetësh për herë të parë në këtë jubilar, Zoti po ju sjell shpërblime. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Fjala përfundimtare është e Qeverisë. Fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni edhe mua që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës fillimisht, duke ju falënderoj për shumicën e deputetëve për diskutimet e tyre korrekte, konstruktive, të përgjegjshme në thirrje për tejkalimin e kësaj situatë të re të panevojshme të krijuar, në thirrje për tejkalimin e tendencave të interesave partiake por mbi të gjitha të interesave shtetërore të gjithë qytetarëve pa dallim etnie, t'i adresoj edhe unë disa nga opinionet për zhvillimet e fundit politike në vend.

Viti 2012, është prej viteve më të rëndësishme për Republikën e Kosovës prej vitit 1999, atëherë ku e kemi fituar lirinë, në vitin 2008 kur e kemi shpallur pavarësinë dhe tani në këtë vit kur do ta përmbyllim procesin e pavarësisë së mbikëqyrur.

Qytetarët e Kosovës, me padurim e kanë pritur dje lajmin - konfirmimin, zotimin politik të Brukselit por edhe të Qeverisë së Kosovës për hapjen e dialogut për procesin e liberalizimit të vizave. E kam theksuar edhe sot në mëngjes, por po e ritheksoj edhe sot në mbrëmje: Kjo është meritë e shtetit të Kosovës, është meritë e institucioneve të Kosovës, është meritë e gjithë spektrit politikë dhe i falënderoj edhe gjithë ata deputetë që kanë punuar bashkërisht sidomos në Komisionin për Integritet, por edhe kryetarët e komunave, shoqërinë civile dhe mediat.

Natyrisht, për fat të keq, Kosova në vend që të shkonte, jashtëzakonisht do të shkojë e përgatitur, por të shkonte pa imazhin negativ të zhvillimeve të fundit në takimin e Grupit drejtues ndërkombëtar në Vjenë që do të mbahet më 24 janar, pra ishin dy agjenda shumë pozitive për Kosovën - ai i dialogut për liberalizimin e vizave që ndodhi dje, dhe më tutje agjenda për përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur, më datën 24 janar dhe ndodhi ajo që më së paku pritej të ndodhte dhe që ajo më së paku do të duhej të ndodhte. Por për çdo rrethanë, unë jam optimist dhe me besim të plotë për energjinë pozitive të forcave politike në vend, për unitetin politik qytetar dhe shtetëror për implementimin e vizionit tonë perëndimor.

Prandaj, jam optimist se do t'i përmbyllem agjendat për të cilat kemi punuar, kemi sakrifikuar dhe jemi duke e implementuar vizionin tonë perëndimor.

Kosova evropiane është ajo për të cilën kemi luftuar me gjenerata. Gjenerata e gjenerata të tëra!

Këtë vit e shënojmë edhe 100 vjetorin e festës së flamurit si shqiptarë, e në të njëjtën kohë jemi edhe në prag të 4 vjetorit të pavarësisë së Kosovës, dhe kurrë shqiptarët nuk kanë qenë në pozicion më të volitshëm, më të fuqishëm, më stabilë, më kredibilë edhe në kuadër të drejtave të tyre që kanë por edhe në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare apo rrjedhave globale botërore.

E festojmë 100 vjetorin e festës së flamurit dhe pavarësisë së Shqipërisë, kur Shqipëria është pjesë e NATO-së dhe kur Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Kur Shqipëria veç e ka tejkaluar procesin e liberalizimit të vizave dhe kur ne po i hapim kufijtë dhe po ndërtojmë autostrada, kur po humb kuptimi i kufijve dhe po ngarend vlera e hapjes së kufijve, vlerat e evropianizimit edhe të Kosovës edhe të rajonit.

Unë nuk dëshiroj të bëjë paralele, por për kufijtë e Kosovës do të ketë kritere dhe standarde evropiane me këdo që është në kufi.

Natyrisht ne si kemi përcaktuar kufijtë, as unë as ju. Të tjerët na i kanë përcaktuar dhe ne po bëjmë përmirësimin historik që na ka ndodhur për padrejtësitë në rajon. Padrejtësitë, për më tepër se një shekullorë, por natyrisht me një filozofi dhe me një qasje krejt të re – me atë të partneritetit me Bashkësinë Ndërkombëtare.

Më 10 qershor 1999, Kosova e ka larguar, do të thotë e kemi larguar më 10 qershor 1999 Kosovën nga Serbia, por në të njëjtën kohë e kemi larguar edhe ideologjinë komuniste. Nga ideologjia komuniste 50 vite Shqipëria mbeti e izoluar, e diskriminuar, e vetëpërkrahur nga bota dhe për 50 vite, mund të them, po nga ndikimet e asaj ideologjie Kosova mbeti e pushtuar nga Serbia. S'po them që ka fillua 1945-ës se të gjithë e dimë historinë kur ka filluar. Tash është e diskutueshme për shkencëtarë kjo, apo në ndonjë akademi shkencore me argumente të cilat kanë qenë ato.

Prandaj, ne do të vazhdojmë të punojmë me përkushtimet më të mëdha për perspektivën tonë evropiane duke respektuar standardet më të larta perëndimore, duke implementuar të

gjitha kriteret e nevojshme dhe të domosdoshme për liberalizim të vizave, për procesin e plotë të anëtarësimit të Kosovës në NATO dhe Bashkim Evropian, por në të njëjtën kohë edhe dallimet politike që janë duhet të forcojnë vizionin tonë shtetëror. Dilemave që mund t'i kemi, duhet t'i përgjigjemi këtu - në Kuvend, në institucione dhe jo në rrugë.

E di se ka njerëz që pretendojnë që të paraqiten si gardianë të së vërtetës. Askush nuk është gardian i së vërtetës, nga ne. E vërteta është një. Apo pretendojmë të paraqiten si pronarë të patriotizmit. E di që dikujt i ka mbetur merak që të ishte ashtu siç do të dëshironte të ishte por nuk mund të jetë. Prandaj, e theksoj edhe një herë Kosova evropiane është ajo për të cilën kemi luftuar me gjenerata. Vlerat evropiane janë ato për të cilat kemi derdhur gjak.

Ndërtimi i rrugëve edhe hapja e kufijve janë udhërrëfyes për ne. Jo mbyllja e tyre, jo bllokadat. Ka kaluar koha, edhe në Kosovë dhe kudo, edhe Leninit edhe Troçkit, edhe Stalinit e besa edhe e Musolinit.

Dhe në fund të fundit, dëshiroj të theksoj se ne fituam vetëm me vlera evropiane.

Këtu u dëgjuan etiketime se dikush është tradhtar, dikush patriot. Madje u dëgjuan edhe prej individëve që kur është themeluar Ushtria Çlirimtare e Kosovës, kur kam dashur unë të diskutoj në atë kohë kanë ikur nga unë. Prandaj, të lutem, mos t'i hapim letrat se kur t'i hapim, hapen keq.

Dhe në fund të fundit dëshiroj të theksoj se e ardhmja jonë evropiane, në fund të fundit nuk ka të bëjë vetëm me respektimin e ligjit. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me respektimin e Kushtetutës, megjithëse edhe Kushtetutën edhe ligjet i kemi të modelit evropianë. Kjo ka të bëjë mbi të gjitha me vlerat, vizionin dhe Kosovën që duam ta ndërtojmë, e ne duam dhe jemi të përcaktuar ta ndërtojmë Kosovën evropiane.

E vizioni ynë për Kosovë evropiane nuk ndërtohet përmes bllokadave, qoftë fizike qoftë mendore, të kujto qoftë. Vizioni ynë evropian nuk ndërtohet duke definuar veten dhe të ardhmen tonë me urrejtje me të tjerët dhe për të tjerët.

Ai vizion nuk ndërtohet duke e definuar veten kundër të tjerëve. Askush, askujt këtu nuk ka nevojë t'i tregojë çka ka bërë Serbia në Kosovë. Të gjithë e dimë dhe të gjithë e kemi përjetuar. Tashmë kemi reciprocitet.

Të nderuar deputetë,

Ky debat ka pasur kuptim para 25 korrikut, nuk ka më rikthim mbrapa dhe sot kur e gjithë bota demokratike është mobilizuar në agjendën për tejkalimin e gjendjes së krijuar në veri, atëherë ne i nxjerrim probleme vetvetes, probleme të tjera edhe vetvetes edhe miqve tanë.

Problemet, e ritheksoj, dhe dallimet politike që mund t'i kemi dhe i kemi dhe jemi demokraci, e theksoj edhe një herë, duhet të debatohen këtu, të diskutohen këtu dhe të

zgjidhen këtu. Por, në fund të fundit, duhet ta respektojmë parimin demokratik, atë të shumicës.

Unë edhe një herë ftoj që diskutimet tona, bashkëbisedimet tona, debatet tona t'i zhvillojmë në Parlament dhe jo në rrugë. Këtu mund t'i zgjidhim dilemat tona, natyrisht me një komunikim normal, me një komunikim emancipues, civilizues dhe qytetërues dhe jo urrejtës, fyes, e denoncues.

Prandaj, e ftoj edhe grupin politik tuajin që debatin të mos e bartë në rrugë por ta respektojë jetën institucionale që e kemi kultivuar edhe si traditë në Republikën e Kosovës.

Unë ju ftoj të gjithëve, pa dallim partie, duke u nisur edhe nga Partia Demokratike kryetar i së cilës jam - që përvojat e këqija të kujt do qoftë që kanë ndodhur të mos pretendojë kush t'i bartë në Kosovë. Nuk do të ketë sukses, do të dështojnë.

Ky është vullneti politik i qytetarëve të Kosovës, i të gjithë ata që na kanë votuar neve pa dallime partiake dhe ky është vizioni ynë përëndimor politik.

Të nderuar deputetë,

Ne kemi luftuar për të pasur parlament dhe ju e dini sa sakrificë është bërë që të kemi Parlamentin tonë, që të kemi njerëzit e zgjedhur tanë, që të kemi Qeverinë tonë, që t'i kemi autoritetet tona komunale, që t'i kemi institucionet legjitime të dala nga vullneti i qytetarëve të Kosovës, nga mendja dhe shpirti i tyre dhe të njohura ndërkombtarisht.

Prandaj, ju ftoj të gjithëve t'i respektojnë ato vendimet e Parlamentit, qofshin ato që nuk na pëlqejnë apo që na pëlqejnë, duhet t'i respektojmë dhe do t'i respektojmë të gjitha.

Ftoj, përsëri, duke ripërsëritur: të shmanget rruga, të shmanget dhuna. Ftoj që të bisedojmë këtu në institucione, pa ndalur, me orë të tëra, ditë e natë, por në asnjë rrethanë askush të mos pretendojë të bartë atë debat që mund ta zhvillojmë këtu në rrugë.

E respektoj me përulësi dhe në mënyrë shenjtë të drejtën për protestë. Edhe unë krejt jetën e kam kaluar në protestë, veç kundër Serbisë.

Unë kam qenë opozitë.... Të lutem, të lutem!

Unë kur kam qenë në opozitë, kam qenë në opozitë në vitet 2004 – 2007. Kur presidenti Rugova ka formuar ekipin e unitetit menjëherë iu kam bashkangjitur atij ekipi të unitetit, me të gjithë potencialin dhe lidshypin e Partisë Demokratike të Kosovës, duke tjetërsuar apo mohuar rolin e opozitës për t'i shërbyer procesit negociator për të shpallur pavarësinë. Dhe koha na ka dhënë të drejtë në atë vendim që nuk ishte shumë popullor për elektoratin e Partisë Demokratike të Kosovës, por ishte në interes të shtetit, ishte në interes të gjithë qytetarëve. Prandaj, edhe sot ndihem mirë dhe krenar, por në asnjë rrethanë kurrë pushtetin se kemi kërcënuar me demonstratë apo dhunë. E kemi zhvilluar jetën parlamentare këtu, duke shkuar me gjithë kolegët tjerë të pushtetit të atëhershëm - që ishte koalicioni, tjetër në Vjenë, në takime.

Prandaj, kam qenë edhe kundër edhe kur më keni ftuar që të ju përkrah në demonstratën e shkurtit të vitit 2007 dhe ju kam thënë: jo. Rruga nuk është zgjidhje, sepse nuk ka pasur Kosova nevojë për viktimat e reja në kohën e paqes, kur u vra Mon Balaj dhe Arben Xheladini. Sot fëmijët po rriten jetimë! Duhet me ju ardhur marre!

(Ndërhyrje)

Keni thanë... Unë kam qenë në opozitë. Unë nuk e akuzoj askënd. Kemi qenë në opozitë, ju kam thanë mosni, rruga nuk është zgjidhje. Është Parlamenti, jeta institucionale. Ju kam ftuar gjithmonë me iu bashkëngjitur jetës parlamentare dhe demokracisë. Keni bërë mirë që keni dalë në zgjedhje. Keni bërë mirë që e keni pranuar dokumentin e Ahtisarit. Keni bërë mirë që jeni në Parlament. Jeni duke gabuar që po dilni në rrugë dhe mos i merrni në qafë njerëzit. Dhe nuk do të mund t'i merrni në qafë njerëzit, po ju tregoj shumë hapur, sepse theksoj edhe një herë e kuptoj frustrimin, arrogancën dhe agresivitetin tuaj, sepse e di që e dini se keni gabuar shumë rëndë.

Prandaj, edhe një herë i ftoj të gjithë që të vazhdojmë të punojmë këtu në institucione me këmbëngulësinë më të madhe, që të bashkëbisedojmë në mënyrën më të urtë dhe më të mençur të mundshme duke pasur parasysh gjithmonë respektin për të kaluarën tonë, që të na bashkojë edhe sakrifica e madhe e qytetarëve tanë por në të njëjtën kohë edhe vizioni ynë për të ardhmen. Por në asnjë rrethanë nuk do të ketë kompromis me ligjin, me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Pretendimi për të demonizuar Policinë e Kosovës, është i papranueshëm. Ata janë vëllezërit, motrat, fëmijët tanë. Ata, e ritheksoj edhe një herë, e kanë ligjin zot, Kushtetutën zot Ata janë mbi çdo politikë, ata janë në interes të qytetarëve të Kosovës, të shtetit të Kosovës.

E kemi policinë për herë të parë të ndërtuar prej neve, dhe u theksua këtu edhe prej deputetëve të tjerë - se si është formuar në bazë të vullnetit tonë, por edhe standardeve më të larta ndërkombëtare.

Policia e Kosovës madje ka dëshmuar se është e gatshme të rrezikojë edhe jetën e tyre në mbrojtje të personalitetit të Republikës së Kosovës.

Është e turpshme analogjia që po i bëhet, është e papranueshme, është e patolerueshme, nuk është e pjekur politikisht. Të flitet sot se kush e do flamurin kuq e zi më shumë, kush e do gjuhën shqipe më shumë, kush e respekton gjuhën shqipe më tepër, kush është patriot më tepër a më pak, është e papranueshme. Të bëhet ndarje në qytetarë, në patriotë dhe tradhtarë, është e papranueshme.

Ne të gjithë kemi luftuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, pa dallime ideologjike, dhe pikërisht këto tejkallime të dallimeve ideologjike krahinore. Ne, për herë të parë në

Kosovë arritëm që të unifikohe mi dhe të shënojmë fitoren tonë historike kundër Serbisë më 10 qershor 1999. Prandaj, të gjithë qytetarët e Kosovës që jetojnë në Kosovë dhe diasporë kanë qenë, janë dhe do të mbesin për mua çlirimtarë dhe meritore për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Edhe një herë ju ftoj që të mbështetet dhe i ftoj të gjithë deputetët pa dallime, duke i falënderuar për kontributet e tyre, për diskutimet e tyre, për sugjerimet, që unë i vlerësoj disa prej tyre shumë të urta, shumë të mençura - për tejkalimin e kësaj gjendje dhe të vazhdojmë me agjendën tonë evropiane dhe zhvillimore të Republikës së Kosovës. Edhe një herë ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Debatin e kemi kryer, dhe fjalën përfundimtare e ka kërkuesi i mocionit për debat, kryetari i Grupit Parlamentar deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Së pari dua t'i falënderoj të gjithë kolegët për mendimet e tyre. Nga debati vlerësoj, ka dalë qartë se pjesa më e madhe e kolegëve kanë treguar gatishmërinë e tyre për t'i marrë përgjegjësitë që na takojnë si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, si pjesëtarë të organit më të lartë vendimmarrës, pra të Parlamentit të Kosovës.

Nga debati që e dëgjuam, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës propozon këto rekomandime:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës mirëpret marrëveshjet e arritura në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë përmes procesit të dialogut dhe mbështet zbatimin e tyre të tërësishëm.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të vendos përmasat përkatëse reciproke për mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe implementimin e konkluzioneve të arritura.
3. Qeveria obligohet t'i raportojë Kuvendit lidhur me mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe reciprocitetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe i shfuqizon të gjitha vendimet e Kuvendit në lidhje me këtë çështje.

I ftoj të gjithë deputetët që t'i mbështesin këto rekomandime të cilat vlerësojmë se ia hapin rrugën e perspektivës vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: A i keni harmonizuar, ju lutem? Ju lutem, unë e kam fjalën tash!

(Ndërhyrje)

A i ke harmonizuar këto me grupet parlamentare? Jo!
Atëherë, ju lutem për 15 deri në 30 minuta, i harmonizoni.

A jeni dakord?

(Ndërhyrje)

Pra e bëjmë një pauzë që t'i harmonizoni dhe pas 15 – 20 minutash kthehemi në seancë. Harmonizoni me propozuesin, dhe pas 20 minutave të kthehemi në seancë.

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI: Të nderuar deputetë vazhdojmë seancën!
Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Rekomandimet nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim. Prandaj, unë propozoj që t'i qesim në votim.

KRYETARI: Lus deputetët dhe regjinë le të përgatiten për votim.

(Ndërhyrje)

Veç një gjë ta dimë! Sipas procedurës nuk ka debat. Megjithatë nga dy minuta i keni.

Fjalën e ka kryetari i grupit...

Ju lutem, unë e udhëhiqi seancën. Kur të vini ju e udhëhiqni, ashtu si të dini. Ju lutem!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!
Unë nuk dua të zgjasë, por po e them edhe një herë qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ne konfirmojmë edhe një herë se do të votojmë kundër këtij mocioni. E kemi votuar një mocion më herët, dhe ne nuk shohim asnjë ndryshim që është në kuptimin pozitiv që do të ketë arsye që të bëhet një mocion tjetër dhe për këtë arsye Lidhja Demokratike e Kosovës, gjegjësisht Grupi ynë Parlamentar do të votojë kundër mocionit të propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Vetëvendosjes, kryetari i Grupit, deputeti Visar Ymeri, e ka fjalën.

VISAR YMERI: faleminderit, kryetar!
Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje do ta votojë kundër këtij mocion. Është absolutisht i papranueshëm për ne, edhe si tekst edhe si tendencë.

Mocionin të cilin e paraqiti kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-ës, nuk ishte në asnjë mënyrë reflektim i debatit që e patëm këtu. Pra, është një mocion i cili flet për gjëra që as nuk u diskutuan e as nuk u prekën në këtë Kuvend.

Aty janë futur edhe marrëveshje ndërkombëtare për të cilat nuk qe debati, por debati ka qenë i orientuar dhe i përqendruar në diçka krejt tjetër prej asaj. Dhe ky mocion tash është sikur me ardhur prej qiellit këtu.

As nuk është mocioni i cili u propozua në fillim nga kryetari i Grupit parlamentar, dhe konsiderojmë që një pikë e atij mocioni veçanërisht ku kërkohet shfuqizimi i vendimeve të Kuvendit, është një precedent jashtëzakonisht i rrezikshëm për këtë Kuvend, dhe nuk do të lejojmë të ndodhë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, kryetari i grupit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Gjithsesi, edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë kundër mocionin e paraqitur.

Mendojmë se është një tendencë për të zhbërë diçka që ka ndodhë më përpara në Kosovë. Pra, jo për të ndërtuar por për ta zhbërë atë çka ka ndodhë më përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, deputetja Myzejene Selmani, e ka fjalën. Nuk e do fjalën, mirë.

Të SLS-së, gjithashtu janë dakord, siç duket!

E “6+”? Edhe ata. Atëherë po hymë në procedurën e votimit.

Në sall janë 101 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 40 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi...

(Ndërhyrje)

Po, pa kartelë - “për”?

“Kundër”, sa janë? Mirë, 41.

Atëherë “për” janë 59.

Konstatohet se me 59 vota “për”, 41 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar dhe Koalicioni qeverisës.

Të nderuar deputetë,

A jeni që ta vazhdojmë seancën apo ta lëmë për të hënë prej orës 14:00? Faleminderit!

Atëherë, të hënë vazhdon seanca, në ora 14,00 dhe deri atëherë, mirupafshim!

* * *

(Vazhdimi i seancës, me datë 23. 01. 2012)

Drejton seancën, nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës të filluar më 20 janar 2012 për pikat e mbetura.

Konstatoj që të pranishëm janë 76 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj zëvendëskryeministren Mimoza Kusari Lila që ta prezantoj dhe arsyetojë projektligjin para deputetëve.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA MIMOZA KUSARI LILA: I nderuari kryesues i Kuvendit,

Të nderuar kolegë nga Kabineti qeveritarë,

Të nderuar deputetë,

Prodhimtaria dhe aktivitetet bujqësore janë një ndër aktivitetet më të shpeshta dhe më të rëndësishme në zonat rurale të vendit tonë dhe qëllimi i këtij projektligji është krijimi i kornizës ligjore e cila do të shërbej si bazë e qëndrueshme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe si lehtësim për zbatimin e politikave bujqësore në realitet.

Ky veprim legjislativ i ndërmarrë është në linjë të plotë me përkushtimin tonë për vendosjen e ligjshmërisë dhe për përmbushjen e zbrazëtirave ligjore që na janë paraqitur përgjatë zbatimit të planit kombëtar të bujqësisë dhe zhvillimit rural, i cili i përcakton në mënyrë të hollësishme objektivat afatshkurtra dhe veprimet që derivojnë nga politikat bujqësore dhe politika për zhvillimin rural.

Aktualisht, Ligji në fuqi për bujqësinë dhe zhvillimin rural, nuk ka gjetur zbatueshmëri të plotë për shkak të mangësive të tij dhe kjo situatë ka sjell nevojën për ndryshimin e tij, veçanërisht për çështje që kanë të bëjnë me objektivat, masat e programin e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Po ashtu, nevoja për ta plotësuar këtë kornizë ligjore është paraqitur edhe për shërbimet publike bujqësore dhe për përcaktimin e kritereve për krijimin e bazës së të dhënave dhe

informacioneve në fushën e politikës bujqësore dhe zhvillimit rural, si dhe për themelimin e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë e cila do të jetë në mbështetje të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Bujqësisë për krijimin e programit për bujqësi dhe zhvillim rural.

Kjo agjenci do të udhëhiqet nga kryeshefi ekzekutiv dhe parashihet t'i ketë 25 të punësuar, ku 6 prej tyre do të jenë staf aktual i Ministrisë, ndërsa 19 të tjerë do të jenë staf i ri i cili do të paguhet nga Marrëveshja që është arritur me Bankën Botërore, përkatësisht nga kredia që është miratuar për financimin e projektit për bujqësi dhe zhvillim rural. Pra, ky plotësim ndryshim i këtij projektligji nuk do të prodhojë kosto shtesë buxhetore deri në viti 2017 që do të zgjasë Projekti me Bankën Botërore.

Prandaj, miratimi i tij ka shumë rëndësi për bujqësinë kosovare dhe në masë të madhe do të ndikonte edhe në përmirësimin e mjedisit në të cilën po jetojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Pas prezantimit të projektligjit, hapi debatin për diskutim në parim.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për bujqësi, pylltari, mjedis e planifikim hapësinorë, deputetin Nait Hasani të marrë fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje kabinet,

Të nderuar kolegë,

Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin dhe i propozon Kuvendit që ta shqyrtojë në parim dhe t'i jep rekomandimet e veta për ndryshimin e këtij ligji, i cili është i nevojshëm për bujqësinë organike dhe zhvillim rural. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, janë përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit!

Unë nuk jam paraqitur në emër të Grupit, por vetëm kam diskutim si deputete.

KRYESUESI: Atëherë, deputeti Hasani, e ka fjalën prapë.

NAIT HASANI: Edhe në emër të Grupit pajtohem për Projektligjin.

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, është paraqitur Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe njëkohësisht vërejtja jonë është tek themelimi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me

të cilat përkojnë edhe nga vërejtjet të cilat i ka bërë, dhe Deklarata financiare apo Departamenti i buxhetit në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, sepse për një agjencion i tillë, të cilën e ka paraparë Ministria e Bujqësisë me një numër prej 25 zyrtarëve të punësuar, mendojmë që nuk ka buxhet nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga prezantimi të cilën e bërë zëvendëskryeministrja e cila theksoj se pjesa prej 19 zyrtarëve do të paguhet nga projekti i Bankës Botërore. Këto deklarata financiare edhe Departamenti i buxhetit i ka theksua se një gjë e tillë nuk mund të ndodhë, dhe unë mendoj dhe vlerësoj se më mirë ky buxhet edhe kjo kredi e cila është dhënë nga Banka Botërore t'i epet fermerëve për ngritjen e kapacitetit të tyre se sa ta kemi një numër të punësuar, diku prej 25 zyrtarëve.

Kjo për arsye se në Departamentin e Zhvillimit të Bujqësisë, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, ekziston një numër i punëtorëve dhe mendoj se në mungesë të buxhetit duhet startohet dhe të fillohet të punohet në këtë Agjencion me këta punëtorë dhe, gradualisht pas krijimit të buxhetit, i cili do të sigurohet nga buxheti i Republikës së Kosovës në vitet në vijim ka mundësi që ky agjencion të zgjerohet.

Mirëpo, në deklaratë, edhe një herë po e them, është diçka kundradiktore me vlerësimin të cilën e ka dhënë Ministria e Bujqësisë dhe njëkohësisht me vlerësimin të cilën e ka dhënë Departamenti i Buxhetit në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

Ne si Grup Parlamentar në parim do ta votojmë, por kërkojmë që ministria përkatëse në këtë rast Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa të gjejë gjuhën e përbashkët dhe njëkohësisht nëse nuk ka buxhet për t'u punësuar ky numër kaq i madh, i cili është i paraparë, atëherë duhet të fillohet sipas vitit në vijim me një buxhet i cili do të jetë i implementueshëm për këtë ligj. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Pas shqyrtimit të projektligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, arritëm të vërejmë se kryesisht në plotësim-ndryshimin që do t'i bëhet Ligjit të tanishëm, bëhet fjalë vetëm për krijimin e një agjencie të re, pra Agjencionin e Zhvillimit të Bujqësisë.

Një agjencion më tepër, rrjedhimisht një shmangieje e përgjegjësisë direkt nga Ministria dhe këtu kemi të bëjmë pra me një agjencion i cili do të ketë përgjegjësi për pagesa direkte dhe për hartimin e planeve zhvillimore. Edhe pse do t'i hartoj ky agjencion këto plane zhvillimore, edhe pse ato do t'i raportoj Kuvendit, në njëfarë mënyre këtu në këtë rast do të anashkalohej plotësisht Kuvendi.

Pra, në këtë rast kemi një agjencion të ri, siç është bërë pra kjo në vazhden e ndërtimit të agjencioneve të reja, ku të cilat paralelisht me ndërtimin e decentralizimit e shndërrojnë një vend totalisht jofunksional.

Në vendet, të cilat e praktikojnë punën përmes agjencioneve të tilla, normalisht nuk ekziston decentralizimi. Në vendet ku decentralizimi është më i fuqishëm, mos të harrojmë se kemi monitorim nga qendra respektivisht nga ministria - nga niveli qendror.

Ne po e zhvillojmë decentralizimin në nivelin lokal, ndërsa në nivelin qendror po aplikojmë e po e ndërtojmë, po hapim agjencione të reja të cilat në njëfarë mënyre po e shmangim përgjegjësinë nga Ministria respektivisht nga autoriteti qendror. Kjo në një farë mënyre çon drejtë dekompozimit të shtetit, drejt dekompozimit të funksionit të shtetit. E kemi jashtëzakonisht të nevojshme që kur ke decentralizim në nivel lokal të kesh monitorim më të fuqishëm nga niveli qendror.

Po që se qytetarët në nivelin lokal iu duhet shërbimi më i afërt, në rregull. Ama, kjo duhet patjetër të monitorohet nga niveli qendror dhe nëse në nivelin qendror tani fillojmë t'i ndërtojmë agjencionet e vazhdueshme për çështje të ndryshme, në këtë rast ne jemi duke e shndërruar totalisht sistemin dhe duke e çuar drejtë asaj, në një sistem total jo funksional.

Shembull konkret e kemi edhe çështjen e pyjeve, ku me një anë kemi dhënie të kompetencave të autoritetit lokal, e në anë tjetër kemi agjencion respektivisht kemi 3 nivele të cilat në njëfarë mënyre e kanë shndërruar totalisht sistemin e pyjeve në krejtësisht jofunksional dhe sot kemi dëmtim të pyjeve.

Po ashtu, çështje tjetër në lidhje me këtë, është çështja e buxhetit. Mos të harrojmë se sot buxheti i Kosovës është i limituar dhe ndërtimi i agjencioneve të tilla do ta rëndonte edhe më tepër.

Por, sidomos duhet të kemi parasysh që tash po duhet të bëhet një agjencion i pavarur, dhe nëse themi çka do të ketë në kompetencë të tij, ai do të ketë pra kompetencë pagesat direkte. Dhe për bujqit e për fermerët të cilët do të jenë në terren dhe do të bëhen pagesat direkte, do të jetë ky agjencion i pavarur i cili do të merret me to.

Prandaj, Lëvizja Vetëvendosje nuk do të votojë pro këtij projektligji. Do të jemi kundër me shpresën që gjatë trajtimit të tij Agjencioni i zhvillimit të bujqësisë do të hiqet dhe do të vazhdon puna e këtyre kompetencave në kuadër të ministrisë. Dhe, në rast se ndodhin këto ndryshime, ne atëherë do ta votojmë për. Por, tani për tani me këto vërejtje tona, jemi kundër.

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës Grupi Parlamentar i AAK-së deputetja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrahë në parim Projektligjin për ndryshim-plotësim të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural. Vërejtjet dhe sugjerimet tona gjithsesi se do t'i përcjellim përmes anëtarëve tanë në grupet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kosova shpreson të bëhet shpejtë një vend kandidat për në BE. Në të ardhmen përmes agjencisë së pagesave BE-ja do të kanalizojë fondet strukturale në mbështetje të modernizimit të sektorit rural të shteteve anëtare para hyrjes në BE.

Këto fonde të BE-së do të përkrahin financimin e planit të zhvillimit rural dhe bujqësor. Nëse nivelet e financimit do të ishin ekuivalente me ato të dhëna për Bullgarinë 2000 – 2006, Kosova do të merrte një mesatare prej 16 milionë euro në vit.

Kosova si vend potencial për tu bërë në të ardhmen anëtare e vendeve të BE-së do të duhej të adaptojë dhe implementojë aquicomunitaire. Andaj edhe plotësim-ndryshimi i Ligjit për zhvillim rural, nenet në të cilat e avancojnë njësinë e pagesave në Departament të pagesave për zhvillim rural do të hapin rrugë për organizim më të mirë institucional të këtij institucioni dhe do të ndihmojë Ministrinë e Bujqësisë në menaxhimin efektiv të pagesave direkte dhe të granteve për zhvillimin rural dhe të bujqësisë.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrahë ndryshim-plotësimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, deputeti Todoroviq.

BOBAN TODOROVIĆ: Zahvaljujem gospodine predsjedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmatrala je ovaj Nacrt zakona i smatramo da je od velike važnosti za razvoj poljoprivrede. I razvojem poljoprivrede razvijaćemo naravno i ruralni razvoj i stanovništvo koje živi u ruralnom razvoju. Glasaćemo u načelu i daćemo doprinos kroz dotičnu komisiju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, deputeti Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsjedavajući!

Parlamentarna grupa „6+“, analizirala je i razmatrala Nacrt zakona i u načelu podržavamo Nacrt zakona o izmenama i dopunama. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e deputetëve. Deputetja Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky projektligj rregullon implementimin e Planit për bujqësi dhe zhvillim rural si dokument kryesor politik i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Përmes këtij projektligji rregullohet përgatitja dhe implementimi i programit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, të granteve dhe subvencioneve sipas modeleve të shteteve të Bashkimit Evropian, në mënyrë transparente duke involvuar të gjitha palët e interesit dhe duke krijuar strukturat administrative për implementimin e politikave bujqësore dhe rurale.

Themelimi i Agjencionit të pagesave është shumë i rëndësishëm duke pasur parasysh proceset integruese. Lëvizja nga statusi i vendit kandidat potencial në statusin e shtetit kandidat për anëtarësim në BE krijon një mundësi për përfitimin e fondeve strukturale nga programi – instrumenti para anëtarësimit dhe për zhvillim rural.

Themelimi i Agjencionit të pagesave për vendet kandidate është i domosdoshëm dhe parashihet në marrëveshjen sektoriale në mes të vendeve kandidate dhe Bashkimit Evropian.

Me aprovimin e këtij projektligji Kosova bënë një hapë para në thithjen e fondeve të Bashkimit Evropian, e po ashtu rregullohet menaxhimi i fondeve nacionale në mënyrë shumë të rregullt dhe transparente, sipas rregullave dhe procedurave të Bashkimit Evropian.

Për funksionalizimin e plotë të këtyre strukturave kërkohen kohë, ekspertë, resurse humane dhe financiare.

Vonesa në themelimin e këtyre strukturave, disa vendeve iu ka kushtuar me dështim në përfitimin e fondeve në dispozicion në fazën e para anëtarësimit.

Ne jemi të vetëdijshëm për sfidat që na presin në të gjitha fazat e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian. Dhe në këtë aspekt Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - konsideroj se ka bërë hapin e parë duke themeluar Agjencionin e pagesave strukturë kjo e domosdoshme për menaxhimin e programit, instrumente para anëtarësimit për zhvillim rural, e më vonë edhe për implementimin e politikave të përbashkëta bujqësore evropiane.

Projektligji njëkohësisht rregullon edhe krijimin e data-bazave të dhënave dhe integrimin e një sistemi administrativ që mundëson kontrollin dhe menaxhimin e programit për zhvillim rural dhe subvencioneve në bujqësi.

Projektligji, po ashtu bënë ndarjen e përgjegjësive në mes politikbërjes dhe implementimit të politikave të Agjencionit të pagesave, e me këtë rast edhe shmanget konflikti i interesave dhe fuqizon transparencën në ndarjen e fondeve.

Aprovimi i këtij projektligji është në përputhshmëri me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe direkt ndikon në zhvillimin dhe promovimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti, Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministër i nderuar,

Kolegë dhe kolege deputetë të nderuar,

Pa dyshim që ky projektligj sa i përket bujqësisë dhe zhvillimit rural është në projektligjet me rëndësi më vitale dhe më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës, për faktin se me një menaxhim dhe zhvillim të mirëfilltë pa dyshim që do të arrihet një qenie e mirëfilltë ekonomike të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Bujqësia ka qenë një ndër sektorët më të lënë pasdore pas luftës dhe nuk i është dhënë fare prioritet këtij sektori në krahasim me sektorët tjerë. Se sa e pa zhvilluar ka qenë bujqësia, tregon shkalla e lartë e importeve nga produktet e huaja, ndërsa shkalla e ulët e eksporteve të produkteve kosovare bujqësore.

Faktor tjetër që dëshmon edhe shkallën e ulët të zhvillimit të bujqësisë është edhe fluksi i madh i banorëve nga zonat rurale drejt zonave urbane. Mungesa e stimulimit dhe përkrahjes së bujqësisë ka bërë që shumë fermerë të cilët para luftës e kanë pasur profesion dhe kanë mbijetuar nga bujqësia, ata pas luftës janë detyruar ta braktisin këtë profesion, të migrojnë drejtë qyteteve, zonave urbane dhe drejt vendeve jashtë Kosovës.

Është e pakuptimtë që çmimet e produkteve jo kosovare, do të thotë ato që kanë ardhur nga jashtë, kanë pasur shkallën më të ulët të shitjes në tregun kosovar se sa vetë produktet vendore. Këtë e dëshmon edhe mos zhvillimi adekuat i bujqësisë.

Është për tu përshëndetur dhe lavdëruar puna e ministrit të Bujqësisë aktual dhe Qeverisë në përgjithësi se në kohët e fundit i është dhënë prioritet bujqësisë, ngase ne jemi dëshmitarë se shumica e vendeve të zhvilluara të Bashkimit Evropian dhe vendeve tjera, të ardhurat kryesore mbi 50% i kanë të ardhurat nga bujqësia. Këtë duhet pasur parasysh, duhet ndihmuar vazhdimisht bujqësia qoftë përmes grandeve, subvencioneve dhe kredive pa kamatë në mënyrë që të zhvillohet bujqësia edhe më tepër.

Unë, për të mos u ndalur më shumë në këtë projektligj, e kam vetëm edhe një vërejtje, e për të mos i përsëritur ato që kolegët tjerë i përsëritën, them që te neni 22 i këtij projektligji ku thuhet se: “nëse bujqit nuk i përmbahen marrëveshjes atëherë parashihen gjopa me kamatë” çka nuk është e drejtë për tregun e tyre dhe zhvillimin e mirëfilltë të

tyre. Pra, të parashihen gjoba në bazë të nenit 6 dhe 7, po të hiqet gjoba me kamatë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në radhë është deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Edhe unë e mbështesë Projektligjin për procedurë të mëtejme.

Dhe, megjithatë, sikur edhe disa kolegë tjerë deputetë këtu, dëshiroj të vë në pah nevojën që të jemi shumë të kujdesshëm në krijimin e agjencioneve të reja dhe t'i matim mirë konsekuencat buxhetore.

Ne kemi probleme shumë të mëdha me agjencionet që janë krijuar deri më tani. Të gjitha po thuaj se bazohen në aquicomunitaire, por ne duhet të jemi të kujdesshëm edhe të shohim t'i racionalizojmë për arsye se do të vijmë në një situatë shumë të rëndë.

Në këtë drejtim ne duhet të jemi të kujdesshëm edhe në rastet kur thuhet se këta 19 të punësuar dhe të paguhen nga Banka Botërore me grand. E atëherë, çka do të bëhet kur të përfundoj grandit? Kjo duhet të rregullohet me ligj.

Në qoftë se duhet t'i paguajë buxheti, atëherë duhet të thuhet – Ligj. Dhe, pas periudhës së grandit a do të jetë ligj, dhe Ministria e Financave duhet të japë mendimin për konsekuencat buxhetore në atë drejtim.

Unë do të kisha kërkuar që çështjen e pagesës dhe çështjen e ngarkesave buxhetore, në procedurën e mëtejme të ligjit, ta shikojnë me kujdes edhe Komisioni për buxhet edhe komisioni tjetër funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur.

Në vazhdim kërkojmë deklarinimin me votim në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-98 për bujqësi dhe zhvillim ruralë.

Në mbledhje janë prezentë 93 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Faleminderit!

Konstatohet se me 71 vota “për”, 8 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratohet në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-98 për bujqësi dhe zhvillimin ruralë.

Kërkoj nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime. Faleminderit!

Tani në radhë është pika e tetë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshim-plotësim të Ligjit për lirinë fetare.

Lidhur me këtë, e kemi një mocion nga Qeveria, dhe është autorizuar zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari Lila që ta thotë fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA MIMOZA KUSARI LILA: Faleminderit kryesues, Të nderuar deputetë,
Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 56, pika 5 - propozoj të tërhiqet Projektligji për ndryshim dhe plotësim Ligji për lirinë fetare për konsultime dhe plotësime të mëtutjeshme në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Dëgjuam mocionin, me arsyetim. Tani, e hedhë në votim. Apo doni të deklaroheni? Në rregull, do të deklarohen grupet parlamentare.

Grupi Parlamentar i PDK-së lidhur me mocionin, kush e donë fjalën? Zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!
Grupi Parlamentar i PDK-së, e përkrahë mocionin dhe meqë Qeveria është sponzorisues i këtij ligji, e ka pa të udhës që të plotësojë e kompletojë këtë ligj dhe të na e kthejë për në një seancë tjetër. Prandaj, Grupi Parlamentar e përkrahë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!
Ne nuk kemi asgjë kundër të tërhiqet ky projektligj, por është mendoj shumë e papërgjegjshme të tërhiqet në këtë mënyrë.

Këtu së paku nuk dëgjuam asnjë arsyetim, sepse nuk mjafton të thuhet duhet me u plotësua. Po vërtetë është dashur një arsyetim dhe mos të vijmë në pozitë të tillë si deputetë që të tërhiqet një projektligj pa as të vetmin arsyetim.

Arsyetimi se duhet të plotësohet nuk është arsyetim. Absolutisht, është e papërgjegjshme në këtë mënyrë. Duhet me e arsyetuar se cilat janë arsytet dhe me i dhënë pak më ndryshe. Përndryshe, le ta tërheqin.

Nuk kemi asgjë kundër, por mendoj se ju e dini që sa kohë është ky projektligj dhe arsyetimet e tilla janë vërtetë të pakuptueshme. Pra, iu bien në mend dhe ne konsiderojmë se veç iu ka ra në me u tërheqë, pa arsyetim se ka me u shtuar, dhe çka ka me u shtuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Vetëvendosje, deputetja Alma Lama, e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje mendon që projektligji duhet të procedohet. Është e vërtetë që ky ka nevojë për disa plotësime, mirëpo është në detyrën e Kuvendit që t'i bëjë ato plotësime.

Nuk shohim ndonjë arsye të qëndrueshme që Projektligji të tërhiqet dhe madje mund të themi që ai është mjaftë i vonuar, sepse ka nevojë për një rregullim të mënyrës se si funksionojnë bashkësitë fetare në Kosovë.

Aktualisht situata është mjaftë kaotike dhe unë mendoj që ka nevojë të vihet rend në këtë punë, duke u nisur edhe nga fakti që Kosova është vendi ku kanë depërtuar shumë e shumë rryma të ndryshme fetare dhe pa asnjë lloj kontrolli. Nuk mendoj që i shërben funksionimit të mirë të shtetit demokratikë kjo situatë aktuale.

Prandaj, mendojmë që ligji duhet të vazhdojë të sillet në Kuvend, të plotësohet me ato nene të cilat ka nevojë dhe më pas të procedohet për votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Pajtohem që të tërhiqet projektligji, por megjithatë me vërejtjet që u dhanë, të jepen arsyetimet kur tërhiqet një projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, deputeti Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Koalicioni për Kosovë të Re e përkrahë kërkesën e Qeverisë. Ligji ka nevojë për ndryshime, për të cilat kemi pas për t'i dhënë vërejtjet edhe sot. Pra, ne e përkrahim kërkesën e Qeverisë.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar SLS, deputeti Milosavleviq.

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

I Parlamentarna grupa Samostalne strane podržava povlačenje Zakona jer i mi smatramo da treba da se ovaj Nacrt zakona doradi.

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, zoti Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala predsjedavajući!

I Parlamentarna grupa „6+“ podržava predlog Vlade da se odloži Nacrt zakona o verskoj slobodi za drugu sednicu, kako bi se ovaj Zakon bolje doradio.

KRYESUESI: faleminderit!

Tani e votojmë mocionin.

Përgatitemi për votim, dhe votojmë tani.
Në sall janë 93 deputetë.

Faleminderit! Konstatoj se me 55 vota “për”, 5 abstenime dhe 10 “kundër, Kuvendi miratoj mocionin e Qeverisë për tërheqjen e përkohshme të Ligjit për liritë fetare në Kosovë.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës, që është:

9. Shqyrtimi i parë i Projekt-rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projekt-rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim.

Ftoj kryetarin e Nën-komisionit për Mandate e Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, deputetin Armend Zemaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projekt-rregulloren.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Duke u mbështetur në nenin 40 të Rregullores së Kuvendit, në cilësi të propozuesit të Nënkomisionit për mandate, imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, para jush po e paraqes raportin hyrës për Propozim-rregulloren e re të Kuvendit të legjislaturës së katërt.

Baza juridike për nxjerrjen e Rregullores së Kuvendit të legjislaturës së katërt si ndryshim i Rregullores së Kuvendit të legjislaturës së tretë, është Rregullorja në fuqi, neni 81.

E drejta e Kuvendit të Republikës së Kosovës për të rregulluar organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës me Rregullore të Kuvendit mbështetet në nenin 76 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ndryshimi i Rregullores në fuqi, në radhë të parë është imanenca e harmonizimit me Kushtetutën e pastaj edhe synimet e progresit dhe praktikat e mira parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Organizimi i brendshëm i Kuvendit dhe detyrat e përgjegjësitë e organeve janë përcaktuar me Kushtetutë. Me Kushtetutë është përcaktuar edhe rasti kur kryetari dhe nënkryetarët veprojnë si Kryesia e Kuvendit. Neni 67 i Kushtetutës e ka përcaktuar Kryesinë. Po citoj: “Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit” mbyllet citati.

Duke u nisur nga dy determinim kushtetues, disa detyra të Kryesisë kalojnë në instanca tjera, e disa i mbesin edhe më tutje asaj.

Dokumentet zyrtare për Kuvendin, të cilat deri tash i adresoheshin Kryesisë së Kuvendit për procedim të mëtejshëm, pas miratimit të këtyre ndryshimeve, duhet t'i adresohen kryetarit të Kuvendit. Po ashtu bashkëpunimi ndër-parlamentar do t'i takojë kryetarit të Kuvendit në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare dhe me Kuvendin.

Funksionimi administrativ i Kuvendit dhe përgatitja e miratimit të buxhetit dhe llogarive buxhetore për njësitë buxhetore të Kuvendit bashkë me çështjet tjera përcjellëse në lëmin e administratës dhe buxhetit është kompetencë e Kryesisë së Kuvendit.

Përcaktimi i kalendarit të punimeve dhe Kuvendit dhe përcaktimi i propozimit të rendit të ditës për seancat plenare, të cilat deri më tash ishin në kompetencë të Kryesisë së Kuvendit, me propozim-ndryshimet e reja do të jenë në kompetencë të konferencës së kryetarëve.

Konferenca e kryetarëve është një trup i ri i cili ka disa cilësi të organit ndër-fraksional, në këtë rast pozitë – opozitë. Konferencën e kryetarëve nuk e zgjedh Kuvendi por përbëhet prej kryetarit të Kuvendit dhe nënkryetarëve të të gjitha grupeve parlamentare.

Konferenca është një trup koordinues operativ i cili koordinon dhe e bënë operativën në aspektin procedural, aktivitetet parlamentare.

Konferenca punon në principin konsensual dhe në rast të mos arritjes së konsensusit, çështjet i adresohen Kuvendit për vendimmarrje.

Organizimi i brendshëm i Kuvendit e përcakton mënyrën e funksionimit të Kuvendit në seancë plenare dhe mënyrën e nxjerrjes së akteve nga Kuvendi.

Ndryshimet e propozuara në strukturën organizative të Kuvendit janë të vogla dhe nuk ndikojnë në ndryshimin e mënyrës së funksionimit të Kuvendit. Prandaj, ajo mbetet siç është. Kuvendi i vendos grupet parlamentare, si përfaqësues të partive politike, i formojnë politikat dhe marrin qëndrime politike në raport me çështjen në Kuvend.

Komisionet parlamentare si trupa punues i përgatisin çështjet për Kuvend.

Instituimet e reja. Përveç atyre që u përmendën më lartë, janë insistuar edhe:

- Barazia gjinore në organe drejtuese dhe në trupa punuese të Kuvendit konform përqindjes së pjesëmarrjes të femrave në Kuvend.
- Shqyrtimi i projektligjeve me procedurë të përshpejtuar.
- Amendamenti i ndryshimit dhe plotësim të ligjit, vetëm brenda propozimeve të sponsorizuesit me përjashtime të specifikuar.

- Komisionet ad-hoc, angazhimi i ekspertëve të jashtme në komisionet parlamentare,
- Mënyra e mendimit të Kushtetutës,
- Zgjedhja dhe emërimi i organeve kushtetuese ligjore,
- Rastet e mundshme të dyfishimit të kohës së diskutimit të deputetëve dhe raportet e organeve të pavarura dhe rekomandimi i përgjegjësisë në rastet kur nuk miratohen raportet e tyre në Kuvendin e Republikës.
- Avancimet. Janë propozuar avancimet të instituimeve ekzistuese.
- Kushtit për parashtrimin e një projektligji i është shtruar edhe certifikata e lekturimit gjuhësor.
- Deklarimet e lira të deputetëve në fillim të seancës. Është propozuar zgjatja e kohës së deklarime nga 30 në 40 minuta.
- Mocionet përmbajtësore për debat në Kuvend.
- Puna publike dhe transparente e Kuvendit dhe trupave punuese dhe dokumentacioni i tyre publik e transparent.
- Transparenca e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit dhe Konferencës së kryetarëve.
- Rregulli në Kuvend.
Në këtë kaptinë ka edhe normime të reja dhe strukturim, modifikim të normave ekzistuese.
- Strukturimi. Propozim-rregullorja e strukturuar në tërësi në pikëpamje logjike, teknike dhe gjuhësore;
- Efektet e pritshme. Demokratizimi i mëtejshëm i raporteve parlamentare në të gjitha instancat në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- Funksionalizimi i Kuvendit, i organeve dhe trupave të tij punuese;
- Racionalizimi i shfrytëzimit të kapaciteteve dhe racionalizimi kohor;
- Puna publike dhe transparente e Kuvendit, organeve dhe trupave të tij punuese

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Propozim-rregullorja e Kuvendit si tërësi, është një dokument rregullativ solid dhe bazë e mirë për të begatuar edhe më tutje me standardet dhe praktikat më të mira të demokracive të zhvilluara, si ato amerikane e evro-perëndimore.

Për këtë i falënderoj anëtarët e Nënkomisionit për punë të zellshme dhe kompakte: Behar Selimin; Ardian Gjinin; Albulena Haxhiun, Jasmina Zhivkoviq; Myfera Shinik dhe Amir Ahmeti. Njëherësh edhe Institutin kombëtar demokratik amerikan – NDI për mbështetjen profesionale; OSBE-në për organizimin e disa punëtorive dhe mbështetjen e ekspertëve, si dhe Komisionin Evropian në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Ju thërras ta martojmë në parim Propozim-rregulloren dhe t'i hapim rrugë amendimit të saj sipas Rregullores në fuqi. Ju faleminderit!

(Seancën e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Fjalën mund ta marrin edhe kryetarët e komisioneve. A e doni fjalën? Ose, po shkojmë në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Behar Selimi, në emër të Partisë Demokratike.

BEHAR SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht më lejoni ta falënderoj kryetarin e Grupit punues, përkatësisht të Nënkomisionit për mandate dhe imunitete i cili me përkushtimin e tij ka bërë që të kemi debate të mira, konstruktive dhe të arrijmë deri te ky Projektligj që është sot këtu.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mendon se duhet ta aprovojmë këtë Projekt-rregullores sot dhe në ndërkohë kontributin do ta japë në vazhdim me disa amendamente.

Çështja që ne mendojmë se ka ngritur dilema gjatë kësaj periudhe, është çështja e Komisionit për arsim, kulturë, rini, sport, administratë publike, qeverisje lokale dhe media.

Ne mendojmë se këtu është bërë një fuzionim, një ngarkesë bukur e madhe e këtij komisioni, prandaj do të propozojmë dhe do ta amendantojmë projektligjin që nga ky komision të krijohen dy komisione që të kemi komision të veçantë për Administratë publike, duke marrë parasysh edhe prioritetet që i ka Qeveria e Republikës së Kosovës nga Raporti i progresit për reformë të Administratës Publike.

Pra e konsiderojmë tepër të rëndësishme Administratën publike dhe së këndejmi edhe mendojmë se duhet ta kemi një komision të veçantë për Administratë publike të shkëputur nga ky që është sot, dhe ndërkohë i kemi edhe sisa sugjerime tjera, por gjatë amendamentimit do të përqipemi ta japim kontributin tonë.

Ju inkurajojmë që ta votoni Projekt-rregulloren. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, kush e donë fjalën?

(Ndërhyrje)

E kreu. Mirë!

Në emër të Vetëvendosjes? Deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Ju faleminderit kryetar!

Fillimisht për ne si grup parlamentar është shumë e rëndësishme që me këtë rregullore të sigurohet fuqizimi i Kuvendit për ushtrimin e funksionit përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës.

Edhe pse në nënkomisionin për mandate, imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, kemi punuar gjatë kohë në lidhje me këtë drafat-rregullore, ne mendojmë se duhet përfshirë edhe disa çështje tjera, të cilat do t'i paraqesë në vijim, në mënyrë që kjo rregullore të jetë e implementueshme dhe ta fuqizojë Kuvendi.

Po filloj me propozimin e Grupit të Grave Deputete, më konkretisht neni 8, që ka të bëjë me përfaqësimin gjinor në Kuvend, ku thuhet se “Kuvendi me rastin e zgjedhjeve dhe emërimeve të organeve dhe trupave të tij punuese, duhet të respektojë përbërjen gjinore të deputetëve të Kuvendit”, që mendoj që duhet të rishikohet edhe pse ka pasur mjaft debat në lidhje me këtë edhe si nen ne mendojmë se është në rregull dhe i drejtë, mirëpo duhet të sigurohet një formulë apo mekanizëm që do të siguronte implementimin e kësaj dispozite, pasi që nuk munden të kushtëzohen grupet parlamentare se në çfarë gjinie të propozojnë deputetët për Kryesi.

Më pastaj, edhe pse kompetencat e Kuvendit janë të parapara me Kushtetutë, mendoj që duhet të jenë edhe në Rregullore pasi që shumica e neneve në rregullore kanë të bëjnë me punën në Kuvend dhe kështu si është, duket shumë e mangët.

Neni 11 pika 1, që ka të bëjë me shkarkimin e kryetarit dhe nënkryetarëve, thuhet: “Shkarkimi i kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit, bëhet me propozimin e grupit parlamentar që e ka propozuar”.

Në parim ne mendojmë që është në rregull që shkarkimi i tyre të bëhet me propozimin e grupit parlamentar që e ka propozuar, mirëpo në Kushtetutë e ka kuptimin tjetër që kryetari ose nënkryetarët mund të shkarkohen vetëm me 2/3 e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve. Pra, pa propozimin paraprak të grupit parlamentar.

Neni 18, të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Është hequr paragrafi që deputeti ka të drejtë të ketë qasje në të dhënat materiale dhe në dokumentit zyrtarë që përgatiten ose mblidhen nga trupat e punës së Kuvendit, nga stafi i Kuvendit, Qeveria, ministritë, doganat e administratës. Kjo pikë duhet të shtohet pasi që për ne si Grup është mjaft e rëndësishme.

Neni 24, paragrafi 5, thotë: Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike, i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe i Forcës së Sigurisë së Kosovës, udhëhiqet nga opozita. Është lënë të kuptohet që vetëm këto tri komisione i takojnë opozitës. Pra, edhe kjo duhet të rregulloret.

Neni 14, deklaratimet e lira të deputetëve dhe të grupeve parlamentare. Është mirë që janë shtuar 10 minuta në deklaratimet e lira të deputetëve, pasi që ne e konsiderojmë si pikë mjaft të rëndësishme. Mirëpo koha e caktuar për një deputet është vetëm 3 minuta. Kaq kohë ka edhe një deputet, te e drejta e replikës. Kjo nuk është në rregull pasi që te deklaratimet e lira ngritët një çështje shumë e rëndësishme dhe i ke kohë vetëm 3 minuta dhe kjo, jo gjithëherë mjafton. Pra nuk mund të jetë koha e caktuar e njëjtë si te deklaratimet e lira të deputetëve, si te e drejta e replikës.

Neni 46 paragrafi 5 mocionet procedurale. Thuhet se kur deputeti parashtrohet mocion procedural se janë shkelur të drejta e tij, kryetari i Kuvendit e shqyrton mocionin dhe më së voni në seancën e ardhshme e informon Kuvendin nëse mocioni është i vlefshëm. Kur janë shkelur të drejtat e tij kryetari e urdhëron shkelësin të korrigjohet. Por çka ndodhë nëse të drejtat e deputetit janë shkelur nga kryetari i Kuvendit? Pra edhe kjo çështje duhet të kihet parasysh.

Neni 50, te kuorumi, vendimmarrja dhe votimi. Pas shumë presioneve, trysnive që janë bërë nga Qeveria në Kuvend, pra te deputetët si për çështjen e zgjedhjes së presidentit, votimit për ligje ose jo, mocioneve të ndryshme, ne mendojmë se duhet të jetë pikë e veçantë që ndalon rreptësisht çdo tentim apo ndikim përmes formave të ndryshme të presionit në votimin e deputetit. Është e domosdoshme futja e këtij paragrafi që e ndalon këtë.

Gjithashtu një paragraf tjetër i cili i ndalon pauzat apo pushimet gjatë votimit, asnjë deputetë, anëtar Qeveria apo kryetar i Kuvendit nuk duhet të ketë të drejtën ta ndërprejë seancën para votimit. Kjo na ka ndodhur shumë shpesh në praktikë.

Po ashtu votimi 2 herë për një çështje. Mund të marrë shembullin e amendamenteve të votuara një herë për Ligjin për të zhdukurit, pra një herë janë votuar, pastaj pas dy ore është kthyer prapë votimi. Pra, kjo gjë nuk është e lejueshme në asnjë shtet tjetër dhe nuk duhet t'i lejojmë as ne praktika të tilla.

Gjithashtu votimi i mocionit, pra edhe tentimi për ta kthyer prapë votimin, kinse deputetët kanë votuar gabim, këto gjëra nuk duhet as të mendohen e le më të praktikohen.

Po ashtu, edhe te Kodi penal, Kodi civil dhe të tjerat të kësaj rëndësie, ne mendojmë që duhet të votohen me shumicë të cilësuar dhe jo si ka ndodhur e kaluar me Kodin penal. Pra, edhe një paragraf i këtillë duhet të shtohet.

Sa i përket pyetjeve parlamentare, për përgjigje me gojë, pra te neni 75, mendoj që deputeti pas përgjigjes së dytë të ministrit, duhet t'i jepet kohë edhe një minutë shtesë

në fund, sepse fakti që diskutimin po e përmbyllë kryeministri apo ministri, lejon hapësira që të devijohet pyetja.

Një problem që duhet trajtuar tek pyetjet parlamentare, është mungesa e kryeministrit apo e përfaqësuesve tjerë të Qeverisë. Nuk mjafton vetëm të publikohet në ueb-faqen e Kuvendit. Duhet të shikohet mundësia që në rast të mungesës pa arsye, kryetari i Kuvendit të kërkojë publikisht nga kryeministri ose përfaqësuesi i Qeverisë t'i tërhiqet vërejtja me emër dhe të kërkojë prezenca e tij në seancën e radhës.

Kryeministri, ministri duhet të jetë i përgjegjshëm sa i përket pyetjeve të fushë-veprimtarive të tyre.

Sa i përket interpelancës, ne mendojmë që duhet të rregullohet koha në mes të Qeverisë dhe parashtresit, pasi që kështu si është, po e dëmton parashtresin dhe po e devijon komplet çështjen.

Dhe në fund, sa pi përket fushë-veprimtarive të komisioneve, kam hasur në shumë shqetësime të deputetëve sa i përket pra fushë-veprimtarive të tyre, kështu që mendojmë që secili prej deputetëve duhet t'i adresojë vërejtjet në Nënkomisionin për mandate dhe imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, po ashtu mund të dërgojmë vërejtje edhe në cilësi të komisioneve.

Në fund, ne do të votojmë në favor të kësaj draft-rregullore dhe të gjitha këto vërejtje do t'i paraqesim në Komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë kam respekt për të gjithë deputetët dhe të gjitha diskutime, por realisht disa çështje duhet të shikohen si janë të rregulluara në parlamentet e tjera dhe në praktikat parlamentare, jo sipas dëshirave të grupeve parlamentare.

Pra, mendoj që ka disa kërkesa që dalin jashtë praktikave parlamentare. Po e marrë një shembull: Pyetjet parlamentare janë sipas praktikave parlamentare, është pyetja e deputetit, është përgjigja e ministrit, është pyetja shtesë e deputetit, është përgjigja e ministrit. Kështu është çdokënd tjetër.

Sa i përket çështjes së pjesëmarrjes së Qeverisë, unë mendoj që praktika është që zakonisht Qeveria përgjigjet para Parlamentit, një herë në javë, dy herë në muaj ose një herë në muaj.

Është në përgjegjësinë e Qeverisë, por edhe është në të drejtën e Parlamentit që dy herë ta bëjë pyetjen publikisht dhe unë mendoj që, nëse një deputet nuk merr përgjigje në dy pyetjet që ia adreson Qeverisë, tregon dhe përgjegjësinë e Qeverisë dhe kjo për mua do të mjaftonte. Është opinioni ai që do ta vlerëson se kush ka të drejtë dhe kush nuk ka të drejtë.

I bëra këto ndërhyrje për të treguar se megjithatë edhe kërkesat e deputetëve, edhe amendamentet, edhe vetë Rregullorja, duhet të jetë e harmonizuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe natyrisht, duhet të jetë e harmonizuar me praktikën parlamentare. Mos të përzihen praktikat parlamentare. Përzierja e praktikave parlamentare në një rregullore të një kuvendi, vërtet e bënë jo funksional Kuvendin dhe qëllimi i rregullores është me të funksional punën e Kuvendit dhe trupave që i zgjedhë Kuvendi.

Në emër të Aleancës, deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se Kuvendi i Kosovës për katër legjislaturat ka filluar që ta ndërtojë fizionominë e vet politike, fizionominë e vet të funksionimit dhe ajo që të gjithë ne bashkërisht për një kohë të gjatë e kemi mësuar se demokracia merr kohë, na është thënë merr kohë – zhvillohet hap pas hapi.

Kjo ka ndodhë edhe në këtë Rregullore të punës të Kuvendit të Kosovës, besoj unë, për shkak se është avancuar ajo pjesë e cila mund të avancohet për shkak se në Kuvend - në Parlament gjithmonë ndodhin negociata, gjithmonë ndodhin marrëveshje në mes forcave politike, ndodhin pjesërisht për shkak të asaj që e thatë ju, se grupet politike kanë qoftë në mendime, qoftë interesa të ndryshme, dhe këto interesa dhe këto mendime duhet të harmonizohen në mënyrë që të kemi rregullore pjesë, pjesë, gradualisht hap pas hapi që bënë që të gjithë të pajtohen të paktën për ato që janë arritur.

Nëse secili grup parlamentar do të kishte ide krejt të ndryshme për Rregulloren, ne nuk do të mund as të kishim rregullore, që është e vërteta. Dhe ajo që e bënë ky draft i kësaj rregulloreje të re, është se provon me e avancuar edhe pak më tutje prej asaj kulture të sjelljes, prej asaj kulture demokratike e cila është ndërtuar në Kosovës që katër legjislatura, do të thotë për këtë, deri te kjo legjislaturë e katërt.

Kjo është pjesa e parë për të cilën kisha dashur ta them. Grupi punues, mendoj, po edhe drafti tregon se ka provuar me e ruajtur atë konsensus i cili është arritur deri më tani, atë kulturë demokratike e cila është arritur deri me tani.

Ka pasur debate, shembull ta marrim, se si zgjidhet kryetari i Kuvendit, dhe shumë prej anëtarëve të Komisionit kanë thënë që deri më tani nuk kemi pasur problem me zgjedhje të kryetarit të Kuvendit, se është arritur gjithmonë konsensus dhe ky konsensus është arritur për shkak se është synuar që kryetari ta paraqes në masë sa më të madhe që të jetë e mundshme unitetin e Kuvendit.

Do të thotë, këto elemente të cilat kanë qenë gati koncesuale ose konsensuale për tri e më shumë legjislatura, janë provuar që të ruhen. Të ruhen për shkak se e kanë ndërtuar një kulturë të sjelljes demokratike në Kuvendin e Kosovës.

Sidoqoftë, çdo legjislaturë provon me e bë edhe një hap më përpara në avancimin e demokracisë së Kuvendit - vetanake, nëse guxoj t'i them kështu dhe nëse e kisha

përmbledhë këtë draft të Rregullores, kisha thënë që ky draft i rregullores provon me e bë një hap përpara më të madh, edhe disa hapa tjerë më të vegjël, por hapi kryesor përpara është marrja e kontrollit të plotë prej grupeve politike të cilat tentojnë me ndërtuar konsensus pak më tutje, më vonë.

Është një rrezik, gjithmonë është një rrezik që grupe politike të cilat thirren me arritur konsensus, për shembull sikur që është përmendur këtu përmes konferencës së kryetarëve, mundet me pasur vështirësi në fillim. Mirëpo Kosova ka nevojë me kaluar në këtë fazë të vetëkontrollit dhe në këtë fazë të avancimit të demokracisë kur e merr përsipër edhe me gabuar.

Edhe pse mendoj se nuk është gabim, definitivisht, unë po ju them se në një kohë kur është themeluar Kuvendi i Kosovës janë ndërtuar trupa të cilat ka qenë dashur me i mbikëqyrë pak a shumë punën e grupeve politike për shkak se kemi pasur legjislaturë të parë, nuk kemi pasur traditë demokratike, e tjera e tjera.

Kjo rregullore, ky projekt, do me thënë ky draft-projekt i rregullores provon me e kthye vendimarrjen aty ku është në sistemet demokratike, në të gjitha vendet demokratike edhe që është mes grupeve parlamentare.

Ndryshimi më i madh që ndodhë, është ky, do të thotë që agjendën e vendosnin grupet politike, grupet parlamentare. Unë po iu them grupe politike në kuptimin politik, ndërsa ndryshimet tjera janë ndryshime në funksionim për të cilat edhe mund të mos pajtohen disa grupe parlamentare, e disa mund të pajtohen. Mirëpo gjithë duhet të pajtohemi se nuk mundemi që për interes të cilitdo grup të veçantë ta bëjmë një rregullore për shkak se grupet tjera nuk pajtohen dhe rregullorja nuk kalon. Do me thënë, kjo është një copë e kompromisit cilët e bëjmë të gjithë.

Kjo është çështja e brendshme, dhe kjo është çështja për të cilin desha të flas unë por t'i dhënë mbështetje. Dhe më duhet ta potencojë edhe një herë që përkundër faktit se kemi pasur probleme, si çdo parlament në botë, në Kuvendin e Kosovës është ndërtuar një kulturë demokratike dhe fjalën kulturë po e përmendi në sensin antropologjik ku përcillet, do me thënë prej në legjislaturë në tjetrën mënyra e sjelljes, mënyra e zgjedhjes, mënyra se si sillen grupet parlamentare kundrejt, shembull ta marrim, komisioneve ose kryetarit të kuvendit. Këto janë përcjellë dhe janë ruajtur, dhe është e mirë për Kuvendin e Kosovës që po ndodhë kështu.

As kjo legjislaturë nuk ka me arritur me bë rregullore perfekte. Gjithmonë duhet me përmirësuar edhe pak, por ka me qenë fat i mirë nëse kjo rregullore mbërrin me i bë një ose dy hapa goxha të mirë përpara në konsolidimin e demokracisë, edhe një herë po e them, dhe në marrjen e rolit të plotë të udhëheqjes të paktën të agjendës së Kuvendit, dhe të grupeve politike, së bashku me kryetarin e Kuvendit.

Dhe, përfundimisht, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e mbështetë këtë Projekt-rregullore në lexim të parë. Mendojmë se ende ka për t'u rregulluar në lexim të dytë,

dhe mendoj se të gjitha grupet parlamentare do ta japin kontributin ashtu, siç do ta jap edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kush e donë fjalën? Fjalën e ka deputeti Amir Ahmeti.

AMIR AHMETI: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, e mirëpret ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit.

Ne si pjesëmarrës në Nën-komisionin për Rregullore për mandate dhe unitete e kemi dhënë kontributin tonë dhe mendojmë se është bërë një punë e madhe, me një gjuhë të mirë juridike falë punës së palodhshme dhe përkushtimit të anëtarëve këtij Komisioni por edhe të ekspertëve tjerë që na kanë ndihmuar gjatë gjithë punës tonë.

Ne parimisht pajtohemi për këtë Projekt-rregullore, dhe pas leximit të parë, ne do të japim disa propozime të cilat mendojë, si Grup parlamentar, se do ta pasuronin më shumë Rregulloren, si për shembull grupet joformale të deputetëve sipas specifikave profesionale, gjinore, rinore dhe të tjera. E po ashtu edhe pas shumë vërejtjeve apo sugjerimeve dhe kërkesës nga Raporti i progresit, ku kërkohet që ligjet të trajtohen edhe nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, mendojmë se Komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe persona të zhdukur të radhitet te komisionet e përhershme që edhe ligjet të trajtohen nga ky këndvështrim.

Pra, ne do ta miratojë në parim dhe do të japim kontributin tonë për leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputetja Jasmina Zhivković, e ka fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsjedavajući!

I parlamentarna grupa SLS je razmotrila Nacrt poslovnika za Skupštinu i smatra da sadržina odredbi u predloženom Nacrtu poslovnika vrlo jasna i precizna, što će omogućiti korektan i funkcionalan rad Skupštine. Te, s toga pozivam kolege poslanike da podrže ovaj Nacrt poslovnika. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+” deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

Nënkryetar,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë projekt-rregullore të Kuvendit dhe i përgëzon të gjithë ata, të cilët e kanë dhënë kontributin për këtë projekt-rregullore.

Ndërsa edhe ne si Grup Parlamentar “6+” do të mundohemi që të japim kontributin tonë, propozimet dhe rekomandimet për një projekt-rregullore më të kapshme, më të mirë për të gjithë deputetët dhe për punën e këtij Kuvendit dhe e përkrahim në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

Fillimisht dëshiroj ta uroj Nënkomisionin për Rregullore për një punë mjaft të madhe - profesionale dhe konsensuale, dhe të ritheksoj faktin se Rregullorja e punës së Kuvendit është akti themelor me të cilën Kuvendi i Kosovës punon dhe krahas Kushtetutës, përmes Rregullores, rregullohet mënyra si funksionon Parlamenti.

Meqenëse jemi në leximin e parë, unë do të ngriti disa çështje parimore sepse për çështjet konkrete do të bisedohet në leximin e dytë, disa çështje që mund të jenë objekt i amendamentimit në leximin e dytë, në komisionin përkatës.

E para. Rregullorja është korrekte sa i përket kompozicionit. Besoj se është korrekte edhe sa i përket raportit me Kushtetutën, sepse disa çështje që rregullohen me enumeracion takstativë në Kushtetutë, nuk janë përsëritur në rregullore dhe ideja e Kushtetutës ka qenë se çështjet e organizimit dhe funksionimit të brendshëm, të barten tek Rregullorja.

E dyta. Pas 10 viteve parlamentarizëm në Republikën e Kosovës, janë krijuar disa përvoja autoktone parlamentare dhe është madhështia e një vendi ku krahas përvojave ndërkombëtare, praktikave të mira parlamentare, krijon edhe praktika vendore dhe ato praktika i instalon në jetën e vet parlamentare.

Momenti i parë, për të cilin unë do të diskutojë, është stimulimi i aktivitetit aktiv të Parlamentit në ligj dhënie sepse Parlamenti me Kushtetutë është organ legjislativ, pra nuk është organ më i lartë i shtetit, por është pushteti legjislativ. Dhe në fakt në Rregullore ka pak dispozita që stimulojnë një qasje aktive të Parlamentit duke i promovuar iniciativat e Parlamentit dhe praktika e Parlamentit të Kosovës që është pak a shumë edhe praktikë e parlamenteve tjera është që mbi 90% të iniciativave priten nga Qeveria apo nga sponzoruesit tjerë.

Mendoj se në Rregullore duhet të instalohen mekanizmat me të cilët stimulohen dhe mbështeten iniciativat e Parlamentit në ligj dhënie dhe mendoj se duhet të gjejmë 2-3 dispozita që kur të miratojmë agjendën legjislative, në fakt të planifikojmë disa iniciativa, filluar nga Kryesia e Kuvendit që duhet t'i identifikojë disa iniciativa të cilat duhet t'i mbulojë Parlamenti, komisionet dhe deputetët dhe kur kemi një iniciativë të brendshme të Parlamentit, pra iniciativa për hartimin e ligjit, atëherë Rregullorja duhet

të krijojë dispozita që këto iniciativa të mbështetën gjerësisht në aspektet e ndryshme, sepse ne e dimë se kur ligjet vijnë nga Qeveria ato i kalojnë në një proces jashtëzakonisht mirë të përgatitur dhe të mbështetur, dhe neve na duhet në Parlament që me dy-tri dispozita të inkurajojmë komisionet parlamentare por edhe deputetët që të marrin iniciativa për hartimin e ligjit dhe ato pastaj të mbështeten edhe në pikëpamje buxhetore por edhe në pikëpamje profesionale dhe në të gjitha segmentet tjera.

Në këtë mënyrë, ne pak do ta rregullojmë ekuilibrin e iniciativave dhe do të bëjmë përpjekje që disa iniciativa legjislative të sponzorohen nga vetë Parlamenti.

Momenti i dytë, për çka foli edhe kolegu Gjini, është moment shumë i rëndësishëm në Rregullore. Ai e quajti si ndryshimin më të madh në Rregullore, por unë do ta quaja si një moment që e ekuilibron parlamentarizmin, është instalimi i organit të ri të konferencë së kryqtarëve të grupeve parlamentare.

Kjo është edhe esenca e parlamentarizmit që në fakt jeta parlamentare të jetë një proces konsensual që nga planifikimi i aktivitetit e deri te momentet e caktuara dhe është jashtëzakonisht mirë që është krijuar Konferenca e grupeve parlamentare, në mënyrë që grupet parlamentare që janë në Parlament, ta ndërtojnë jetën parlamentare dhe të përcaktojnë agjendat e Parlamentit duke filluar nga planifikimi i legjislativ e deri te vendimmarrja tjetër dhe ky institucion do të na mundësojë që në fakt konsensusi të arrihet në të gjitha segmentet e vendosjes së jetës parlamentare.

Një çështje tjetër që ta diskutoj është forcimi i kapaciteteve administrative të Parlamentit, pra forcimi i të ashtuquajturës logjistike parlamentare që është një tipar serioz i punës së parlamenteve. Edhe në Raportin e fundit të progresit, ne i kemi pa 3-4 pozicione që kanë të bëjnë me Parlamentin dhe që kërkojnë rritjen e kapaciteteve të konsulencës legjislative.

Dhe në këtë drejtim, unë propozoj që në kuadrin e diskutimit për rregullore por ndoshta edhe me Rregulloren e organizmit të brendshëm të administratës së Kuvendit të formohen tri njësi të reja që do të rrisin kualitetin dhe do të mundësojnë një punë më të planifikuar në sferën legjislative.

Njësia e parë, që mendoj se duhet të diskutohet dhe themelohet, është njësia për evitimin e kolizionit të ligjeve.

Njësia e dytë, është njësia për njësimin e ligjeve, dhe

Njësia e tretë, është njësia profesionale e redaktuarës ligjore.

Dëshiroj me dy-tri fjali me e arsyetuar pse duhet patjetër të forcohen kapacitetet administrative logjistike në shërbim të Parlamentit.

Të nderuar kolegë,

Po qe se shohim punën që po e bëjmë në Parlament, atëherë do të vëreni se më tepër se 50% të ligjeve janë ligje për plotësime dhe ndryshime të ligjeve.

Jo rrallë na ndodhë që një ligj, dy-tri herë brenda një legjislature ndryshohet dhe plotësohet. Dhe mendoj se po t'i kishin këto njësi, atëherë shumë parregullsi që vërehen në implementim dhe në zbatim të ligjeve do të mund të evitoheshin dhe ne nuk do të humbshim kohë duke i amendamentuar ligjet që i kemi miratuar para 6 apo 7 muajve.

Në parlamentet tjera, këto janë njësi shumë të fuqishme që mundësojnë profesionalitetin dhe kualitetin e punës së parlamentit. Ne ende nuk i kemi instaluar, dhe kjo po bënë që ne të humbim një pjesë të konsiderueshme të kohës apo gjysmën e kohës në rri-rregullim të legjislacionit të cilin e kemi miratuar.

Dy segmente tjera, që dëshiroj t'i diskutoj, është segmenti i stimulimit të iniciativave qytetare. Kohë më parë ne kemi miratuar Ligjin për iniciativat qytetare, të cilin e kemi amendamentuar dhe e kemi afirmuar të drejtën e 10.000 shtetasve që të propozojnë dhe të paraqiten si propozues të ligjeve.

Në këtë rregullore, besoj që Komisioni këtë nen e ka shkruar para se me hyrë ky ligj në fuqi, sepse këtë ligj e kemi miratuar kohë më parë. Unë kam qenë ai që e ka amendamentuar këtë ligj, pra si kryesues i grupit, dhe ne kemi paraparë disa procedura solemne që zhvillohen në Kuvendin e Kosovës me rastin kur kemi dorëzim të peticioneve të ligjeve të mbështetur nga 10.000 qytetarë dhe në rregullore duhet të krijohet një dispozitë e cila i rregullon këtë procedurë, pra procedurat e pranimi të një ligji nga 10.000 shtetas, të cilat duhet të zhvillohen në mënyrë solemne ose në zyrën e kryetarit të Kuvendit apo në një ambient të Parlamentit, ku qytetarët në mënyrë solemne ia dorëzojnë petitionin me 10.000 nënshkrime Parlamentit dhe Parlamenti e merr në procedim të qytetarëve.

Definitivisht këto janë praktikatat e mira të parlamenteve tjera, dhe mendoj se këto praktika edhe ne duhet t'i marrim.

Dhe momenti i katërt, që kërkon një saktësim në Parlament, janë votimet që në Parlament bëhen me 2/3.

Në fakt kemi nja 20 situata në Kushtetutë, ku votimi i ligjeve bëhet me 2/3 apo me shumicën e dyfishtë.

Kolegët që kanë hartuara rregulloren, i kanë rregulluar mirë procedurat e miratimit të ligjeve në të gjitha leximet dhe votimet, por mendoj se kemi nevojë edhe për dy-tri nene ku saktësisht definojnë rastet e votimit me 2/3 dhe procedurat e votimit me 2/3, sepse edhe në praktikën tonë kemi pasur paqartësi apo kemi pasur shkelje të rëndë të Kushtetutës, duke mos e kuptuar votimin me 2/3, dhe është e nevojshme që Rregullorja në këtë drejtim t'i përmbajë të gjitha segmentet - edhe të kuorumi, edhe të procedurës së votimit për rastet kur në bazë të Kushtetutës kërkohet një vendimmarrje e kualifikuar apo një vendimmarrje që i parasheh 2/3 apo shumicën e dyfishtë.

Me gjithë këto vërejtje, të cilat unë do t'i përpunoj më tutje në Komisionin ku edhe bëjë pjesë, mendoj se do ta kemi një Rregullore shumë më të mirë, kemi një rregullore shumë më të avancuar dhe është jashtëzakonisht mirë që në vitin e parë të kësaj legjislature po amendamentohet kjo Rregullore, edhe pse, sipas Kushtetutës ne e kemi obligim që në seancën konstituive, menjëherë pas konstituimit të Parlamentit ta miratojmë rregulloren e re të punës. Së paku ashtu është fryma e Kushtetutës, por me qenë se nuk po përgatitet seanca në fund të legjislaturës, është mirë që në vitin e parë të kësaj legjislature, po diskutohet kjo rregullore dhe unë uroj që kjo rregullore të hyjë sa më shpejt në fuqi dhe të fillojë jeta parlamentare të zbatohet në bazë të saj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Teuta Sahatqija!

TEUTA SAHATQIA: Ju faleminderit, kryetar!

Mendoj se Rregullorja e Kuvendit, është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm, një dokument i cili mundëson funksionimin e mirëfilltë të secilit kuvend dhe si i tillë është rendi që në çdo mandat ajo të përmirësohet, t'i merr praktikën e mira dhe t'i largojë ato praktika të cilat nuk janë treguar edhe aq të mira gjatë mandateve të kaluara.

Unë do të flas në emër të Grupit të Grave Deputete, Grup i cili i ka 40 anëtare dhe ne mendojmë që neni numër 8, ku flitet për përfaqësimin gjinor në Kuvend, është një nen për t'u përshëndetur.

Mendojmë se është një përmirësim për dallim prej herëve të kaluara kur është kërkuar prej strukturave të Kuvendit që me mundësi të aplikohet barazia gjinore. Këtu neni 8 është shumë më decidiv dhe mendoj që kjo është për t'u përshëndetur.

Por gjithashtu edhe praktikën e mira kanë treguar që Kuvendi gjatë kuota e cila ka qenë e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, ka treguar një sukses dhe mendoj që ky sukses në fuqizimin e gruas, duhet të reflektohet edhe në vendimmarrje të Kuvendit.

Ne më 7.06, si Grup i Grave, i kemi dërguar disa amendamente, amendamente këto të cilat janë përkrahur me nënshkrimet e 64 deputetëve dhe diçka prej atyre amendamenteve janë aprovuar, por mendojmë se ende ka edhe amendamente tjera të cilat do t'i dërgojmë si deputete në Komisionin për shqyrtimin dytë.

Mendojmë se te neni 24, aty ku flitet për emërimin e kryetarëve, zëvendëskryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve, në nenin 24 pika 2 është një pikë ku thuhet që "së paku njëri prej zëvendës-kryetarëve duhet të jetë i komunitetit tjetër nga ai i kryetarit" dhe mendoj që kjo gjë është e mirë. Por mendojmë që këtu duhet të shtohet edhe pika e cila thotë: "Së paku njëri prej zëvendëskryetarëve, duhet të jetë i gjinisë tjetër nga ai i kryetarit" për të plotësuar gjithashtu edhe nenin numër 8, i cili e bënë këtë obligim.

Gjithashtu në nenin nr. 17, ku flitet për kryetarët e grupeve parlamentare, mendojmë që edhe ky nen 17 duhet të reflektojë atë çka thotë edhe neni numër 24 dhe të kërkohej që

kryetarët e grupeve parlamentare që janë zakonisht më të mëdha se komisionet të kenë edhe zëvendëskryetarë të cilët do të jenë të gjinisë tjetër.

Për gjërat tjera, dhe për amendamentet tjera mendoj që me kohë do t'ia dorëzojmë Komisionit që t'i merr parasysh. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete! Fjalë e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Te shtojca numër 2, ka një dallim në titull ndërmjet versionit në shqip dhe në serbisht. Në shqip thuhet vetëm “fushëveprimi i komisioneve parlamentare”, ndërkaj në serbisht është edhe fjala “përgjegjësi”, siç është në versionin aktual të Rregullores së punës së Kuvendit.

Pra fjala “përgjegjësi” është hequr në shqip dhe tash nuk e di se cili është gabim, mirëpo duke e lexuar këtë Projekt-rregullore nuk do mend se në fakt versioni në shqip duket të jetë i saktë, me qenë se përpjekja ka qenë që të hiqet sa më shumë roli i komisioneve parlamentare, prandaj edhe është hequr fjala “përgjegjësi”, e cila është aq afër shprehjes tjetër “kompetencë”. Ndërkaj fushëveprimi është më tepër një zonë ku ndodhet komisioni dhe në të cilin mund të veprojë, por fjala “përgjegjësi” ka të bëjë me kompetencën, ka të bëjë me rolin dhe rëndësinë që e luan komisioni.

Pra, më shumë duket që nuk e kanë hequr fjalën “përgjegjësi” në versionin serbisht se sa që e kanë hequr gabimisht në versionin shqip.

Më tutje, tek kompetencat përkatësisht fushëveprimin e Komisionit për punë të jashtme, mund të konstatojmë që një numër i madh i përgjegjësive në fakt është eliminuar.

Pra, është eliminuar ajo që thuhet në Rregulloren aktuale që “në koordinim me kryetarin dhe me Kryesinë e Kuvendit kemi ndërtimin e bashkëpunimit të parlamenteve të shteteve tjera”. Mandej është hequr shoqërimi i kryetarit të Kuvendit në takimet parlamentare ndërkombëtare. Po ashtu edhe i ministrit të Punëve të Jashtme, në takime të caktuara të rëndësishme. Është hequr, që është shumë e rëndësishme, ratifikimi në bllok ose ndaras i traktateve ekzistuese, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruajë. Është hequr edhe përcjellja e negociatave të udhëhequra nga Qeveria, për bashkëpunim të saj në traktate të reja dhe thuhet për Komisionin e Punëve të Jashtme, që e nis debatin për ratifikimin e tyre. Dhe, gjithashtu, është hequr edhe ajo se ky komision mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave, ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni. Pra, kemi një rrudhje të kompetencave, që është reflektuar, me gjasë, në heqjen e fjalës “përgjegjësi” dhe vetëm në lënien e fjalës “fushëveprim”.

Mendoj se duke e bërë një këso rrudhje, fushëveprimi do të shndërrohet në një fushëbetejë të interpretimeve për funksionet, për rolin e Komisionit për Punë të Jashtme dhe që rrezikon të dominohet prej interpretimeve konservatore, duke qenë që shumica e anëtarëve të komisioneve përgjithësisht vijnë nga pozita.

Ajo e fundit, që desha të them është se ka pozitë pa demokraci dhe kjo është monarkia, ka pushtet pa demokraci. Por, nuk ka demokraci pa opozitë. Opozita është thelbësore për demokracinë. Dhe, në kontekstin tonë, duke pasur këso prirjesh, tendencash antidemokratike, po konsiderohet që Kuvendi është vetë opozita, prandaj duhet ta minimizojmë në përputhje të bërjes së Republikës sonë Republikë qeveritare.

Por, përvoja e ka dëshmuar edhe në vendet tjera, që aty ku republika bëhet qeveritare, në atë shtet kemi shumë qeveri e pak republikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi!

EMILIJA REĐEPI: Zahvaljujem predsedniče!

Komisija za zakonodavstvo je dala jedan nacrt zakona o radu poslanika u Skupštini Kosova i ja ću samo potvrditi i dati podršku gospođi Teuti, koja je dala jedno obrazloženje u vezi ravnopravnosti polova. Dakle, da se poštuje ravnopravnost polova prilikom odabira predsednika, zamenika predsednika ili jedan od predsednika da bude pripadnik ženskog pola, s obzirom da ima veliki broj žena deputeta u Parlamentu.

Ono što je bitno za nas poslanike, koji smo bez parlamentarne grupe, ovaj nacrt zakona sada predviđa da možemo biti funkcionalniji u Parlamentu Kosova, odnosno da imamo pravo biti deo parlamentarnih komisija. Nadam se da će ovo što pre stupiti na snagu, s obzirom da nudimo svoju profesionalnost a ne kao što je do sada bilo da možda neko od deputeta bude u po tri parlamentarne komisije. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja, Safete Hadergjonaj!

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë desha t'i ngris nja dy - tri çështje në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Është fjala tek shtojca nr. 2, ku flitet për fushëveprimtarinë dhe e përgjegjësinë e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Ne si Komision për Buxhet dhe Financa rekomandojmë që të fshihet pika e dytë, Shqyrtimi i projektligjeve dhe mocioneve përmbajtjesore, lidhur me koston buxhetore, si dhe për veprimtarinë e përgjithshme në Kuvend dhe në institucionet tjera të Kosovës, që lidhen me fushëveprimtarinë e tij. Edhe Komisioni për Mandate dhe Imunitete, këtu i ka vënë disa pikëpyetje, sepse ka qenë e paraparë në Rregulloren, që ka qenë në fuqi në të kaluarën. Megjithatë, ne mendojmë për sa i përket shqyrtimit të koston buxhetore, është e paraparë dhe e qartësuar në pikat tjera të fushëveprimtarinë, kështu që rekomandojmë që kjo pikë, pika 2 të fshihet.

Po ashtu, rekomandojmë që të shtohet pikë e re, domethënë, e drejta për të iniciuar dhe hartuar projektligje. Secili komision ka të drejtën e vet, për të hartuar dhe për të iniciuar projektligje. Kjo pikë ka qenë pjesë e rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe

Financa, që i është drejtuar nënkomisionit për mandate dhe imunitete dhe rregullore të Kuvendit të Kosovës, kurse në fushëveprimtarinë e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pika 3 duhet të riformulohet si vijon. Shqyrtimin e projektbuxhetit të Kosovës, në sferat që kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e Komisionit dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa, si komision funksional. Jemi të mendimit, që formulimi i kësaj pike tek Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, nuk është e përfshirë ashtu siç duhet.

Në fushëveprimtarinë e komisioneve, kur flitet për shqyrtimin e buxhetit dhe rishikimin e tij nga fushëveprimtaria e komisioneve parlamentare, rekomandojmë, që të shtohet teksti dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa, si komision funksional. Domethënë, Komisioni për Buxhet dhe Financa është Komision funksional dhe i vetmi komision, që i paraqet amendamentet në lidhje me projektbuxhetin dhe rishikimin e tij, kurse komisionet tjera janë të obliguara të shqyrtojnë projektbuxhetin në fushën, të cilën e kanë për obligim dhe amendamentet e tyre i paraqesin në Komisionin për Buxhet e Financa e mandej Komisioni për Buxhet e Financa i rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,
Kabinet Qeveritar,
Të nderuar kolegë,
E përshëndes punën e Komisionit rreth avancimit të Rregullores së punës së Kuvendit, por njëkohësisht mendoj se Kryesia ishte dashur edhe një herë të rishikojë punën e komisioneve funksionale. Konkretisht, do të flas për komisionin, në të cilin bëj pjesë dhe së bashku edhe me dy deputetët, Eqrem Kryeziun dhe Lirie Kajtazin e mbështesim idenë, që ky komision është bërë tepër i madh dhe po krijon ngarkesë dhe njëkohësisht, përveç ngarkesës edhe e rrezikon vetë efikasitetin e punës.

Komisioni për Arsim, Kulturë, Sport, Rini tash është bashkëngjitur edhe diaspora, administratë shtetërore, administratë lokale dhe media, është tepër i madh dhe po krijon ngarkesë, prandaj është rast i mirë, meqë po flasim për këtë, që kryesia ta rishikojë edhe një herë dhe ta ndajë këtë komision, në atë përbërje, që do të kishte mundur ta lehtësojë punën e deputetëve, por edhe mos ta rrezikojë efikasitetin.

Ç'është e vërteta, në Komision kemi diskutuar dhe shumica e deputetëve janë pajtuar, edhe pse nuk kemi votuar, por unë dëgjova edhe diskutimet e mëhershme dhe besoj që shumica e deputetëve që po përballemi me këto ngarkesa, pajtohen që mund të gjejmë forma më të mira, që ky komision të jetë efikas. Faleminderit!

KRYETARI: Pasi që pati disa deputetë, që e shtruan këtë çështje, unë vetëm po ua tërheq vërejtjen si deputetë ta dini që Kuvendi i Kosovës, hyn në Kuvendet, që më së shumti kanë komisione parlamentare dhe veç nëse doni ta bëni, të identifikoheni si Qeveria, sa

ministri i ka Qeveria aq edhe komisione të ketë Parlamenti, po bëhen jofunksionale. Megjithatë, duhet ta keni parasysh që Parlamenti ynë, mendoj që edhe ashtu ka numër të madh të komisioneve dhe ndoshta duhet të reduktohen, por jo të shtohen.

Fjalën e ka deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Më lejoni që në emër të grupit joformal të deputetëve të rinj me moshë, të përkrahim në parim këtë projekt-rregullore. Ne do të shqyrtojmë materialin dhe brenda kohës së caktuar do t'i japim vërejtjet dhe kërkesat tona për mbarëvajtjen e punës së këtij grupi, po edhe të kësaj rregullore.

Grupi joformal parlamentar i deputetëve të rinj përbëhet nga 25 anëtarë dhe kontributi jonë, do të japim pra kontribut në këtë material, i cili besojmë se do të jetë i mirëseardhur për grupin punues dhe Komisionin funksional.

Gjithashtu, paralajmërojmë se së shpejti do t'u dorëzojmë deputetëve të Kuvendit edhe një raport të punës së këtij grupi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne nuk jemi edhe të padukshëm, mos na e ngatërroi herë tjetër rendin! Jo, më bëri përshtypje, ndërsa zonja Sahatçiu po fliste për çështje gjinore, pash që disa deputetë, kështu lehtas e vunë buzën në gaz. Mendoj që është e drejtë e tyre të reagojnë në këtë mënyrë, po duhet ta dinë që shoqëria përbëhet nga dy gjini dhe çdo fushe e jetës përbëhet nga dy gjini. Duan apo s'duan, duhet ta pranojnë dhe duhet të bëhen ndryshime të rëndësishme edhe në këtë rregullore, në mënyrë që të funksionojmë si shtet, i cili ka në përbërje qytetarë që përbëhen nga dy gjini. Faleminderit!

Unë kam disa çështje në lidhje me rregulloren, padyshim, që është një dokument i punuar mirë dhe me përkushtim. Edhe unë vetë kam shkuar aty, sa herë kam pasur mundësi dhe kohë, mirëpo, janë disa çështje, të cilat me të vërtetë duhet të diskutohen.

Për shembull, në emër të Komisionit për Integritet Evropian, ne kemi përgatitur fushëveprimin, i cili vetëm është saktësimi i fushëveprimit, që ka pasur ky komision në të shkuarën ose në Rregulloren aktuale. Mirëpo, komisioni aktual ka bërë një thjeshtëzim dhe pakë a shumë një zhveshje nga kompetencat e këtij komisioni, me arsyetimin që duhet t'i thjeshtojmë gjërat. Mendoj, që kjo nuk është arsye e qëndrueshme. Ne vetëm sa i kemi saktësuar gjërat, në lidhje me këtë komision, që të mos ketë interferime ose konfuzion në lidhje me fushëveprimtarinë e Komisionit për Politikë të Jashtme dhe të komisioneve tjera. Prandaj, mendojmë që duhet të mbetet i njëjti dokument, që ne e kemi dorëzuar, në fakt, në Komisionin për Rregullore, që siç e thashë është mjaftë i ngjashëm me fushëveprimtarinë e komisionit aktual.

Është esenciale ta theksojmë, që Komisioni për Integrime Evropiane e ka në mandatin e tij bashkëpunimin me Këshillin e Evropës dhe me Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Pra, duhet të mbetet ashtu siç është.

Së dyti, ju zoti kryetar, folët në lidhje me praktikat parlamentare, që edhe unë besoj që është pikërisht ashtu, për sa i përket pyetjeve parlamentare, mirëpo unë kam një kërkesë, të cilën do ta kthej në amendament, që për pyetje parlamentare të caktohet një seancë e veçantë gjatë javës, që mund të jetë një orë ose dy orë, varësisht se si të merremi vesh, në mënyrë që të forcojmë, si të thuash rolin mbikëqyrës të Qeverisë, për sa i përket kësaj fushe.

Aktualisht, ashtu siç është, më duket se sikur shumë gjëra të rëndësishme, të cilat ngrihen gjatë kësaj kohe të seancës, kalojnë në heshtje, qoftë për shkak të mbulimit mediatik, i cili brenda një dite nuk mund t'i mbulojë të gjitha edhe kam përshtypjen, që kjo pjesë nuk po merret edhe shumë seriozisht nga Qeveria. Kështu që, shumë parlamente të tjera i kanë pyetjet parlamentare në seanca të veçanta. Besoj, që kjo është e mundur dhe shumë më efikase dhe jam e bindur, që deputetët do të angazhohen për të bërë sa më shumë pyetje parlamentare dhe për ta mbajtur Qeverinë nën kontroll ose të bëjnë rolin mbikëqyrës.

Një gjë tjetër, që mua nuk më duket e drejtë është, për sa i përket shpërndarjes së deputetëve nëpër komisione, mënyrës se si ndahen deputetët nëpër komisione, ku grupet e vogla parlamentare kanë të drejtën që të marrin pjesë në disa komisione dhe kjo me të drejtën e votës. Mendoj, që në këtë mënyrë ka ndryshuar fuqia e votës brenda Kuvendit të Kosovës.

Është e vërtetë që secili grup parlamentar, ka të drejtë të përfaqësohet në këto komisione, por në rast se ata kanë të drejtë vote në disa komisione, mendoj që ka ndryshuar raporti i forcave këtu brenda Kuvendit të Kosovës. Këto ishin disa nga çështjet, të cilat mendoj që janë shumë të rëndësishme që të përmirësohen në këtë rregullore dhe të mos mbeten ashtu si kanë qenë, sepse përndryshe për çfarë po e bëjmë rregulloren e re. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që duke ju përshëndetur ju të gjithëve, të përshëndes posaçërisht anëtarët e Komisionit, që kanë punuar në këtë rregullore dhe t'i përgëzoj për punën e bërë. Konsideroj se është bërë një punë e lavdërueshme, e cila me debatin që po bëjmë, besoj që do të plotësohet e përmirësohet edhe më tej.

Megjithatë, po parashtroj disa vërejtje me shpresë se Komisioni, që në këtë rast duhet të jetë edhe funksional, do t'i marrë parasysh në mënyrë që të mos bëjmë amendamente, po ato të sintetizohen në variantin përfundimtar. E konsideroj këtë shumë të rëndësishme

dhe në funksion të funksionalizimit të Kuvendit dhe parandalimit të dezavujimit të punës së Kuvendit, që është një tendencë, për mendimin tim, shumë e rrezikshme.

Vërejtja ime e parë është ka të bëjë me nenin 2. Bëhet fjalë për seancën themeluese të Kuvendit. Ka qenë një anomali edhe përpara, por që ka qenë korrigjuar. Kuvendi themelohet një herë, konstituohet ... legjislaturat e njëpasnjëshme, prandaj flitet për legjislaturën e radhës, por jo për konstituimin e Kuvendit. Mendoj që duhet të korrigjohet.

Në nenin 67, ku bëhet fjalë për zgjedhjen e kryetarit, ne kemi pasur një praktikë dhe të nënkryetarëve, që ata të zgjidhen në pako. E konsideroj të vlefshme për ta rishikuar. A më mirë është për hir të konstituimit më efikas të legjislaturës, të bëjmë një votim “on block” të kryetarit dhe nënkryetarëve, sepse është njëfarë automatizmi, apo të shkojmë veç e veç. Unë jam për të parën, për votim “on block”.

Te komisionet, s’di pse ka rrëshqitur një formulë, që është në çdo rregullore, se Kuvendi zhvillon punimet e tij në seancë plenare dhe komisione. Është e rëndësishme kjo për të theksuar edhe në funksion të vlerësimit të drejtë të punës në komisione, që nuk bëhet gjithmonë. Kurse, te komisionet kam edhe vërejtjen te ajo ndarja, që na ka pas mbetur prej fillimi prej komisioneve të mëdha dhe komisioneve tjera, që ka qenë një anomali e llojit të veçantë. Tani është bërë komisione të përhershme dhe komisione funksionale. As kjo nuk është e qëndrueshme dhe nuk është e saktë. Kriter është marrë nëse një komision i shqyrton të gjitha ligjet ose jo, gjë që është specifike e vetëm Kuvendit tonë. Mendoj që do të duhej rishikuar, do të duhej marrë praktikën e vendeve tjera, ç’është komision i përhershëm dhe ç’është komision funksional? Për mendimin tim, madje nuk do të ishte mirë që me rregullore, ne ta prejudikojmë edhe konstituimin, strukturën e komisioneve, sepse së paku kjo pjesa funksionale, duhet të korrespondojë me Qeverinë dhe do të ishte mirë t’i lihet çdo legjislaturë që ta bëjë këtë.

Në nenin 23, është lënë mundësia për keqkuptime me fjalinë “grupet parlamentare kanë të drejtë përfaqësimi në çdo komision.”.

Grupi parlamentar përbëhet prej 6 anëtarëve dhe ai ka të drejtë të prezantimit në çdo komision, por pa të drejtë vote. Kemi pasur edhe një keqkuptim. Mendoj se do të ishte mirë të sqarohet, që të mos lejohen keqkuptime.

Te neni 44, te deklaratimet, mendoj që ka qenë e nevojshme të sqarohet çështja e deklaratimeve të deputetëve dhe e ministrave, sepse siç është thënë këtu, vërtet është shndërruar në një “hajt pak”. Dhe, do të ishte mirë që këtu të futet çështja e çështjeve urgjente, që janë lënë atje shumë më vonë, në nenin 77, ka të bëjë edhe me fillimin e seancës dhe për mendimin tim, duhet precizuar, çka mund të futet në këtë instrument, i cili për mendimin tim, duhet të mbetet. Vendet tjera kanë praktikuar edhe një ndarje. Çështjet e agjendës jashtë rendit të ditës, shtrohen edhe në fund të seancës, në mënyrë, që të jetë përgatitje për seancën vijuese dhe jo në fillim të seancës. Në fillim të seancës lihen vetëm çështjet urgjente. Mendoj, që ia vlen edhe të mendohet.

Në nenin 47, ku flitet për mocionin, mendoj që duhet të sqarohet më mirë ç'është mocioni? Ne na ka hyrë edhe në praktikën tonë, në njëfarë mënyre përdorimi i shprehjes mocion, jo vetëm në kuptimin që ka si nismë për diçka, por mocioni si akt, që është në kundërshtim edhe me kompetencat e Kuvendit edhe në Kushtetutë edhe në Rregullore. Mocioni nuk është rezolutë, prandaj mocioni mund të jetë një nismë për rezolutë ose për një akt tjetër, por Rregullorja, mendoj që edhe në variantin e ri, nuk e ka sqaruar.

Në nenin 51, përsëri është bartur një formulë, që ka qenë e kritikueshme edhe përpara. “Deputetët duhet të zbatojnë urdhrat e kryetarit të Kuvendit.” Duhet një shprehje tjetër, jo, urdhrat, kërkesat, sugjerimet e diçka të ngjashme, por jo urdhrat.

Mu më ka bërë përshtypje një formulë e re, që ka hyrë te neni 57, ku janë përshkruar kushtet si mund të parashtrohet një ligj. Por, është e çuditshme në 65.3 është një formulë, që përshkruan Qeverinë si parashtruese të ligjit, por ky nen e përjashton, pikërisht këtë paragraf në një formë, që është krejt e pazakonshme për një rregullore. Nuk e kuptoj si nuk mund të mos vlejë kushtet për parashtrimin e një ligji, pikërisht për Qeverinë. Mendoj, që Qeveria nuk duhet të jetë përjashtim në këtë rast. Edhe te çështja e votëbesimit, e mosbesimit dhe e votëbesimit, nuk është sqaruar, madje është më keq se përpara- ç'është votëbesimi dhe ç'është mosbesimi? Kryeministri ka të drejtë të kërkojë votëbesimin, por edhe grupet parlamentare, deputetët kanë të drejtë të kërkojnë mosbesimin dhe secila prej tyre duhet të adresohet veç e veç, në nene përkatëse siç e kanë rregulloret tjera.

Te neni 93, te çështja e imunitetit, mendoj vetëm që duhet precizuar kjo çështje dhe Kuvendi duhet ta iniciojë edhe një formë debati, ndoshta edhe me Gjykatën Kushtetuese për të evituar kolizionin që është krijuar.

Mua më ka bërë përshtypje edhe te neni 95, një anomali që përsëri mbetet humbja e statusit, thuhet tekstualisht “e statusit të deputetit”. Dhe, deputeti humb statusin në kushtet a, b, c, ta zëmë nëse mungon 6 muaj, por nuk sqarohet se çka ndodhë? Deputetit i merret statusi ose mandati më drejtë, jo statusi. Statusi rezulton nga mandati, po i merret, ai nuk e humb automatikisht, nuk do të thotë që atë ditë që bëhen 6 muaj, roja e ndal e i thotë ti s'mund të hysh. Megjithatë, duhet të rregullohet një procedurë institucionale, që ka qenë shtruar edhe përpara.

Dhe, duke kërkuar falje edhe për zgjatjen, mendoj që kësaj rregulloreje, për të cilën përsëri kam komplimente dhe meritojnë mirënjohje ata që kanë punuar, i mungon edhe një kapitull, çështja e konfliktit të interesave. Ka qenë shtruar edhe përpara dhe nuk ka qenë arritur të ndërtohet. Nuk mund deputeti të vendosë dhe të votojë për gjithçka, ku ka konflikt interesi, në çdo rregullore, ai e përjashton vetveten. Angazhohem që këto korrigjime të bëhen nga komisioni, nëse jo, ne do t'i bëjmë si amendamente. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Hamza Balje e ka fjalën!

HAMZA BALJE: Zahvaljujem, predsedniče!

Poštovani ministri,
Poštovani zastupnici,
Poslovnik rada Skupštine je pravni akt kojim se određuje procedura organizovanja i funkcionisanja rada Skupštine Republike Kosova. Ovaj poslovnik, sada veoma jasno definiše način organizovanja Skupštine u organe i radna tela, kao i njihovo funkcionisanje na plenarnim sednicama, što u ranijim slučajevima nije bilo tako. Novina u ovom poslovniku je što od velike važnosti jeste reforma koncepta transparentnosti rada Skupštine i samih poslanika po radnim organima, odnosno komisijama.

Naime, ako pogledamo član 23. tačka 1. kaže se da poslanik mora da bude član najmanje u jednoj parlamentarnoj komisiji, što ranije nije bilo slučaj.

I tačka 5. istog ovog člana, u nastavku se kaže da se to određuje od strane predsednika Skupštine Republike Kosova. A misli se na one zastupnike, koji nemaju mogućnosti da formiraju svoje parlamentarne grupe. A znate da u Parlamentu imamo više takvih zastupnika i da se njihova jačina zasniva i bazira na učešće u radu Skupštine Republike Kosova, a ako nisu članovi nijedne komisije, njihova jačina se gubi, kao što to stoji u tački 3. sastav parlamentarne komisije reflektira političku snagu parlamentarnih grupa i ja bih tu dodao i zastupnika. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Vesimir Saviq, e ka fjalën.

VESIMIR SAVIĆ: Zahvaljujem, predsedavajući Skupštine!
Dame i gospodo narodni poslanici,
Predstavljam jednu parlamentarnu grupu, neformalnu parlamentarnu grupu, koja nije član nijedne grupe u Parlamentu do sada. Dolazimo iz jedinstvene srpske liste koja je na prethodne izbore imala oko 6.000 glasova. Prethodnim poslovnikom o radu, nama poslanicima bilo je skraćeno pravo na učešće u radu komisija, gde je uskratilo i našu aktivnost u izradu i dopunu nekih važnih zakona. Ovim članom, sada i ovim poslovniku u radu, dozvoljavaju se i ovim poslanicima da budu učesnici u drugim komisijama, koje su izuzetno važne za nas. Mi iz političke opcije Jedinstvena Srpska Lista, podržaćemo ovaj poslanik o radu, u ime 5 poslanika i nadam se da ćemo aktivno učestvovati i davati svoj doprinos u tim komisijama. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!
I nderuar kryetar,
Përfaqësues të Kabinetit Qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Unë kam një pyetje, faktikisht ia drejtoj Kryesisë dhe Kuvendit dhe gjithashtu një sugjerim.

Neve gjatë vitit të kaluar kemi pasur raste ku si Komision për Buxhet dhe Financa kemi ndërhyrë në ligj, kur kemi pasur një projektligj për ndryshim dhe plotësim të ligjit. Edhe komisioni, në fakt ndryshimin në ligj e kemi bërë pasi kemi marrë përgjigje me shkrim nga Zyra Ligjore e Kuvendit, e cila na ka thënë që keni të drejtë, do të thotë, qoftë si grupe parlamentare ose si komision funksional, që të ndërhyni edhe në ligj, kur është fjala për projektligje, që janë ligje për ndryshim dhe plotësim. Edhe kjo është pyetja. Mandej kemi rënë në kundërshtim me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe na u ka kthye ligji mbrapa. Përgjigja ka qenë se deputetët nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë në ligj, në pjesën e ligjit ku sponsorizues është Qeveria edhe kemi të bëjmë me projektligj për plotësim dhe ndryshim.

Unë mendoj që ne si organ ligjvënës duhet të kemi të drejtë të ndërhyjmë edhe në pjesën, që nuk e ka propozuar për ndryshim plotësim Qeveria, sepse Qeveria jo gjithëherë i ndryshon ligjet për t'i vu ato në funksion të qytetarëve, sidomos kur është fjala te ligjet që kanë ndikim financiar, për shembull, rritja e taksave e tjera, ne si organ ligjvënës duhet të na lihet e drejta dhe kjo e drejtë duhet të përcaktohet, qoftë me ligj, qoftë me këtë rregullore, që ne të kemi të drejtë të ndërhyjmë edhe në ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Fjalën e ka deputeti, Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!
Edhe pse ke bërë diskriminim kësaj radhe, po ta fali!

KRYETARI: Po lejohet nganjëherë...

NAIT HASANI: Faleminderit!

Mendoj, që Rregulloren që e kanë përpunuar, kemi pasur përafërsisht edhe kesi rregullore edhe më herët me disa ndryshime të vogla. Nëse e lexojmë Kushtetutën dhe Rregulloren, bëmë ndesh me vendimet e Kushtetutës dhe me nenin 92 të Rregullores dhe me nenin 75 të Kushtetutës. Në Kushtetutë përcaktohet imuniteti i deputetëve, ndërsa vendimet e Gjykatës Kushtetuese, që i kemi ne, që na i kanë pru neve, që jemi ankuar, ndër ta unë jam ankuar për çështje të imunitetit, ajo na thotë neve që nuk kemi imunitet. Prandaj, unë kërkoj që ky kapitull ose ky nen 92-shi dhe 93-shi të fshihen nga Rregullorja e Kuvendit të Kosovës. Nuk duhet ta mashtrojmë veten se kemi imunitete, për arsye se nuk kemi imunitete.

Prandaj, lenia këtu jep të kuptojmë, thotë: Deputeti gëzon imunitetin në pajtim me Kushtetutën. Vendimi i Gjykatës thotë se nuk kemi imunitet. Kjo shihet nga rastet e përditshme, arrestimet e përditshme, torturat e përditshme, që iu bëhen deputetëve. Pse e mashtron vetes si deputet. Kemi imunitet apo s'kemi imunitet?

Tjetra është, unë mendoj që këto janë çështje të ditura të gjithëve dhe duhet t'i bëhet kërkesë. Mendoj që edhe një çështje që duhet të ngritet këtu mbeten pa u përfaqësuar çështja e burrave. Këtu dolën gratë joformale, dolën të rinjtë joformal, unë mendoj që

duhet të ketë edhe grupi i burrave joformal, të paktën ta dimë a ka burra ky Kuvend, apo s'ka?

Prandaj, edhe çështja e grave unë mendoj që duhet të jenë më të shfrytëzueshme politikisht. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Edhe 3 deputetë i kemi nga Partia Demokratike.
Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse, shumë nga preokupimet e mia u diskutuan, u ezauruan dhe u trajtuan në një mënyrë, unë veç në formë mund t'i trajtoj ndryshe, sepse në përmbajtje nuk mund të ngreh ndonjë çështje tjetër dhe shumicën nga këto preokupime i dëgjova. Besoj se është më mirë ta kursej këtë debat më tutje dhe t' u lë rastin të tjerëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
E ka fjalën deputeti, Fadil Demaku.

FADIL DEMA KU: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar zoti zëvendëskryeministër,
Kolegë deputetë,
Fillimisht e përshëndes punën e Nënkomisionit për mandate, imunitete dhe rregullore për projekt-rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Çështja për të cilën unë dua të flas ka të bëjë me Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë.

Duke udhëhequr punën në pozitën e nënkryetarit, në kuadër të këtij komisioni, nga puna e deritanishme në këtë legjislaturë, por duke parë edhe raportet nga legjislatura e mëparshme, mendoj se fushëveprimi i këtij komisioni është shumë i kornizuar dhe është i ngushtë dhe nga kjo unë kisha propozuar që Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, duke iu referuar edhe deputetit Sadri Ferati, që e mori shembull një komision tjetër, Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, domethënë ku përfshihen, është një fushëveprim i gjerë, gjithashtu edhe nga mediat. Ndërsa, gjithashtu duke iu referuar edhe vetë fjalës së kryetarit të Kuvendit, i cili tha se ne ashtu kemi shumë komisione, mendoj se Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar të Inteligjencës, do të mund të funksiononte si një nënkomision në kuadër të Komisionit për Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Mendoj se kjo do të ishte më rationale, do të ishte në funksion edhe të ruajtjes së financave, të kohës dhe të shumë faktorëve tjerë, me të cilët përballlet Kuvendi. Ne kemi parë, domethënë me gjithë angazhimin e anëtarëve të Komisionit, vetë fushëveprimtaria e Komisionit, pasi që është e ngushtë, ato më tepër koha e takimeve në kuadër të Komisionit është shfrytëzuar për të bërë politikë se sa për t'u marrë me materialin, të cilin e kemi pasur përpara si komision.

Me një fjalë, dua të them se do të ishte funksionale, nuk është se ne mund të bëjmë ndonjë precedent. Unë kam qenë vetë në vizitë tek komisioni parlamentar në Republikën e Shqipërisë, ata nuk kanë Komision për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar të Inteligjencës të veçantë, por kanë një nënkomision në kuadër të Komisionit për Siguri. Ashtu kështu, veprimtaria ka të bëjë me çështje të sigurisë dhe mendoj se do të ishte në funksion të kësaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Sala Berisha- Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ju të pranishëm,

Edhe unë e kam analizuar pakë a shumë këtë rregullore të punës së Kuvendit dhe e përsëritet ardhjen e saj në Kuvend. Shpresoj që do ta funksionalizojë më tepër punën e Kuvendit, duke i parë disa nene këtu, që e bëjnë më funksionale.

Po nisem së pari nga neni 8, mënyrën se si është paraqitur këtu, unë mendoj se nuk i jep kurrfarë obligimi Kuvendit dhe është paraqitur në atë formën, veç hajt të themi diçka për gjininë, sepse zbatimi i tij është i pamundshëm, duke e ditur se si funksionojnë trupat e Kuvendit. Ne kemi pasur rastin, për shembull edhe në Komisionin për Shëndetësi ka pasur më shumë gra të përfaqësuara në atë komision se sa burra. Kjo për mua nuk ka asnjë rëndësi ky nen. Prandaj, nuk e di se a do të votohet apo jo, le t'i mbetet seancës, është i pazbatueshëm.

Ajo, për të cilën e mora fjalën më tepër, ka të bëjë me disa çështje tjera, sidomos te neni 23, ku është paraqitur përbërja e komisioneve parlamentare. Shpresoj se edhe komisionet parlamentare do të jenë më funksionale me futjen e paragrafit 3, ku thuhet se përbërja e komisionit parlamentar reflekton fuqinë politike të grupeve parlamentare. Jemi dëshmitarë të kësaj legjislature se raporti në mes të pozitës dhe opozitës nëpër komisione është vetëm një votë e nganjëherë edhe mungojnë ato dhe nuk reflektohet fuqia politike nëpër komisione, kështu që shpresoj që këtë çështje ta rregullojë ky nen.

Tjetër, te nismat legjislative, ku paraqiten te neni 58.3, më falni e kam pak të paqartë te nismat legjislative, ku thuhet se nismat mund t'i bëjnë deputetët, komisionet parlamentare apo edhe 6 deputetë, mirëpo unë mendoj se nismat legjislative e kanë qëllimin kur ju mbetet në kompetencë, domethënë, kur ju jepet kjo e drejtë deputetëve, qëllimi është që çështjet e caktuara, që duhet të rregullohen me këtë ligj, qëllimi është që të jetë procedura më e shkurtuar.

Në formën se si është paraqitur këtu, te nismat legjislative, mendoj që aspak nuk e ka zvogëluar afatin kohor që një ligj të bëhet me një procedurë më të shpejtë, sepse parasheh një muaj ditë me e paraqitë në Kuvend, mbasandaj për ta dërguar dhe kërkuar mendim te Qeveria. Qeveria për ta kthyer në Kuvend e kështu me radhë.

Besoj që Komisioni Parlamentar, gjatë amendamentimit të kësaj rregulloreje, do të ketë parasysh një afat sa më të shkurtë për këtë çështje. Mandej neni 64, ku ka të bëjë me plotësim- ndryshimin e ligjit, thuhet se plotësimi dhe ndryshimi i ligjit vjen dhe komisioni duhet ta shqyrtojë vetëm atë pjesë, ku Qeveria e ka paraparë që të plotësohet dhe ndryshohet. Mendoj që nuk duhet të jetë ashtu, nga përvoja ime parlamentare kemi pasur raste kur Qeveria ka prurë për plotësim- ndryshim një ligj, i cili ka qenë në fuqi e nuk janë prekur disa dispozita, të cilat komisioni i ka konsideruar, që ndërlidhen ngushtë me ato plotësim ndryshime që janë bërë dhe duke u nisë nga ky paragraf, domethënë, nuk është lejuar që të preken edhe ato dispozita tjera apo nene tjera, të cilat nuk i ka paraparë plotësimin dhe ndryshimin Qeveria.

Mendoj, që kur të vjen një ligj për plotësim ndryshim është mirë që në qoftë se komisioni konsideron, që është edhe ndonjë nen apo dispozitë tjetër, të plotësohet dhe ndryshohet, t'i jepet edhe kjo e drejtë.

Mandej, te neni 65, shqyrtimi i dytë i projektligjit, ka të bëjë, për shembull thuhet se në rastin kur janë miratuar, së paku, një e katërta e amendamenteve, ju ftoj për vëmendje, të projektligjit, në rastin kur janë miratuar, së paku një e katërta e amendamenteve të projektligjit, kurse të tjerat refuzohen, komisioni funksional ose propozues i projektligjit, para votimit në tërësi mund të propozojë që projektligji të dërgohet në shqyrtim të tretë.

Për mua, mendoj që është e panevojshme, sepse është fjala për amendamentet dhe në qoftë se komisioni ka bërë amendamente, mirëpo seanca nuk i voton më shumë se një të katërtën, atëherë ky është mendimi i seancës dhe unë mendoj se është e panevojshme që të sillen ky projektligj në lexim të tretë, në qoftë se nuk ka ndonjë arsye, që e kërkon edhe Qeveria të shkojë në lexim të tretë.

Shpresoj që kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit të kësaj projekt-rregulloreje. Faleminderit!

KRYETARI: E ka fjalën deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit zoti kryetar Krasniqi!

Unë s'do ta zgjas bisedën, sepse do t'i them vetëm dy-tri çështje, meqë unë dëgjova se secili e lavdëroi punën e komisionit, tani foli shumë vërejtje, që i bie që s'del që qenka kaq e përsosur, logjikisht.

Në memorandum shpjegues, këtu thuhet, që kjo rregullore është bazuar tek nën krahësimi me rregullore evropiane, po s'kallxohet me cilat. Mbasandaj tregohet që është e re. E re është vetëm për një gjë, që funksionet që i ka pasur kryesia si organ rreth rendit të ditës, i kalohet një institucioni të ri, që quhet konferenca e kryetarëve. Këtu shpjegohet se njëra, konferenca merr kompetenca procedurale ligjore ndërsa tjetra Kryesia kompetenca procedurale administrative. Unë nuk po e shpjegoj tutje këtë veç po e them le të shikohen mirë e mirë nenet 64 edhe 67 të Kushtetutës. Atje shihet edhe qysh votohet edhe formohet Kuvendi edhe qysh votohet dhe formohet udhëheqësia e tij politike. Sepse,

më duket kolegu Bajrami tha “kem përvoja autoktone parlamentare” është e vërtetë, sepse kem edhe përvoja autoktone “sui generis” përfaqësimit.

Nuk ka Kuvend në botë që pakica është shumicë vazhdimisht, në Kuvend tonë është. Me këto dy nene të Kushtetutës, pakicat janë shumicë domosdo, sepse Kushtetuta i sanksionon të jenë në shumicën parlamentare edhe në shumicën qeveritare. Domethënë, ato që quhen “universalitete demokratike” këtu s’funksionojnë, sepse të tilla si lë Kushtetuta dhe unë, unë votoj që sot që këto dy nene të Kushtetutës të ndryshohen, veçse është punë shumë problematike a votojnë tjerët. Çfarë duhet të them? Që kemi Parlament që udhëheq shumica, kryetar dhe një nënkryetar kushtimisht opozita një nënkryetar formal. Po kjo nuk ndodh këtu, sepse sanksionohen edhe zgjedhjet edhe përfaqësimi edhe udhëheqësia politike me Kushtetutë. Dhe, patjetër në leximin e dytë edhe hartuesit do t’i kthehen këtij problemi, se s’mund t’i ikin.

Dhe, çështja e dytë është unë propozoj që te pjesa e komisionit të formohet Komisioni Kushtetues i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk duhet t’i elaboroj sot arsyet, arsyet janë multi, edhe kushtetuese te ne sot edhe çka na pret politikisht në të ardhmen. Nuk mundemi ne të arnojmë Kushtetutën prej rastit në rast me komisione ad hoc, Kuvendi duhet ta ketë komisionin e përhershëm kushtetues në krye të cilit rrinë normalisht kryetari i Parlamentit si në çdo Parlament. Të ketë numër përfaqësimi, le të merren vesh partitë për formatin, po ne nuk mund të shkojmë tutje pa një komision të tillë. Ka edhe probleme të tilla që janë definuar, problemi kryetarit të shtetit, unë i di maraku ka qenë me i rregulluar të gjitha problemet po s’mund t’i rregulloni se ne nuk e dimë ende raportin kushtetues të kryetarit të ri me Kuvendin. Pra, janë pikëpyetje të mëdha këto, kot shkruhen këtu si hipoteza.

Raporti i kryetarit të ardhshëm me Kuvendin nuk dihet, sepse ne s’kemi votuar ende amendamente për raportin që do ta ketë Kuvendi me atë kryetar, kushdo qoftë. Dhe, unë po ndalem këtu, domethënë kam sugjerim të shihen nenet 64, 67 të Kushtetutës nën një dhe nevoja e formimit të Komisionit Kushtetues të Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë i falënderoj të gjithë deputetët që kontribuan me diskutimet e tyre, për këtë arsye është paraparë që Rregullorja e Punës së Kuvendit ta ketë procedurën sipas rregullores në fuqi dhe të jetë mes dy leximeve dhe ne me vëmendje dhe me konsideratë do t’i marrim këto diskutime dhe propozime dëshirojmë që të jenë edhe të matrealizuara me shkrim.

Unë e thashë që në fillim se rregullorja është strukturuar në tërësi në pikëpamje logjike, teknike dhe gjyqësore. Më lejoni të shpjegoj se kur kemi filluar punën e kemi pas dy gjëra parasysh: 1. Kushtetutën e Republikës së Kosovës, këtë të tanishmen edhe pse gjithë jeni pajtuar që ka gjëra që mund të elaborohen dhe të diskutohen edhe më tutje apo të ndryshohen dhe 2. gjithë anëtarët e komisionit kanë punuar në mënyrë të pavarur, pa ndikime dhe asnjëherë, asnjëri prej tyre nuk e ka parë veten në një pozicion të caktuar.

Kjo e ka bërë punën tonë shumë më efikase dhe për këtë çështje potencova që ka qenë shumë kompakte. E treta, te fushëveprimtaria duke filluar nga kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës edhe deri te komisionet, asnjëherë nuk ka ekzistuar ndonjë tendencë e një rregullimi të ri apo marrja e kompetencave dhe bartja te “x” personi apo te personi tjetër. Këtë e them se ne ju kemi dhënë afat edhe kryetarëve të komisionit dhe t’i japim të gjitha sugjerimet, vërejtjet besoj që tash do t’i marrim. Ajo çka është bërë në fushë veprimtarinë dhe përgjegjësit e komisioneve dhe them me të drejtë ka qenë një stërngarkim gjyqësor dhe elementet të cilat e kanë devaluuar vetë fushë veprimtarinë dhe kompetencat e komisioneve në fjalë. Nëse është lëshuar ndonjë gabim ne me shumë konsideratë do ta marrim, por asnjëherë nuk kemi dashur të lëmë apo të nënkuptojmë që jashtë mbikëqyrjes të ekzekutivit ka diçka tjetër.

U thanë disa çështje te raportet pozitive-opozitive se ne e kemi parashtruar shumë me të drejtë, ne kemi pasur edhe vizita mos të harroj edhe në Kuvendin Popullor të Turqisë, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me neve ka punuar një kohë të gjatë edhe ish-nënkryetarja e Parlamentit të Gjermanisë si e paguar nga Komisioni Evropian dhe rregulloret tjera që janë marrë për bazë janë duke filluar nga vendet e rajonit dhe vendet më demokratike që janë evropiane, pa i apostrofuar të gjitha me rend, por nëse rishikohen unë thash nga pikëpamja logjike mund të gjeni shumë elemente nëse bëni anën krahasimore.

Çështjet që janë me risi dhe që mbeten vullnet politik i partive politike si barazia gjinore, përfaqësimi në komisionet parlamentare edhe këtu jemi nisur nga fakti që Kuvendi funksionon që 10 vjet. Nuk po e formojmë Kuvendin e Republikës së Kosovës ne me këtë rregullore, por jemi bazuar në praktikën e ndërtuar parlamentare nga konsensusi politik dhe nga disa norma morale që janë edhe raportet e Qeverisë ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës. Unë edhe njëherë ju falënderoj të gjithëve. Ne do t’i marrim këto sugjerime, po e potencoj nëse janë parafrazuar në mënyrë jo vetëm gojore mos të mbesin të jenë edhe me shkrim dhe në afatin e përshtatshëm ligjor ta begatojmë edhe më tutje edhe ta avancojmë Rregulloren e punës së Kuvendit. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Pasi deputetët i kryen diskutimet e tyre edhe unë dua t’i them 3-4 çështje më tepër të formuluar në mënyrë të përgjithshme se sa konkrete, por që komisioni do të duhej t’i kishte parasysh.

Më tepër dua të flas, të nderuar deputetë, në lidhje me përvojën se sa diçka më konkrete. Unë konsideroj që janë disa punë që janë kryer këtyre ditëve dhe konsideroj që nuk janë në përputhje me praktikën parlamentare dhe do të duhej të ishin në përputhje me praktikën parlamentare. Unë e falënderoj deputetin Sabri Hamitin që tha se duhet të jetë në rregullore, por realisht do të duhej të ishte edhe në Kushtetutë, që Komisioni Kushtetues është i përhershëm dhe e drejton kryetari i Parlamentit. Unë jam kësaj radhe, nesër mund të jetë dikush tjetër. Konsideroj që ky komision duhet të udhëhiqet nga kryetari i Kuvendit, se sigurisht do të kishim edhe shëtitje më pak, por jo kjo nuk është esenca e kësaj që po e them.

Ajo që e kemi miratuar edhe në seancat e para të vitit që e lëmë pas, për një komision ad hoc, realisht bie ndesh krejt me Kushtetutën. Bie ndesh me Kushtetutën se neni 144 i Kushtetutës e saktëson se kush ka të drejtë ta jep amendamentin kushtetues. Janë 30 deputetë, $\frac{1}{4}$ e deputetëve është kryeministri dhe presidenti ose presidentja. Janë vetëm këto 3 formacione që mund të bëjnë amandamente, por jo Komisioni ad hoc. Edhe shtesa që është dhënë, shtimi që i është dhënë këtij komision mendoj se nuk është në përputhje me Kushtetutën se ata që kanë menduar ta amandamentojnë Kushtetutën është dashur të mendojnë amandamentimin në tërësi dhe jo pjesërisht. Por, edhe formimi i këtij komisioni si duket ka qenë sui generis, por megjithatë është koha që Kuvendi realisht mos të bëhet pjesë e shkeljeve, të praktikave në fund të fundit se si amandamentohet Kushtetuta, se pastaj janë edhe disa procedura tjera.

Një çështje tjetër që dua ta them është çështja e komisioneve, e thash edhe njëherë po e them edhe tani: sigurisht që duhet një harmonizim ndoshta më i mirë dhe një ndarje më e mirë e punëve në komisione, por Kuvendi ynë me 120 deputetë dhe formimi i shumë komisioneve realisht komisionet i bën jo funksionale edhe për shkak të numrit të kufizuar të deputetëve, prandaj mendoj që këto duhet ndoshta ta shfrytëzojmë këtë mandat që e kemi si Kuvend për të ardhur në përfundim se sa komisione i duhen këtij Kuvendi dhe sigurisht kjo duhet të kihet parasysh edhe kostoja buxhetore e komisioneve. Unë mendoj që e kemi për përgjegjësi si deputetë të mendojmë.

Çështjen e Rregullores, nuk duhet ta shohim pozitë-opozitë, se dikush sot është opozitë nesër mund të jenë pozitë dhe e kundërta. Qëllimi i punës tonë duhet të jetë, ta bëjmë një Rregullore të Kuvendit, ta hartojmë një Rregullore të Kuvendit e cila e bën funksionale punën e Kuvendit. Nganjëherë me disa praktika që i kemi vendosur, unë droj se ne me punën tonë po e bëjmë funksionale punën që duhet ta kryej Kuvendi si institucion përfaqësues, ligjvënës dhe monitorues. Sigurisht që unë do të shikoj dhe do ta ngarkoj stafin tim që t'i këqyrë edhe këto amendamente ose këto nene të kësaj rregullore, do t'i bëjë edhe amendamentet që mendoj që do ta ndihmonin dhe do ta ndryshonin apo përmirësonin përmbajtjen e kësaj rregullore që vërtet secili trup i Parlamentit ta kryejë punën e vet si duhet.

Një çështje që mendoj tjetër që duhet ta shikojmë, duhet ta shikojmë çështjen e kryesisë dhe mendoj se Kryesia e Kuvendit tonë nuk mund të krahasohet me ato kuvende që kanë kryesinë kryetarin, një nënkryetari i pozitës dhe një i opozitës. Prandaj, duhet shikuar se mbi cilën bazë ose me cilën praktikë është ndërtuar kryesia jonë e punës dhe ajo duhet t'i ketë konformitë asaj praktike. Gjithsesi, duhet të shikohet edhe Kushtetuta, nenet e Kushtetutës që në një formë ose tjetër ia lënë një vend Kryesisë së Kuvendit. Gjithnjë, nëse duhet vërtet Konferenca e kryetarëve të grupeve parlamentare të jetë më vendimmarrja në krijimin e rendit të ditës, duhet ta shikojmë se a e lehtësojmë a e vështirësojmë vendimmarrjen? Unë mendoj se e vështirësojmë, atëherë duhet ta ndjekim një praktikë, cila është praktika që nuk krijon kriza. Unë mendoj që nëse shkojmë te e dyta, te konferenca që është propozuar, duhet të shikojmë praktikën sllovene që konsideroj është prej praktikave më të mira që nuk e pengon punën e Kuvendit. Që atje përfaqësuesit e grupeve parlamentare janë fuqishëm sa është fuqia e grupit parlamentar dhe pastaj zgjedhjet me votime nëse vijnë, mund të jenë më të lehta, edhe pse në

Kuvendin tonë deri tani mund të them që ky është mandati i dytë që mbledhjet plenare janë përgatitur, as 5 mbledhje s'besoj që janë me numër që është bërë votimi, por janë organizuar me konsensus të plotë. Megjithatë, gjithnjë kur e hartojmë një dokument duhet të shikojmë se mos sanksionimi që bëhet e vështirëson vendimmarrjen dhe pastaj krijon jo harmoni, gjithnjë fjalën e kam që Kushtetuta, Rregullorja e Punës të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ta bëjë sa më funksionale dhe sa më demokratike punën e Kuvendit.

Edhe një çështje tjetër ndoshta që është mirë tani ta shikojmë, i kemi pyetjet parlamentare dhe deklarimet jashtë rendit të ditës. Mendimi im është që në deklarimet jashtë rendit të ditës më shumë të diskutohet për çështjet që mund të hynë në rend të ditës se sa për çështjet që nuk do të mund të hynin në rend të ditës. Në fund të fundit kjo është përgjegjësia e secilit deputetë veç e veç, por ndoshta duhet të shikuar mundësia për ta lehtësuar punën e seancave kur miratohen ligjet. E për me lehtësuar punën edhe me bë më funksionale punën e seancave, mbledhjeve plenare që miratohen ligjet, pyetjet parlamentare t'i lënë dy herë apo qoftë edhe njëherë në muaj, por nëse mbesin një herë në muaj atëherë koha të shtohet ose 1 herë në javë të mbetet e njëjta kohë që është, por disi me e shkëput këtu seanca nga seancat e punës se mendoj që edhe e lehtësojnë punën e seancave të punës dhe në anën tjetër unë konsideroj që praktikat parlamentare gjithnjë po flas sipas praktikave parlamentare kur bëhen pyetjet parlamentare dhe deklarimet jashtë rendit të ditës s'është e thënë të jetë prezenca e deputetëve tjerë që s'janë të interesuar të jenë pjesë e pyetjeve parlamentare dhe që s'janë të interesuar të deklarimeve jashtë rendit të ditës, se në fund të fundit edhe pyetjet parlamentare edhe deklarimet jashtë rendit të ditës më tepër është një komunikim i deputetëve dhe i Kuvendit si trup me opinionin se sa që është me punën tonë brendapërbrenda.

Unë po them nga ajo që e kam parë në praktikat parlamentare që kanë edhe 500, 400 ndoshta më tepër deputetë, kurse në pyetjet parlamentare, në deklarimet jashtë rendit të ditës, marrin pjesë një numër i kufizuar i deputetëve. Kështu mendoj e bëjmë më të lehtë dhe më funksionale punën e Kuvendit dhe po them edhe njëherë punën e komisionit, punën e grupeve parlamentare që t'i dorëzojmë amendamentet dhe vërtet është e pamundshme ta bëjmë një rregullore të punës të përkryer, por defektet që i kemi hasur gjatë këtyre viteve, është mirë t'i eliminojmë. Ju faleminderit për vëmendjen!

Pasi i kemi harxhuar diskutimet rreth kësaj çështje, prezentë kemi 96 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.

Me 92 votime “për”, asnjë “kundër”, një abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projekt Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kërkohet nga komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projekt Rregulloren dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime. Vazhdojmë, pikën e 10 të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullimin e tokës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për rregullimin e tokës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar këtë ligj dhe në bazë të punës që e kanë bërë edhe ekspertët që i kemi pasur në këtë projektligj, Abdullah Nishori dhe Flamur Hyseni, kanë propozuar dhe amendamentet të cilët ne i kemi prezantuar në miratim në këtë seancë megjithëse edhe pse kemi pasur disa vërejtje shqyrtimit të këtij ligji në raportin e grumbullimit vullnetar të tokës apo të detyrueshëm, ne me shumicë votash jemi pajtuar që të mbetet po ashtu forma vullnetare.

Mendoj që projektligji është mjaftë i mirë dhe duhet të harmonizohet me Ligjin për kadastrë, i cili është në fuqi tashmë me amendamentet sqaruese që do të jetë në shfrytëzim të fermerëve, të cilët janë të gatshëm të punojnë tokën bujqësore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tjetër kush s’e do fjalën.

Shkojmë në votimin e amandamenteve.

A ka “kundër” për amendamentin e parë?

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 2. A ka “kundër”? Abstenim?

S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 3

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 4

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 5

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 6

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 7

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 8

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 9

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 10,

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 11,

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 12,

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 13,

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 14,

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 15, “kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Tani miratojmë ligjin në tërësi dhe votojmë tash.

Prezent janë 83 deputetë. 31 deputetë “për”, “kundër” s’ka, abstenim s’ka. Kuvendi miratoi Ligjin për rregullimin e tokës.

Pika e fundit e rendit të ditës,

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për policinë

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për policinë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Siguri, deputetin Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni ka përfunduar amandamentimin duke e marrë parasysh edhe vërejtjet ose sugjerimet që kanë qenë prej deputetëve, po ashtu në bashkëpunim me ekspertët e Ministrisë së Punëve të Brendshme edhe pas amandamentimit që është bërë kemi 4 amandamente në të cilat do të ndalemi për t’i rishqyrtuar për arsye se në bashkëpunim, po ashtu me propozuesit e amendamenteve kemi konsultuar që të bëhen plotësimet, ndryshimet ose edhe fshirja e dy amendamenteve të cilat kur të vijnë në radhë do t’i kemi vërejtjet tona.

KRYETARI: Për cilat amendamente e ke fjalën, deputet?

AHMET ISUFI: ... 8, 36 dhe amendamenti 47, po ashtu edhe një amendament i fundit i propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që përkrahet nga Komisioni për Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

KRYETARI: Kur të vijmë aty... mirë, vazhdojmë. A ka diskutues tjetër për këtë çështje? Si duket s’ka vazhdojmë.

A “kundër” amendamentit të parë?

Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2, “kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 3, “kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 4, “kundër” s’ka.

Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 5, “kundër” s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 6, “kundër”? Regjia i numëroni! Shkojmë me elektronikë! Ju lutem, amendamentin e 6 shkojmë me elektronikë. Vazhdojmë!

Kush është “për”? amendamenti është i Komisionit funksional... hajt ta dëgjojmë arsyetimin nga këta që po thonë “kundër”. Kush e ka fjalën? Kryetari i Komisionit e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Është mirë që kur është dikush “kundër” për të kallëzuar pse është “kundër”, sepse po e dinë as për çka veç ju ka thënë dikush, por unë kisha thënë të votohet amendamenti, sepse në komision unanimisht e kemi përkrahur, me ekspertët e kemi bërë bashkarish, nuk bie në kundërshtim me interesat edhe me Ligjin për policinë edhe gjithçka është në rregull, prandaj nuk është mirë të ndërhyhet kështu.

KRYETARI: Regjia e qesim në votim.

Kush është “për” amendamentin 6 të Komisionit funksional?

Regjia, votojmë tash. 90 deputetë prezentë.

Me 47 vota “për”, 24 vota “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miraton amendamentin 6.

Amendamenti 7.

A ka “kundër”?

Abstenim?

S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 8.

“Kundër” s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 9.

“Kundër” s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet

Amendamenti 10.

“Kundër” s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet

Amendamenti 11.
“Kundër” s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
“Kundër” s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
“Kundër” s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 14.
“Kundër” s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 15.
“Kundër” s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 16.
“Kundër” s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 17.
“Kundër” s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 18.
“Kundër” s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 19.
“Kundër” s’ka.
Abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 20.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 21.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 22.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 23.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 24.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 25.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 26.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Propozim i Komisionit është që amendamenti 26 të fshihet, të mbetet si në projektligj.

KRYETARI: Faleminderit!

Fshihet amendamenti i 26...

Amendamenti 27.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 28.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 29.
“Kundër” s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 30.
“Kundër” s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 31.
“Kundër” s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 32.
“Kundër” s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 33
“Kundër” s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 34.
“Kundër” s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 35.
“Kundër” s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 36.
“Kundër” s'ka.

Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.
Është fjala për amendamentin e 36.

AHMET ISUFI: Në bazë të konsultimit në Komision kemi menduar se amendamenti i 36, ndryshohet në paragrafin 6 të nenit 38 dhe zëvendësohet si po citoj: “Zëvendës drejtorët e

përgjithshëm janë njëkohësisht udhëheqës të ndonjërit nga departamentet e fushave përkatëse në kuadër të Policisë së Kosovës”.

KRYETARI: Kush është “për” këtë amendament? Propozimi i kryetarit të Komisionit. Faleminderit! Kush është “kundër”? Nuk ka. Domethënë, miratohet propozimi i kryetarit të Komisionit për amendamentin e 36.

Në radhë është amendamenti 37.

A ka “kundër”?

Abstenim?

S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 38, urdhëro fjalën e ke deputet?

AHMET ISUFI: Amendamenti 38, po ashtu ndryshohet nën paragrafi 2 i paragrafit 1 të nenit 39, propozojmë me këtë formulim: “të jetë i diplomuar në një nga universitetet e akredituara ose të ketë diplomë të nostrifikuar”

KRYETARI: Kush është “për”? A ka “kundër”? Nuk ka. Miratohet. Urdhëro! 1 “kundër”, pra megjithatë miratohet amendamenti i 38 i kryetarit të Komisionit.

Arsyetim. Urdhëro! Jo s’është shkelje e Rregullores, mund të arsyetohet vota “për” ose “kundër”.

XHAVIT HALITI: Votova “kundër” për një arsye dhe qëndrim absolutisht mendoj të padrejtë që u bëhet kuadrove që janë shkolluar në Republikën e Shqipërisë. A ne kemi kuadro të shkolluar për policinë dhe të edukuar në shkollat besoj që janë më të mira se me nostrifikim që po quhen këtu dhe ata janë pa punë dhe askush nuk i qasë, prandaj po kërkoj që ata që kanë kryer Akademinë Policore në Shqipëri të vlerësohen mbi bazën e edukimit që e kanë marrë aty. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Megjithatë, mendoj që edhe ajo është përfshirë në këtë paragraf, por është votuar. Shkojmë!

Amendamenti 39

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 40.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 41.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 42.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 43.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Tani jemi te amendamenti 44.

Amendamenti 44 është i deputetit Rexhep Selimi, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Shkojmë në votim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, por deputeti Rexhep Selimi do ta paraqes arsyetimin.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në tërësi Ligji i Policisë së Kosovës është një ligj shumë i mirë i cili e plotëson ose e pasuron edhe më shumë krejt infrastrukturën ligjore që ka të bëjë me sigurinë në Kosovë edhe vërtet edhe grupi punues të cilin e kam udhëhequr dhe po ashtu edhe ekspertët të cilët kanë ndihmuar kanë bërë punën më të mirë të mundshme që ky ligj të futet në funksion të zhvillimit të policisë si organizata më kredibile në Kosovë, në fushën e sigurisë.

Po sidoqoftë, në përjashtim me nenin 43 i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me zgjedhjen si quhet përzgjedhja e veçantë e komandantëve të stacioneve të policisë, ne si Grup parlamentar mendojmë se me këtë nen, pavarësisht që është marrë nga plani i Ahtisarit për t’u futur në këtë ligj e dëmton drejtpërdrejt gjithë zinxhirin komandues dhe nuk e ndihmon zhvillimin e Policisë së Kosovës, për shkak se bëhet fjalë për përzgjedhjen e veçantë të komandantëve të stacioneve të policisë. Ndoshta, do të duhej të kishte përzgjedhje të veçantë të komandantëve të stacioneve të policisë, por në këtë rast përzgjedhjen e veçantë të komandantëve të stacioneve të policisë vetëm në komunat ku citoj, në komunat ku komuniteti serb është komuniteti më i madh etnik, komandantët e stacioneve policore dhe komandantët e nënstacioneve i emëron ministri i Punëve të Brendshme, me pjesëmarrjen në Kuvendin Komunal, gjë që i mohohet dhe gjë që nuk e kanë këtë të drejtë komunat me shumicë shqiptare dhe eventalisht me shumicë turke dhe boshnjake që mund të ketë më shumë në të ardhmen.

Pra, mendojmë që është nen diskriminues ndaj shumicës shqiptare dhe ndaj pakicave tjera në Kosovë jo serbe siç janë pakicës: turke, boshnjake etj dhe privilegjes vetëm ndaj

një etnie të caktuar asaj serbe në Kosovë. Ky nen me këtë qasje diskriminuese nuk i ndihmon as zhvillimit të policisë, e madje nuk i ndihmon as integritet të komunitetit serb, qoftë në polici, qoftë në gjithë shoqërinë e Kosovës, përkundrazi me këtë qasje ose me këtë qasje mendojmë se thellohen edhe më shumë ndarjet e komunitetit serb me komunitetet tjera në Kosovë dhe po ashtu i kontribuohet edhe ndarjes territoriale, administrative i mbështetur mbi baza etnike.

Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” në përputhje me konceptet dhe parimet politike që i ka e ka amendamentuar që të hiqet fare ky nen nga ligji, pra neni 43 të hiqet fare nga Ligji i Policisë së Kosovës, gjë që ju ftojmë ta mbështetni. Asnjë komunitet apo etni e caktuar nuk mund të jetë mbi komunitetet dhe etnitë e tjera, në këtë rast as komuniteti serb e të cilit deri më tani vetëm sa po i jepen privilegjet e radhës, i cili po ashtu shumica e këtij komuniteti po vazhdon akoma të jetë edhe për fat të keq të mbetet edhe kundërshtari më i madh edhe i Republikës edhe i sovranitetit të Kosovës.

Pra, në varësi nga votimi i këtij neni, ne do të votojmë “për”ligjin ose abstenojmë nëse rastësisht ky amendament nuk kalon, sepse Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” mendoj që nuk duhet të bëjë këso dallime dhe këso privilegje për një komunitet të caktuar apo kesi diskriminimi ndaj shumicës në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju e dëgjuat arsyetimin e propozuesit të amendamentit, megjithatë nuk e ka përkrahjen e Komisionit funksional. Mendoj që komisioni funksional s’ka ndryshuar mendim. Atëherë, e votojmë propozimin e deputetit Rexhep Selimi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Me 25 vota “për”, 54 vota “kundër”, 8 abstenime, nuk miratohet amendamenti i 44, i propozuar nga deputeti Rexhep Selimi.

Kemi amendamentin e 45.

A ka “kundër”?

A ka abstenim?

Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 46.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 47, Ahmet Isufi e ka fjalën, kryetar i Komisionit.

AHMET ISUFI: Amendamenti i 47, propozohet që të fshihet në tërësi, të mbetet ashtu siç është në tekstin e projektligjit.

KRYETARI: Deputetë, a jeni të mendimit që të fshihet amendamenti i propozuar nga kryetari i Komisionit, deputeti Ahmet Isufi? Është amendamenti i 47. Jeni “për”? Kush është “për” fshirjen e këtij? Mirë! Faleminderit!

Do të thotë, Kuvendi miraton që të fshihet amendamenti i 47.

Votojmë tash amendamentin e 48.

A ka “kundër”?

Abstenim?

S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 49.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 50.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 51.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 52.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Dhe, amendamenti i fundit është i 53, i propozuar nga Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa. Arsyetimin do ta paraqesë deputetja, kryetarja e Komisionit, Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar pjesën që i takon Komisionit për Buxhet, domethënë, koston buxhetore të këtij projektligji dhe ka ardhur në përfundim që tek neni 52 paragrafi 1, fjalët “të miratuara” nga Kuvendi duhet të hiqen dhe të zëvendësohen me fjalët “të miratuar në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë”. Arsyeja e Komisionit ka qenë se ndryshimi i propozuar ka për qëllim që të shmangen paqartësitë lidhur me përgatitjen dhe miratimin e buxhetit të Policisë, i cili duhet të jetë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të miratohet pra në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, për arsye se ka mundësi që të keqkuptohet, sepse aty shkruan që buxheti miratohet në kuadër të Ministrisë dhe po ashtu miratohet nga Kuvendi.

Në Ligjin për buxhet ne miratojmë buxhetin e të gjitha ministrive, kurse policia është si program i veçantë në kuadër të Ministrisë dhe miratohet bashkarish me buxhetin e Ministrisë. Domethënë, është vetëm të rregullohet sipas ligjit në fuqi dhe për t'u rregulluar sipas ligjit në fuqi duhet të shënohet sipas Ligjit për menaxhim të financave publike dhe përgjegjësi. Edhe kryetari i Komisionit tha që është përkrahur nga Komisioni funksional, prandaj rekomandoj gjithë deputetët që ta përkrahin.

KRYETARI: E dëgjuat arsyetimin, a ka “kundër” amendamentit 53? “Kundër” s’ka. Abstenim s’ka.
Pra, miratohet.

Tani miratojmë ligjin në tërësi. Në sallë janë prezentë 95 deputetë.
Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.

Me 80 vota “për” 2 vota “kundër”, 8 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për Policinë.

Të nderuar deputetë,
Këtu edhe kemi përfunduar mbledhjen e sotshme plenare.
Mirupafshim, më 26 janar në mbledhjen e re plenare!

Përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë